



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:088714

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06010792

PKR.nr. 170/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Krime të Rënda, Trupi gjykues në përbërje prej Kryetarit të trupit gjykues Agim Kuçi dhe anëtarëve të trupit gjykues – gjyqtarëve profesional Ngadhnjim Arni dhe Medije Bytyçi, me pjesëmarrjen e bashkëpuntores profesionale Arlinda Rexhaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E.S, për shkak të veprës penale Shtytje për të kryer Vrasje të Rëndë në kundërshtim me nenin 147 (3) dhe (9) lidhur me nenin 25 të Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës (Kodi R.2003/25), tutje (KPK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me shenjë PPS.nr.467/2009, të ndryshuar më datën 27.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur me datë 29.04.2024, në prezencën e Prokurorit Special Burim Qerkini, të dëmtuarit SH.R, të akuzuarit E.S, me mbrojtësen e tij me autorizim Avokatën Kosovare Kelmendi, me datë 03.05.2024 publikisht shpalli, ndërsa pas kërkesës për vazhdimin e afatit për përpilimin e aktgjykimit, në afatin e lejuar ligjor, më datë 02.08.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.S, nga i ati H dhe e ëma M, e gjinisë A, i lindur më datë //, me numër personal // me adresë të banimit , Rr”/” ne P, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Nga incidentet që kishin datuar nga viti 2000-2001, kur tani i ndjeri T.R kishte filluar punën si Zyrtar i Policisë së Kosovës, me ç’ rast ishte kërcënuar nga i akuzuari E.S me granat dore, e pastaj duke vazhduar me përcjellje te vazhdueshme për të diktuar primatin nga njerëz të afërm me E.S dhe vet i akuzuari E.S, ku këta persona të afërm vepronin sipas kërkesave te tij, duke e përndjekur e kërcënuar në vazhdimësi tani të ndjerin, duke ja shfryer fillimisht gomat e veturës e pastaj duke i shpërthyer ato. Rivaliteti -Konflikti mes T.R dhe E.S, merr një hov tjetër pasi që

tani i ndjeri kishte marr në mbrojtje A.I pikërisht nga E.S, e ku i ndjeri dhe e lartcekura kishin filluar një lidhje dashurie në periudhën e vitit 2005. Nga kjo kohë motivi për hakmarrje, kërcënimet, sulmet, e përcjelljet ndaj T.R ishin të një pas njëshme ku vetëm në disa raste tani të konstatuara ai ishte përcjellë nga personat e afërm të të akuzuarit, si dhe vetë i akuzuari, fillimisht në një rast në G, pastaj kur i ndjeri ishte me familjaret e tij në V, po ashtu edhe në një rast tek // në P, ku në gjitha këto raste ishte përcjellë e kërcënuar me vetura të blinduara e me skuter. Përgjatë përndjekjes së të ndjerit në mënyrë të vazhdueshme, të njëjtit i ishte djegur edhe vetura e tij “” e të gjitha këto kishin ndodhur nën kërkesat e tani të akuzuarit E.S.

E.S me persona të afërm të tij, në fund të vitit 2005 kishte pasur një konflikt tjetër të armatosur ndaj tani të ndjerit T.R me shokë, ku kishte pasur edhe persona të plagosur e të rrezikuar (me ç’ rast E.S kishte akuzuar T.R lidhur me rrahjen që i ishte bërë duke mos ja falur të njëjtit – duke kërkuar hakmarrjen, Rasti “S.Casino”). Tutje për gjatë vitit 2006 (Rasti Ferizajit), E.S kishte pasur një konflikt ku ishte rrahur nga zyrtar policor e që përsëri i njëjti drejtonte gishtin kah T.R, me ç’ rast, për të gjitha rastet e cekura me radhë, i akuzuari kërkonte hakmarrjen.

Rreth dy javë para vrasjes së tani të ndjerit, nën kërkesën e E.S, ishte organizuar atentat ndaj tani të ndjerit, ku në fshatin S, i ishte organizuar pritë duke u munduar të ja rrokullisin veturën të cilën aj e ngiste me qëllim që të njëjtin ta privojnë nga jeta, me ç’ rast konstatohet se E.S kishte vendosur tani ta privoj nga jeta T.R.

Tri ditë para vrasjes, T, ishte nën përcjellje të A.B, I.A e Rr.A ku ky i fundit i raportonte E.S. Përfundimisht rreth dy javë pas atentatit të lartcekur, dhe tri ditë pas përcjelljes së konfirmuar, me datën 30 gusht 2007 ishte organizuar në detale vrasja e T.R ku njerëzit e afërm të E.S të cilët ishin prapa gjate çdo përcjellje e kërcënimimi ndaj T, e që ishin Rr.A (R), I.A (L), ishin takuar me tani dorasin A.B, po ashtu person i afërm dhe punëtorë i E.S, ku ishin takuar në kafe “Bar S” dhe pasi që E.S i kishte ftuar në takim të lartcekurit, me dashje që përfundimisht ta privonte nga jeta tani të ndjerin T.R për motive të ulëta e hakmarrje të pa skrupullt, nën ndikimin e tij e kishte shtytur A.B ta privonte nga jeta tani të ndjerin, e ku A.B kishte dalur nga Kafe “-” i armatosur i shoqëruar me Rr.A, I.A, të cilët kishin lënë pastaj në një kafene afër kafenesë “” ku pasi që paraprakisht T, ishte përcjellë, A.B e kishte pritur rreth një orë e dyzet minuta të ndjerin, me ç’ rast në mënyrë tinxare nga prapa kishte shtënë në të njëmbëdhjetë herë në tri rafalë, duke e godit me dy predha në shpinë dhe një predhë në kofshën e djathtë, me armën e tij të tipit “Glock” të kalibrit 9x19, duke qar kështu përfundimisht në arritjen e qëllimit nga E.S, e që ishte privimi nga jeta i T.R, për motive të tij hakmarrëse.

Me këto veprime, i akuzuari i lartcekur ka kryer veprën penale Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje të Rëndë në kundërshtim me nenin 147 (3) dhe (9) lidhur me nenin 25 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Andaj gjykata, në bazë dispozitave të neneve 3, 6, 11, 34, 36, 38, 64, 65, 73 të KPK-së dhe neneve 360 dhe 364 dhe 365 të KPPRK-së, **të njëjtin e gjykon me:**

DËNIM ME BURGIM

I.Ashtu që të akuzuarin E.S, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **25 (njëzet e pesë) vite** burgim, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.Koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 03.01.2014 deri më datën 15.10.2021, dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 15.10.2021 deri më datën 09.02.2024, si dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 23.02.2024 deri më datë 03.05.2024 do t’i llogariten në dënimin e lartcekur.

III. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **150€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **50.00€ (pesëdhjetë euro)**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për shpenzimet tjera eventuale, gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm, pas përllogaritjeve të kësaj gjykate.

IV.I dëmtuari SH.R, lidhur me kërkesën pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës dhe pretendimet e palëve në procedurë

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me numër PPS.nr.467/2009, të datën 24.04.2014, të ndryshuar me datën 27.04.2016, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.S, për shkak të veprës penale Shtytja në kryerjen e veprës penale “Vrasja e rëndë” në kundërshtim me nenin 24 dhe 147(3) dhe (9) të KPK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, në këtë çështje penale, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.467/2009, të datës 24.04.2014, të ndryshuar me datën 27.04.2016, ka nxjerrë aktgjykim dënues për të akuzuarin E.S, PKR.nr.218/14, të datës 17.05.2016, ashtu që të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale “Shtytja për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë” nga neni 24 dhe neni 147 (3) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 37 (tridhjetë e shtatë) vitesh, ndërsa për veprën penale “Detyrimi”, nga neni 267 (1) të Kodit Penal të Kosovës, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh, duke i zbatuar dispozitat për shqiptimin e dënimit unik, të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 37 (tridhjetë e shtatë) vite.

Tutje mbrojtësit e të akuzuarit E.S, Avokatja Kosovare Kelmendi dhe Avokati Bostian Penko, kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë PKR.nr.218/14 të datës 17.05.2016, kanë parashtruar ankesë më datën 08.12.2016 dhe 09.12.2016 për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Kodit Penal dhe vendimit mbi dënimin, ndërsa Gjykata e Apelit duke marrë parasysh ankesën e mbrojtësve të të akuzuarit E.S ka nxjerrë Aktgjykimin PAKR.nr.1/2017 të datës 19.10.2017 me anë të së cilës ka aprovuar pjesërisht ankesat e mbrojtësve, ka anuluar dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim, ashtu që për veprën penale “Detyrimi” sipas paragrafit (1) të nenit 267 të KPPK-së (pika II) ndryshohet ashtu që i akuzuari E.S është liruar nga akuza.

Tutje Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda pasi që është kthyer çështja në rigjykim ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësorë dhe ka nxjerrë Aktgjykimin me shenjë PKR.nr.347/17 të datës 16.09.2019 ka shpallur të akuzuarin E.S fajtor dhe të njëjtën për veprën penale Shtytja në kryerjen e veprës penale Vrasje të Rëndë në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPK-së e ka dënuar në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vite burgim. Mbrojtësit e të akuzuarit E.S, Avokatja Kosovare Kelmendi si dhe Avokati Bostjan Penko, kanë ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, ku Gjykata e Apelit ka marr Aktvendimin me shenjë APS.nr.10/2020 të datës 06.03.2020 përmes të cilës ka aprovuar kërkesat e mbrojtësve të të akuzuarit E.S dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të

Rënda me shenjë PKR.nr.347/17 të datës 16.09.2019 e ka anuluar dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim, ku rekomandimet e kësaj gjykate me rastin e kthimit të çështjes në rigjykim kanë qenë që në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të qartësuar dhe theksuar saktë se cilat janë veprimet inkriminuese që i akuzuari i ka kryer apo nuk i ka kryer. Duhet të rivlerësohet fakti i kontrollit në lokalitetin “//” në përputhje me nenin 246 të KPP-së, të rivlerësohet me saktësi dhe të jepen arsyet e kjarra dhe të plota nëse provat e siguruar për trekëndëzimin e numrave të telefonave përkatës ishin të ruajtura me vendim gjyqësorë në mënyrë ligjore, duke përfshirë bazën ligjore për ruajtjen e tyre, si dhe dëgjimi i dëshmitarit A.C si dhe Xh.B.

Pas kthimit të çështjes në rigjykim, ka vazhduar gjykimi për të akuzuarin E.S ku seanca e shqyrtimit gjyqësorë është caktuar më datën 12.01.2021 pranë një trupi të ri gjykues.

Shqyrtimi gjyqësor

Siç është specifikuar më sipër, gjykata pasi që çështja është kthyer në rigjykim kishte caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën prezent ishin prokurori special Haki Gecaj, i dëmtuari – Sh.R, i akuzuari E.S me mbrojtësen e tij sipas autorizimit Avokaten Kosovare Kelmendi.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata i kishte dhënë mundësi përsëri të akuzuarit të deklarohet lidhur me fajësinë ose pa-fajësinë e tij në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa i akuzuari ishte deklaruar i pa-fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pasi që i akuzuari ishte deklaruar i pa-fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar, gjykata tutje kishte proceduar me fjalën hyrëse.

Fjala hyrëse e palëve

Prokurori special, në fjalën hyrëse ishte deklaruar si vijon: unë do t’i përmbahem në tërësi fjalës hyrëse të dhënë pranë trupit të mëparshëm gjykues në shqyrtim gjyqësorë si në procesverbalin e datës 04.09.2019 pasi që është i bindur se është në shkresat e lëndës dhe nuk ka asnjë ndryshim që atëherë. Ndërsa në fjalën hyrëse pranë trupit gjykues të mëparshëm i njëjti kishte deklaruar se i njëjti është ngarkuar për të përfaqësuar këtë aktakuzë dhe në bazë të së cilës ky shqyrtim gjyqësorë do të mbahet vetëm për pikën I të dispozitivit të aktakuzës së ndryshuar. Tutje ka shtuar se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, tutje (PSRK-ja) e ka akuzuar sipas kësaj aktakuze tani të akuzuarin E.S, për shkak të kryerjes së veprës penale të nxitjes. PSRK-ja ka zbatuar hetimet në këtë çështje penale kundër të tani të akuzuarit dhe nga provat e mbledhura gjatë hetimeve siç janë ato me dëgjimin e dëshmitarëve, të dëmtuarve, të cilët para trupit gjykues do të dëshmojnë se rasti i vrasjes i të ndjerit T.R nuk ka filluar më datën 30.08.2007 kur ka ndodhur vrasja, por ky rast ka filluar shumë më herët, ku problemet në mes tani të akuzuarit E dhe grupit të tij me të ndjerin T.R kanë filluar qysh herët në vitin 2003-2004, pastaj në vitin 2005 në një rast ku ka ndodhur në “//”, ku ka pas përleshja e përdorim të armëve dhe plagosje. Duke shtuar se dëshmitë të cilat do të dëgjohen në këtë shqyrtim do të vërtetojnë se i akuzuari E.S është ai i cili e ka planifikuar, është ai i cili ka koordinuar, ai i cili e nxit të dënuarin A.B në kryerjen e veprës së vrasjes të datës 30.08.2007. I njëjti ka shtuar se është i sigurt se pas administrimit të provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarëve, të cilët do të dëshmojnë për këtë konflikt të mëhershëm dhe për problemet që i ka pas T.R me grupin S dhe vet E.S me këtë do të vërtetohet se E.S e ka nxit të dënuarin A.B në kryerjen e veprës penale, i njëjti beson se E.S në fund të këtij shqyrtimi do të shpallet fajtor dhe do të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari Sh.R në fjalën e tij hyrëse ishte deklaruar si vijon: e përkrahi plotësisht prokurorin special, e kam të qartë edhe më herët se dëshmitë të cilat i kemi dhënë më herët, ato ende vlejné, ndërsa nuk heq dorë nga asnjë e drejtë e paraparë me ligj.

Avokatja Kosovare Kelmendi në fjalën e saj hyrëse ishte deklaruar si vijon: meqenëse jeni trup i ri gjykues në këtë çështje penale, përkatësisht jeni trupi i tretë gjykues në shkallë të parë, i cili do të trajtoni këtë çështje penale, përveç deklarimit të saj ka deklaruar se mbetet pranë fjalës hyrëse të datës 04.09.2018 ku ndër të tjera ka deklaruar se unë do të jem e shkurt, do të përqëndrohem në çështje të rëndësishme për faktin se ne këtu jemi të gjithë profesionit, se para veti kemi një vendim të gjykatës së instancës më të lartë e cila për të mos thënë vetëm në mes rreshtash por edhe qartazi na bën me dije se kjo aktakuzë nuk do të duhej të kishte ardhur fare në këtë fazë, në qoftë se shikohet aktakuza trupi gjykues do të ballafaqohet qysh në start me problemin se si është përshkruar vepra penale në këtë aktakuzë, ku përmendet kryesi i vrasjes së tani të ndjerit T.R i dënuari A.B si bashkëkryes me I.A etj, por pyetja të cilën mbrojtja do të ngre gjatë këtij shqyrtimi është Nxitja për faktin se këtë çështje penale i akuzuari akuzohet për nxitje, ndërsa në tjetrën për vrasjes në bashkëkryerje. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ju do të bindeni si trup gjykues pas administrimit të të gjitha provave se në aktakuzë, por edhe me provat të cilat do të administrohen nuk do të dihet nuk do të vërtetohet fare përmbajta çështja apo forma e mënyrës së nxitjes e të dënuarit A.B nga ana e të akuzuarit E.S, Kjo për faktin se nuk ekziston fillimisht një përshkrim ligjor dhe faktik i nxitjes në aktakuzën që e kemi para nesh, e aq me tepër që kjo nuk do të gjejë prova të cilat do të argumentonin përtej dyshimit të bazuar se ka ekzistuar fare një nxitje. Mbrojtja do të provoj se nuk ka pas nxitje nga ana e të mbrojturit tim E.S, se veprimet apo mosveprimet e të mbrojturit tim nuk plotësojnë përkufizimin ligjor të nxitjes së urrejtjes e cila janë përmend në aktakuzë. Ne presim që provat do të dëshmojnë se i mbrojturi im nuk ka kryer veprën penale të supozuar me të cilën akuzohet ashtu si në gjykimin e parë, që u dëshmuua edhe për dy pika te tjera. Trupi gjykues do të bindet jashtë çdo dyshimi se kjo aktakuzë është e bazuar në dyshime, supozime, thashetheme, opinione, spekulime, dhe përfundime të cilat janë pa bazuara. Dhe për fund dua t'ia bëjë me dije trupit gjykues se pse nuk do të mund të vërtetohet vepra penale e Nxitjes, sepse aktakuza si motiv të urrejtjes së të akuzuarit E.S ndaj te ndjerit T.R merr për bazë pikën II të aktakuzës e cila ka ekzistuar më herët që është vepra penale e Detyrimit ndaj A.I, e kinse marrja në mbrojtje e të njëjtës nga ana e T.R. Vendimi i Gjykatës së Apelit thotë se vepra penale detyrimit nuk ka ekzistuar, atëherë cili është motivi, cila është arsyeja, mbi të cilën prokuroria ka ngritur aktakuzën për të ekzistuar vepra penale nxitjes.

Mbrojtja është e bindur se pas analizës së vendimit të Gjykatës së Apelit, vërejtjeve, saktësisht të precizuara dhe administrimit të provave që i sugjeron instanca e dytë ky shqyrtim do të përfundoj me një aktgjykim lirues për të mbrojturin e saj. Ndërsa në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë ka shtuar edhe disa pretendime të mbrojtjes në fjalën hyrëse. Ku para se të fillojmë me procedurën e të provuarit në këtë çështje penale, do t'iu kisha lutur shumë sinqerisht, meqenëse për tetë vite me radhë është e kyçur në këtë rast, që të apstrahoni tërësisht emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit këtu dhe të koncentrohëni ekskluzivisht në veprimet apo mosveprimet e tij, sikurse për një NN person, kjo për faktin se ashtu siç e ka cekur edhe më herët është e bindur se do të vërejnë se në këtë çështje penale është gjykuar vetëm personaliteti dhe epitetet e m veshura ndaj të akuzuarit, sepse për ndryshe, sikurse të ekzistonin prova për një veprim të tij inkriminues, gjithsesi se nuk mund të kthehej kjo lëndë dy-herë në rigjykim. Mbrojtja fuqimisht beson se ju keni analizuar vendimet, dy numerikisht të Gjykatës së Apelit dhe vërejtjet dhe sugjerimet e dy kolegjeve të Gjykatës së Apelit, të cilat vendime urdhërojnë, jo vetëm sugjerojnë, edhe Gjykatën e Shkallës së I-rë njëkohësisht edhe Prokurorinë që të konkretizojnë veprimet e të akuzuarit në drejtim të veprës penale të shtytjes për vrasje të rëndë. Tutje ka shtuar se Prokuroria nuk ka ndër marrë asnjë veprim të modifikimit të aktakuzës, respektivisht, të konkretizimit të vendimit të tij të datës 19.10.2017, ka konstatuar me të drejtë, se dikush “nuk mund të akuzohet dhe të

dënohet për shtytje për kryerjen e një vrasje, pa bërë ndonjë përshkrim të duhur për atë se cilat akte, respektivisht cilat veprime ka kryer ky person, i caktuar për të shtytur ekzekutuesin fizik që të kryej vepër penale”. E njëjta ka shtuar se Kolegji i Apelit, ka udhëzuar gjykatën e shkallës së I-rë, për tri çështje kryesore në këtë çështje penale, e që kanë të bëjnë me prova materiale, në fakt për ligjshmërinë e këtyre provave materiale. Pra duke pasur parasysh dëshmitarët në këtë çështje penale, janë dëgjuar diku përafërsisht që të gjithë, diku nga 5-6 në të gjitha fazat e procedurës. Nuk presim se çka do të ndryshoj në deklaratimet e tyre, por detyrë e juaja është që në veçanti të shqyrtoni vërtetësinë e deklaratës së dëshmitarit D2 dhe vlerën provuese të kësaj deklarate, 2) ligjshmërinë e bastisjes së lokalit “//” dhe 3) pranueshmërinë dhe vlerën provuese të dokumenteve të PTK-së për faktin se ju do të shihni gjatë procedurës së provave, se prokuroria në mungesë të provave është munduar që me prova rrethore, gjithsesi të nxjerra në mënyrë të mundur ta mbaj aktakuzën ndaj të akuzuarit në këmbë, edhe pse kjo aktakuzë që nga fillimi qëndron në këmbë të qelqit. Prandaj e bindur sikurse për tetë vite me radhë, se nuk ekziston asnjë provë as direkte, as rrethore e cila do të vërteton aktakuzën ndaj të akuzuarit, do ta keni fuqinë ligjore dhe guximin profesional, që përfundimisht bazuar në vërejtjet dhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit të akuzuarin ta lironi nga akuza.

Procedimi i provave personale

Gjykata në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 04.02.2021, kishte dëgjuar të dëmtuarin në cilësi të dëshmitarit Sh.R si dhe dëshmitarin V.R.

1.Dëshmia e dëshmitarit Sh.R

I njëjti përgjatë deklaratës së tij të dhënë në prokurori më datën 09.11.2007 si dhe në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura pranë kësaj gjykate më datat 05.11.2014, 26.11.2018, 04.02.2021 ndër të tjera ka theksuar se T është punësuar në Policinë e Kosovës në fund vitin 1999 apo në fillim të vitit 2000. Ai e kishte njoftuar për shqetësimet dhe problemet që kishte pasur me të akuzuarin E.S dhe shokët e tij. Kishte treguar se gjatë vitit 2000, derisa ishte në detyrë me një koleg ndërkombëtar nga Pakistani, në afërsi të shkollës së mesme, në afërsi të rrethit, kishte ndalur një veturë të cilën e ngiste i akuzuari E.S i cili nga xhepi i tij kishte nxjerrë një granatë dore me kërcënimin për ta aktivizuar, dhe befasisht kishte ikur nga vendi i ngjarjes, po ashtu i njëjti kishte përmendur edhe herën kur T ishte përcjellë nga E.S dhe banda e tij me tre vetura pranë gjimnazit në rrugën për G/ ku në veturë kanë qenë T, dhe A, dhe A,e kishte vërejtur se T, ishte shumë i shqetësuar dhe spo e mbante armën gjatë gjithë kohës dhe në momentin kur ajo e ktheu kohën për të parë prapa ajo kishte vërejtur se ata po përcilleshin nga banda e tij dhe në atë moment kanë dalë nga rruga, kanë hyrë në një rrugë brenda një oborri privat dhe në këtë mënyrë ata e kanë shmang incidentin duke theksuar se për këtë rast i ka treguar T,, po ashtu i njëjti e ka përmendur edhe rastin kur T,t i është vënë zjarri në veturën e tij të tipit "L,R". Ndërsa njëri nga problemet që kishte eskaluar ka qenë rasti në //, ku i akuzuari me bandën e tij e kishte sulmuar, dhe nga kjo ngjarje ishte plagosur kolegu dhe shoku i T, A.S, i cili ishte shëruar në Zagreb dhe pas kësaj ngjarje kishte ikur në Amerikë. Përpos ngjarjes në //, T vazhdimisht e kishin përcjellë edhe me vetura e skuter, për të cilat ngjarje i kishte rrëfyer T. Përveç punës zyrtare, T kish pasur edhe një fermë të dhive në fshat, 120 krerë dhe janë marrë me prodhimin e djathit të cilin kryesisht e kanë dërguar në Hotel G” për ta shitur. Rast tjetër për të cilin T. i kishte treguar kishte qenë kur persona të panjohur, dy javë para ngjarjes kritike, i kishin bllokuar rrugën në fshat i cili rast është raportuar në polici me dyshimin se prapa kësaj ngjarje fshihej i akuzuari dhe grupi i tij, ndërsa kur me A kishte qenë në rrugë kishte pasur gurë të mëdhenj i cili rast kishte ndodhur menjëherë pas rastit në //. Prej djalit kishte dëgjuar për pjesëtarët e kësaj bande si: R – Rr.A, I.A, N.S, ku i njëjti i është kërcënuar disa herë me fjalët “ja ti ja na se Kosova është shumë e vogël” kjo kishte

ndodhur para Hotel "T" në P. Personin me emrin A.B, nuk e kishte përmendur asnjëherë i biri i tij T.

Pas deklaratës së të dëmtuarit, në cilësi të dëshmitarit Sh.R, gjykata tutje kishte vazhduar me dëgjimin e dëshmitarit V.R

2.Dëshmia e dëshmitarit V.R

I njëjti përgjatë deklaratës së tij në prokurori të dhënë më datën 25.10.2007, si dhe në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura pranë kësaj gjykate më datat 06.11.2014, 26.11.2018 si dhe më datën 29.03.2021 ndër të tjera kishte theksuar se vëllai i tij T.R që kur kishte filluar detyrën si polic, T kishte pasur probleme me tani të akuzuarin E.S edhe para ngjarjes në //, dhe këto probleme kanë qenë lidhur me punën e tij. Përveç këtij rasti, i ndjeri ka pasur edhe probleme tjera të akuzuarin dhe njerëzit e tij. Fillimisht i njëjti ka treguar për rastin që ka ndodhur tek shkolla e mjekësisë ku në ditët e para të punës deri sa ka qenë në detyrë tek rrethi, afër shkollës së mjekësisë e ka ndalur një veturë siç e ka shpjeguar në të cilën veturë kanë qenë vëllezërit Edhe N.S, ku të njëjtit posa kanë ndalur veturën E ka nxjerrë një granat dore dhe pas kërcënimit, me të shpejtë është larguar nga vendi i ngjarjes. Po ashtu rasti tjetër që i kujtohet ka qenë edhe ky, T, nëna dhe vajza e tij duke shkuar me xhip nga Prishtina në fshatin S, kur kanë dalur në Veterrik kanë vërejtur dy persona që po i përcillni, dhe T i ka thënë se këta persona që po na përcjellin janë "R" dhe "L", ku së bashku me E në xhip ka pasur edhe persona të tjerë por i njëjti ka njohur vetëm E. Para rastit të S.Casinos i njëjti ka shtuar se T. i është djegur edhe vetura e tipit "L. D" ku T i ka thënë se njerëzit e E.S e kanë djegur veturën dhe se i njëjti kishte dhënë edhe emrat e tyre në polici. Gjithashtu i njëjti ka theksuar se ka pasur përcjellje të vazhdueshme nga i njëjti grup, i është djegur vetura dhe më vonë i është bllokuar rruga në fshatin S,, raste të cilat ishin raportuar në polici. Bashkë me të kishte qenë kur disa herë janë përcjellë nga grupi në fjalë. Rast specifik ku ishte prezent edhe vetë ka qenë kur duke shkuar në fshat, rrugës për V, përpjetë i kanë përcjellë prapa me vetura dhe skutera dhe pasi që kishte qenë ulur në anën e djathtë, në ulësen e pasagjerit, kishte identifikuar personin me pseudonimin "Rr" Rr.A, ndërsa tjetri kishte qenë vëllai i tij "L" emrin e të cilit nuk e dinte. Derisa A, së bashku me T, me veturën xhip ishin duke shkuar rrugës për "G" te kisha katolike, grupi S, e kishin përcjellë dy vetura, njëri xhip i gjelbër dhe tjetra veturë e vogël. Pjesë e këtij grupi kanë qenë Rr (Rr.A), L (I.A) dhe vëllai i tij. Nuk ka qenë në dijeni dhe nuk i ka njohur por derisa ishte në veturë, i ndjeri i kishte thënë se "ky po më përcjellë" Në lokalit /// kishin shkuar shpesh me të ndjerin vëllain e tij. Ka qenë në dijeni lidhur me raportet që i ndjeri vëllai i tij T. kishte me A.I. Ditën kritike, me datën 30.08.2007, në parkingun e Hotel "G" kishte parë Rr.A duke qëndruar jashtë Hotelit duke i shikuar ata direkt derisa ishte duke biseduar në telefon. T e kishte marrë dhe e kishte dërguar në punë. Më vonë, përafërsisht pas 30 minutave kishte pranuar një thirrje telefonike nga një shok i tij i cili i kishte treguar se T, ishte plagosur ku më vonë kishte kuptuar se kishte vdekur. I ndjeri T, asnjëherë nuk e kishte përmendur emrin e A.B. Sa i përket A.B i njëjti ka theksuar se para ndodhjes së vrasjes si fytyrë e ka parë disa herë para lokalit "S" në lagjen D, duke ndenjur së bashku me E, vëllain e E dhe me "L" dhe "Rr", po ashtu lidhur me A.B i njëjti ka shtuar se deri në vrasjen e T asnjëherë ska dëgjuar për emrin e A.B dhe se T se ka përmend asnjëherë që ka pas ndonjë problem me të.

Në seancën e radhës në kuadër të vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor është proceduar me dëshminë e dëshmitarit G.H si dhe B.Sh.

3.Dëshmia e dëshmitarit G.H

I njëjti përgjatë deklaratës së tij të dhënë në prokurori më datën 27.09.2007 si dhe në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura pranë kësaj gjykate më datat 20.11.2014, 17.10.2018, 28.04.2021 ndër të tjera ka theksuar se T.R e kishte njohur që nga shkolla e mesme dhe kishte pasur raporte të afërta

me të njëjtin. T. shumë shpesh kishte shkuar në lokalin e tij me të cilin kishin biseduar për shumë çështje pasi që edhe ishin shokë. I njëjti ka theksuar se për problemet e T me E.S i ka treguar vet T, fillimisht për rastin në vitin 2001 kur i ka ndaluar vëllezërit E dhe N.A të cilët kanë qenë duke e drejtuar veturë, ndërsa T. ka qenë në cilësinë e policit ku të njëjtit e kanë provokuar T, dhe kanë ikur, po ashtu i njëjti ka treguar edhe për rastin kur T i'a kanë shpërthyer gomat e makinës tek Menza e Studentëve, e më pastaj edhe për incidentin e // ku në këtë rast kanë pësuar lëndime si A.S, A e që sipas rrëfimit të T. deri tek incidenti kanë ardhur për shkak të provokimeve nga ana e E.S dhe grupit të tij, e po ashtu edhe lidhur me rastin kur T. ishte duke udhëtuar në fshatin e tij S, ku rruga i është bllokuar me gurë dhe guraleca dhe se T i ka thënë të njëjtit se ai gjithmonë kishte dyshimet në E.S. Sa i përket ditës kritike të 30 Gushtit 2007, e kujton mirë, atë ditë kishte takuar shokun e tij T, dhe i kujtohej se dy herë kishin dalë me të në marketin e afërt për të blerë akullore, dhe pasi kishte dalë ta përcjellë të njëjtin, derisa ishte duke u kthyer në lokal kishte dëgjuar disa të shtëna rafal, dhe se dikush nga stafi kishte bërtitur “T”, dhe kur kishte dalë jashtë lokalit kishte parë një person i cili mbante kapelë në kokë dhe duke ikur në drejtim të tunelit të cilin nuk kishte mundur ta identifikojë. T. e kishte parë të gjunjësuar, dhe me stafin e tij dhe disa klient T. e kishin dërguar në emergjencë të cilin e kishin marrë në përkujdesje dhe trajtim stafi mjekësor, dhe pas 10 minutave kishin kuptuar se T. kishte vdekur. Lidhur me personin e quajtur A.B, nuk kishte dëgjuar nga T ta ketë përmendur më parë. T. vitin e fundit ka qenë i shqetësuar për shkak të problemeve që kishte me të akuzuarin, këtë e deklaroi sepse ashtu i kishte thënë vetë i ndjeri, i cili kishte treguar për shumë probleme duke përmendur të akuzuarin, vëllain e tij, shpuarjen e gomave të veturës së tij, problemi në “S.Casino” e shumë tjera.

4.Dëshmia e dëshmitarit B.Sh

I njëjti përgjatë shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura pranë kësaj gjykate më datat 22.01.2015, 26.11.2018, 28.04.2021 ndër të tjera theksuar se në polici kishte filluar të punojë nga datën 12 shkurt 2000, dhe kishte shërbyer në stacionin policor nr.2. T.R e kishte njohur në kursin për trajnime të mbrojtjes së afërt, në vitin 2001 ose 2002. T. i kishte treguar se kishte pasur probleme me E.S, lidhur me detyrën zyrtare. Viti nuk i kujtohej, kur T me një ndërkombëtar, kishin tentuar të ndalojnë me veturë E.S, bazuar në atë se çfarë i kishte thënë T, E kishte pasur një granatë dore dhe se i kishte kërcënuar që mos ta ndalojnë, rastin tjetër që ka njohuri që i ka treguar personalisht T lidhur me problemet me E.S ka qenë fillimisht rasti që T i ishte djegur vetura e tij e si rast ishte hetuar nga njësia në të cilën ka punuar i njëjti dhe jo personalisht nga ai, i njëjti ka specifikuar se si të dyshuar ishin E.S, A.B dhe A.C, ndërsa rasti tjetër kishte të bënte me pritën në fshatin S” ku T, i kishte treguar të njëjtit që diku në mes të rrugës kryesore dhe fshatit S dikush e zuri atë në pritë, dikush i kishte vënë disa dru dhe shkëmbinj në rrugë dhe sipas tij ai tha se kishte pa disa persona të armatosur ai i kishte ndjekur ata por nuk kishte mundur t'i identifikoj.

Tutje ka specifikuar se T i kishte treguar se kohë të fundit ishin duke e përcjellë Rr.A, I.A dhe persona tjerë që nuk i kishte përmendur me emra, dhe kur T i është djegur vetura i njëjti kishte menduar se po këta ishin personat e dyshuar të cilët qëndronin prapa këtij akti. Kolegu i tij A.S kishte dhënë dorëheqje nga Policia e Kosovës për arsye se kishte qenë i kërcënuar prej Grupit të E.S. Ditën kritike, me datën 30.08.2007, kishte shkuar në punë, ishte takuar me T. ku kishin dalë gjatë pauzës për të pirë kafe dhe së bashku kishin shkuar në zyrën e tij. T nga zyra kishte dalë dhe i kishte thënë se do të shkonte në Dardani në kafiterinë “//”. Në këtë kafiteri disa herë kishte shkuar me T, kolegun e tij A dhe kolegë tjerë. I njëjti lidhur me A.B është pyetur se a do të thotë ndonjë gjë emri i A.B para vrasjes së T, i njëjti ka theksuar se kurrë nuk e ka parë ata person dhe se për herë të parë e ka parë në TV, dhe se Ti para se të ishte vrarë asnjëherë nuk e ka përmendur A.B. I njëjti po ashtu ka specifikuar se lidhur me problemet që ka pasur T.R me E.S ka dëgjuar edhe prej A.S në momentin kur T i është djegur vetura.

Në seancën e radhës përgjatë vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor është proceduar me dëgjimin e dëshmitarit B.S

Dëshmitari B.S përgjatë deklaramit të tij në shqyrtimin gjyqësor, në mes tjerash ka specifikuar si vijon:

5.Deklarata e B.H

I njëjti përgjatë deklaratave të tij të dhëna në polici më datën 27.09.2013, prokurori 05.09.2013, 17.09.2013 si dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura pranë kësaj gjykate më datat 01.06.2015, 11.12.2018 ndër të tjera theksuar se kishte qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës që nga viti 2000 deri në vitin 2008. T.R e kishte njohur si kolegë por kishte pasur edhe raporte shoqërore me të njëjtin mirëpo nuk kishin punuar bashkë. T gjithnjë gjatë bisedave që kishte pasur me të i kishte treguar rreth problemeve që kishte pasur me E.S dhe grupin e tij, dhe me aq sa kishte njohuri, nuk kishte pasur probleme me persona tjerë përveç atyre të cekur më lartë e që janë E, Rr, emri Rr, L, F.M, R.S, A, F.Sh (për të cilin gjatë gjykimit një polic gjerman hetues kishte thënë se është në grupin e E.S) dhe shumë të tjerë. T. për herë të parë kur kishte pasur problem me E.S, kishte qenë rasti në një pikë kontrolli të veturave në një ndalje trafiku si polic patrollues, e për të cilin rast i kishte treguar vetë T. Mandej rasti tjetër kishte ndodhur në //, ku policët T dhe A.S kishin qenë në rroba civile, dhe me sa kishte njohuri, T, kishte qenë me A, kurse A, me gruan e tij apo dikë tjetër. Ditën kritike kur është vrarë T, A.S e kishte thirrë në telefon dhe i kishte thënë “e vrajti E.S, T. Për emrin A.B nuk i kujtohet ta ketë përmendur T, ndonjëherë të cilin as vetë nuk e kishte njohur. Raste tjera apo probleme që kishte pasur T, kishte qenë djegia e veturës së tij, përcjellja me dy vetura nga E, Rr, L dhe të tjerë që nuk i kujtohen. Nga biseda që kishte bërë me A, ajo ka qenë e bindur se E.S e ka vra T dhe i njëjti posedon një pjesë të incizimit kur dikush e thërret A, në telefon dhe i thotë se “ki me shkue edhe ti te T”.

Në seancën e radhës përgjatë vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor është proceduar me dëgjimin e dëshmitarit F.Sh.

Dëshmitari F.Sh përgjatë deklaramit të tij në shqyrtimin gjyqësor, në mes tjerash ka specifikuar si vijon:

6.Deklarata e dëshmitarit F.Sh:

I njëjti përgjatë deklaratave të tij të dhëna në polici më datën 10.09.2007, prokurori 30.10.2007, si dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura pranë kësaj gjykate më datat 19.11.2014, 20.11.2014, 15.01.2019, 29.04.2021 ndër të tjera ka theksuar se T.R e kishte njohur që nga vitet e 90-ta, në atë mënyrë që vajza e axhës së tij e kishte banesën afër me të, dhe ishin njohur familjarisht pasi që banesat kanë qenë ngjitur. Nuk i kujtohej që T ti ketë përmendur ndonjëherë ndonjë problem lidhur me punën e tij, por pasi që është bërë polic nuk ka dëgju që ka pas problem me dikënd tjetër përpos me E.S. Lidhur me vrasjen e T. ka potencuar se A.B nuk ka qenë shumë i afërt me E, mirëpo A, ka qenë i lidhur shumë ngushtë me I, A (L) dhe afërsisht për 1 vit A.B ka fillu të identifikohet si person në grupën e E.S dhe qe 1 vit nonstop ka ndejt në lokal të E.S dhe ka qenë e pamundur me kalu nga lokali i E dhe mos me pa A, kur ka bisedu me T lidhur me problemet e tij me S. atij asnjëherë nuk i kujtohet se e ka përmend A dhe as që ka pas problem me ndonjë person me emrin A grupa e S. I njëjti lidhur me biznesin "/" ka deklaruar se pronarë ka qenë E.S ndërsa në B// Kafe ka punuar A nga grupa e S. Për vrasjen e T. kishte kuptuar nga ish e dashura e tij Z.I e cila e kishte kontaktuar përmes telefonit dhe i kishte treguar për vrasjen e T. Të akuzuarin E.S e, kishte njohur pasi që kishte pasur shoqëri me të. Me Z, E dhe A nuk kishte ndenjur asnjëherë mirëpo me E dhe A po. Në lokalin e E që e kishte frekuentuar disa herë,

personi që i kishte rënë në sy më së shumti kishte qenë personi me emrin A dhe personi i tezës së këtij të fundit me emrin A, mandej kishte qenë edhe një person tjetër me emrin Agron “s.x.”, i kujtohej personi me emrin Rr, me pseudonimin Rr” si dhe një person të cilin e thërrisnin S, Të njëjtë i kujtohen edhe personat I.A (L) dhe A.B. E.S kishte biznes shpërndarjen e kafes “//” dhe shpërndarjen e kafes e bënte me një veturë pick-up, kishte pasur një Golf 3 dhe një Grand Cheeroko, të cilat vetura i kishin përdorur edhe personat tjerë të afërt me E. Dëshmitari e kishte njohur edhe N.S, vëllain e E si dhe S.S, të afërmin e E. Me personat e përmendur më lartë kishte ndenjur por nuk ishte shoqëruar shumë mirëpo me A.B nuk i kujtohej. Për rastin e vrasjes së T, me sa i kujtohej kishte dëgjuar nga Z, i cili ato momente ishte me një shok, kishte thirrur E në telefon dhe nuk i kujtohej se kishte biseduar me të. I (L), Rr (Rr), A ishin shoqëruar mes vete, A kishte qenë si truproje e L. Pas vrasjes së T.R, derisa është shpallur në kërkim kishte pasur kontakte me E.S, mirëpo pas kësaj jo. A.B e kishte njohur të cilin e kishte parë në qytet, në lokalin e E si dhe në lokale tjera, të cilin gjithmonë e kishte parë të shoqëruar me I (L), i njëjti përgjatë deklaramit të tij ka theksuar se A.B e ka parë në grupin e Vranjefcit duke ndenjur me djemtë të cilët janë përmendur më herët. I njëjti dëshmitarë përgjatë dhënies së dëshmisë së tij është pyetur më detajisht lidhur me punë e A.B dhe lidhjen e të njëjtë me familjen S, i njëjti ka theksuar se nuk e din se a ka punuar apo jo në lokalin S, ndërsa kur është pyetur me atë se A.B a ka poseduar ndonjë veturë, ai është përgjigjur *“në qoftë se e mbaj mend ni Golf 2 të portokallt mirëpo nuk e kam 100 %, aty ka pas veturë që ka pas mbishkrim, ka qenë një pikap kush mujke i hypke prej shoqnisë së tybe që është shërby me to”*, ndërsa lidhur me atë se a ka pasur ndonjë mbishkrim ky pikap a ka qenë me firmë dhe se kush ka qenë pronarë, i njëjti ka deklaruar se *“diçka me kafe B apo nuk e di qysh u kanë, B” kafe, ndërsa lidhur me atë se kush ka qenë pronarë ka deklaruar se me letra nuk e di por sa më kujtohet thoshin që vëllaut të E apo E, nuk e di kush i ka veç e di që vëllau vet u merrke me këtë punë, N”*.

Dëshmitari Sh.Q përgjatë deklaramit të tij në shqyrtimin gjyqësor, në mes tjerash ka specifikuar si vijon:

7.Deklarata e dëshmitarit Sh.Q

I njëjti përgjatë deklaratave të tij të dhëna në polici më datën 11.01.2008 dhe në kuadër të seancave të shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura pranë kësaj gjykate më datat 15.06.2015, 03.06.2015, 23.01.2019 ndër të tjera ka theksuar se nga fillimi i vitit 2002 kishte filluar punën në Policinë e Kosovës, ku kishte punuar në sektor të ndryshëm, T.R e kishte njohur nga viti 2003. Ndër shqetësimet kryesore të T, kishte qenë hierarkia e policisë për faktin se ai kishte bërë shumë raporte lidhur me disa kërcënime nga Grupi i E.S si dhe nga vetë ky i fundit, mirëpo menaxhmenti nuk kishin ndërmarrë asnjë nga masat parandaluese. Raportimet e T, kishin qenë se ai kërcënimet nga grupi i E.S kishin filluar qysh në vitin 2000, kur kishte parandaluar disa padrejtësi që janë bërë në shkolla nga Grupi i S, i njëjti ka theksuar se kur e ka pyetur E.S lidhur me arrestimin që i është bërë atij në Ferizaj i njëjti ka deklaruar se *“unë kam probleme të njëpashnjëshme me T.R, T më ka plagosur në // dhe jam i sigurt se T. ka shokë në polici në Ferizaj dhe ata ma kanë pregaditur këtë rast”*, e të cilat shqetësime dhe probleme shkonin duke u shpeshtuar edhe pas njoftimit të T me këngëtarin A.I, po ashtu i njëjti ka potencuar lidhur me rastet kur i njëjti ka qenë i shqetësuar nga rasti kur të njëjtë i është vu zjarr në veturën e tij, më pastaj atentatet të cilat i janë përgaditur në rrugën e Stagovës ku i njëjti siç ka shpjeguar i është përgaditur një kurth duke i vendosur disa druna në rrugë dhe ai ka qenë i përgaditur për mbrotje të afërt dhe e ka parë se është kurth dhe i njëjti e ka tejkualuar sepse e ka pasur xhipin dhe ka hyrë nëpër rrugë dytësore nëpër arra dhe nuk është ndaluar.

I referohet si grupi i S, pasi që edhe T. kishte përmendur 10-15 persona si: I.A me pseudonim “L”, Rr.A me pseudonim “Rr”, A.B apo E nuk është i sigurt, me pseudonim “A s...x.”, I.V, S.S dhe disa të tjerë. Gjatë bisedës së tij me E, i njëjti kishte menduar se rasti i Ferizajit kishte qenë

i montuar nga T.R, T. kohë të fundit kishte jetuar në S, dhe këtë bazuar në atë që i kishte thënë T, ishte detyruar me e lënë Prishtinën për shkak të kërcënimeve. Për personin me emrin A.B kishte kuptuar vetëm pasi që i njëjti ishte dorëzuar, e që kurrë as T.R e as A.S nuk e kanë përmendur që të njëjtit kanë pasur problem me personin e quajtur A.B. Një ndër motivet e E.S për të privuar nga jeta të ndjerin kishte qenë edhe A.I pasi që T e kishte pasur A si bashkëshorte dhe atë e kishte mbështetur për sigurinë e saj personale për arsye se kishte kërcënime në vazhdimësi. Pas vrasjes së T, A.I ishte kërcënuar dhe për këtë ekziston një video incizim ku të njëjtës i thotë personi i panjohur se: “ke me pësua njëjtë si T.R”. Shërbimi i Inteligjencës në të cilin edhe ka shërbyer, një javë para se të vritej T, kishte informacione se ishte duke përgatitur diçka serioze ndaj T.R dhe përmes vijave zyrtare janë informuar që ti ofrohet mbrojtje T. Për shkak të këtij rasti, dëshmisë së këtij rasti ka qenë i kërcënuar dhe kjo është raportuar në Prokurori për të cilin rast edhe i posedon provat, dhe në përfundim ka shtuar se prapa vrasjes së T.R qëndron E.S. Po ashtu i njëjti përgjatë deklaratimit të tij ka potencuar se është në mbajtje të dënimit për rastin e shpërthimit në lokalit S. ku të cilin akt e kanë ndërrmarë për hakmarrje ndaj kolegut të tyre T.R

Dëshmitarja B.M, përgjatë dëshmisë së saj në shqyrtimin gjyqësor ishte deklaruar si vijon:

8.Dëshmia e dëshmitares B.M

Në seancën e datës 24.05.2021 kishte deklaruar se E.S e njuh prej vitit 2007 ka qenë periudha para se me ndodh vrasja, e cila ka pasur një afërsi me të për një periudhë shumë të shkurtër rreth 1 muaj. T.R nuk e ka njohur personalisht dhe nuk ka dëgjuar për emrin e tij deri sa ka ndodh vrasja dhe prej momentit kur kanë fillu seancat dhe marrja e saj në pyetje në polici. Ditën kritike kur ka ndodh ngjarja ka deklaruar se sa i kujtohet ka qenë në punë, ku ka punuar afër një dyqani afër KEK-ut te Santea, butiku N, ku zakonisht orarin e kanë pasur 8 orë punë dhe se lidhur me rastin që ka ndodh ka dëgjuar prej njerëzve që ka ndodhur një vrasje dhe se e kanë përmendur emrin e T.R, sa i përket profesionit të T.R e ka kuptuar se ka qenë polic por vetëm mbasi është kryer vrasja. Sa i përket ditës kritike kur ka ndodh ngjarja ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë takim me të akuzuarin E.S, ndërsa numrin e tij e ka poseduar, sa e mban mend atë ditë nuk kanë dërguar ndonjë sms mes vete. Tutje prokurori special e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori në pasuesin e parë të faqes 3 i cili ka pasur këtë përmbajtje “*para se të vritej T.R, unë me E. jemi takuar çdo 2-3 ditë por me telefon jemi dëgjuar çdo ditë, ditën kur është vrarë T, unë nga telefoni menjëherë posa u ktheva nga vendi i ngjarjes i dërgova një SMS E.S në numër telefonit 044/// por ai nuk më është përgjigjur edhe pse i ka shkruar SMS*” e njëjta është pyetur lidhur me atë se a qëndron pranë deklaratës që e ka dhënë më parë, e njëjta ka deklaruar se atë ditë nuk i kujtohet se a i ka shkruar apo e ka parë, me sa e mban mend jo, e njëjta ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së seancës së fundit që ka qenë ku ka qenë pranë trupit gjykues vendor, ndërsa sa i përket deklaratave në polici dhe prokurori në pika të shkurta ka dhënë sqarim se ka kaluar kohë e gjatë dhe vetëm se i kujtohet saktë kur e ka thirrë policia, kanë ardh në vendin e punës dhe e kanë ftu me dhon deklaratë në polici për shkak të lidhjes së saj me E.S. Lidhur me deklaratat e saja përgjatë viteve 2008, 2019 dhe tash në vitin 2021 ka theksuar se me thënë të drejtën skisha dasht me kujtu asnjë, deklarata e parë para se gjithash ka kaluar shumë vite dhe smë kujtohet e gjitha, kam qenë me presion dhe frikë e kam përballur vetë këtë rast pa mbrojtjen e askujt dhe se nuk e ka dit se çfarë është duke bërë. Nuk e mban mend se pas sa kohe është takuar me E. pasi që ka ndodhur rasti, janë takuar në lagjen V.. me një shtëpi por nuk e mban mend saktë ku janë taku përmes ni djalit që nuk e mban mend se kush ka qenë. E njëjta ka shtuar se si ka interesuar se pse ska ardh personalisht i akuzuari E. me marr, se pse janë takuar brenda asaj shtëpie e jo jashtë shtëpisë, me rëndësi për të ka qenë që e ka parë të njëjtin, dhe se gjatë kohës sa ka qëndruar me E nuk kanë biseduar lidhur me rastin që ka ndodhur.

Në pyetjet e avokates mbrojtëse të të akuzuarit E.S e njëjta ka deklaruar se policët kanë ardhur në vendin e punës për ta njoftuar se duhet të shkojnë me dhënë dëshmi, nuk e din orën saktë në sa ora kanë ardh policët në vendin e saj të punës, janë prezantuar njëri ka qenë B.O dhe se tjetri si kujtohet, ata nuk kanë prezantuar ndonjë autorizim që janë të autorizuar ta intervistojë të njëjtë, ka shtuar se nëse s'gabon ka shku at ditë pas orës 5 mesditë. E njëjta ka deklaruar se ja kanë marrë telefonin pasi që i kanë thënë duhesh me lënë telefonin, nuk ka qenë në dijeni që ekziston mundësia që me rastin e intervistimit ta ketë avokatin e saj mbrojtës, e ka intervistuar B.O ka qenë edhe një femër por si kujtohet me emër. E njëjta ka pohuar se ka qenë disa herë në Bar S” dhe ka ndejt vetëm me E. me askënd tjetër, nuk i kujtohet se me kënd E. ka pasur relacione shoqërore, nuk ka takuar as familjarët e E, N.S se ka takuar asnjëherë por pas një kohë e ka kuptu që është vëllai i E, tutje përveç V që e ka njohur si shok të E pasi që përmes tij është njohur me E ka shtuar se nuk ka njohur asnjë shok të tij. Sa i përket A.B personi që e ka privu nga jeta T. ka deklaruar se ka lexu në media por sosht që i ka kushtu vëmendje dhe s'mund të thotë që i kujtohet diçka, për të ska qenë emër i njohur. Në pyetjen se a ka parë ndonjëherë në Lokalin S” të njëjtin në shoqëri të të akuzuarit E. ka deklaruar se si figurë nuk i kujtohet, as atëherë nuk i kujtohet. E njëjta lidhur me atë se pse e mban në mend vetëm emrin e B.O si person që e ka marrë në pyetje, e njëjta është përgjigjur se B. e njoh nga ai moment i parë kur ka filluar me u paraqit në polici, kur ka ardh në vendin e punës dhe nuk e harron për shkak të sjelljes që ka pas ndaj të njëjtës dhe mos respektit që ka treguar, e njëjta ka deklaruar se ka pas frikë sepse sjelljen e ka pas të rreptë ndaj saj. Ndërsa lidhur me SMS të cilat e ka ballafaquar mbrojtësja “nëse bashkëpunon me policin, kom me ta shkatërru jetën ty dhe familjes tënde” ku sipas raportit të policit B.O pretendohet se i ka dërgu i akuzuari E.S, e njëjta ka deklaruar se jo, asnjë sms e as me fjalë ska pranuar asnjëherë as kërcënim e asgjë të tillë deri më sot. Lidhur me shkëmbimet e sms sa i përket përmendjes së policisë, T. ose A. ka deklaruar se nuk osht që kanë pasur rast e as mundësi e as nuk i ka interesu pjesa tjetër, ka pasur një lidhje afatshkurtër gjatë asaj periudhe afër një muaj nuk është e siguru para se me ndodh vrasje, ndërsa masi që ka ndodh rasti, mas marrjeve në pyetje spo din është taku disa herë edhe më se ka taku. Sa i përket nxitjes së A.B nga ana e E.S lidhur me vrasjen e T.R ka deklaruar se ka dëgjuar në polici prej policëve kur ka shku me dhënë deklaratë, ata kanë thënë që e kanë nxitë për vrasje, prej dikujt tjetër jo. Ndërsa në pyetjet e trupit gjykues lidhur me marrjen e telefonit të saj kur është shkuar me dhënë deklaratë në polici e njëjta ka deklaruar se telefoni i është marrë për ekzaminim të telefonit, ku telefonin ja ka dorëzuar policit me emrin B, mbas 3 dite e ka marrë telefonin dhe nuk i është dhënë ndonjë vërtetim që po i kthehet të njëjtës.

Seanca e radhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitarit M.K i cili në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ishte deklaruar si vijon:

9.Dëshmia e dëshmitarit M.K

I njëjti përgjatë deklaratave të tij të dhëna në kuadër të seancave të shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura paranë kësaj gjykate më datat 12.02.2015, 20.09.2015, 25.02.2019 ndër të tjera ka theksuar se në Policinë e Kosovës punon që nga viti 2000, fillimisht në Stacionin Policor në Lipjan, pastaj në vitin 2005 ishte transferuar në Regjionin e Prishtinës në cilësinë e hetuesit dhe në Tetor të vitit 2005 në Drejtorinë e Krimeve të Rënda në Prishtinë ku edhe tani punon me gradën e rreshterit. Nuk e kishte njohur T.R personalisht, por vetëm si polic, si figurë. Më datën 30.08.2007, ditën kritike, kishte qenë duke punuar në Drejtorinë e Krimeve të Rënda ku edhe aktualisht punon. Provat të cilat ishin mbledhur gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe pranimi i tyre janë bërë në përputhshmëri të plotë me zingjirin e ruajtjes dhe shënimit të tyre. Kishin pranuar informata të shumta nga Drejtoria e Analizës së Inteligjencës lidhur me grupin që atë kohë e udhëhiqte E.S, i cili kryente vepra të ndryshme penale. Sipas informacioneve të cilat i kishin, ky grup përbëhej prej E.S, I.A (L), Rr.A (Rr), F.A dhe shumë të tjerë emrat e të cilëve

nuk i kujtoheshin. Sa i përket T.R, disa raste kishin qenë të hapura në cilësi të viktimës, lidhur me E.S dhe grupin e tij, dhe këto shënime ishin marrë nga raportet policore dhe sistemi i bazës së të dhënave policore, dhe në ato raporte asnjëherë nuk përmendet ndonjë rast mes T. dhe A.B. Pas marrjes së rastit dhe ekzaminimit të dëshmisë dhe të gjitha informacionet, është vërtetuar saktë se A.B është pjesë e “Grupit S” dhe kjo vërtetohet me shumë dëshmi. Në një dëshmi, në një video incizim, A.B shihet në një aheng familjar që kanë pasur ata, ku i njëjti luan rolin e truprojës në atë aheng, kjo është vërejtur edhe përmes komunikimeve me telefonata apo hyrje dalje sms që është identifikuar A.B si pjesëtar i grupit të E.S. Lidhur me këtë rast hetimet kishin vazhduar edhe ndaj personave tjerë të grupit S. Në bazë të dhënave që posedonin, A.B kishte punuar për E.S dhe kishte vozitur një pikap për bartjen e kafes për “B.Kafe”. T.R nuk e kishte njohur mirëpo gjatë hetimeve kanë hasur në prova të cilat kanë vërtetuar se kishte ekzistuar një ankesë nga tani i ndjeri, ndaj të akuzuarit E.S dhe se nuk ka hasur në ndonjë kërkesë se i njëjti kishte kërkuar mbrojtje nga Policia e Kosovës apo mbrojtje të afërt. Raportin e datën 04.09.2007, e pranon si të tij, në të cilin vërtetohet se një dëshmitar kishte shprehur gatishmëri që të tregojë lidhur me rastin i cili fillimisht kishte dhënë informata se personat të cilët kishin qenë në lokalin Sekiraqa pas vrasjes së T.R të cilët kishin bartur në veturat e tyre armë dhe gjësende tjera, e të cilit dëshmitar i ishin ofruar kushtet për anonimitet.

Seanca e radhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitarit F.G

Dëshmitari F.G në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka specifikuar si vijon:

10.Dëshmia e dëshmitarit F.G

Përgjatë deklaratave të tij të dhëna në shqyrtimet gjyqësore të datës 20.07.2015 si dhe 25.06.2021 ka deklaruar se funksioni i tij gjatë vitit 2007, kur edhe kishte ndodhur ngjarja kritike e datës 30.08.2007, kishte qenë shef i sektorit për hetimin e krimeve të rënda, në të njëjtën drejtori. Ditën kritike, ishte informuar nga zingjiri komandues Qendra Operative – Prishtinë, se në lagjen “Dardania” kishte ndodhur një vrasje dhe viktimja ishte zyrtar policor. Pas marrjes së njoftimit kishte shkuar në vendin e ngjarjes ku kishte qenë prezent edhe prokurori i rastit O.M. Në hierarkinë e tij ka qenë nën kolonel L.M si mbikëqyrës i dytë, dhe si mbikëqyrës i parë ka qenë A.N, që atë ditë nuk ka qenë në detyrë sa i kujtohet dhe detyrat e tyre paraparakisht janë caktuar se kush do të jetë, mirëpo sipas rastit që ka qenë që ka pas volum të punës i njëjti është caktuar në vendin e ngjarjes nga nën koloneli në atë kohë L.M por edhe që në rastet të tilla përgjegjësia shkon dhe më lart në hierarki po që në atë kohë ka qenë i angazhuar edhe si ekzekutiv edhe policia e UNMIK-ut që kanë marr një rol të udhëheqjes me strategji të rastit dhe është formuar dhoma-incidenti për t’i udhëhequr të gjitha punët brenda njësisë dhe jashtë njësisë në këtë rast policisë dhe gjykatës që në këtë rast kanë menaxhuar incidentin që ka ndodh. I njëjti ka shtuar se nuk i kujtohet saktë koha e fillimit por pas orës 17-18:00 ka qenë aty dhe prokurori ka ardh aty dhe të gjitha veprimet që janë marrë dhe kanë qenë të planifikuara në vendin e ngjarjes por për të komunikuar edhe me njësitet e tjera në teren të angazhuara kanë qenë të komunikuar me prokurorin por edhe të koordinuara me atë personalisht për tu krahasu dëshmitë në vendin e ngjarjes por prokurori sa herë dhe në çdo veprim ka qenë i informuar dhe i kyçur për udhëzimet që janë dhënë për tu marr udhëzimet direkte nga vendi i ngjarjes edhe për tu marr udhëzimet e tjera ligjore. Dëshmitari ka theksuar se nga momenti i mbërritjes në vendin e ngjarjes deri në kohën e trajtimit të informacioneve nuk mund të jemi saktë mirëpo nga momenti i trajtimit të disa informacioneve-dëshmime tjera krahasuese është komunikuar se vrasja mund të jetë kryer për çështje hakmarrjes të thëna nga dëshmitarët e ndryshëm që e kanë quajtur tek Grupi S. ku informacionet e para në vendin e ngjarjes kanë qenë që rasti ka ndodhur për shkaqe të hakmarrjes dhe që nuk ka qenë analizë e tyre fillestare në vendin e ngjarjes se Grupi S. e ka vrarë T. R por kanë qenë dëshmitë e dëshmitarëve okularë që kanë kontribu në mbledhjen e informacioneve në lidhje me rastin që ka ndodh. I njëjti është pyetur lidhur me udhëheqjen e dhomës së incidenteve

ku i njëjti ka deklaruar se njëri ndër ata që ka qenë në dhomën e incidenteve dhe që ka mund të komunikoj me ata në vendin e ngjarjes ka qenë nën koloneli L.M, me të cilin kanë komunikuar sa i përket kësaj dhome dhe vendin të ngjarjes. Sa i përket planifikimit të bastisjeve ka theksuar se pas trajtimit të informacioneve nga vendi i ngjarjes po jo të vetmit janë planifikuar bastisjet të cilat në bazë të dëshmimeve të marra nga vendi i ngjarjes dhe krahasimi i informacioneve të tjera janë planifikuar bastisje-kontrolla të lokacioneve të caktuara, ku të gjitha kontrollet-bastisjet e planifikuara është informuar prokurori O.M dhe çdo herë e kanë pasur parasysh se nga dhoma e incidenteve që është formuar enkas për këtë rast është komunikuar me gjyqtaren e procedurës paraprake e që në kohën e incidentit ka qenë D.H, ku nga gjyqtarja e procedurës paraprake kanë pas urdhër verbal sa i përket kontroleve-bastisjeve të lokaleve por edhe të vendit të ngjarjes ka qenë urdhër verbal i gjyqtarës, por i njëjti ka shtuar se nuk ka komunikuar direkt me gjyqtarë por nga dhoma komanduese i është dhënë njoftimi se është kontaktuar gjyqtarja e procedurës paraprake dhe njëkohësisht të gjitha njësit e tjera për marrjen e veprimeve nga ai urdhër verbal nga ana e saj për mbledhjen e provave nga vendi i ngjarjes për ta lokalizuar të dyshuarin i cili ka ikur me armë në dorë. Në rastin konkret në ditën e incidentit ka shtuar se nuk është bërë kërkesë me shkrim për marrjen e shkresës me shkrim nga gjyqtari pasi që prokurori që ka qenë në vendin e ngjarjes dhe gjyqtarja veq ka komunikuar urdhrin verbal, për të vazhduar në bazën ligjore të urdhrit verbal për të grumbulluar të gjitha dëshmitë tjera lidhur me rastin konkret, veprim të cilin e kanë bërë dhe e bëjnë në përvojë të misioneve ndërkombëtare por edhe të përgjegjësisë të ekzekutimit të sundimit të ligjit të UNMIK-ut në atë kohë që kanë kërkuar të bëhen sa më shpejtë veprimet operative policore sipas urdhrit verbal të gjykatës. I njëjti ka konfirmuar për aq sa të njëjtën informatë e ka pas edhe prokurori në vendin e ngjarjes se për çdo shkuarje të policisë që është kërkuar nga dhoma komanduese për kontrollin e vendimit të caktuar është komunikuar nga prokurori dhe po ashtu është njoftuar edhe gjyqtari. Po ashtu nga L.M, po për siguri se dhoma komanduese a e ka bërë një veprim të informimit të tillë e mbështes se dhoma komanduese njëkohësisht ja ka konfirmuar dhe prokurorit se një njoftim-urdhëresë nga gjyqtarja verbale është marrë, të njëjtit i kujtohet se në ditën e incidentit nga dhoma komanduese janë njoftu nga ai dhe prokurori, se do të vazhdohet me kontrollë në lokalit në Lakrishtë me lokacion që është në pronësi apo në posedim apo në menagjim të biznesit të E.S në atë kohë, dhe emri i lokalit ka qenë Sekiraqa. Në rastet kur policia kryen bastisje si në rastin konkret ka bërë procesverbale të shkruara apo të formave që përdoren sipas stacionit policor, forma-shabllone që plotësohen gjatë veprimeve të vendit të kontrollit, ndërsa polici e bën formularin ose kur kthehet në vendin e punës pas operacionit dhe informatave të mbledhura ato i formulon dhe i shënon veprimet e veta dhe bazën ligjore në të se si ka vepruar, në formuar ose raportin pas operacional, i shënojnë këto të dhëna dhe i administron, dhe duhet ta arsyetoj në cdo rast dhe beson që edhe në këtë rast në së çfarë baze ligjore e ka kryer secilin veprim por gjithëherë duhet të kemi parasysh se në rastet kur stresi është i lartë në menagjimin e veprimeve operacionale policore dhe komunikimi nuk mund të rrjedh i rregullt atëherë dhe në mënyrë praktike bëhet një raport nga udhëheqësi ose menagjeri i përgjithshëm i atij incidenti, mbi komunikimet ligjore por edhe tjera asistuese se çka ka pranuar për të kryer veprimet e veta në baza ligjore. Në këtë rast nëse mungon forma-shablloni që nuk janë unike dhe janë të dallueshme sipas stacioneve kanë mund apo nuk ka mund të jetë i shkruar emri i gjyqtarës paraprake që ka dhënë urdhër verbal sa më kujtohet është shkruar dhe është thënë se shkruhet në raport në komunikimin që ai person e ka bërë direkt me gjyqtaren apo personat që kanë bërë direkt me gjyqtaren gjatë zbatimit të urdhrit verbal. Ndërsa pas përfundimit të këtyre veprimeve, por edhe në rastin konkret mendon se të gjitha këto raporte nga 12 orëshi i parë i veprimeve të tyre nga koha e incidentit e tutje janë bërë të gjitha raportimet në prokurori për t'i njoftuar me veprimet e tyre që janë bërë për të marrë urdhëresë të tjera të zbatimit të masave hetimore si dhe ka pas persona që kanë qenë në paraburgim të cilat brenda 24 orëve kanë obligim t'i raportojmë me të gjitha shkresat në prokurori dhe me këto kanë kërkuar konfirmime për veprimet e tyre të ndërmarra në 24 orëshin e parë por edhe kërkesa të tjera për zbatimin e

masave të tjera të bëra në atë kohë për atë rast. Prokurori special përgjatë marrjes së dëshmisë nga dëshmitari ka prezantuar 3 procesverbale të bastisjeve të kryera me dt 30.08.2007, një është e cila mban kohën e fillimit në ora 20:50 në adresën rruga “G.L”, dhe në formularë është plotësuar se është kryer me urdhër të gjyqtarës D.H, procesverbali tjetër i të njëjtës datë për bastisjen që ka ndodhur në banesën ose shtëpinë e të dyshuarit thuhet F.S, dhe në këtë procesverbal është evidentuar se bastisja është bërë me urdhrin e gjyqtarës D.H në ora 23:10, dhe procesverbali i 3 i po të njëjtës datë me orë të fillimit 19:15 në rrugën “B.C” në kafe Bar S” dhe në këtë procesverbal nuk është shënuar-evidentuar emri i gjyqtarit që e ka dhënë urdhrin për bastisje-kontrollë, si mund të arsyetohet kjo, të dy procesverbalet e para patëm emër se bastisjet janë kryer me urdhër verbal të gjyqtarës D.H dhe te kjo nuk patëm emër se me urdhër të kujt është kryer bastisja e lokalit S ku i njëjti është pyetur pse ka mund të ndodh kjo a ka qenë në dijeni. Dëshmitari ka deklaruar se në format konkrete nuk e din se kush ka qenë aty në kontroll nga policët por në forma shabllone konkrete janë vetëm udhëzuesit e policisë për ti shënuar gjërat që ai bën në vendin e caktuar të kontrollit. Forma konkrete nëse polici nuk e ka shënuar nuk është i obliguar dhe këtë procesverbal nuk e marrim si procesverbal të përfunduar të raportimit të policit nga vendi i ngjarjes por i njëjti polic e bën prap një raport të policit që e shpjegon të gjitha veprimet e veta, por edhe të gjitha veprimet ligjore që i ka marrë. Në rastin konkret kur incidenti është madhorë për tu bërë bazë e mirë ligjore por edhe për tu vërtetu si provë secili e shkruan raportin e tij mbi veprimin që e ka bërë ose ka vepru në rastin konkret dhe në këtë rast urdhëri verbal ligjorë në kohën konkrete ka qenë për tu bërë nga personi- polici që ka kontakti me gjyqtarin për ta përpiluar raportin në rast se ai ka marrë urdhër verbal nga prokurorja edhe e ka zbatu këtë urdhër verbal, në rastin konkret (është fjala për procesverbalin e 3) polici nuk e ka shënuar emrin e gjyqtarës paraprake me siguri se ai nuk ka komunikuar me gjyqtarin, një ndër arsye që se ka shënu mund të jetë aspekti profesional i tij dhe rasti i dytë mund të jetë se nuk e di a ka qenë raporti i tij i cili e ka bërë kur e ka kry apo kur ka qenë në zyrë se çka ka bërë në atë lokacion dhe kush ju ka thënë dhe cila ka qenë baza ligjore nëse nuk është ai raport i oficerit, ai duhet të vjen para gjykatës dhe të dëshmojë se pse nuk e ka shënuar atë raport mbi veprimet e veta për të cilat ka shku dhe ka përfunduar atë kontrollë në atë lokacion dhe që e ka përpiluar atë raport. Ndodh që mund të jetë se polici që e ka kry bastisjen e ka përpiluar procesverbalin ndërsa polici tjetër që kanë qenë në të njëjtën ekipë e ka bërë raportin e vendit të ngjarjes, kjo ndodhë dhe është praktik e zakonshme. Dëshmitari po ashtu është pyetur edhe për procesverbalin e 4 të datës së njëjtë të ushtruar në rrugën “V. F” në shtëpinë e të dyshuarit O.B dhe në këtë procesverbal është shënuar që urdhër kontrolla është zbatuar me urdhër të gjyqtarës D.H, i njëjti më saktësisht është pyetur lidhur me atë se gjatë përvojës së tij nga viti 2000 a ka ndodh ndonjëherë që të urdhërohen ose të urdhëroj dikën si shef i njësisë që të kryet ndonjë bastisje ose kontroll të rastit e natyrës pa urdhër të gjykatës a ka ndodh ndonjëherë, dëshmitari ka deklaruar se në fakt në përvojën e tij ende dikush nuk e ka urdhëruar të bëjë veprime të paligjshme apo të pambuluara në ligj dhe në formë të urdhrit të hierarkisë së tyre apo të ndonjë personi të paautorizuar apo të pa mbështetur në ligj, mirëpo ka shtuar se me të gjitha rastet që kjo gjykatë ka dënuar dhe me raste të përjetshme të vrasjes të gjitha veprimet policore incidente të rënda të vrasjeve janë kryer dhe janë duke u kryer me urdhër verbal, në orët e para të incidenteve të cilat kërkohet që dëshmitë dhe të dyshuarit të arrestohen dhe të grumbullohen me qëllim të administrimit të tyre sa më të shpejtë të rastit konkret, në rastin konkret në ekzekutiv të policisë së Kosovës ka qenë policia e UNMIK-ut dhe nga momenti i parë si sinjal i kuq i veprimeve policore është dhënë edhe nga komisarit i policisë në atë kohë sa më kujtohet për ti shfrytëzuar të gjitha kapacitetet policore, vendore por edhe ndërkombëtare po ashtu edhe ato gjyqësore që nëse nuk kemi efikasitet të prokurorisë dhe gjykatës në këtë rast të aktivizohet prokuroria dhe gjyqtari ndërkombëtarë, UNMIK-ut në atë kohë, në rastin konkret urdhër verbal që ka qenë i prokurorisë dhe gjykatës kanë qenë ligjorë, duke u mbështetur edhe në vlerësimin e rrezikut për arsye se edhe pse fillimi ishte një dyshim i mundshëm, se kush mund të jetë kryes i kësaj veprë penale dhe

ende pa u ditur saktë nga dëshmitë por edhe nga identifikimi i të dyshuarve, i është besuar se është ataku dhe policia dhe se i dyshimti është në flagrancë se mund të atakoj dhe policinë dhe kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale.

Në pyetjet e avokates mbrojtëse të të akuzuarit E.S, avokates K.K i njëjti ka deklaruar se: të njëjtit janë informuar rreth orës 16:00 dhe rreth orës 17:00 kan mbri në vendin e ngjarjes. I njëjti është pyetur lidhur me atë se në shqyrtimin e mëhershëm gjyqësorë nuk është pyetur lidhur me atë se kur janë dalë saktë në vendin e ngjarjes, e që lidhur me këtë rrethanë i njëjti është pyetur se nga koha kur jeni dal në vendin e ngjarjes personalisht e deri në kohën kur ka ardh prokurori a i kujtohet se çfarë veprime janë ndërmarrë, i njëjti ka deklaruar se veprimet e tyre kanë qenë në menagjimin e vendit të ngjarjes ku ai ka qenë përgjegjës por secili veprim që është bërë ka deklaruar se është dëshira e tij që të merren për bazë deklaramet e tij më të mëhershme se mund të mos jetë i saktë për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, e që po ashtu ka deklaruar sërish se kanë grumbullu informacione nga dëshmitarët se nën dyshimin se është kryer një akt i vrasjes në rrethanat që ka sqaruar dhe që ende nuk e kanë kuptuar dhe kuptojnë se në çfarë rrethane është kryer ajo vrasje. Lidhur me vendimet e tyre në vendin e ngjarjes ka shpjeguar se kanë qenë për t'i grumbulluar provat materiale në vendin e ngjarjes dhe për t'i administruar dhe për t'i marr informacionet nga dëshmitarët okular dhe për t'i plasuar në dhomën komanduese për veprime tjera operative, i njëjti ka shtuar se nuk ka pasur kompetencë për t'i përshkruar të gjitha veprimet që ka ndodh në këtë rast dhe për t'i analizuar ato në vendin e ngjarjes si ka deklaruar në deklaramet e mëparshme siç është përshkru dhe më herët për administrimit në rast. I njëjti ka shtuar se si dëshmitar nuk ka marr vendime nga vendi i ngjarjes se kush do të bastiset dhe kur do të bastiset, i njëjti ka deklaruar se nuk ka qenë përgjegjës dhe nuk e di se kur dhe si është vendos për kryerjen e kontroleve në kohën e saktë për bastisje, të njëjtit janë informuar se po zhvillohen bastisje por kohën e saktë nuk e ka dit sepse nuk ka qenë përgjegjës për atë. Sa i përket vendimit se duhet të bastisen disa lokacione i njëjti ka shtuar se dhoma komanduese është ajo që ka koordinu të gjitha veprimet tjera operative në këtë rast, çdo herë dhe në çdo rast përgjegjësi i vendit të ngjarjes është vetëm përgjegjës i një lokacioni, por jo ti koordinojë të gjitha veprimet tjera se është e pamundshme profesionalisht dhe e paarritshme, dhomat komanduese në rastet hetimore të incidenteve që ndodhin aty për aty nga njerëzit përgjegjës që janë në pozitë ndër ta ka qenë L.M me të cilin ka komunikuar direkt për veprimet në vendin e ngjarjes. I njëjtë ka theksuar se ka raportuar, i njëjti ka koordinu veprimet në vendin e ngjarjes dhe i ka plasu në dhomën komanduese dhe janë koordinu veprimet tjera operative. Lidhur me atë se si ka ardh vendimi apo organizimi është çështje që koordinohet mes të gjitha ekipeve që kanë vepru dhe administru në dhomën komanduese, mirëpo secili lokacion duhet të kontrollohet ka qenë koordinim i dhomës komanduese nga vlerësimi i provave të cilat i ka theksuar. I njëjti përgjatë deklaramet të tij është pyetur se në bazë të cilave të të gjeturave-dëshmime të marra në vendin e ngjarjes janë planifiku bastisjet, cila ka qenë dëshmia e cila ata i ka drejtuar në lokacionin e parë që duhet të bastiset është "Bar S", i njëjti ka deklaruar se veprimet të cilat janë bërë në vendin e ngjarjes kan qenë veprime ekipore policore që zakonisht bëhen e që nëse themi që në momentin e caktuar nuk kam mujt ta kem informacionin qysh më vonë që është dëshmuar dëshmitarët okular kan pru fotografi që e kanë fotografu, vetëm pas vrasjes të dyshuarin ose kryesin e veprës penale, të gjitha këto informacione kanë qenë për mu të pamundshme t'i apsorboj mirëpo kan qenë të plasura në dhomën komanduese e nga ku janë koordinu veprimet tjera. Nuk janë të gjitha veprimet-infomacionet që unë i kom apsorbu atë ditë në vendin e ngjarjes sepse ka qenë e pamundur mirëpo që atë ju e thoni që i ka shefi kryesorë unë them që janë një ndër 7 shefat e policisë. Si ka rrjedh ajo janë informacione që kan qenë në marrje e sipër të dëshmitarëve okularë e të cilët kan përshkru të gjith personat që në procedurë janë të akuzuar, ku në rastin konkret është deponuar një strukturë analitike e skematuar që ata e quajn qart-anogram që bëhet grupi kriminal që nuk është bërë nga ai por që është bërë nga policia, anagram i tillë i funksionimit të

grupit ka qenë i përpiluar dhe prezantuar edhe në seancat e kaluara të trupit gjykues. Po ashtu i njëjti është pyetur lidhur me atë se sa kohë i ka marrë të kuptojnë identitetin e të dyshuarit për vrasjen e T.R nga momenti që kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku dëshmitari ka deklaruar se janë dy momente, nga fillimi ka pas informacione që janë thirrur në përmes linjave të policisë, me sa më kujtohet se qytetarët të cilët duan të mbesin anonim e din se kush e ka kry vrasjen dhe gjatë kohës në vazhdim edhe do të kontaktojnë policët për të dhënë dëshmi për dyshime në rastin e vrasjes. Mirëpo nga fillimi kur kemi shku ne vendin e ngjarjes janë transmetu informacione se persona të cilët për momentin nuk janë dit kush jon kan që kan thanë, këto informata më kan ardh në mes policëve të tjerë, këta persona do të dëshmojnë lidhur me të dyshuarin dhe do të bijnë dëshmi materiale që si rjedhohë më vonë pas orës 20:00 është deponu një fotografi e të dyshuarit nga ana e dëshmitarëve (A.B). I njëjti është pyetur lidhur me atë se kur është kuptu përmes fotografisë që A.B ka qenë i dyshuari, pse ka qenë pista e parë e hetimeve Lokal “Bar S i njëjti ka deklaruar se ka qenë e vërtetë edhe çka ka thënë në deklaratimet e mëparshme dhe duhet të kuptohet se nga fillimi janë trajtu informacione mbi dyshimet dhe indiciet se mbi cilin drejtim dhe kah duhet të shkojnë veprimet hetimore, i njëjti ka shtuar se nuk është direkt ai nga vendi i ngjarjes sepse është e pamundshme që i njëjti të tregoj indicien dhe të ndërtoj rastin se nga kush është i përfshirë ai rast dyshimi i parë që është në momentet e para janë thirr policia me të gjitha linjat dhe komunikimet direkte-indirekte se kush e ka vra dhe kush është në këtë rast i involvuar, dhe se lidhur me të gjitha veprimet hetimore dhe të gjithë personat që kanë mujt me u kontaktu janë kontaktu dhe të gjitha deklaratimet e personave o drejtpërdrejt me shkrim në marrje të deklaratave me shkrim apo marrjes të kontrakteve të persoanve në rrugë operative të bisedave verbale janë të shënuara dhe duhet të jenë të shënuara në rast dhe duhet të jenë të argumentuara, dhe deklaror që ka qenë informacion se personi është fotografu dhe do të dihet me fotografi se ky person është identifiku me fotografi dhe me emër, informacioni që është dhënë për policinë që nga fillimi, që ka rezultu si provë materiale dhe që është e pranueshme në procedurë gjyqësore dhe personi që e ka bërë fotografimin a është intervistu nuk e di, dhe a është me emër mbiemër rast të cilin nuk e di unë. Janë shumë të tjerë në këtë formë por që kanë qenë informacione të trajtume e që kanë sjell rezultat hetimor të dëshmuar.

Dëshmitari është pyetur lidhur me atë se cila është baza ligjore që thirret policia e Kosovës dhe dëshmitari si menagjer që ka lejuar që të ndërmeren veprime hetimore në vendin e ngjarjes dhe atë mbesin të paevidentuara askund, kur përmenden dëshmitarë dhe dëshmi në mënyrë të përgjithësuar të cilat i kanë orientuar në një pistë hetimi dhe nuk janë evidentu askund, ku dëshmitari ka deklaruar veprimet tona në rastin konkret kanë qenë sipas autorizimeve policore që duhet të bëj në çdo rast e veçarisht në rastet të cilat janë me rrezikshmëri të lart. Në këtë rast policia sipas ligjit të policisë është e shkruar qartë se duhet të disponoj informacione preventive në vlersimin e rrezikut të përgjithshëm apo të personave individual dhe në momentin kur rasti ka ndodhur unë jo tani të jemi të qartë, policia ka shfrytëzu këtë bagazh- informacion të mëparshëm preventive që ka bërë vlerësimet e personit viktimë tani të ndjerit, se nga kush dhe si mund të jetë rreziku, ndërsa në momentin kur rasti ka ndodh policia vepron sipas ligjit të policisë të grumbullimit të informacioneve përmes bisedave informative me të gjith personat që mund të kontribuojnë apo mund të japin info apo dëshmi lidhur me rastin konkret e që policia ka vepru mbi këtë bazë dhe mbi dëshmitarët e rastit lidhur me indikacionin e rastit. I njëjti është pyetur lidhur me atë se në qoftë se e kanë kuptuar rreth orës 20-21 se i dyshuar është A.B atëherë a ka qenë në dijëni se përse policia ka shkuar në bastisje në shtëpinë familjarëve të E.S, përveç Lokalit Bar S” gjersa tek në orën 00:50 minuta kanë shkuar në shtëpinë e A.B, a ka ndonjë sqarim se pse është bastisë lokali edhe shtëpia e S., 2 orë e gjysmë-3 para se të bastiset shtëpia e të dyshuarit A.B, ku dëshmitari ka deklaruar se arsyet e veprimeve individuale operative nuk i di për shkak se është shku në një lokacion më herët apo më vonë mirëpo shkaqet janë mesiguri shpia e A nuk ka mund me u identifiku se ku është shtëpia e tij, mirëpo edhe në vlersime të tjera që janë bo nga dhoma komanduese apo nga përgjegjësit e tjerë. Pas kësaj i njëjti është pyetur sërish lidhur me

urdhëresat verbale të cilat janë kërkuar nga gjyqtarja e procedurës paraprake lidhur me atë se kush ka kërkuar urdhër verbal, i njëjti ka deklaruar se njoftimin e kanë marrë nga nën koloneli L.M dhe sa i kujtohet nga gjykata e ka kërku në atë kohë nën L.M ku nga fillimi ka potencuar që përmes dhomës koordinuese-komanduese është transmetu informacioni për marrjen e urdhërave ligjor dhe përmes prokurori është udhëzuar prokurori që të merren urdhërat verbale nga gjyqtarja, dhe kontesti i kësaj komunikimi ka qenë profesional ku ka kërku nga komanduesi se duhet me u marr urdhërat verbal për me fillu bastisjen në mënyrë ligjore, mund të thotë se ka kërku ka urdhëru dhe ka marrë sygjerime. I njëjti është pyetur edhe lidhur me atë se si ka mundësi që në procesverbalin mbi bastisjen e lokal Bar S” të figuroj ora e fillimit të bastisjes 19:15 ndërkaq nga raporti i krim teknikës të sektorit të vendit të ngjarjes për procesverbal është dokumenti zyrtar policorë me titull “sektori i vendit të ngjarjes, njësia regionale e krim teknikës me datën 01.09.2007” në të cilin raport në faqën 4 B.Rr pjesëtar i krim teknikës ka deklaruar “më pastaj prapë nga toger N. S...” Në procesverbal po figuron se bastisja ka fillu në 19:15 ndërsa në raportin e krim teknikës thot se hala pa shku në ora 18:50 krim teknika arrin dhe në fotot që krim teknika i ka bo në lokal bar S. përmbajnë orën 17 e diqka, si ka mundësi që ora e bastisjes të shënohet 2 orë më vonë se që fillon bastisja konkretisht dhe të përfundoj madje për 30 minuta se ora e përfundimit është 19:45?, i njëjti ka deklaruar se duhet të shiqohen se si kanë rrjedh ato shënime teknike mirëpo bastisja duhet të vlerësohet në bazë të raportit pas operacional i cili duhet të jetë në lëndë që nuk e din a është apo nuk është, e që poashtu edhe kërkuar që me veprimet e tyre hetimore me u dërgu raporti hetues për prokurorinë dhe të kërkohet nga gjykata konfirmimi i veprimeve të tyre paraprake, nuk i kujtohet lidhur me atë se a është marrë ajo urdhëresë por e di që prokuroria është njoftu për të kërku nga gjykata, nëse prokurori se ka dërgu atëherë është çështje e prokurorisë. Tutje dëshmitari është pyetur edhe lidhur me atë se përgjatë deklarimit të tij ka përmendur edhe policinë e UNMIK-ut dhe pjesëmarrjen e tyre duke u pyetur pse në asnjë raport policor dhe në asnjë dokument tjetër policor nuk figuron pjesëmarrja e tyre, dëshmitari ka deklaruar që nuk e din por duhet ta kenë të kuartë se komisiari i policisë së Kosovës ka qenë në kompetencë të plotë ekzekutive nga policia e UNMIK-ut. Tutje dëshmitari është pyetur edhe lidhur me atë se çfarë sqarimi mund të jap i njëjti kur është njoftuar se nga raportet policore të bartësit të rastit M.K që e ka pasur edhe rastin ta dëgjojnë drejtëpërsëdrejti i njëjti ka deklaruar se A.B është identifikuar si person që mund të ketë lidhje me të ashtuquajturin Grup S” disa ditë më vonë pas hetimeve, i njëjti ka deklaruar se për çka policia përveti mban informacione dhe të cilat materiale policia e Kosovës mund t’i disponoj në tërësi për individ apo grupe të caktuara mirëpo i njëjti ka deklaruar se ditën e parë të incidentit është pranuar informacion mbi dyshimin e bazuar se si ka mundur të ndodh rasti, dhe se lidhur me pyetjen që ka të bëjë me përfshirjen e E.S 4 muaj më vonë si i dyshuar pasi kanë fillu hetimet, i njëjti ka theksuar se veprimet hetimore kanë qenë të planifikuara dhe të organizuara në koordinim me prokurorin dhe se si dhe kush të procedohet për çështjet hetimore dhe të ngritët siç i kanë në kallëzimet penale apo veprimet tjera ka qenë qështje të cilat janë organizu me prokurorin për grumbullimin e dëshmitave për format e tjera operative mirëpo gjithëherë shton se ka qenë prokurori dhe ai ka vendosur se kur të quhen persona për këtë çështje procedurale janë dashur të zbatohen disa urdhëresa dhe masa të tjera që është dasht të përpilohen.

Në pyetjet e trupit gjykues i njëjti ka deklaruar se kur ka ndodh rasti në fillim ka qenë menagjer i personelit dhe detyrave që ata i kryejn, përpos që A.B që e ka kry vrasjen aq sa i kujtohet dhe në bazë të urdhërarresteve që kanë qenë persona të tjerë të përfshirë në këtë vrasje kanë qenë Rr, I .A, por që nuk i kujtohet sakt sepse nuk është nën menagjimin e tij për me i shiku. Ka shtuar se E.S e ka dëgju si emër mirëpo nuk ka pasur kontakt të drejtpërdrejt me të as si zyrtar as në forma tjera, ndërsa sa i përket lëvizjeve të të personave të tjerë që kanë qenë të përfshirë në vrasje ka theksuar se lëvizjet e tyre ditën kritike kur ka ndodh rasti i kanë vërtetu dhe sa i kujtohet lëvizjet e tyre kanë qenë nga Hotel G” nëpër rrugë të cilat shpjen në Dardani në pjesën e incidentit ku ka

ndodh, në pjesën e incidentit ku ka ndodh, në pjesën e kafe Bar S” siç u përmend edhe në lëvizjet e tjera por që nuk i kujtohen. I njëjti është pyetur edhe lidhur me atë se a ka dëgjuar nga ana e dëshmitarëve që kanë thënë se E.S do t’i marr këto veprime ndaj T.R, i njëjti ka deklaruar se personalisht ai nuk i ka dëgjuar, por ka dëgjuar nga policët e tjerë që kanë hetuar rastin dhe që kanë qenë kontaktuar si dëshmitarë.

Seanca e radhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitarit L.M

11.Dëshmia e dëshmitarit L.M

I njëjti përgjatë deklaratave të tij të dhëna në kuadër të seancave të shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura parandë kësaj gjykate më datat 12.02.2015, 20.09.2015, 25.02.2019, 07.09.2021 ndër të tjera ka theksuar në vitin 2007, ka punuar në Drejtorinë e Krimeve të Rënda, në nivelin Qëndror në Drejtorinë e Policisë me gradën nën kolonel, thuajse e tërë karriera e tij ka qenë në fushën e hetimeve. Ditën kritike, me datën 30.08.2007, kur është vrarë oficeri policor T.R, kishte qenë në detyrë por edhe sikur të mos ishte në detyrë, në raste të tilla thirren dhe angazhohen në procesin e punës. Në rastet kur vritet një oficer policor, figura politike apo shtetërore, hetimet lidhur me rastet e natyrës së tillë i ka zhvilluar Drejtoria e Krimeve të Rënda. Fillimisht në rastet e vrasjeve, reagimin e parë e bëjnë niveli i Stacionit Rajonal, dhe pasi që ky incident kishte ndodhur në orarin e punës, ishin njoftuar shpejt për vrasjen e tani të ndjerit T.R. Njëri nga eprorët i cili kishte qenë në vendin e ngjarjes ishte togeri F.G mirëpo kishte pasur edhe oficer tjerë të cilët kishin ndërmarrë veprime si ekip, sektor dhe jo individualisht. Informacioni i parë nga vendi i ngjarjes që kishte marrë kishte qenë se T.R është i vrarë në qytet dhe dikush me shpejtësi është larguar nga vendi i ngjarjes, pasi që kishte shtënë në të. Për shkak të historikut pothuajse të njohur që T.R kishte pasur problem me E.S, sigurisht se mendja e të gjithëve ka mundur të shkojë se mund të ketë lidhje me E.S. Personi i cili kishte shtënë në T. ishte i panjohur dhe rrethanat se si kishte shtënë në të tregojnë se ka dalë pikërisht për të kryer vrasjen pasi që nuk kishte pasur ndonjë konflikt aty për aty. Në ndërkohë kishin pranuar një informacion se një person, një qytetar kishte bërë një foto të atij personi i cili kishte qenë duke u larguar nga vendi i ngjarjes. Zakonisht për rastet e vrasjeve, në 24 orët e para ndërmerren shumë veprime hetimore e që rriten gjasat për të zbuluar kryesin e veprës penale. Diten kritike nga vendi i ngjarjes kishte komunikuar me toger F. i cili kishte qenë bashkë me prokurorin O.M, dhe sipas njohurive të tij ishte e nevojshme që të kryhen bastisje në lokalit “Kafe Bar S” i cili gjendet në lagjen Dardania, pastaj në shtëpi dhe lokalet tjera përcjellëse të akuzuarit E.S. Në vendin e ngjarjes është kërkuar që i njëjti të kontaktoj me gjyqtarin e procedurës paraprake z. D.H, komunikimi kishte qenë direkt dhe në bazë të aprovimit të urdhrin verbal për bastisje, mbi bazën e kësaj vlerëson se njësitë policor kishte kryer bastisjen. Gjyqtarja e procedurës paraprake kishte qenë e njoftuar lidhur me bastisjen, bastisja primare është bërë në lokalit “S”, bastisja në shtëpinë e të akuzuarit E.S dhe përherë lidhur me bastisjen kontaktojnë gjyqtarin se ku do të bëhet bastisja dhe në rastin konkret ishte e specifikuar lokali, shtëpia dhe objektet përcjellëse. Kontakti me gjyqtarin ka qenë menjëherë pas incidentit derisa prokurori O.M ishte në terren me njësitë përkatëse. Kodi i Procedurës penale e rregullon çështjen e bastisjes, kur ka kohë të mjaftueshme në dispozicion bëjnë kërkesë verbalisht nga gjyqtari i procedurës paraprake, mirëpo në rastin konkret, gjyqtarja nuk ka pasur kohë që të jap urdhër me shkrim, në këtë mënyrë kanë vepruar qindra herë sepse edhe ligji kështu e parasheh, në të kundërtën po të ishte përgjigja negative nga ana e gjyqtarës, nuk do të kishin vepruar. Toger F.G kishte qenë në komunikim direkt me prokurorin O.M në vendin e ngjarjes. Në raste të tilla, prokurorët kërkojnë që të kontaktohet me gjyqtarin e procedurës paraprake për marrjen e urdhrin verbal gjë që edhe kishte vepruar në këtë mënyrë. Për të gjitha bastisjet dhe veprimet e ndërmarra kishin përpiluar procesverbalet. Në momentin kur ishte kërkuar bastisja, nuk kishin pasur informacione për emrin e të dyshuarit si kryes i veprës penale, më vonë kishte qarkulluar

fotografia e tij, me punë operative është arritur të identifikohet se bëhej fjalë për personin me emër A.B

Seanca e rradhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitares D.H

12.Dëshmia e dëshmitares D.H

tani me profesion avokate, ish gjyqtare Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në këtë çështje penale kishte udhëhequr procedurën paraprake hetimore, lidhur me vrasjen e policit T.R, me datën 30.08.2007, lidhur me urdhrat dhe urdhëresat në ditët e para të vrasjes së T.R, është vërtetuar se në kallëzimin penal të parashtruar nga Policia e Kosovës, ishin disa emra të pandehurve për të cilët seanca e paraburgimit ishte mbajtur në ndërtesën ku ndodheshin zyrat e Prokurorisë Speciale, mirëpo emrat e të pandehurve, të mbrojtësve, të prokurorëve dhe policëve nuk i kujtoheshin. Me siguri të plotë kishte deklaruar se kishte lëshuar urdhra sa i përket këtij rasti mirëpo në pyetjen specifike të prokurorit lidhur me bastisjen e lokaleve, pronave, lokalit “S” nga Policia e Kosovës, në mbrëmjen e datës 30.08.2007, nuk i kujtohej të ketë lëshuar urdhër verbal dhe as se kishte lëshuar urdhrin verbal të cilin i’ a kishte komunikuar gojarisht përmes telefonit zyrtarit të lartë të policisë L.M, mirëpo nëse policia e kishte kontaktuar në telefon për ndonjë urdhër verbal për bastisje për ndonjë rast urgjent, me siguri se do ta lejonte këtë dhe do të kërkonte nga policia që brenda fatit 12 orësh, t’i dorëzonin në zyrën e saj kërkesën me shkrim për bastisje, të cilën kërkesë do ta kontrollonte dhe verifikonte, që bastisja (kontrolli) të kryhej në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtë do ta vërtetonte me anë të nënshkrimit të saj që do të vërtetohej se kërkesa është shqyrtuar në zyrën e saj dhe ishte njoftuar, edhe sikur ndonjë nga zyrtarët policor do ta kontaktonte përmes telefonit, për të kërkuar lëshimin e një urdhri verbal si rezultat i një situatë emergjente, pa i përmendur hapësirat e ndryshme për bastisjen e hapësirave të ndryshme, sigurisht se nuk do të lëshonte një urdhër të tillë pa i ditur specifikat e rastit dhe mënyra tjetër përmes së cilës do t’i nënshkruante dokumentet e policisë do të ishte e mundur të bëhej në formë të një shënimi zyrtar i cili do të vërtetonte se një urdhër i tillë kishte ekzistuar. Lidhur me urdhrin për ekzaminimin e 6 (gjashtë) telefonave, për dëshmitë e gjetura në kafenenë “S” si dhe me aktvendimin me të cilin ishte urdhëruar zbatimi i masës së paraburgimit, përveç kërkesës së prokurorit kishte edhe dëshmi tjera bashkëngjitur kërkesës në fjalë, mirëpo ishte e bindur se urdhrin e kishte lëshuar vetëm duke u bazuar në kërkesën e prokurorit dhe se nuk kishte pasur kohë që t’ia hidhte një sy dhe të lexonte tërë dosjen e rastit për të parë nëse ato ishin aty, pasi që policia ishin duke pritur me urgjencë një urdhëresë të tillë dhe atë javë kishte qenë gjyqtare në kujdestari dhe kishte pasur 20-30 raste, gjykata atë kohë ishte e stërngarkuar.

Seanca e rradhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitares K.B

13.Deklarata e K.B

E dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datën 07.10.2021, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratave të mëparshme të dhëna në seancat e shqyrtimeve gjyqësore, dhe kërkoj nga trupi gjykues që deklarata e saj mos të merret, të cilën kërkesë trupi gjykues e aprovoi me aktvendim me pëlqimin e Prokurorit Special dhe mbrojtëses së të akuzuarit, që deklaratat e dhëna pranë Prokurorisë, Policisë dhe shqyrtimit gjyqësor pranë gjyqtarit të EULEX-it, të konsiderohen të lexuara, ndërsa nga deklarata e saj e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datën 21.11.2014, është vërtetuar se: Rr.A është bashkëshorti i saj, të cilin për herë të parë e kishte takuar në muajin nëntor të vitit 2006, atë kohë punonte në një shitore në lagjen Dardania dhe kishte shkuar për të blerë kafe në “Kafe Bar S” në të cilën kalonte kohën edhe Rr, aty ku edhe ishin njoftuar. Rr kishte nofkën Rr” të cilin e takonte thujse për çdo ditë e shumë shpesh në kafiteri S” Rr. shoqërohej shumë me kushëririn e tij I.A. Për personin me emrin A, e njëjta kishte deklaruar se ishte A.B, shok i Rr, t të cilin e kishte parë në kafenenë e S. derisa e njëjta shkonte për ta takuar

Rr.A edhe para vrasjes së T.R, në gusht të vitit 2007 ku ka theksuar se të njëjtin e ka parë tri katër herë në përgjithësi ndërsa kur e njëjta është ballafaquar nga ana e prokurorit me deklaratën e dhënë në prokurori në të cilën kishte deklaruar se “Unë shpesh e kam parë A.B në kafenenë e S para vrasjes së T.R” dhe se a është e vërtetë e njëjta ka deklaruar se “po”, ndërsa E.S e kishte parë vetëm në TV. Me A.B ishte shoqëruar derisa ishte me shoqen e saj Sh.I e cila ishte dashnorja e tij. Pas ngjarjes kritike, Rr e kishte parë në shtëpinë e tij për 5-10 minuta pas disa muajve sepse i njëjti ishte në arrati. Në dëshminë e saj kishte pranuar faktin se ditën kritike e kishte kontaktuar A.B në numrin e telefonit 044 ///-////, me të cilin kishte biseduar dhe e kishte pyetur për Rr. Në “Kafe Bar S” ishte shoqëruar me Rr, I dhe A, ndërsa me N.S dhe E.S asnjëherë dhe atë akuzuarin as që e kishte përshëndetur dhe as që kishte pasur ndonjëherë kontakt me të. Me Rr I, E.Z dhe A.B kishin shkuar edhe në lokale tjera si :restorant P// në Gj. Në Q., në M. dhe fshatin S/. E.Z ishte e dashura e I.A.

Seanca e rradhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitarit Xh.B

14.Deklarata e dëshmitarit Xh.B

I njëjti kishte dhënë deklaratë në polici më datën 05.09.2007 dhe në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë më datën 19.01.2022.

Në deklaratën e tij në polici kishte theksuar se ditën kritike të 30.09.2007 kishte shkuar në lokalin S” rreth orës 14:15, ku aty kishte takuar personat N A, N.S dhe dy kamarierat që ishin në lokale. Ai ka potencuar shkuarjen në lokal se N. i kishte mbetur disa euro borxh dhe kishte shkuar për t’ia kërkuar dhe më pas kishte vazhduar të qëndroj në lokale, kishte pirë kafe dhe sipas tij Nja kishte përmend borxhin dhe më pas rreth orës 15:10, ai ishte quar dhe ishte dal nga lokali, ku kishte shkuar në një lokal tjetër. Dëshmitarit i ishte prezantuar fotoja me numër evidence T-1 dhe më pas ai e ka identifikuar si A.B që e njëjfte kohë më parë në shkollë dhe se atë ditë e kishte parë në parking para se të hynte në lokalin S”, ku A e kishte ngushëlluar për babgjyshin që i kishte vdekur dëshmitarit kohë më parë. Dëshmitari po ashtu është pyetur se a e kishte parë me kënd shoqërohej A dhe ai është përgjigjur se A ishte shoqëruar pikërisht me personin Rr. dhe ishte gjithnjë sipas dëshmitarit me veturat e grupit S.

Në seancën e datës 19.01.2022 i njëjti kishte deklaruar se banon në rrugën "Sh.H" e cila rrugë gjendet në lagjen K.T, ai ka shtuar se E.S e ka njohur si person i lagjës si kojshi dhe me të cilin nuk ka pasur raporte vetëm se ka pasur një përshëndetje. Ai ka shtuar se ka njohur djalin e axhës së E, N dhe vëllaun e E, N. I njëjti ka deklaruar se janë marrë me shitjen e pemëve e perimeve dhe se familja S ka blerë prej tyre po që ka qenë nevoja edhe u'a kanë dërguar edhe në shtëpi, i njëjti ka qenë në dijeni se të njëjtit kanë mbajtur një lokal tek “B.K”. Këtë lokal ka shtuar se e ka vizituar vetëm kur ka pas kohë të lirë dhe kur ka pas ndonjë obligim kur ka dërguar mall tek shtëpia e tyre është shku me i marr të hollat në lokal nga vëllau i E, N. I njëjti është pyetur lidhur me atë se a e njeh A.B, i njëjti ka deklaruar se e njeh vetëm si figurë, dhe se nuk i kujtohet se a ka parë ndonjëherë kur ka shkuar në lokalin S. Lidhur me ditën kritike ka shtuar se me këtë nuk më kujtohet se kanë shkuar shumë vjet por kemi pasur rast vdekje gjyshi i tij ka vdekur, dhe qelimet i kanë mbajtur si sot në mbrëmje i kanë kryer. Kur kanë dal me i përshëndet disa familjarë të cilët nuk kanë mundur të vinin, ka qenë në treg me pastru tezgën për me fillu punën, për shkak se kanë pasur rast vdekje, dhe ka dal për me i mbledh të hollat kujt i ka dërguar pemë dhe perime në shtëpi, madje ka shkuar për të pirë kafe tek "M" në Bill Kllinton, e që pastaj ka shkuar në lokalin S”, ka hyrë e ka taku N dhe aty i ka shprehur ngushëllime për babgjyshin që i ka vdekur, dhe se ka qenë një shumë e vogël e parave diku 32 ose 33 euro nuk i kujtohet saktësisht nuk ka qenë shumë e madhe mirëpo për në treg ka qenë e mjaftushme. Ka shtuar se nuk e ka parë A.B në lokal S” atë ditë dhe se nuk e ka parë asnjëherë në lokalin S”

Prokurori special dëshmitarit ja ka dhënë në shikim procesverbalin e datës 05.09.2007, i njëjti ka konfirmuar se procesverbali i ka gjithsejt 5 faqe në të gjitha faqet dhe e konfirmon se është

nënshkruar nga ana e tij. Prokurori special dëshmitarin e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë më herët, ku në këtë procesverbal i njëjti kishte deklaruar se "*pasi që jam takuar me A.B në lokalin S" në parking...*", "*Unë sa herë kam shkuar në Bar S" gjithmonë A ka qenë aty*", pyetja është se cila deklaratë është e vërtetë atëherë apo tani, dëshmitari është përgjigjur se "*prej tregut kam ardhur me autobus deri tek Bar S" në D", dhe bar S" e ka hyrjen përpara, unë A.B atë ditë nuk e kam parë, dhe se më ka shprehë ngushëllime pas 15 ditëve për babgjyshin nuk është e vërtetë, sepse mua babgyshi më ka vdekur 1 apo 2 ditë para se me ndodh rasti, qelimet i kemi kryer familja dhe jam dalë të pasnessërit për me punu*". I njëjti është pyetur sërish nga prokurori special se me kënd shoqërohej A.B, e që i njëjti ka deklaruar se me D.H e di se i thoshin Arap Arap. I njëjti përgjatë deklaramit të tij është pyetur lidhur me kohën se kur ka dhënë dëshmi ku mbrojtësja e të akuzuarit E.S e ka pyetur se përgjatë dëshmisë thatë se ju keni dhënë në mbrëmje deklaratë, ndërsa në deklaratën kur e keni filluar shkruan në ora 14:00 në secilën faqe të deklaratës, dëshmitari deklaroi se kanë qenë në kafe bar "M" Bill Kllinton që luajn Shah dhe ora ka qenë afër 20:00, kjo bëhet fjalë pas 1 jave pasi që ka ndodhur rasti i vrasjes së T.R dhe një kojshi i ka thënë se a po shkon prej shpie, emri i të cilit nuk i kujtohet pasi që ka kaluar kohë e gjatë dhe se kur kan dal te dera e lokalit "M" nuk ka ditur asgjë vetëm kur i kanë kap policia dhe se kojshia nonstop i kundërshtonte sepse kishte qenë në moshë pasi që sjelljet e policisë kishin qenë marramendëse, dhe se të nesermën thotë në ora 13:00 ka shku në polici me jap deklaratë. I njëjti ka deklaruar se ka pasur keqtrajtme nga ana e policisë kur është marrë në pyetje, ndërsa prokurori special të njëjtin e ka pyetur lidhur me atë se a është ankuar dikund te eprorët e tij për këto sjellje të policëve, i njëjti është përgjigjur se është shku me u anku dhe nuk e kanë lënë te dera me u afru pasi që e kanë kuptu për çfarë arsye ka shku.

Seanca e rradhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitarit O.M

15.Deklarata e dëshmitarit O.M

I njëjti ka dhënë deklaratë në seancën e datës 20.07.2015 në të cilën seancë kishte deklaruar se kishte qenë prokurori i rastit të hetimit të vrasjes së T.R, i cili me datën 30.08.2007, kishte shkuar në vendin e ngjarjes, tek parkingu "F", për të bërë inspektimin e vendit të ngjarjes dhe i kujtohej se në vendin e ngjarjes kishin qenë policia e Krimeve të Rënda. Në bastisje të lokalit "S" nuk kishte marrë pjesë për arsye se bastisja ishte kryer pas përfundimit të orarit të punës, në raste të tilla, kur gjykata nuk ka punuar pas orarit të punës, ishte praktikë që të kontaktonin gjyqtarin e procedurës paraprake dhe me këtë vërtetohej se kishin siguruar urdhrin verbal për bastisje.

Dëshmitari ka dhënë deklaramin e tij edhe në seancën e datës 05.05.2022 në të cilën seancë ka deklaruar se mbetet pranë dëshmisë së tij të dhënë në seancën e datës 20.07.2015. Lidhur me ditën kritike të 30.08.2007 ka deklaruar se ka qenë Prokuror i Qarkut në Prishtinë dhe ka qenë në punë, nuk e din saktësisht a ka qenë kujdestar por e din që kryeprokurori O.K i ka thënë të dal në vendin e ngjarjes ku sa i kujtohet ka qenë prezent edhe policia e Krimeve të Rënda dhe me policinë e Krimeve të Rënda kanë dal në vendin e ngjarjes, ku ka qenë rreth orës 16:00 e që prezent ka qenë edhe një zytar i Policisë së Kosovës së Krimeve të Rënda me emrin F.G Dëshmitari tutje është pyetur lidhur me atë se pasi që policia ka kërkuar nga ai që të udhëzohen si të veprojnë tutje, a i kujtohet të njëjtit se a është kërkuar nga policia ose a ka dhënë ndonjë udhëzim që duhet të kryhet ndonjë bastisje, ndonjë kontrollë ndonjë vend të caktuar lidhur me këtë rast, i njëjti ka deklaruar se në fillim e thash se nuk është i sigurt se a ka qenë kujdestar apo jo atë ditë, aryeja është që po e thot se prokurori kur ka dalur në vendin e ngjarjes e ka pasur telefonin e kujdestarisë dhe ka qenë në dijeni se kush është prej gjyqtarëve kujdestar, më sa i kujtohet është polici i krimeve të rënda me mbiemrin G. dhe sa i kujtohet se kujdestare si gjyqtare e procedurës paraprake ka qenë gjyqtarja D.H, pasi që gjatë orarit të punës nuk ka pasur mundësi që të bëhet kërkesa nga prokurori lidhur me bastisjen e ndonjë objekti apo lokali edhe pse në raset urgjente policia ka pasur të drejtën të bëjë kërkesë të drejtpërdrejtë tek gjyqtari i procedurës

paraprake, ku i kujtohet se polici i krimeve të rënda me mbiemrin G, e ka thirr gjyqtarën e procedurës paraprake lidhur me disa bastisje se për ku nuk i kujtohet por e din që ka biseduar drejtpërdrejt me gjyqtarën, por shton që si prokurori nuk ka marrë pjesë në bastisje as nuk e din se cilat lokale kanë qenë. I njëjti tutje është pyetur lidhur me atë se pse nuk është bërë kontakti nga ana e ktij si prokuror me gjyqtarën e procedurës paraprake por nga ana e zyrtarit policor, i njëjti ka deklaruar se unë në fillim thashë se nuk e di se a ka qenë kujdestar atë ditë dhe se a e ka pasur telefonin e kujdestarisë të prokurorisë atë ditë, por e din se ka qenë afër tij, është konsultuar me policin G, nuk e din se çfarë grade ka pasur ka harruar, por që në prezencën e tij e ka thirr gjyqtarën dhe me siguri edhe gjyqtarja e ka ditur se i njëjti është prezent dhe se kanë vendosur bashkarisht për me e dhënë urdhëresën gojore për bastisje, pasi që nuk ka pasur mundësi që brenda orarit të punës të merret urdhëresa me shkrim. Sa i përket veprimit në këtë mënyrë është pyetur lidhur me atë se gjatë përvojës së tij si prokuror a ka pasur raste që janë kry bastisjet, kontrollet pa urdhër të gjykatës qoftë të shkruar apo urdhër verbal, i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet se ndonjëherë kanë qenë në bastisje pa urdhër gojor të gjyqtarit të procedurës paraprake. Dëshmitari përgjatë deklaramit të tij është pyetur nga avokatja mbrotjtëse e të akuzuarit E.S lidhur me atë se si është e mundur të konstatohet në procesverbal se i njëjti ka dalur në vendin e ngjarjes në ora 17:40 min, ndërsa ju deklaruat se ju kujtohet se keni dalur në vendin e ngjarjes kah mbarimi i orarit të punës pra në ora 16:00, ku dëshmitari ka deklaruar se unë thash se afërsisht kah mbarimi i orarit të punës, ndërsa saktësisht nuk e din se nuk ka mbajtur kurrfarë shënime, por mendon që ka qenë ora rreth 16:00 për arsye se deri në ora 16:00 kanë punuar ndërsa pas orës 16:00 ka shkuar në shtëpi në P, ndërsa at ditë ka qëlluar në zyre. Tutje i njëjti është pyetur me atë se nëse i kujtohet që gjatë orarit të punës ka qenë në zyre pse nuk është bërë kërkesa tek gjyqtarja e procedurës paraprake pasi që e njëjta ka qenë vetëm një kat më poshtë në objektin ku ka punuar, i njëjti është përgjigjur se pikë se pari pa dalur në vendin e ngjarjes, pa u bërë vendshiqimi, ekzaminimi, konsultimi me policinë nuk kemi pasur mundësi të bëjmë kesi lloj kërkesa. I njëjti po ashtu është pyetur lidhur me atë se a e dini se kur sigurohet urdhri verbal duhet brenda afatit 12 orësh që të sigurohet retroaktiv urdhëresa me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe atë pas dorëzimit të raportit policor nga ana e zyrtarëve të cilët i kryejnë bastisjet, i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet. Ndërsa në pyetjet e trupit gjykues lidhur me rastin, saktësisht kur është pyetur lidhur me atë se a ka qenë në dijëni se në rastin e lëshimit të urdhëresës nga ana e gjyqtarës së procedurës paraprake a do të duhet të kujdesej për konfirmimin e urdhrin verbal ka shtuar se unë thash se bashkarisht kam vepruar me zyrtarin policor, e ka marr konfirmimin gojor dhe se çka u bo më vonë nuk është në dijëni, pasi që këtë kërkesë për konfirmimin e urdhrin verbal e ka bërë prokurori i çështjes i cili e ka marrë lëndën që e ka pasur radhën për caktimin e paraburgimit.

Seanca e radhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitarit N.R

16.Deklarata e dëshmitarit N.R

Që i njëjti fillimisht ka deklaruar që deri në nëntor të 2014 ka punuar në Policinë e Kosovës. I njëjti ka shtuar se e mban mend datën e 30.08.2007 kur ka ndodhur ngjarja kritike që ka qenë në krye të detyrës, i cili ka qenë kujdestar nga ora 16:00 e deri në ora 08:00 mëngjes, për ta plotësuar përgjigjen polici që ka qenë kujdestar nuk ka pasur ndonjë përshkrim të detyrave të punës përveç që duhej të paraqitet në thirrje në rastet që binin në kompetencë të hetimeve regjionale dhe më pas do të mund të jetpe ndonjë udhëzim tek policët patrullues që lajmërohen gjithherë të parët në raste do të kryente atë punë, pjesëmarrje në vendshiqime dhe kur rastet janë të nivelit të lartë duhet të thirrej edhe njësia përkatëse që merret ekskluzivist me ato raste. I njëjti ka shtuar se ka njohuri për kontrollet, në dy apo tri lokacione ku ka qenë personalisht edhe ky. Më sa i kujtohet fillimisht ka qenë në lagjen “D” tek lokali “S”, e që nuk e kujtohet mirë se a është futur brenda në lokal, por vetëm e din se ka qenë një kërkesë t’ua dërgon disa procesverbale për kontroll nuk

e din se a është kërkuar nga ai që na nënshkruar apo jo, dhe më pas ka marrë pjesë në kontrollimin e dy apo tri shtëpive, kushtimisht ka marrë pjesë në shtëpinë e E.S, që në atë kohë nuk e ka ditur se është shtëpia e tij, ka hyrë në shtëpinë, në atë kohë ka qenë asistent i hetuesve dhe zyrtarëve të tjerë, për shkak se kujton që në momentin kur ka ndodhur rasti shumica apo të gjithë hetuesit kanë qenë akoma në punë dhe kanë daluar dhe janë marrë drejtpërdrejt me rast hetuesit kompetent të njësive kompetente. I njëjti ka shtuar se procesverbali për ushtrimin të kontrollit në një vend të caktua duhet të përpilohet në rastin e fillimit të kontrollit, ku duhet të shënohen të gjitha detajet, koha e fillimit dhe të gjitha veprimet tjera që parashihen gjatë kontrollit, lidhur me atë se çka duhet të përmbajë një procesverbal ka shtuar se me aq sa mban mend do të cek e që ishin si në vijim: vendi ku kryhet kontrolli, data dhe kohën e fillimit, personat prezent, arsyet e kontrollës, zyrtarët policor pjesëmarrës gjatë kontrollit edhe pse në procesverbal nuk mund të përfshihen të gjithë personat prezentë përveç atyre që janë përgjegjës për rastin, më pas shkruhet se çka është sekuestruar, adresa në të cilë kryhet kjo kontrollë apo urdhri verbal tek fundi nëse pronari ka vërejtje dhe dëshmitarët nëse kanë vërejtje, nënshkrimet e dëshmitarëve, pronarit dhe zyrtarëve përgjegjës dhe koha e përfundimit, po ashtu edhe procesverbalin e nënshkruan ai që e mban procesverbalin.

Të njëjtit i janë prezantuar procesverbali mbi bastisjen e lokalit Bar S” ër ta dëshmuar se a është ky procesverbal i nënshkruar dhe i hartuar na ana e tij, i njëjti ka deklaruar se në pjesën e parë është i shkruar nga unë, pjesa tjetër fleta e dytë e ka vetëm nënshkrimin e tij ndërsa shkrimi tjetër nuk është i tij. Po ashtu është pyetur lidhur me atë se a ka qenë në dijeni se a ka pasur urdhër të gjykatës ose një urdhër gojor për bastisje të lokalit Bar “S” ose vende të tjera, ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni. Lidhur me plotësimin e këtyre të dhënave ka shtuar se procesverbalin me të dhëna që i ka plotësuar, i ka shkruar në momentin që ka shkruar tek lokali S”, në fletën e parë dhe nënshkrimi në fund pasi që është kërkuar nga të tjerë që kanë qenë duke udhëhequr rastin që ai si kujdestar ta plotësoj procesverbalin. Më sa kujton nuk ka qëndruar gjatë kontrollit në kafën “S” dhe se e din sigurt se nuk ka bërë asnjë veprim kontrollues.

Tek procesverbali i kontrollit në shtëpinë e H.S, nuk është i nënshkruar nga ai dhe nuk ka fare nënshkrim të zyrtarit policor, po ashtu tek procesverbali tek F.S nuk është i nënshkruar nga ai dhe nuk ka nënshkrim të zyrtarit policor, është i hartuar nga ai dhe shkrimi është i tij tek 3 procesverbalet të cilat janë hartuar nga ai.

Tutje i njëjti është pyetur lidhur me hartimin e procesverbaleve ku në procesverbalin ku është kontrolluar lokali “S” me rastin e deklarimit të tij që i njëjti i ka hartuar këto është plotësuar vendi se bastisja e banesës dhe personave në lokalin Bar “S” është bërë me urdhrin e gjyqtarës D.H kurse në lokalin “Bar S” nuk është plotësuar vendi se me urdhër të kujt është kryer bastisja, a ka ndonjë shpjegim lidhur me këtë, ku në këtë rast dëshmitari ka deklaruar se siç tha edhe më herët nuk ka marr ndonjë veprim kontrollues, përveç i ka shërbyer të jetër çfarë i është kërkuar si kujdestar i asaj dite. I njëjti ka shtuar se nuk i kujtohet se nga kush ka marr urdhër dhe se nga kush është telefonuar, po ashtu sa i përket plotësimin të dhënave në procesverbal ka shtuar se nuk ka qenë kompetent, edhe pse më herët ka deklaruar se kujdestari nuk ka pasur ndonjë përshkrim konkret të detyrave që duhet t’i bëjë, por në atë kohë siç e ka cekur edhe ma herët, duke mos pasur njohuri për mënyrë të kujdestarisë në hetimet e përgjithshme, i është kërkuar të tjerët dhe i ka bërë ato veprimet që i është kërkuar në asistencë, ai nuk e din se kush i ka kërku që t’i bëjë këto veprimet por nuk është e ndaluar që i njëjti ta nënshkruaj në procesverbal edhe pse më vonë e ka kuptuar se në disa procesverbale ekziston vetëm emri i tij, e në shumicën e procesverbaleve duhet të ishte edhe zyrtari përgjegjës i kontrollit dhe mungon emri i tij dhe kanë lënë vetëm emrin e tij.

Seanca e radhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitareve A.I, E.I dhe Z,I

17.Deklarata e dëshmitares A.I

E dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datën 27.04.2015 si dhe ajo e datës 18.11.2022 e cila ishte e mbyllur për publikun kishte dëshmuar se e kishte njohur T.R në vitin 2006, i cili kishte shkuar si mysafir në shtëpinë e saj e i cili kishte pyetur për problemet në lagjen e saj. Me të akuzuarin E,S personalisht mohon të ketë pasur ndonjë problem. Me T.R kishte filluar një lidhje më datën 27.09.2005. E njëjta fillimisht është pyetur lidhur me lidhjen e saj dhe T.R se a ishte e njëjta në lidhje me T.R kur ka ndodh rasti i “S.C”, e njëjta ka theksuar se besoj që po, edhe pse në momentin kur ka dekalruar nuk i kujtohet a ka qenë në paralidhje apo në lidhje sepse në fillim kanë qenë shok, i kujtohet se kur ka ndodhur rasti i “SC” kanë qenë Krishtlindjet, dhe se lidhur me këtë rast ka deklaruar se T. si ka dhënë detaje, por i ka treguar që ka ndodhur diqka ka insistu me ditë më shumë rreth këtij rasti por nuk i ka treguar T, me siguri mos ta shqetësonte, ajo ka potencuar se e ka ditur që bëhet fjalë për Grupin S, e njëjta poashtu është pyetur se kush ka qenë pjesë përbërëse e këtij grupi ajo ka deklaruar se E.S dhe plotë të tjerë që nuk i kujtohen sepse kanë pasur edhe nofka. Para ngjarjes kritike të datës 30.08.2007, ajo kishte deklaruar se ka qenë në dijeni se T. ka pasur probleme me Grupin S., probleme me profesion me ta që ka qenë i ngacmuar nga ata, e njëjta ka theksuar se T. kishte ndjenjën se po përcillej dhe si rast specifik ishte kur T. ishte duke e dërguar tek shtëpia e gjyshes së saj, atë kohë quhej rruga “S.M dhe këtë e kishte kuptuar në një moment kur T. i kishte thënë: “mos u kthe prapa, mos provoko, i kemi ata prapa po na ndjekin” dhe ata që po i ndiqnin ishin nga Grupi S. Ndjekje të tjera kishte edhe te Qafa, mandej në lagjen e T. dhe përgjatë seancës të datës 18.11.2022 e ka përmendur edhe rastin që ka ndodhur në fshatin e T fshatin S.. ku i njëjti i ka treguar se ka dyshuar që janë Grupi S, Lidhur me problemet e T. me E.S ka theksuar se ajo ka qenë në dijeni se T ka pasur problem me të ashtuquajturin Grupi S, por nuk kujtohet se a ka pasur problem me A.B. Po ashtu nga anëtarë i trupit gjykues është pyetur lidhur me atë se disa herë përgjatë deklaratës së saj në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë ka specifikuar se shumë gjëra nuk i kujtohen për shkak të kohës që ka kaluar dhe e njëjta është pyetur se, a do të duhet që kujtesa e saj në lidhje me rastin të ishte më e kthjellët në deklaratat e mëparshme se sa atë to sotmen duke marrë parasysh kohën që ka kaluar, e njëjta është përgjigjur se “*po besoj, që në kujtesën e saj ka ndikuar koha e gjatë, por edhe trajtimi mjekësor që ka marrë pas asaj ngjarje*”. Lidhur me Grupin S, e njëjta ka deklaruar se si Rr. dhe L. dhe të gjithë ata që i ka përmendur më herët i kanë denoncuar në polici si familje po që nuk i kujtohet se çfar përmbytje ka pasur ngacimimi dhe përmbytja e denoncimit për arsye se ka shumë kohë që ka ndodhur kjo gjë. Personin me emrin A.B kishte mohuar ta ketë njohur, po ashtu ka mohuar se e njëjta ka pasur ndonjëherë lidhje me të akuzuarin E.S

18.Deklarata dëshmitares E.S

E dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të mbyllur për publikun të datës 18.11.2022 ka deklaruar se mbetet vetëm pranë deklaratës së dhënë më datën 28.01.2015 ku ndër të tjera e njëjta ka theksuar se gjatë periudhës kohore të viteve 2002-2003, kishte një sallon për rregullimin e flokëve, më pas kishte pasur një kompani të marketingut. T.R e kishte njohur para kohës së luftës përmes shoqes së saj, kishin shoqërinë e përbashkët. Me të njëjtin kishte pirë kafe disa herë derisa ai ishte me A. Kohën kur punonte në sallonin e bukurisë, T e kishte takuar vetëm njëherë ndërsa kur i njëjti kishte filluar lidhjen me motrën e saj A, e kishte parë më shpesh. E.S e kishte njohur, ndoshta mund të ketë biseduar ndonjëherë me të, mirëpo motra e saj A nuk kishte treguar asaj se kishte ndonjë lidhje me të, dhe nuk ka ekzistuar një lidhje mes saj dhe E.S. Anëtarët e familjes apo shokët e E.S të cilët i kujtoheshin ishin: N i cili ishte vëllai i E, L (nuk i kujtohet emri), Rr., S.S (nipi i babait të tij), me këtë të fundit kishte pasur problem ditën kur policia kishte arrestuar E.S në afërsi të sallonit të saj, dhe S.S i revoltuar e kishte sharë atë vetëm pse e kishte parë duke qeshur. E njëjta përgjatë deklaramit të saj është pyetur lidhur me atë se a i ka treguar ndonjë herë T se ai është përcjellë, e njëjta ka deklaruar se, po ai më tha atë që është duke u përcjellë nga

dikush prej Grupit S, ku e ndiqnin me makina të njëjtin. E po ashtu e njëjta ka potencuar faktin se ka qenë në dijeni që T dhe A kanë pasur probleme me Grupin S, por asnjëherë me vrasësin e T.R, A.B. Po ashtu e njëjta është pyetur lidhur me rastin e S,C” ku e njëjta ka deklaruar se ka dëgjuar për këtë rast pasi që ka ndodh rasti T e ka thirr në telefon dhe i ka treguar por jo në detaje. Ditën kritike kur është vrarë T.R ka deklaruar se ka qenë në qytet, dhe se i kujtohet se dikush nga fqinjët i ka telefonuar lidhur me rastin dhe ka shkuar drejt në spital, lidhur me vrasësin e T.R, A.B ka deklaruar se kurrë nuk ka dëgjuar më parë për emrin e tij, e qoftë T e qoftë A. snjëherë nuk e kanë përmendur se kanë pasur ndonjë problem e të njëjtin. Në fund e njëjta ka potencuar edhe njëherë faktin se e njëjta kishte qenë në dijeni për problemet që ka pasur A,me T, me të ashtuquajturin Grupin S, por asnjëherë me personin e quajtur A.B

19.Deklarata e dëshmitares Z.I

E njëjta në seancën e datës 18.11.2022 ka deklaruar se mbetet pranë të gjitha deklaratave të dhëna më herët përkatësisht në polici më datën 02.08.2008 si dhe në shqyrtim gjyqësorë të datës 10.01.2015 ku ndër të tjera ka theksuar se gjatë periudhës kohore 2000-2003, profesioni i saj ka qenë këngëtare të cilin profesion e vazhdon edhe tani. Nuk ishte e martuar dhe nuk kishte të dashur, ndërsa me F.Sh ishte takuar për herë të parë në vitin e parë të shkollës së mesme fillimi i vitit 2000, më të cilin kishte qenë në të njëjtën klasë. Në fillim kishin qenë vetëm shokë mirëpo pas dy vitesh lidhja e tyre ishte qift, lidhje e cila kishte përfunduar një vit më parë nga koha kur deklaroi, në vitin 2014. Lidhur me T.R ka deklaruar se i njëjti ka qenë i dashuri i motrës së saj A dhe se lidhjen ata e kanë filluar në vitin 2005, ku fillimisht T së bashku me shokun e tij A.S kanë shkuar në sallën të ondulimit të motrës së tij E, dhe i kanë thënë a keni nevojë për ndihmë, pasi që të njëjtit ishin informuar se familja e saj kishin probleme me Grupin S, në mënyrë që ata t’i ndihmonin, ndërsa më vonë me ftesën e E, ata kanë ardhur në banesën e tyre dhe kanë biseduar me A, M dhe E, ajo ka theksuar se nuk e din se për çka është biseduar por më vonë pas disa takimeve në mes A dhe T. ka filluar lidhja e tyre. Sa i përket problemeve me Grupin S, ka shtuar se e din që A ka pasur probleme me E.S dhe anëtarët e grupit të tij, ku përpos A, edhe M dhe E kanë pasur të raportuara raste në polici por askush nuk është dënuar. Sa i përket problemeve të T. dhe E, ka shtuar se që nga viti 2000 të njëjti kanë pasur probleme në vazhdimësi e deri tek rasti i S.Casino, ku e njëjta ka shtuar se ajo ishte në dijeni se të njëjtit ishin në armiqësi sepse kur dy njerëz përleshën me njëri tejetrin ata nuk janë miq por armiq. E njëjta përgjatë deklaratës së saj ka përmendur edhe personin e quajtur Gj, ku e njëjta kishte kënduar në Prizren ku organizator ka qenë i njëjti, ajo ka shtuar se të njëjtën së bashku me nënën e saj e ka transportuar Gj, nga P” e deri në Prishtinë, ku i njëjti përgjatë rrugës i ka treguar që e ka kusherinë gruan e A.S (B), ku i njëjti i ka potencuar Z. që ka marrë pjesë në pajtimin e A.S dhe E.S. Po ashtu e njëjta është pyetur edhe lidhur me ish të dashurin e saj F.Sh lidhur me atë se a ka qenë i njëjti anëtar i Grupit S, ku ka shtuar se e din që një kohë F. është shoqëruar me E, pastaj janë prishur një kohë mirëpo ka dëgjuar se sërish i janë rregulluar raportet.

Tutje e njëjta është pyetur lidhur me atë se kush e ka vrarë T.R, ku e njëjta ka deklaruar se A.B e që të njëjtin nuk e njeh por vetëm përmes lajmeve është informuar, ndërsa lidhur me atë se me kënd është shoqëruar A.B, ka deklaruar se F.Sh e kishte informuar se A.B ishte anëtar i Grupit S, dhe më së shumti ishte shoqëruar me L, i cili ka qenë anëtar i Grupit S. Të akuzuarin E.S pohon ta ketë njohur, mirëpo personalisht me të kishte biseduar njëherë para shumë kohësh. Derisa kishte qenë me F, E, shte afruar dhe kishte biseduar me F, dhe aty kishte qenë hera e parë kur kishte biseduar duke e përshëndetur me “mirë dita, si jeni”. F.Sh kishte pasur raporte shoqërore me E, ndërsa motra e saj A nuk e kishte pohuar ndonjë lidhje të saj me E.S, mirëpo ekzistonte një lidhje me të, dhe ajo nuk dukej atë kohë e lumtur. Se A. kishte shkëputur lidhjet me E.S, ishte bindur kur gjatë vitit 2004-2005, ajo filloi të dilte me T.R. E kishte njohur T.R në fillim si zyrtar policor mirëpo pas një kohe si të dashur të motrës së saj i cili kishte shkuar në

shtëpinë e tyre disa herë, ndërsa E.S nuk kishte qenë ndonjëherë në shtëpinë e tyre dhe nuk ka qenë i mirëpritur në shtëpinë e tyre.

Seanca e radhës kishte vijuar me dëgjimin e dëshmitarit A.B

20.Deklarata e dëshmitarit A.B

I cili ka deklaruar në seancën e datës 23.01.2023 Në pyetjet e avokates mbrojtëse të të akuzuarit E.S, avokatës K.K i njëjti ka deklaruar se qëndron pranë dy deklaratave të dhëna në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 29.10.2015 si dhe të datës 14.05.2019. I njëjti ka theksuar se ka qenë tregtar i kerreve, ka qenë një qytetar i thjeshtë, që ka jetuar në bashkësi familjare me prindërit e tij, me 2 vëllezërit e tij, motrën dhe kumatë, në vitin 2007 ka qenë 26 vjeçar, përveç tij me tregti të kerreve janë marrë edhe vëllezërit e tij nganjëherë ka punuar edhe motra e tij. Sa i përket gjendjes financiare ka theksuar nuk ka qenë as e varfër as e pasur, ka qenë mesatare. Në vitin 2007 është shoqëruar me disa shokë të mahallës dhe se i njëjti jeton në V' tek Kodra e Trimave. Në vitin 2007 ka shtuar se e ka njohur E.S dhe se nuk kanë pasur raporte as të mira e as të këqija, i njëjti ka njohuri se E.S ka jetuar në Vranjefc dhe se nga familja e E ka njohur D.S i cili ka qenë tregtar i kerreve, ka njohur edhe N.S si figurë por ska pasur kurrfarë raporte me të, e po ashtu e njeh edhe Rr.A është shoqëruar me të dhe se i njëjti ka qenë edhe tregtar i kerreve në atë kohë dhe i ka mbetur një lloj shoqërie me të, kjo do të thotë që është shoqëruar me të dhe kanë pirë kafe rrallë ndonjëherë, po ashtu e ka njohur edhe I.A në atë kohë si figurë por nuk kanë pasur raporte të shumta me të. Më shpesh ka shtuar se është parë me Rr.A. Sa i përket lokalit S, ka njohur si lokal, ka qenë si krejt kafiqat e Prishtinës është flitur si lokal i E.S dhe asgjë më shumë, në atë lokal ka qenë me shoqëri të lagjës, mahallës dhe kanë pirë kafe asgjë më shumë, në lokalin S, përpos me Rr.A që ka pirë kafe, është shoqëruar edhe me F.D dhe O.T, lidhur me atë se sa shpesh e ka frekuentuar këtë lokal ka shtuar se nuk ka shkuar shumë shpesh, brenda një jave një herë ka mundur të jetë shkuar por jo shumë shpesh, sa i përket E.S ka shtuar se e ka parë një herë në lokal, kur ky ka qenë në lokal tu pi kafe dhe ka qenë rastësi që janë pa. Në shoqëri të E.S nuk ka ndejt asnjëherë pasi që nuk i ka lidh asnjë raport me të. I njëjti është pyetur se a ka punuar ndonjëherë në lokalin S. qoftë për një ditë të vetme, i njëjti ka deklaruar unë nuk kam punuar në lokalin “S” kurgjo dhe se aty ka shku vetëm si qytetarë me pi kafe në atë lokal, e as në kompanin “ B” Kafe ska punuar asnjëherë. Po ashtu i njëjti është pyetur se a ka qenë ndonjëherë ne shtëpinë e E.S, ai ka deklaruar se vetëm një herë ka qenë aty, ka shkuar rastësisht dhe aty ka qenë me D.S, ku atë ditë D.S e ka thirr me pi kafe dhe aty rastësisht te shtëpia e E, dyert e oborrit të shtëpisë së E jon kon qelë dhe kishin qenë edhe disa këngëtarë me sharkia që këndoreshin në oborr të shtëpisë së E dhe D i ka thënë “mos më le me ndejt vetëm, hajde rrina bashkë, dhe i ngojnë këta këngëtarët me sharkia se këndojnë mirë” dhe ajo ka qenë hera e parë që ka qenë në shtëpinë e E.S në oborr dhe brenda në shtëpi të tij nuk ka qenë asnjëherë”.

Tutje i njëjti është pyetur lidhur me CD që e kanë shikuar në vitin 2015 se a qëndron pranë atyre deklaratave, i njëjti ka shtuar se qëndron pranë deklaratës së dhënë para gjyqtarëve të EULEX-it, në foton e prezantuar ka treguar që është personi me nr.2 nga ana e majtë, ku kjo fotografi është bërë në lokalin “S” Bar, ndërsa personi nr.1 nga ana e majtë është F.D shok i mahallës, personi nr.3 është O.T shok i mahallës, dhe me nr.4 është I.A nga lagjja V., dhe personi nr.5 është K', ku kanë qenë duke pirë birra. Tutje është prezantuar fotografia 0164 ku është e njëjta përbërje por edhe një person shtesë, ku shihet se fotografinë nr.2 në vend të F.D është ulur dikush tjetër, i njëjti ka deklaruar se është personi E.S, është e njëjta ditë dhe e njëjta ndej, pasi që edhe rrobat të njëjta i kanë pasur dhe mbrëmje ka qenë kur janë bërë këto foto aq sa i kujtohet të njëjtit, foton e parë atë mbrëmje E. nuk ka qenë aty, ai dhe E. nuk kanë pasur raporte, dhe E, erdhi aty rastësisht, ka hyrë në lokal atë ditë dhe një shok i imi F.D, foli me E.S, u qua në këmbë dhe i'a lëshoj karrigen dhe i tha “a po ulesh këtu, po kem qejf me bo një foto me ty me mbajt si kujtim” dhe E. i tha “po bon me bo foto” dhe kemi bërë atë foto dhe E. nuk ka ndejt aty shumë më pstaj

dhe është qua dhe ne kemi vazhduar aty duke pirë. Raste tjera që i përmendi më herët që ka shkuar me D.S në oborr tek E.S, por nuk ka ndejtur me E. Përgjatë deklaratimit të tij është pyetur rreth kryerjes së veprës penale të Vrasjes e që është duke vuajtur dënimin, i njëjti ka shtuar se qëndron pranë deklaratës që i njëjti ka kryer veprën penale dhe se është penduar për veprën penale, ka shtuar se 6 muaj para se me ndodh vrasja e ka njohur T.R dhe të njëjtin e ka njoftuar prej një shitorje në lagjen "D" e cila shitore thirret "Max", kur jam dalur prej shitores më ka ndaluar mi ka kërkuar dokumentet, me qenë se ish kon me rroba civile, dhe unë nuk e kam njohur më përpara, dhe ai më tha "*ami dokumentet*", dhe unë i thashë "*kush je ti me ti dhënë unë dokumentet*" ai më tha prapë si me nervoz "*ami dokumentet se të rrehi të qoj në polici, dhe ta bëjë më but shpinën se barkun*", pa më treguar kurrfarë dokumenti se është policë, unë i thashë "*çka po dyshon në mua*" dhe i'a dhashë dokumentet, dhe unë e kam pasur një tiketë që më pat dënuar policia për kundërvajtje, dhe unë i'a dhashë atë tiketë, dhe ai e mori e shikoj atë tiketë dhe ma kthej prapë, dhe unë e pyeta "*se çka po dyshon në mua*", ai mu përgjigj se "*po më dukesh facë negative*", dhe pastaj me tha "*maje në mend se ku të zateti gjithë kështu e ke*", dhe me tha "*mos të shoh këtu pari hiq*", dhe kjo ishte hera e parë që i njëjti është takuar me tani të ndjerin T.R. Ka shtuar se deri në momentin e parë kur është takuar me T.R nuk ka qenë i dënuar asnjëherë dhe nuk ka pasur vepra penale asnjëherë dhe se nuk ka pasur fjalë të tjera me T.R. Në ato momente ka shtuar se u ndje shumë keq dhe ka menduar se mos ju ka përzier ai me dikënd tjetër, ka shtuar se e ka takuar edhe njëherë edhe 3 muaj para se me ndodh rasti, ku ka qenë duke ecur këmbë tek kafet e vogla rrugës "F.A" në P. dhe përsëri rastësisht është takuar me T.R u i njëjti ka qenë duke e vozitur një xhip të bardhë, e ka ndal veturën dhe ka dal prej veturës dhe e ka ndal të njëjtin, dhe ky i ka thënë "*për çfarë arsye po më ndal*" i njëjti i ka thënë "*çka të kam thënë ty*", dhe ja ka dhënë dy shuplaka në fytyrë dhe i ka thënë "*mbaje në mend mirë sa herë të zateti kështu e ki dhe ik prej këtuhi*". Ka shtuar se nuk ka reaguar as hërën e dytë, dhe se ka ditë që i njëjti ishte polic, i njëjti ka shtuar se ka qenë vetëm por ka pasur edhe qytetarë të tjerë por nuk i kanë rënë në sy nese e kanë parë apo jo, e po ashtu si ka treguar askujt që po e ndal për herë të dytë një njeri dhe po ja jep dy shuplaka për arsye se i ka ardhur inati dhe e ka mbajtur në vete, ka shtuar se nuk është tut prej tij se nuk i ka pasur borxh të njëjtit asgjë por vetëm është qudit. Ka potencuar se herën e tretë kur e ka parë T. ka qenë ditën kritike kur ka ndodh rasti, i njëjti ka shtuar se armën e ka pasur por nuk e ka mbajtur rregullisht me vete, armën e ka blerë 4 muaj para se me ndodh rasti, ku të njëjtën armë nuk e ka mbajtur rregullisht pasi që revolen thekson se e ka blerë me qëllim me e shit me fitu diqka e që edhe herën e dytë kur e ka taku T, nuk e ka pas armën. Sa i përket ditës kritike ka theksuar se rastësisht janë takuar në parkingun e Lagjes D". Ka shtuar se ky ka qenë duke pirë kafe në Lagjen D" po që si kujtohet emri i kafiqit, ka qenë ora 15:30, afër terracës ku ka ndejt 1 orë, ka pi kafe, ka qenë vetëm, kur u qu është nis me shku në "Intermeks" dhe i njëjti u kon tu ec në parking dhe e ka thirr ka fishkëllu tani i ndjeri T dhe janë takuar qaty rastësishtë dhe i njëjti është ndal. Kur ka fishkëllu T, ka shtuar se ka qenë me shpinë i kthyer tu ec, u ndal dhe është kthy, distancën e kanë pas 20 metra qashtu, ka pas njerëz në lokale dhe do tu ec, T, ishte në këmbë. Pasi që është ndal ka shtuar se T, më kapi për këmishë dhe më shajti më tha "*Të q... hajnin e nënës qa po sillesh kësajde ti*" dhe unë i thash "*lëshom thash qa po me maltreton ti, sa herë që po më zatet në udhë*" dhe T.R më shajti dhe më tha "*Hup se po ta q.. nënën se të vraj si qenin*" dhe është kthyer tani aj me shpinë nga një xhip i zi i cili ka qenë aty dhe është ndal dhe më ka shiku dhe me tha "*hup se po ta q.. nënën se po të vras*" dhe tani T.R e ka qu dorën e djathtë në anën e majtë të brezit dhe unë kam menduar se mos po don me nxjerr revolen dhe unë nga frika i pari e kam nxjerr revolën, e kam raportir dhe kam shtënë dy herë rafal në drejtim të tij dhe e kam ndi vetën shumë të rrezikuar dhe kam vepruar kështu në vetë mbrojtje dhe distanca ka qenë në mes meje edhe T, për afërsisht 7-8 metra, ka qenë ora 15:30 kur ka ndodhur rasti dhe nuk e ndiej vetën fajtor dhe T.R atë ditë ka qenë shumë agresiv, në momentin që e ka ngrit dorën në brez unë armën nuk e kam parë, vetëm se e ka ngrit dorën e djathtë në brez në qantë të cilën e ka pasur lidhur për brezi, ka shtuar se i vjen keq që ka ndodhur

ky rast, pendohet. Ditën kritike ka shtuar se në ora 11:00 kam dalur nga shtëpia revolen e kam pasur jashtë shtëpisë e kam mbajtur në një shtëpi tjetër - shtëpi të kojshive, emri i pronarit të kësaj shtëpie nuk e di pasi që i njëjti jeton jashtë vendit nuk e di se ku, dhe e ka marrë revolën atë ditë me veti e kam shti në brez me qëllim që me ja shit najkujt, dhe tani kam vazhdu me ec këmbë kah "H.D", kah B, te Qafa, kah stacioni policor 92, dhe kam shkuar në lokalin "S Bar" i cili është kafiq, në lokalin Sekiraqa kur ka mbërrë ka mundur me qenë ora 11:30 ose 11:35 dhe se ka ndejt aty rreth 1 orë e 10 minuta, atë ditë nuk e ka takuar fare E.S, por e ka takuar R. A. dhe tani është ardh edhe I.A ku kanë pirë kafe dhe pasi që kanë pirë kafe janë dal prej aty, ka shtuar se as Iliri as Rrahimi skanë qenë në dijeni që ka pasur armë me veti. Kur kanë dal nga lokali i S", kanë hyp në kerr të I.A "Passat" e ka pas ngjyrën e gjelbërt, dhe prej aty janë sjell në semaforat te "B.K" dhe kanë vazhduar rrugën deri te semaforat afër lokalit "Q", ku Rr.A dhe I.A kanë thënë që po shkojnë prej shpisë, dhe i njëjti ka zbritur dhe u ndal tek lokali "Q" ka dal ka pirë kafe vet aty ka ndejt vet, përafërsisht rreth 1 orë e 40 minuta dhe pastaj ka dal te lokali tjetër emri i të cilit nuk i kujtohet në parkingun e lagjes D"aty ku rrin më shumë rinia. I njëjti ka shtuar se incidentet që ka pasur me T, shihet arsyeja se pse e ka vrarë të njëjtin, ka shtuar se nuk e ka nxit askush me vra T.R dhe se E.S është i pa fajshëm. Ka shtuar se nuk më ka nxit E.S me vra T.R, as nuk kam marrë urdhra prej tij, as prej kërkujt hiq, e as nuk ka fol me askënd hiq, dhe sa i përket thashethemeve për pranimin e shumës prej 50.000 euro ka shtuar se nuk ka fol kurr me askënd për këto lloj shpërblimi dhe se këto janë llafe të kafeve. Sa i përket ndërtimit të shtëpisë në vitin 2011, ka shtuar se para vitit 2011 është kon shtëpi banimi, ndërsa sa i përket vitit 2011 e kanë prish shtëpinë e vjetër familjare që u kon dhe e kanë ndërtu dhe se ky është kontribut i familjës, që ka punuar familja.

Ka shtuar se nuk ka qenë në dijeni se i ndjeri E.S dhe T.R të kenë pasur ndonjë problem, ndërsa lidhur me përdorimin e armës në ditën kritike ka shtuar se ka pasur përvojë, pasi që i njëjti ka qenë pjesëtar UÇK-së në Koshare, në brigadën "138 A.R", dhe prej atëherë ka pasur armë nëpër dorë kështu që din me i përdorë, dhe në fund ka shtuar se nuk jam tranu ende për me mbajt burg për E.S, jo për E.S por për askënd tjetër.

Në pyetjet e prokurorit special i njëjti ka deklaruar se: me D.S e kemi pas shtëpinë larg dikund 20 minuta për me ec, nuk ka pasur numër të tij. Dëshmitari ka potencuar se ka pasur numër në atë kohë dhe numri i telefonit ka qenë 044****. I njëjti është pyetur se a i ka pasur numrat e Rr.A dhe I.A pasi që ka pasur shoqëri me të, i njëjti ka theksuar se e ka pasur numrin veq të Rrahimin dhe kemi komunikuar nganjëherë dhe se mesazhe telefonike kanë shkëmbyer shumë rrallë. Tutje i njëjti është pyetur se a ka pasur shkëmbime me mesazhe me Rr. para se me ndodh rasti, ka deklaruar se e ka pasur një mesazh sa i kujtohet pasi që ka ndodh rasti, ndërsa para se me ndodh rasti nuk i kujtohet. I kujtohet që Rr. në atë kohë ka qenë në lidhje me një vajzë të quajtur K.B, dhe se nuk i kujtohet nëse e njëjta e ka pasur numrin e tij, sepse nuk ka pasur të bëjë kurgjo me të njëjtën pasi që ka qenë femra e Rr, I njëjti është pyetur lidhur me ndejën në të cilën ka marrë pjesë në shtëpinë e E.S së bashku me D, është pyetur rreth arsyes se a e din pse është mbajtur ajo ndejë, i njëjti ka deklaruar se ka shkuar aty pasi që e ka thirr D.S dhe rastësisht ka shkuar me D, i cili i ka thënë hajde rri me mua mos më le vet qitu dhe i ngojmë këngëtarët me sharkia. Qysh i ka thënë D është një fejesë apo dasëm, ashtu diqka nuk e din saktë sepse nuk ka qenë i ftuar në atë ndejë, po ashtu i njëjti është pyetur pasi që keni pasur moshën 25-26 vjeqare i rritur sa shkoni në një vend nëse stë ftojnë, i njëjti ka deklaruar "jo unë nuk kisha shkuar në dasëm pa ftesë, por u ndala pasi që më ftoj D.S dhe i kishte thënë mos më le vetëm këtu". I njëjti është pyetur lidhur me atë se a ka kontaktuar me E gjatë ndejës, ai ka shtuar se kur jom kon tu ndejt aty në oborr te do shkallë, tuj dëgju shahirët me sharkia, e ka thirrë E.S, i njëjti i osht afruar ngat atij dhe E, e ka pyetur se me kënd ke ardh ti, i njëjti i ka thënë se "jam ardhur me D.S se e ka shok, dhe kanë pasur qejf me i dëgju këta këngtar, dhe u ka thënë ndoshta nuk të vjen mërzi

që po rrim pak këtu”, dhe E i ka thënë “dilni uluni dhe rrini qatje dikund”, nuk e din se a e ka njohur E në momentin që e ka thirrë, por që E, e ka thirr duke ja bërë me dorë.

Përgjatë deklaramit të tij është pyetur edhe lidhur me incidentet që kanë ndodhur lidhur me atë se a i ka paraqitur ato raste në polici, i njëjti ka deklaruar se nuk e ka paraqitur rastin në polici dhe nuk i ka treguar askujt se i ka ardh inati, ndërsa kur ka deklaruar se nuk është frikësuar nga T, prokurori i shtetit e ka ballafaquar me deklaratën e dhënë në shqyrtimin e datës 14.05.2019 në fq.4, të procesverbalit nga fundi, në pyetjen e mbrojtjes së të akuzuarit, a jeni frikësuar nga i ndjeri T. në atë kohë, ju atëherë jeni përgjigjur “*po, kam pasur frikë prej tij*”, sot deklaruar “*jo, se nuk i kam pasur asgjë borxh*”, cila është e vërteta, i njëjti pas ballafaqimit ka deklaruar se nuk ka pasur frikë se nuk i ka pasur borxh T. dhe çka po deklaroi sot është e vërteta. Tutje është pyetur lidhur me armën të cilën e ka poseduar, ku i njëjti ka theksuar se armën se ka mbajtur në shtëpinë e tij por në shtëpinë e një fqinji, që ska qenë e banueshme dhe se pronarët skan qenë të pranishëm aty, e në fund ka shtuar se nuk e njeh personin me emrin F.A.

Në pyetjet e trupit gjykues i njëjti ka deklaruar: fillimisht është pyetur për gjendjen financiare ku në procesverbalin e datës 29.10.2015 para gjyqtarëve të EULEX-it ka deklaruar se lidhur me gjendjen financiare e njëjta ka qenë e dobët, kurse sot në shqyrtim gjyqësorë ka deklaruar se ka qenë mesatare, i njëjti ka deklaruar se në atë kohë nuk ka qenë as shumë e mirë por as e keqe jo, ka qenë si një lloj mesatare pasi që krejt familja ka punuar, babai me KEK i cili ka pasur përvojë 40 vjeqare, kanë punuar vëllezërit dhe motra, vëllau i dytë me një lokal në lagjen V.. dhe ka pasur një kafe bar me qera, motra ka punu nganjëherë si rrobaqepëse ndërsa vëllau i parë ka punuar në internet kapak. Po ashtu i njëjti është pyetur lidhur me atë se i njëjti ka jetuar në “K.T” dhe se ka qenë i shoqëruar me të afërm të E.S e po ashtu edhe me shoqërin e tij ka pasur rast të rri në kafe bar “S”, është pyetur lidhur me atë a nuk ka dëgjuar as edhe një herë të vetme lidhur me problemet në mes të akuzuarit E.S dhe tani të ndjerit T.R, i njëjti ka deklaruar se “jo nuk kam dëgjuar asnjëherë lidhur me problemet e E.S me T.R se secili ka problemet e veta”. Po ashtu i njëjti është ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë më datën 29.10.2010 ku ka shpjeguar kronologjinë e ditës kritike duke mohuar faktin se ditën kritike ka qëndruar në Bar S”ndërsa pastaj ka shpjeguar se pikërisht ditën kritike ka qëndruar në kafe bar “S”, është pyetur lidhur me atë pse fillimisht e ka mohu një gjë të tillë, i njëjti ka deklaruar se “nuk ka pasur ndonjë arsye se pse kam deklaruar kështu”, të njëjtit i është rikutjuar që në shqyrtimin gjyqësorë të vitit 2015 ka dhënë arsye dhe se arsyeja se pse ka deklaruar ashtu ka qenë për të mos inkriminuar edhe një person tjetër është pyetur lidhur me atë se cila është e vërteta, i njëjti ka deklaruar se “e kam dhënë këtë arsye mirëpo nuk ka pasur R.A të bëjë asgjë në lidhje me këtë rast”. Tutje i njëjti është pyetur lidhur me fotografitë të cilat i janë prezantuar sot lidhur me personat prezent në ato foto, ku fillimisht ka deklaruar se të akuzuarin E.S personat që ishin prezent me të e kanë ftuar për pije me ata, ndërsa tutje ka deklaruar se ai ka qëndruar veëm për të bërë një foto së bashku, i njëjti ka deklaruar “po na jena kanë edhe qysh e ceka edhe ma herët tu pi birra, është ardhur E.S dhe tani F.D, tani edhe aj ke pak i dehur dhe i tha E a po ulesh qaty me pi me ne najsen”, e pastaj E ja lëshoj karrigen e vet, dhe u ul E, dhe tani F.D insistoj me bo një foto me E. për me mbajt kujtim”. I njëjti po ashtu është pyetur lidhur me ditën kritike ku e ka cekur dy herë rradhazi që ka pirë kafe vet, pse është dashtë me i ndërru 2 kafe dhe me qëndru vet pse, i njëjti ka deklaruar se “po unë jam dal si zakonisht vetë me pi kafe, atë ditë kam qëndruar aty ku qëndrojnë krejt rinia, nuk kam ndonjë arsye se pse tërë kohën kam qëndruar vetë”. I njëjti është pyetur sërish rreth asaj se a ka pasur ndonjëherë shoqëri me E. dhe se a e kanë përmendur ndonjëherë sa kanë qëndruar me D, E, i njëjti ka deklaruar se “E e njoh si figurë dhe nuk kam kurrfarë raportit me të, 2 ndejat kanë qenë të rastësishme dhe se me D. asnjëherë nuk kanë folur për E”. Lidhur me mbrojtjen në stacion policor ka deklaruar se e ka pasur nga shteti ndërsa mandej e ka pasur sipas autorizimit dhe se për buxhetin e tij kanë qenë të përbalueshme.

Në seancën e datës 06.07.2023 palët në procedurë janë dakorduar që deklaratat e dëshmitarit D2 të dhëna ma herët dhe ato të datës 19.08.2007, si dhe të datës 02.06.2015 dhe 18.11.2015.

21. Deklarata e dëshmitarit D2

E dhënë në polici nën kushte anonimiteti, me datën 19.09.2007, ka deklaruar se më datën 30.08.2007, kishte qenë në vendin e tij të punës (vendi i punës i njohur për policinë). Rreth orës 07:00, kishte parë E.S, i cili kishte shkuar në lokalin e tij Bar S”, me veturën e tij Golf III, ngjyrë e zezë, me supozimin se ishte i blinduar. E.S kishte qenë i vetëm, kishte hyrë brenda në lokal dhe pas pesë minutave kishte dalë nga lokali dhe kishte ecur këmbë në drejtim të bastoreve “T Sport” dhe “L”, në drejtim të stacionit të autobusëve për F.K, që ndodhet afër agjencionit “M”, në “D”. Derisa i njëjti ecte nëpër rrugë, tërë kohën kishte biseduar me dikë në telefon dhe pastaj kishte shkuar në drejtim të lokalit të vet. Nuk e kishte vërejtur se kur kishte dalë nga lokali mirëpo rreth orës 11:15, kishte vërejtur se veturën nuk e kishte aty të parkuar ku zakonisht e parkonte. Atë ditë, E.S kishte pasur të veshur një maicë të zezë me vija të bardha, pantallona (farmerka ngjyrë e kaltër), patika ngjyrë të kaltër dhe të zezë, kishte qenë i rruar në fytyrë. Pas ngjarjes kritike, rreth orës 16:15, kishte vërejtur disa persona si: N.S, një person të cilin e quajnë G, kamarieri i quajtur Sh, F i cili ruan veturat e E, A, si dhe dy persona tjerë të cilët nuk i kishte njohur, të cilët bartnin disa çanta të zeza dhe qese të mëdha ngjyrë të kuqe me të bardhë në të cilat qese kishte vërejtur tyta të armëve të gjata, të cilat i kishin bartur nga lokali S” deri në parkingun e veturave cili gjendet mbrapa “Kafe Bar S”. Pasi që të njëjtit ishin kthyer nga parkingu i veturave dhe ishin ndalur para lokalit në fjalë, dhe qeshnin me zë të lartë, ku njëri nga ta për të cilin nuk e di se cili ishte por vetëm e kishte dëgjuar të ketë thënë: “Kjo është hakmarrje”. Derisa ata bartnin armët, kishte vërejtur N.S i cili mbante një revole në brez. Në parkingun e veturave mbrapa lokalit S, kishte vërejtur disa vetura të grupit S, një veturë pick-up ngjyrë e kuqe, me mbishkrimin ”B. Cafe”, të cilën e ngiste A.B ku të njëjtin e kishte parë me këtë veturë duke shpërndarë kafe nëpër kafiteritë e Prishtinës dhe se punon për këtë kompani, pronar i së cilës është E.S, kishte vërejtur një veturë passat karavan, xhami i majtë i së cilës kishte qenë i thyer, ndërsa para lokalit S”, kishte qenë e parkuar vetura xhip ngjyrë e gjelbër, të cilën e ngiste N.S. Atë ditë në lokalin S” para se të ndodhte vrasja e policit, kishte vërejtur edhe personin e quajtur “L”, Rr (Rr) dhe N.S.. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 02.06.2015, si dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.11.2015, cila ishte e mbyllur për publikun, gjatë marrjes së deklaratës përmes video linkut, i njëjti kishte deklaruar se: ditën kritike, me datën 30.08.2007, kishte parë E.S rreth orës 08:00, i cili kishte dalë dhe shikonte terrenin, kishte shkuar në stacionin e autobusëve për F.K, dhe para se të kthehej në kafiterinë e tij kishte parë të njëjtin duke biseduar në telefon. Atë ditë kishte qenë aty duke pirë kafe sepse ishte klient i rregullt, dhe kishte parë E.S kur ishte kthyer dhe kishte hyrë brenda në zyrën e tij. Derisa ishte në kafiteri, aty kishin qenë edhe personat, Rr, L, A, ndërsa F, po kujdesej për veturën. Personat e përmendur, E i kishte dërguar në zyrën e tij dhe kishte vërejtur se diçka nuk po shkonte mirë. Pasi që kishte pirë kafën, ishte larguar nga kafiteria në orën 01:30, L, dhe A, ishin larguar gjithashtu, ku në ato momente E, kishte marrë veturën dhe ishte larguar, kishte ikur. Më vonë, rreth orës 14:00 ose 14:10, kishte dëgjuar se zyrtari policor T, ishte vrarë, dhe kjo kishte qenë arsyeja se pse kishte shprehur vullnetin që të dëshmojë, sepse ishte vrarë një polic i mirë i Kosovës. Koha nuk i kujtohej saktë, por kishte parë grupin që kishte shkuar atje (kafiteria), dhe dikush nga ata kishte folur për hakmarrje. Rreth orës për afërsisht 15:00 deri 15:30, ata (personat e apostrofuat më lartë), po bartnin me vete diçka si armë me tyta të gjata. Para se të vritej T.R diku rreth orës 15:30, kishte qenë jashtë lokalit por brenda në veturë në parking, kishte parë duke dalë nga lokali A.B, L, F, N, të cilët kishin armë me tyta të gjata dhe kishin shkuar me veturat e tyre të cilat kishin qenë të parkuara në parkingun prapa kafiterisë dhe të cilët kishin shkuar në aksion dhe pas kësaj kishte dëgjuar se është vrarë polici T.R. Vetura me të cilën ata ishin larguar kishte qenë me gjasë Jeep, ngjyrë e gjelbër, në të cilën kishte qenë A.B. Kur ata (L, Rr, N) ishin kthyer me

veturën xhip në kafiteri, pohoi t'i ketë dëgjuar duke thënë se "hakmarrje" ose "gjakmarrje" dhe ishte në një distancë nga ata afër 15m. Kur ata ishin kthyer në kafiteri, L, mbante në dorë një çantë në të cilën shihej se kishte armë me tyta të gjata, ishin futur brenda në lokal, ishin ngjitur shkallëve lartë, kishin qëndruar aty për një kohë të gjatë, më pas kishin zbritur poshtë, kishin hipur nëpër veturat e tyre dhe ishin larguar nga aty në drejtim të panjohur. Para datës 30 gusht 2007 ka shtuar se e ka ditur se kush është A.B, atë e ka parë duke ngarë veturën dhe duke shpërndarë kafe, ai ka punuar me E.S, pra ai ka shpërndarë kafën "B", dhe se A.B e ka parë shpesh në kafiterin e S" e ka parë çdo ditë, dy herë në ditë, gjithashtu të njëjtin e ka parë në shoqëri me L si dhe E.S

Tutje në kuadër të seancës të datës 11.07.2023 pas propozimit të avokates mbrojtëse të të akuzuarit E.S deklaratat e dëshmitarëve si në vijim janë konsideruar të lexuara:

Konsiderohen si të lexuara deklaratat e dëshmitarëve:

22.Deklarata e dëshmitarit B.M

Në cilësi të zyrtarit policor të Njësisë së Forenzikës në Prishtinë, të dhënë në shqyrtimin kryesor të datën 17.11.2015 ku ndër të tjera i njëjti kishte deklaruar se: në rastin e vrasjes së policit T.R, në cilësi të zyrtarit policor nga departamenti i forenzikës, kishte ndërmarrë disa veprime hetimore lidhur me rastin. Ditën kritike, me urdhër apo kërkesë të hetuesve, kishin shkuar në "Kafe Bar S" ku është bërë fotografimi i pjesëve të provave të cilat duhej të konfiskoheshin nga policët hetues, të cilat konsideroheshin me rëndësi se do të ndihmonin në ndriçimin e rastit. Në vendin e ngjarjes kishin hyrë së bashku me policët hetues, të cilët kishin qenë para lokalit në fjalë duke pritur. Brenda lokalit kishte parë disa persona të arrestuar të cilët ishin nën kontrollin e policisë speciale. Koha kur kishin shkuar në vendin e ngjarjes, në shkresat e lëndës figuron 18:50, për të cilat veprime kishin përpiluar edhe raport të veçantë për të gjithë hapat që kishin ndërmarrë. Përveç bastisjes së lokalit S, kishin qenë edhe në disa lokacione tjera në disa shtëpi në lagjen e Vranjevcit si: në shtëpinë e H.S, O.B, një tjetër lokacion në lagjen K.T, në QKUK ishte bërë fotografimi i viktimës T.R si dhe në vendin e ngjarjes në lagjen "D".

23.Deklarata e dëshmitarit A.H

E dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 01.12.2015 i njëjti kishte qenë Hetues në krimet e rëndë ekspert i IT-së, i njëjti ishte thirr në cilësinë e hetuesit lidhur me mjetin e regjistrimit lidhur me leximin e të dhënave të cilat janë ruajtur në hard drive. I njëjti për gjykatën ka sqaruar se brenda kësaj pajisje ka një hard drive disk, ku këtë hard disk e ka marrë nga makina dhe e ka lidhë atë në softver të mjekësisë ligjore në kompjuter, pas kësaj ka bërë një imazh të plotë të hard driv-et. Zakonisht në një imazh të tillë mund të shohim fotografi, dosje, dokumente, por në këtë hard drive janë vetë të dhënat që është e pamundur për tu interpretuar, kjo është për shkak se këtë sistem e përdorin softuerine e tyre për regjistrimin e imazheve, pra nuk ka asnjë të gjetur që i njëjti ka qenë në gjendje t'i rigjej në hard drive. Hapi tjetër është që e lidh regjistruesi për një monitor për të parë nëse është e mundur që ta ndezë atë, ku ishte një problem i vogël sepse në këtë kuti nuk ka pasur askund ndonjë markë të prodhimit apo ndonjë gjë, por është e mundur të ndizet dhe të jenë në gjendje ta shohin në ekran. Ka shtuar se makina gjithashtu e kishte një mundësi që të bëjë një kopje rezervë në CD disa, ku për fat të keq CD-ja rezervë është gjithashtu e pamundur për tu lexuar nga PC, ku edhe me ndryshimin e CD Room brenda tij rezultati ishte i njëjtë- nuk ka punuar. Ka shtuar se k lidh një apart fotografik modern në regjistruesi dhe ajo që ka prezantuar është një foto e korruptuar, kjo tregon se makina mund të jetë e sistemit amerikan dhe e lidhur me kamera të specifikimit evropian dhe kjo është arsyeja pse ka imazh të keq. I njëjti është pyetur lidhur me atë se a kishte tentuar dikush të eksploronte në të dhe të merrte të dhëna nga ai hardisk, i njëjti ka deklaruar se siç e ka kuptuar nga një ekzaminues i UNMIK-ut ajo është

ekzaminuar në vitin 2007, dhe mendon se cilësia e keqe është për shkak të cilësisë së keqe që është transferuar në regjistres e jo për shkak të ndërhyrjeve në pajisje. Dhe se lidhur me kohën e përfundimit të regjistrimit e cila figuron të jetë 06:22:25 më datën 30 Gusht 2007 ka shtuar se regjistruesi që nga ajo kohë nuk po regjistronte.

24.Deklarata e dëshmitarit R.B,

E dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 01.10.2015, i njëjti që nga paslufta, kishin një zyrë për patundshmëri, në Dubai ka një kompani përmes së cilës kishin një bashkëpunim me shtetin Gana të Afrikës, ku punojnë në miniera. Me të akuzuarin E.S njihen që nga koha e paraluftës mirëpo nuk kishte pasur raporte biznesi. Për vrasjen e T.R kishte dëgjuar në media por se nga kush dhe pse nuk ishte në dijeni. Gjatë vitit 2000-2001, derisa ishte me bashkëshorten dhe vëllain e tij duke ngasur veturën nga Dragodani në drejtim të qendrës, afër qendrës së rinisë dhe kulturës në afërsi të RTV 21, rreth orës 20:30 në mbrëmje, kishte hyrë në rrugën një kahëshe dhe ishte ndalur nga policia, ku njëri nga ta i kishte drejtuar dritën dhe kur e kishte hapur dritaren, polici T.R i kishte thënë: “dil jashtë llum dhe mi jep dokumentet”, dhe i kishte dhënë dokumentin identifikues të Republikës së Serbisë si dhe lejen e vozitjes, ku letërnjoftimin e kishte grisur copë-copë dhe më pas i kishin dërguar në stacion policor ku nga aty e kishte njohur T, i cili i kishte shkruar dy gjoba dhe kishte kërkuar nga kolegu i tij H që ti konfiskohej edhe vetura, si dhe e kishte fyer duke i thënë ta q..... nënën dhe e kishte kapur për fyti, ku situata kishte eskaluar dhe polici H i kishte hedhur në fytyrë sprej dhe e kishin rrahur katër polic një ndër ta edhe T.R, i cili edhe i kishte dhënë goditjen e parë në kokë me shufër, si pasojë e kësaj kishin marrë trajtim mjekësor në QKUK, dhe pas kësaj ishin arrestuar dhe ndaluar në polici. Nuk kishte dëgjuar për grupin S, por për familjen S, se është një familje e mirë dhe punëtore, ndërsa nuk i njihin personat A.B, L,, Rr,kurse N.S e njihin. Gjatë deklaramit të tij, bëri përshkrimin e një ngjarje e cila i kishte ndodhur një argjendari emri i të cilit është R,, i cili ishte rrahur dhe keqtrajtuar nga T.R para lokalit të tij i cili gjendej përballë Gjykatës së Apelit, dhe këtë rrëfim të kësaj ngjarje e kishte dëgjuar nga vet R. Lidhur me rastin e Ferizajit, i cili sipas tij kishte ndodhur në vitin 2005 ose 2006, kishte kuptuar në media se si E.S ishte maltretuar dhe të cilin rast e ndërlidhë me pretendimin se T.R, ishte i përfshirë duke aluduar se vet T, kishte kërkuar që kolegët e tij të dilnin në rrugë dhe ta ndalnin E. Kjo ishte arsyeja se pse kishte kontaktuar me N.S me qëllimin e vetëm që nëse do të paraqitej nevoja, do të ishte i gatshëm të jepte dëshminë e cila do të kishte me qenë dobishme dhe në favor të akuzuarit E.S

25.Deklarata e dëshmitarit A.D

E dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 02.10.2015, ku i njëjti ka theksuar se ka pasur një problem me tani të ndjerin T.R ku ka ndodhur para 10 viteve në atë kohë kur i njëjti dëshmonte, ai ka shtuar se ka qenë duke biseduar me një femër e cila ka qenë shoqe e T.R dhe ajo quhej B,, ndërsa T i'a ka marrë asaj telefonin dhe dëshironte ta takonte domosdoshmërisht, i njëjti ka shtuar se nuk e ka njohur T.R dhe se për herë të parë e ka parë tek Qendra Tregtare në K.D ku i njëjti kishte ardhur së bashku me dy djem të tjerë dhe vëllaun e tij dhe e kanë takuar aty, i njëjti ka theksuar se së pari kanë diskutuar lidhur me atë se pse A, e ka telefonuar B, e më pastaj T, e ka godit të njëjtin, të njëjtin e kishte goditur në vesh dhe në atë moment i njëjti është rrëzuar poshtë dhe pasi që është ngritur në këmbë ka ikur dhe nuk ka pasur mundësi që më T, ta godas të njëjtin. Ai ka deklaruar se këtë rast e ka paraqitur në polici por asnjëherë askush nuk e ka kontaktuar. I njëjti përgjatë deklaratës së tij është pyetur nga Prokurori i shtetit lidhur me disa ngacmime që i njëjti i kishte bërë të ashtuquajturës B, ku të njëjtin e ka pyetur se pas këtij incidenti a ka shkuar jasht për të jetuar, e që i njëjti ka potencuar faktin se ka qenë jasht vendit por që është kthyer.

26. Deklarata e dëshmitarit F.A

E dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 06.10.2015, ku ndër të tjera ka deklaruar se me të akuzuarin E.S jetojnë në të njëjtën lagje. I njëjti ka theksuar se ka punuar tek vëllau i E,S, N.S si kopshtar para lokalit dhe në parkingun ku parkoheshin veturat pra në kafenenë “S” dhe ka konfirmuar se në cilësi të kopshtarit ka punuar edhe në kohën e ngjarjes kritike të datës 30.08.2007. Të akuzuarin E.S e kishte parë disa herë në kafiterinë “S” pasi që ishte pronar së bashku me vëllain e tij N, mirëpo me të akuzuarin nuk kishte pirë ndonjëherë kafe apo shoqëruar me të. Me personat L, Rr, jeton në të njëjtën lagje, ndërsa A.B e kishte njohur vetëm si emër të cilin e kishte parë shumë rrallë kur kalonte andej, dy apo tre herë, ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datën 01.10.2007, kishte deklaruar se A.B nuk e kishte njohur dhe nuk e kishte parë kurrë. Ditën kritike, të datën 30.08.2007, rreth orës 18:00, kishte shkuar në punë te kafiterija S, dhe nuk kishte hyrë brenda për të parë se kush ishte sepse puna e tij kishte qenë jashtë lokalit, kishte zëvendësuar kolegun e tij S.R i cili atë ditë kishte qenë në ndërrimin e mëngjesit. Kishte tri vetura për të cilat përkujdesej, dy xhipa dhe një veturë VË Golf të cilën e ngjasin N, dhe E.S, mirëpo sa i përket ditës kritike nuk i kujtohej se cilat vetura gjendeshin aty. Ditën kritike nuk e kishte parë E.S, dhe në parking kishte qenë e parkuar vetura e N.S E, dhe N, veturat çdo herë kishin parkuar para kafiterisë “S”. Lidhur me SMS e dërguar I.A ditën kritike në ora 13:02, me tekst “fqinji e ka makinën në parkingun e G”, e arsyeton me atë se këtij të fundit i kishte dhënë 1000 (njëmijë) euro borxh sepse i’a kishte kërkuar dhe këtë shumë prej 1000 (njëmijë) euro, i’a kishte dhënë një të afërmi të tij, kështu që nuk kishte asgjë të bënte me ngjarjen kritike dhe as me të akuzuarin E.S me të cilin nuk kishte diskutuar asnjëherë lidhur me T.R. Lidhur me ballafaqimin e deklarimeve të dëshmitarit D2, të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor të datën 20.06.2015, se në mëngjesin e datës 30.08.2007, citim: “Unë e pashë E, L, A, Rr, dhe F ishte poshtë te automjeti dhe N, ishte aty”, i njëjti mohoi këtë duke e quajtur gënjeshtër sepse fare nuk kishte qenë atje atë kohë sepse deri në orën 02:00 ose 02:30, kishte qenë në palestër, ndërsa kafiteria S, asnjëherë nuk ishte hapur kurrë para orës 09:00 ose 10:00, dhe se atë ditë nuk kishte shkuar në punë deri në orën 06:00 pasdite. Gjatë marrjes në pyetje më datën 01.10.2007 kishte deklaruar se: Ditën kritike ishte zgjuar nga gjumi rreth orës 12:00, kishte dërguar nënën e tij me autobus në Klinikën Shëndetësore në afërsi të Xhamisë së Llapit, pas kësaj e kishte dërguar nënën në shtëpi me autobus, rreth orës 13:00 në rrugë afër shtëpisë së tij kishte takuar dajën e tij Sh, me të cilin kishin shkuar në Qendrën e Rinisë për të pirë kafe, ku kishin qëndruar deri në orën 14:00, pastaj kishin shkuar në palestër e cila gjendej përballë Kinemasë ABC dhe në orën 16:00, ishte kthyer në shtëpi së bashku me dajën e tij, duke bërë ndryshimin në kohë, sepse tani gjatë deklaramit, në kafene kishin shkuar në orën 1 e jo në orën 2, ishte takuar me dajën e tij në orën 1 e jo në orën 2, të cilin deklarim të ndryshuar e arsyeton me atë se mbrojtësi i kishte thënë të mbrohet në këtë mënyrë, sikurse të thoshte se nuk e njihte A.B. I pyetur për fqinjin të cilin e kishte potencuar në SMS, se “automjeti i fqinjit është në vend parkimin e G”, i njëjti kishte deklaruar se fqinji ishte personi të cilit I, ti'a kishte dhënë paratë emri i të cilit është D, po ashtu kishte deklaruar se E.S e njihte ndërsa Rr.A dhe I.A nuk i njihte.

27. Deklarata e dëshmitarit J.T

dhënë më datën 30.11.2015, në shqyrtimin kryesor, ai kishte qenë detektiv me gradën rreshter, në Byron Shtetërore të hetimeve në Finlandë, lidhur me rrethanat e ekzaminimit të pajisjes “DVR”, të kamerës së lokalit S”, e konfiskuar me rastin e bastisjes së lokalit, kishte deklaruar se nuk kishte qenë pjesë e hetimeve, mirëpo sa i përket datës 30.08.2007, kishte krijuar hartën e lokacioneve të antenave të operatorit Vala, në mënyrë manuale, që tregon numrin mobil të caktuar të përdorur në një periudhë të caktuar kohore, në një zonë të caktuar. Lokacioni i Bar S” me drejtkëndëshin e lokacionit të vendit të krimit duke përdorur trekëndëshin në hartë. Burimi i të dhënave ishin të siguruara nga Njësia e Hetuesisë – Policia e Kosovës, shtatë (7) faqe në Excel që kanë të bëjnë me të dhënat telefonike, emrat e antenave, celulat dhe të dhënat kohore, e cila

dosje përmbante edhe koordinatat për antenat e operatorit PTK “Vala”. Në këtë ekspertizë lidhur me hartografinë, kishte bërë konvertimin e të dhënave nga exo në të dhëna cml dhe pas kësaj i kishte vendosur në Google Earth dhe nga koordinatat e siguruara nga operatori është krijuar harta e lokacioneve të antenave, duke shtuar më pas vulat kohore për lokacionet ku janë bërë telefonatat, me datën 30.08.2007. Një antenë mund të ketë dy apo tri celula të ndryshme të drejtimeve, mirëpo në këtë prezantim nuk kishte analizuar materialin në nivel të celulave por për antenat, për të përcaktuar se ku është përdorur një numër i telefonit në një kohë të caktuar. Një zonë e caktuar mund të jetë e mbuluar nga dy ose tri antena. Sa i përket personit A.B, ekziston një sasi e kufizuar e të dhënave, 31 regjistrime për periudhën 29 deri me 30 Gusht 2007 dhe 18 regjistrime me datën 30 Gusht 2007, i cili komunikoi me personat e quajtur Rr.A dhe I.A, ndërsa sa i përket të akuzuarit E.S, me arsye theksoi se ishte në lëvizje nga një lokacion në tjetrin në drejtim të perëndimit apo ishte në të njëjtin lokacion por thirrjet e tij telefonike janë lidhur duke përdorur antena të ndryshme, duke përdorur telefonin celular kryesisht përmes antenave “L” dhe “Dardania” dhe gjithashtu disa shenja të vulave kohore në antenën “Cannon”, “Radio”, “Rilindja”, e që tregon se ai ishte në zonën e qytetit, dhe sa i përket lëvizjeve të tij ishte vështirë të përcaktohej pasi që i posedonte të dhënat vetëm për dy ditë. Të dhënat e telefonatave të A.B tregojnë se ai ishte afër vendit të ngjarjes, po ashtu edhe të dhënat e E.S, tregojnë të njëjtën gjë, duke konkluduar se i njëjti ishte afër vendit të ngjarjes. Telefoni i T.R, duke filluar në ora 13:38, në antenën “A. Foto” dhe në 13:48 në antenën “OSBE”, japin shpjegimin se personi ishte diku në qendër të qytetit dhe po lëvizte drejt zonës së vendit të ngjarjes dhe me saktësi nuk ishte e mundur të konstatohej se ku ishin telefonat celular të A.B dhe T.R apo ku ishin përdorur ata, por se të njëjtit përdornin kullat e njëjta dhe më një probabilitet të lartë, të tre personat e lartcekur ishin në të njëjtën zonë, në të njëjtën kohë. Nga krahasimi i të dhënave nga raporti i policisë i datën 15.04.2015, me të dhënat e ruajtura në CD, që i referohen E.S, konkludoi se ishin të njëjtat informata. Bazuar në të dhënat e siguruara, lidhur me lokacionin e N.S, gjatë mëngjesit, prej orës 10:37, i njëjti në këtë kohë ishte në lokalin S. si dhe në pasditen e asaj dite.

28.Deklarata e dëshmitares M.I

Në shqyrtimin gjyqësor ishin lexuar edhe deklaratat e dëshmitares M.I: e njëjta jetonte në Prishtinë, nënë e tri vajza, A, E dhe Z.I (po ashtu dëshmitare në këtë rast). E kishte njohur tani të ndjerin T.R, i cili se bashku me A.S disa herë në uniformë të policisë kishin shkuar në parukeri ku punonte E, të cilët kishin insistuar për mbrojtjen e familjes së saj me arsyetimin se ishin të rrezikuara nga E.S. Vajza e saj A., shumë kohë më parë ishte shoqëruar me E.S dhe për këtë e kishte kuptuar shumë vonë. Në deklaratën e saj të dhënë në polici e njëjta kishte deklaruar se: “së pari A, ka pasur problem me E.S, është thënë se ka marrëdhënie për ca kohë por A, asnjëherë nuk e kishte pranuar këtë fakt por e di se A, ka qenë shumë e frikësuar nga ai (deklaratë kjo e konfirmuar nga vet dëshmitarja në deklaratën e saj të dhënë në shqyrtimin gjyqësor).

Nga dëshmia e dëshmitares familjare e A,s (nëna e saj), rezulton se A kishte një afërsi me E.S (shtojm faktin se gjykata nuk e paragjykon këtë afërsi dhe është irelevante se çfarë afërsie ishte ajo), por e rëndësishme ishte fakti se e njëjta ishte e afërt me të dhe shkëputja e saj nga i njëjti vjen përfundimisht pas lidhjes së saj me T), pasi që e lartcekura ishte e afërt me të akuzuarin para se të lidhej me T. Fakti se A kishte afërsi me E.S, ky fragment gjenë mbështetje edhe në deklaratën e motrës së A. dëshmitarës Z.I e cila po ashtu ka specifikuar për afërsinë dhe raportet mes A. dhe E.S dhe kishte specifikuar se atë periudhë A ishte tejet e pa lumtur dhe se shkëputja e saj përfundimtare nga E.S kishte ndodhur pasi që A, ishte lidhur me T.

Dëshmitarja përmend edhe faktin se në vitin 2003 dhe 2004, derisa ishte me A, në studion muzikore të A.R, kur A, po përgatiste një nga video spotet e këngës së saj me G.S pasi që kishin dalë nga studioja kishin vërejtur se katër gomat e veturës së G.S ishin therrë dhe për këtë kishin dyshuar që ishte bërë nga “grupi S” pasi që kishin vërejtur “grupin S” me veturat e tyre pasi që

e dinin se vetura i përkiste atij dhe duke pasur parasysh se ishte ora tre pas mesnate dhe se nuk kishte lëvizje, rastin e kishin raportuar në polici.

Nga ky fragment i deklaratës së dëshmitares, vërtetohet një fakt i rëndësishëm në rrjedhën e ngjarjes, fakti se kush do që i afrohej A, kishte probleme me “grupin S” dhe kjo është më se e qartë se vinte nga urdhrat e tani të akuzuarit E.S, (sepse lidhshmëria ishte e tij dhe jo e dikujt tjetër).

Lidhur me problemet e T. me E.S, ka theksuar se A nuk i ka treguar shumë raste por një muaj para se të vritej T. i ka treguar se T, i’a kanë vendosur pritën në S. deri sa ai ishte duke shkuar në shtëpi.

E njëjta rrëfen edhe faktin se ishte në dijeni se Gj.K (tani dëshmitar në këtë proces) kishte ndërmjetësuar për pajtim në mes të A, e E, këtë i’a kishte thënë vet Gj.K në një rast kur kanë qenë bashkë me të pasi që vajza saj Z. kishte kënduar një ditë në lokalin e tij. Lidhur me përfshirjen e Gj,K si ndërmjetësues për pajtim, kjo gjykatë do të lëshohet më vonë kur do të trajtohet deklarata e tij pasi që ishte dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor – sipas propozimit të mbrojtjes.

Si përfundim, nga deklarata e kësaj dëshmitare e të cilës gjykata i’a fali besimin pasi që është në përputhje të plotë edhe me deklaratën e dëshmitarës Z, por sa i përket atentatit të fshatit S. edhe në përputhje me dëshmitaren A.I, gjykata vërtetoi faktet si vijon: Që A, kishte afërsi me E.S dhe po ashtu ishte shumë e frikësuar nga ai, se kush do që i afrohej A, kishte problem me të ashtuquajturin “Grupi S”, se T, kishte probleme me grupin S. dhe se pak kohë para vrasjes së tij të njëjtit i është vendosur prita në fshatin S” (për të cilën kjo gjykatë e ka specifikuar disa herë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi).

29. Deklarata e dëshmitares A

E dhënë në shqyrtimin kryesor më datën 16.12.2014, dhe datën 14.01.2015, ku ndër të tjera kishte theksuar se punën si infermiere e kishte filluar me datën 05.06.2006, dhe para kësaj periudhe kishte punuar në butikun “K”, i cili gjendet në Qendrën Sportive në Prishtinë. I.A deri në vitin 2007, ishte i dashuri i saj, që nga atëherë nuk e kishte parë më. Rr.A ishte djali i axhës së I, me të cilin nuk ishte shoqëruar asnjëherë. I. kishte pseudonimin L ndërsa Rr, kishte pseudonimin Rr. Për A.B kishte dëgjuar vetëm pas vitit 2007, ndërsa për T.R, vetëm si qytetar. E.S e kishte njohur pasi që i njëjti ishte djali i tezës së të dashurit të saj, mirëpo nuk kishte pasur asnjë kontakt me të. Ditën kritike, të datës 30.08.2007, kishte qenë kujdestare në vendin e saj të punës, nga ora 07:00 deri në orën 19:00, si infermiere në QKUK. Dy polic e kishin arrestuar dhe e kishin dërguar në stacionin policor nr. 4, ku aty disa polic e kishin kërcënuar se do ta vrisnin. Gjatë fazës së procedurës paraprake kishte dhënë tri deklarata dhe atë, më datën 30.08.2007, ditën edhe kur kishte ndodhur ngjarja, më datën 08.09.2007 si dhe më datën 29.10.2008. Ajo kishte deklaruar se në vitin 2004, ajo kishte pasur një lidhje me E.S e cila kishte zgjatur afërsisht dy javë dhe pas kësaj kishte hyrë në një lidhje me I.A. Atë kohë kur kishte njohur E, ai kishte pasur një numër të telefonit //,/. Lidhur me kontaktin që kishte bërë me telefon të dashurit të saj I, në ditën kritike, kishte deklaruar se nuk e kishte kontaktuar të njëjtin për ti konfirmuar vdekjen e Tt por për ta pyetur nëse dinte diçka për vdekjen e tij, pasi që e njëjta ishte në dijeni për konfliktin në mes të T, dhe E.S. Ajo kishte deklaruar se një ditë më parë, me K.B, I, , Rr, dhe A,B, kishin planifikuar të shkonin në Liqenin e B.. me veturën Passat ngjyrë e gjelbër të I Sipas saj, A. ishte shok i I.A dhe se A, i ngiste një veturë të tipit VË Golf II, ngjyrë hiri. I.A kishte në përdorim disa numra të telefonit si: 044 //,/, 044 //,/, 044 //,/, dhe 044 //,/, ndërsa E.S kishte disa lloje të veturave si: një Xhip me targa //,/,/, një xhip të bardhë të blinduar dhe një Vë Golf 3, të blinduar me numër të targave //,/,/, E, I dhe Rr, kishin mbajtur armë me vete si dhe mbanin jelek antiplumb dhe se A,B ishte në shoqëri të tyre gjatë gjithë kohës. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datën 14.01.2015, kishte deklaruar se: për vrasjen e T.R, këtë e kishte zbuluar vetëm kur kishte shkuar në stacion policor dhe jo para se ti telefononte të dashurit të saj I.A, dhe gjatë bisedës me të nuk e kishte

përmendur T.R, por se kishte qenë vetëm një bisedë normale e zakonshme. I kujtohej dita kur së bashku me I.A (L), K dhe Rr., me makinën e saj Ford Fiesta, ngjyrë vishnje, kishin shkuar për drekë në Liqenin e B., mirëpo kundërshtoi se A.B kishte qenë së bashku me ta të cilin fare nuk e njihnte dhe se deklaratat e saj të mëhershme i konsideron si të sajuara nga ana e policisë nga të cilët edhe ishte kërcënuar se nëse nuk do ta nënshkruante deklaratën e saj, do të dënohej më 6 (gjashhtë) vite burgim ose do ta vrisnin.

30.Deklarata e dëshmitarit A.B

E dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 29.05.2015, ku ndër të tjera i njëjti ka deklaruar se është i moshës 64 vjeçare, i cili në atë kohë ka qenë ende duke punuar në Kosovën B dhe në KEK, ka 4 fëmijë ku edhe fëmijët e tij punojnë ndërsa gruan e ka amvise. Ka shtuar se jeton në shtëpi e cila ndodhet në “H.D”, e cila shtëpi është 2 katshe dhe është ndërtuar në vitin 2011 ku në kohën kur është deklaruar ka shtuar se tanimë është e përfunduar, ka investuar rreth 17.000 euro, parat me të cilat e ka ndërtuar shtëpinë ka shtuar se janë mbledhur nga pagat e vajzës së tij dhe djalit të tij A, i cili gjendet në burg dhe nga dy djemt e tjer. Ka shtuar se A, i ka pasur shitore të kompjuterëve para kësaj ngjarje, ata kanë mbyllur për dy vite e gjysmë dhe pastaj e kanë mbyllur përfundimisht dhe ka mbetur si ka qenë dhe pastaj është marrë nga dikush tjetër, gjithashtu djali i tij i dytë ka punuar si tregtar i automjeteve; i cili ka shitur dhe ka blerë vetura dhe se fitimin e tyre e ka përdorë për jetesë ndërsa me rrogën e tij personale ka marr një kredi për investime, lidhur me kredinë ka shtuar se e ka marrë në Bankën Raiffeisen dhe ka marrë dy kredi në shumën prej 5000 euro, dhe se kredinë ka marrë në vitin 2009, duke shtuar se kredinë e ka kthyer dhe ka tre muaj që ka paguar kredinë e dytë, ku kredia e dytë është marrë dikund në vitin 2013 dhe në atë kohë ka qenë duke e paguar kredinë e dytë. Ka shtuar se shtëpia e ndërtuar në vitin 2011 është ndërtuar në vendin e njëjtë ku ka qenë shtëpia paraprake, ku shtëpia e vjetër është rrënuar në prill të vitit 2011, e që objekti i vjetër ka qenë një katsh dhe i vjetër, në të cilën kanë qenë 3 dhoma të fjetjes dhe një dhomë e ndejës. Ndërsa objekti ka qenë koxha i vjetër siç ka deklaruar i njëjti e ka blerë në vitin 1962 dhe që nga viti 1962 ka jetuar aty, ka shtuar se në momentin kur e ka blerë atë vend e ka rinovuar. Nga prokurori i çështjes i njëjti është pyetur lidhur me pagën të cilën e ka marrë nga KEK-u duke filluar që nga viti 1976, ku i njëjti ka theksuar në mes viteve 1976 dhe 1990 paga në muaj të cilën e ka marrë ka qenë 1000 DM në muaj. Po ashtu nga prokurori i shtetit është pyetur lidhur me atë se pronën pasi që e ka konsideruar si të përshtatshme pse i ka marrë aq kohë të dal nga ajo pronë, pra të filloj rindërtimin në vitin 2011 e ku që i njëjti nga viti 1976 ka pasur një pagë të arsyeshme, ku i njëjti ka deklaruar se *“do t’ua tregoj disa çështje; ne shqiptarët kemi tradita të ndryshme. Më lejoni ta sqaroj. Unë kam qenë fëmija më i madh në familjen time dhe kam pasur obligime familjare. Është dashur që t’i martoj katër motrat dhe gjithashtu është dashur të martohem edhe unë në vitin 1976 dhe të gjitha këto obligime, nuk janë vetëm shpenzime të kota dhe nuk është pyetje e përshtatshme, e që prindërti e mij kanë vdekur përkatësisht babai në vitin 1962 ndërsa nëna në vitin 1985”*. I njëjti është pyetur nga prokurori po ashtu lidhur me deklarinimin e tij se edhe pse ka pasur pagë të arsyeshme, në fakt, të hyrat e tij në dispozicion kanë qenë minimale sepse ka pasur obligime të mëdha për familjen e gjerë, i njëjti ka deklarua se *“unë thash që obligime janë obligime dhe të hyrat janë të hyra, mënyra se si jetojmë dhe i organizojmë gjërat janë të ndryshme. Se a kam pasur mundësi dhe apo nëse më kanë mbetur para për ta ndërtuar shtëpinë këto janë çështje personale të miat; unë nuk i kam treguar askujt se më duhet ta ndërtoj shtëpië dhe t’i martojë djemt e mi. Para se ta ndërtoj shtëpinë, është dashur t’i martojë djemt”*. Ndërsa sa i përket të gjithë investimit deri në kohë kur ka deklaruar ka shtuar se mund të jetë shumë 22-23.000 euro deri tani dhe se nuk ka përfunduar ende, akoma ka mbetur pa përfunduar pjesa e jashtme. I njëjti është pyetur edhe me punë të cilën e ka bërë djali i tij A.B ku ndër të tjera ka theksuar se në fillim i njëjti ka punuar me kompjuter dhe të cilin dyqan e ka mbyllur në momentin e arrestimit, pastaj ka punuar në autolarje dhe në treg, por i njëjti është pyetur nga prokurori se ju thatë se e ka mbyllur dyqanin

e kompjuterëve pastaj ka punuar në autolarje dhe pastaj në treg, e që i njëjti është përgjigjur se, ka punuar në autolarje, në treg dhe në dyqanin e kompjuterëve i cili është udhëhequr nga djali i tij i dytë sepse edhe ai ka punuar së bashku me djalin e dytë, ka shtuar se këto punë janë kryer në vazhdimësi sepse një ditë shkonte në treg, pastaj në dyqan dhe përsëri në treg. Nga prokurori i shtetit po ashtu është pyetur lidhur me atë se djali i tij A.B a ka shpërndarë dërgesa në B” Caffè dhe se a ka vozitur një pickup me ngjyrë të bardhë, e që i njëjti ka deklaruar që nuk e din, po ashtu është pyetur lidhur me atë se a e njeh E.S dhe se djali i tij a e ka përmendur ndonjëherë ndokënd nga familja S,, i njëjti ka shtuar se nuk e njeh E.S dhe se asnjëherë ska dëgjuar ta ketë përmendur emrin e tij djali i tij.

Deklarata e dëshmitarëve: S.L dhe F.G, të dëgjuar më datën 21.07.2015, në shqyrtimin kryesor.

31.Deklarata e dëshmitarit S.Ll: ku ndër të tjera i njëjti ka deklaruar se ditën kritike kur ka ndodhur vrasja më 30 Gusht 2007, unë isha në shitoren time me kushëririn tim dhe policia erdhi dhe tha dy nga ju ejani me neve, shitorja me kafenenë S” është rreth tre metra larg, ku ne gjendeshim në ndërtesën e njejtë veçse ne ishim në katin e parë ndërsa kafeneja ishte në katin e dytë, ka shtuar koha kur kan ardhur policia t’i marrë ka qenë ora 17:00, sa kishte dalur nga ora 17:00, ku ne kemi qëndruar aty për rreth 15-20 minuta, ndërsa kur hymë në kafene së pari ka parë një person të shtrirë i cili peshonte më shumë se 100 kg ishte tullac dhe pastaj ata na vendosën në kënd ku ishte kafeneja dhe kishte dritare të thyera dhe karrige. Ai ka shtuar se policia kishte qenë më herët prezent aty sepse kishte dëgjuar zhurma më parë, me siguri ata kanë shkuar lart gjysmë ore më parë para se të na merrnin neve lart, po ashtu i njëjti ka shtuar se ka parë edhe një kamarier i cili ishte rrahur e që nuk i kujtohet emri i tij po që njifeshin mes veti pas që punon atje. Në momentin kur kanë hyrë në kafene policët kanë kërkuar nga ata që të shkojnë në një kënd sepse ata do të bëjnë një punë. Me të përfunduar bastisjen ka theksuar se policët janë ofruar tek ata dhe u’a kanë dhënë nga një copë letër për të nënshkruar, dhe i kanë pyetur nëse ishte çdo gjë në rregull, dhe me të nënshkruar atë copë letër të njëjtit i kanë përcjellur poshtë pasi që të njëjtit gjendeshnin në katin e dytë.

32.Deklarata e dëshmitarit F.G

Deklarata e dëshmitarit F.G e dhënë në seancën e datës 21.07.2015 ku ndër të tjera i njëjti ka deklaruar se: bastisja në kafenenë S’ më datën 30 gusht 2007 i kujtohet shumë pak, fillimit ka qenë në vendin e tij të punës, dhe ka ardhur në vendin e punës dhe e ka marrë policia dhe e kanë dërguar lartë në restoran, së bashku me të ishte edhe kolegu i tij S.Ll dhe e ka përmend edhe një person tjetër që ishte marrë nga ana e rrugës po që nuk e njifte por vetëm e ka parë atë nga brenda, lidhur me këtë person ka deklaruar se e ka parë edhe kur kanë shkuar lart i cili ishte i shtrirë në tokë. Lidhur me kohën kur të njëjtit i kanë marrë dhe i kanë dërguar lart nuk i kujtohet ora saktë sepse ka kaluar një kohë e gjatë, dhe pasi që policia i ka marrë në kafene ka shtuar se asgjë nuk ka ndodhë veçse e kanë parë një kamarier i cili nuk e dinte se çfarë ishte duke bërë atje. Sa i përket arsyes se pse i ka marrë policia nuk e kanë ditur që në fillim po pastaj e kanë kuptuar që kishte të bënte me një bastisje, i njëjti ka shtuar se ka parë gjësende në tokë, dhe se kur kanë shkuar atje kanë qenë vetëm dy nga ata, ai tek dera dhe tjetri atje, nuk e ka ditur se çfarë ishte ai atje, kamarier apo diçka dhe se me të arritur tek kafeneja kishin qenë dy civilë polic. Pasi që të njëjtit kanë përfunduar bastisjen e që nuk i kujtohet se për sa kohë kanë qëndruar aty me Safetin, zyrrarët policior kanë kërkuar të nënshkruajn procesverbalet dhe mandej gjithqka përfundoi. I njëjtit ishte pyetur lidhur me atë së gjatë kohës sa ishin në bar, çfarë kishte ndodhur atje, a ka pasur ndonjë lëvizje, veprim apo ndonjë person që ka qëndruar, i njëjti ka theksuar se nuk ka parë asgjë.

33.Deklarata e dëshmitarit N.S

Të dhëna në shqyrtimet kryesore të datës 21.07.2015, të datës 22.07.2015, dhe 23.07.2015, ku ndër të tjera i njëjti në senacën e datës 21.07.2015 ka deklaruar: lidhur me bastisjen e lokalit “Kafe Bar S”, ditën kritike të datës 30.08.2007, kishte qenë i pranishëm në “Kafe Bar S” i vetëm si dhe kamarieri Sh. G, kur rreth orës 17:00-17:10, policia me dy kombi dhe tre xhipa ishin ndalur para objektit dhe kishin dalë nga veturat në të njëjtën kohë, të cilët në numër ishin 20-30, të uniformuar, të cilët pa ndonjë paralajmërim kishin drejtuar armët në drejtim të tij dhe kamarierit dhe i kishin detyruar që të shtriheshin në tokë të cilët kishin filluar t’i godisnin pa ndërprerë e më pas e kishin dërguar në stacion policor, ndërsa policia kishte mbetur në “Kafe Bar S”. Edhe në zyrat e policisë ishte pyetur lidhur me një foto se a ishte personi në foto A.B, çka kishte mohuar se e njilhte dhe si arsye e kësaj policët të cilët kishin qenë në rroba civile e kishin goditur. I njëjti është pyetur edhe lidhur me CD se a ka ekzistuar në kohën kur ka ndodh incidenti në S.C”, i njëjti ka deklaruar se nuk kishte pasur një CD të tillë dhe nëse do të ishte e njëjta do të ishte në dijeni. Lidhur me lokalin Sekiraqa ka deklaruar se është i regjistruar dhe pronar i ligjshëm është motra e tij, ndërsa si biznes, në emrin e A.S. Ditën kritike, nga personi i njohur me emrin R (R.I), i cili zotëron zyrën e Ëestern Union, rreth orës 12:00-13:00, kishte pranuar shumën e të hollave rreth 42,000.00 (dyzet e dymijë) euro, të cilat ishin dërguar nga Spanja, e sipas një dokumenti të siguruar nga Ëestern Union në Prishtinë, të cilin prokurori prezantoi para dëshmitarit, për transferin e të hollave nga Ëestern Union në Spanjë, tregon se mes datën 28-30 Gusht të vitit 2007, kishin qenë 21 transfere në emra që dukeshin shumë të njohur përfshirë edhe emrin e dëshmitarit, e që shuma totale e këtyre transaksioneve ishte 63,000.00 (gjashtëdhjetë e tremijë) euro, shumë e cila ishte pranuar edhe nga vet deklarimi i R. në gjykatë, dhe dërguesi kishte qenë N.K, i cili këtë shumë i’ a kishte dërguar për shlyerjen e një borxhi të cilin i’ a kishte për të hollat që më parë i’ a kishte huazuar. Të hollat i kishte vendosur në zyrën e kafiterisë në një sirtar të kyçur me çelës dhe për të hollat e kishte informuar E, përmes një SMS të dërguar me telefon të cilit i kishte thënë: “R. solli të hollat”, dhe se lidhur me këto të holla nuk dinte asgjë pasi që nuk kishte pasur çasje në kafiteri pasi që kishte qenë i paraburgosur dhe as nga policia nuk është pyetur për të hollat, ndërsa sa i përket 6 (gjashtë) telefonave mobil të konfiskuara në kafiteri, kishte deklaruar se njëri telefon kishte qenë i tij, një telefon i Sh.G, ndërsa për telefonat tjerë nuk ishte në dijeni se si ishin gjetur aty. Përveç telefonave, ishin konfiskuar edhe 37 CD të ndryshme për të cilat kishte deklaruar se ato ishin CD të muzikës por për numrin e saktë nuk kishte njohuri. Lidhur me 55 fotografi të konfiskuara nuk i kujtohej, dy kaseta të kamerave, pajisja për incizimin e kamerave, nuk kishte njohuri për to pasi që kishte qenë në paraburgim për tre muaj, mirëpo kur kishte dalë nga burgu, ajo DVD nuk kishte qenë aty. Lidhur me gjësendet e konfiskuara nga policia, asnjëherë sikurse edhe anëtarët tjerë të familjes nuk kishin pranuar ndonjë vendim formal apo dokument zyrtar.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datën 22.07.2015 si dhe atë datës 23.07.2015 lidhur me 9 (nëntë) fotografi të cilat i ishin prezantuar nga mbrojtja, të shtypura, të bëra me aparat digjital, të cilat ishin bërë nga motra e të akuzuarit dhe djali i saj, 21 ditë pasi që bari ishte liruar nga policia, kur edhe ishin liruar që të hynin brenda në bar, të merrnin makinën dhe ishin bërë fotografi të barit, e që pas tri ditësh ishte bërë shpërthimi, në fotografinë nr. 6, i cili shpjegoi pjesën e zyrës që shihej, dollapin e mbyllur i cili ishte nën tavolinën e madhe, i cili shihej se ishte hapur me forcë dhe syzat kishin qenë të lëna jashtë, dhe të hollat kishin qenë në syze, kishte drynin dhe ishte edhe vula e “Kafe Bar S” dhe librat e kontabilitetit. Fotografia nr. 9, tregon vendin ku gjendeshin televizori, kompjuterët, UPS dhe aty ishte DVR. Për vrasjen e T.R, kishte kuptuar atëherë kur policia kishin shkuar në lokalin S, e për të cilin rast, derisa e kishin rrahur, i kishin thënë se “ju e keni vrarë atë”. Ditën kritike, kishte shkuar në “Kafe Bar S” rreth orës 10:00, bari kishte qenë i hapur dhe aty kishin qenë kamarieri, E.S, D.S (djali i axhës së tij), I.LI Atë ditë, E,kishte qëndruar në bar deri në mesditë para orës 12:00, pastaj me I, kishin dalë jashtë. Në bar kishte qëndruar tërë ditën, rreth orës 13:00-13:30, në bar kishin shkuar edhe persona tjerë

si N.S (djali i axhës së tij), A.E (djali i tezës së tij), një fqi dhe shoku A.B, djemtë e axhës së tij I, A. dhe Rr.A, dhe në shoqëri me ata ishte edhe A.B, të cilët kishin qëndruar në bar një orë apo një orë e gjysmë kur edhe kishin dalë dhe më nuk ishin kthyer. E, shoqërohej me biznesmen, njerëz aktiv në politikë, zakonisht me njerëz të LDK-së pasi që e përkrahte atë parti, ku në zyrë edhe mbante flamurin e Dardanisë (të Presidentit R), kishte shoqëri edhe me Rr.P, I dhe Rr.A dhe A.B nuk ishin të punësuar në kafe bar S” e as në kafenenë “B Caffè dhe veturën Pick Up ngjyrë e kuqe me mbishkrimin “B Caffè, asnjëri nga të përmendurit më lartë nuk e kishte ngasur por e kishte ngasur S.S (bashkëpronar i B.Caffè) dhe A i punësuar në kompaninë të Samiri i cili kishte punuar si kamarier në restorantin e S. Në sigurimin e “Kafe Bar S”, kishin punuar fqinjë të tij, F.A dhe S.R, të cilët kishin punuar jashtë barit, në zonat rreth objektit dhe të cilët për punën e kryer merrnin paga të rregullta në shumë prej 150 Euro. Gjatë vitit 2003-2004, rreth orës 22:00, kishte pasur një problem me policin T.R, derisa ishte duke shkuar në shtëpi, në lokacionin të ish Gjykata e Qarkut në Prishtinë, derisa ishte në veturë me E/S dhe D.S, T.kishte dalë nga vetura BMË e cila ishte ndalur në anën e djathtë të rrugës, i është afruar veturës së tyre dhe pasi E.Sd kishte hapur xhamin e veturës për të biseduar me të, T. kishte nxjerrë sprejin me ç’rast dëshmitari kishte nisur veturën duke hyrë në semaforin e kuq, ku T, kishte goditur veturën me shkelm nga prapa, dhe kishte shkuar në stacionin policor në Vranjevc për të raportuar rastin. Në deklaratën e tij të dhënë në prokurori, më datën 20.09.2007, kishte deklaruar se ditën kritike vëllain e tij E, e kishte gjetur në kafiterinë “S” në ora 10:00, pas pak në kafiteri kishin shkuar edhe A.B dhe të tjerët, E. ishte larguar nga kafiteria së bashku me I, rreth orës 12:00, ndërsa rreth orës 14:00 dhe 15:00, A.B, I, dhe Rr, ishin larguar nga kafiteria, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor kishte deklaruar se kur A.B, I dhe Rr, kishin shkuar në kafiteri, E nuk kishte qenë aty, i njëjti pas ballafaqimit me këtë deklaratë ka theksuar se nuk i kujtohet sakt përgjigja e tij po sic ka deklaruar janë shkruar pas diskutimit me prokurorin e rastit, meqë ai diktonte dhe ajo shkruante. I njëjti tutje ishte ballafaquar me pjesën e deklaratimit të tij lidhur me atë se çka kishte veshur atë ditë A.B ku i njëjti kishte deklaruar se "atë ditë A.B kishte veshur pantollë të kaltër dhe këmshië, s'kishte kapelë në kokë...." duke u pyetur se a është korrekt përshkrimi të cilin e ka dhënë, i njëjti ka pohuar që po. Tutje i njëjti është ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë lidhur me atë se sa shpesh e ka frekuentuar A.B kafiterinë S” ku i njëjti ka deklaruar "vjen shpesh", i njëjti ka deklaruar se "në polici më kanë rrahur dhe në përgjithësi këto janë fjalët e mija dhe ata kanë mundur të shkruajnë çfarë kanë dashur, duke shtuar kam thënë njëjtë edhe këtu, që ai vinte shpesh ose nganjëherë nuk vite me javë".

34.Deklarata e dëshmitares F.M

E dhënë më datën 05.10.2015, në shqyrtimin kryesor, ku ndër të tjera ka deklaruar se të akuzuarin E.S e kishte njohur qysh nga fëmijëria e saj, edhe familja e saj me të akuzuarit janë njohur mes vete, xhaxhai dhe babai i saj kanë pasur raporte me vëllain e të akuzuarit. Me të akuzuarin E.S ishte shoqëruar që nga vitit 2000, deri në kohën kur kishte ndodhur rasti në “S.C”. Të akuzuarin e përshkruan si një person të mirë dhe të respektuar. Të ndjerin T.R e kishte njohur sepse i njëjti shoqërohej me një nga shoqet e saj B.Q dhe ishte i fejuari i saj. Po ashtu edhe B.H dhe Sh.Q i kishte njohur në bazë të A, nga Ferizaji, së cilës mbiemrin nuk i’a dinte e cila ishte e dashura e E.S, e cila e kishte thirrë për të pirë kafe në Ferizaj. Atë kohë kur A, e kishte thirrur, kishte qenë në lidhje me B.H, të cilën kur e kishte takuar në një restorant në Ferizaj, në një tavolinë tjetër kishin qëndruar bashkë B.H dhe Sh.Q dhe kjo ishte kur kishte ndodhur incidenti në Ferizaj në mes E.S dhe njësitit policor të Ferizajit. A, kishte kërkuar që ta përkrahte deklaratën e saj, që të thoshte gjëra të këqija për E.S dhe pasi që kishte refuzuar këtë, B dhe Sh, kishin filluar ta thërrisnin në telefon çdo ditë duke insistuar që të takoheshin me të. Sh, i kishte dërguar CD-në e ditëlindjes së E.S të cilën i’a kishte dorëzuar personalisht, mirëpo për këtë ngjarje nuk ishte në dijeni se a kishte ndodhur para apo pas vrasjes së T.R. Përshkruan rastin se si ata e kishin thirrë të takoheshin, e cila kishte lajmëruar nënën e saj në telefon se do t’i takojë këta persona dhe nëse

diçka do t'i ndodhte – të lajmëroj policinë. Ata ishin 5 (pesë) persona me një mercedes të zi, me targa të Gjermanisë (B dhe të tjerë), dhe kishin shkuar në drejtim të Brezovicës, e cila kishte përfunduar në një dhomë. Asaj i kishin marrë telefonat të cilët i kishin lënë në veturë, ndërsa revolet i kishin nxjerrë dhe i kishin vendosur në tavolinë, dhe nga ato skena e njëjta kishte filluar të qajë dhe t'i pyeste se çfarë dëshironin t'i bënin. B.H i kishte thënë se: ti e njeh E.S dhe duhej të shkonte dhe të deklaronte keq për të.

Deklaratat e dëshmitarëve Q.Q, L.L, dhe B.D -ekspertë dhe persona përgjegjës në PTK, të dëgjuar në shqyrtimin kryesor me datën 03.12.2015.

35.Deklarata e dëshmitarit Q.Q

Ku ndër të tjera ka deklaruar është menagjer i zyrës ligjore për bashkëpunim me agjencionet për zbatimin e ligjit, kryejnë detyra administrative teknike, pranojnë urdhra nga sistemi i drejtësisë, kryesisht nga gjyqtarët dhe prokurorët të cilat i pranojnë dhe i lexojnë, pastaj i rishikojnë nëse numrat janë të përmbushur dhe koha e parashikuar për kontroll të numrave të dhënë, të cilët urdhra i përcjellin tek operatorët e njësisë teknike të cilët janë të obliguar ta zbatojnë. Pasi që ata përfundojnë punën e tyre, i kontaktojnë hetuesit policor të autorizuar të cilëve u ofrojnë prapa – veprimin. Lidhur me pranimin e urdhrin të gjykatës për përgjime, policia u dërgon urdhrin të cilin e regjistrojnë dhe pasi që të kompletohen të dhënat, futen në sistem dhe pas kësaj inxhinierët merren me çështjet teknike lidhur me zbatimin e atij urdhri dhe pas përfundimit të detyrës së tyre, autoritetit i cili ka parashtruar kërkesën, i lëshojnë informatat e kërkuar në CD, të cilën u'a dorëzojnë autoriteteve policore. Kjo nënkupton se kur ata pranojnë një urdhër nga gjykata, ata e zbatojnë atë, nuk merren me kualifikimin ligjor të urdhrin por vetëm me çështje administrative teknike. Lidhur me afatin ligjor, kohëzgjatjen dhe ruajtjen e të dhënave, platforma për ruajtjen e të dhënave, kohët e fundit kishte ndryshuar disa herë dhe në raste kur për ndonjë çështje specifike, të dhënat nuk mund të fshihen pa ndonjë urdhër të gjyqtarit por në të kundërtën e kësaj duhet të ruhen.

36.Deklarata e dëshmitarit L.L

Ku ndër të tjera ka deklaruar se është zyrtar ndërlidhës në kuadër të PTK-së, i njëjti ka shpjeguar se ka një kërkesë për nxjerrjen e të dhënave komplet dhe po ashtu ka një shfrytëzues dhe aryeja është se i njëjti është një person i besueshëm për t'i kryer ato detyra. I njëjti ka shpjeguar vetëm lidhur me CD-në që e ka sjell, ka shpjeguar se janë hartat e Prishtinës dhe rrjeteve, ku këto janë hartat të cilat i kanë identifikuar përmes stimulimit që quhen RMP dhe ky është sistemi i zhvilluar nga B.D që e ka përmendur. I njëjti ka shpjeguar për gjykatën se kërkesën të cilën e shfrytëzojnë dmth që e përdorin për bazën e të dhënave, momentalisht shfrytëzohet për bazën e të dhënave, ku automatikisht nuk i lejon të njëjtëve të kenë qasje në ato të dhëna pasi që ato paraprakisht fshihen dhe ky operacion menaxhohet nga një kompani krejtësisht tjetër që nuk ka të bëjë fare me PTK-së e cila gjendet në Kroaci. Lidhur me pranimin e kërkesave ka theksuar se procedura është si në vijim kolegu i tij Q.Q e pranon, ai e regjistron dhe e vendos numrin e protokollit, tani ai dokument i sjellet këtyre por me numër të referencës të PTK-së dhe jo me numër të referencës së gjykatës, në momentin e pranimit të dokumentit e marrin dhe e printojë. Tutje e lexojnë dhe e shohin se a mund të merren me atë apo dokumenti ka të bëjë me numrin e VALËS apo është kërkesë i ndonjë lloj shërbimi tjetër me të cilën nuk mund të merren.

37.Deklarta e dëshmitarit B.D

Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit B.D e dhënë në seancën e datës 03.12.2015 ndër të tjera ka theksuar se në momentin kur ju e kyqni telefoni dhe jeni i lidhur në rrjet, rrjeti i ka informacionet të cilat i keni dhënë në rrjet, nëse dikush mundohet t'ju thërras, kabllo e rrjetit i ka informatat se në cilën qeli ato janë,

përmes njoftimit dhe mundet t'ju lokalizoj saktësisht në cilën qeli jeni, njëra qeli është krijuar nga njëra antenë dhe në momentin që dikush mundohet t'ju thëras rrjeti e nis atë qeli se ku gjendeni, dhe se çdoherë kur ndodh diçka një thirrje apo SMS porosi e nis njoftimin dhe përcakton nëse jeni aty apo jo. Ka shtuar se antenat punojnë në parime të rrezatimit radioaktiv dhe e ka zonën e vet të mbulesës, dhe shumë faktor ndikojnë në mbulesën e antenave. Ka faktorë të cilët janë të kontrollueshëm siç është rryma që i japim antenës, dhe faktorët të cilat nuk mund t'i kontrollojmë që janë kodrat, ndërtesat, faktorët natyral dhe urban në përgjithësi. Lidhur me rajohet urbane dhe rurale ka shtuar se ndodh që 2 antena ose më shumë mbulojnë të njëjtin lokacion.

38.Dëshmitari A.C

Në deklaratën e dhënë në polici, me datën 27.11.2007, ka deklaruar se ditën kritike të datën 30.08.2007, kishte qenë në Turqi së bashku me bashkëshorten e tij I.H. Mes viteve 2002-2006, ishte shoqëruar me E.S, dhe pas kësaj jo më, pasi që tek opinioni kishte reflektuar negativisht. Me të njëjtin kishte shëtitur nëpër rrugët e Prishtinës me veturat e tij Golf III të blinduar, me gjip të gjelbër. Gjatë asaj periudhe kohore, E e kishin shoqëruar edhe Rr.A (Rr), I.A (L), A.B (S), N.S (K), S/S, N.S. Derisa kishte qenë duke u shoqëruar me E.S, ky i fundit kishte pasur probleme të vazhdueshme me T.R, për shkak të A. T.R e kishte njohur se kishte qenë polic si dhe kishte pirë kafe në kafiterinë ///”, në të cilën T, kishte qenë i rregullt. Lidhur me rolin e E.S në grupin e tij dhe njerëzit që e rrethonin, i njëjti deklaroi se E, kishte pasur rolin kryesor të “Grupit”, dhe të gjithë i bindeshin urdhrave të tij kur ata ngarkoheshin me detyra nga ai., dhe se të gjithë anëtarët e tij i kishte i kishte mbajtur me të mira materiale dhe Rr, dhe I.A u kishte ndërtuar shtëpitë. I.A e kishte parë të shoqërohej me A.B me veturë në qytet.

39.Deklarata e A.S

I njëjti ka dhënë deklaratën e tij në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 19.03.2024 ku ndër të tjera ka theksuar se nga viti 2000 deri në vitin 2007 ka qenë Instruktor i Policisë së Kosovës-Instruktor i Njësisë Speciale deri në ditën kur është larguar nga aty si dhe ka qenë pjesëtar i mbrojtjes së afërt. Lidhur me njohjen e T.R ka deklaruar se T. e ka njohur prej shkollës fillore, po ashtu kanë qenë bashkë edhe në gjimnazin “Xhevdet Doda”, pastaj të njëjtin e njef poashtu edhe prej sportit me të cilin është marrë me bodybulding, e ka njohur po ashtu edhe prej punës së tij në OSBE ku edhe ky ka punuar për një kohë. I njëjti ka potencuar faktin se T, ka qenë gjenerata e parë e policisë, ndërsa ky i katërti si gjeneratë. I njëjti ka shtuar se me T. ka punuar deri në ditën kur ka ndërruar jetë dhe me të njëjtin ka pasur një shoqëri të mirëfillt dhe kanë kaluar shumë kohë bashkë si kolegë dhe si shokë, ka shtuar se meqë kemi kaluar një kohë së bashku dhe jemi njohur familjarisht e konsideron se i kanë ndarë të mirat ashtu edhe të kqijat. Sa i përket problemeve të T.R ka shtuar se i ndjeri T.R, në fillimin e karrierës së tij si polic, me qenë se ka qenë polic më i mirë i Njësisë Speciale që ka pasur Kosova, shumë grupe pas luftës që kanë dashur me dominu me anë të krimit në Kosovës, kanë dashur me bo presion, e poashtu e kemi pasur grupin e “S”, që kanë bërë presion, si në rastin të shkollës e mjekësisë “Te rrethi”, në Prishtinë, ai ishte një ndër rastet e para. Pasataj kemi pas raste të përcjelljes, ku janë sjell afër lagjes ku ka jetu, po jo vetëm ai, poashtu kam pasur të njëjtin eksperiencë edhe unë, poashtu, në shumë raste afër banesës, lokaleve që i kemi frekuentuar. Pastaj, ka pasur shfryrje të gomave të veturës së T jo një herë, po më shumë herë. Pastaj me një rast tjetër ka pas edhe shpuarje të gomave.

T ka filluar një lidhje romance me A, në atë kohë, edhe pas një kohe shumë të shkurtër, i është djegur vetura, që ishte një mesazh, apo nuk e di nga ana tjetër, por kulmi ishte kur Operativa e Shtabit të Prishtinës, kur shefi i operativës në atë kohë internacionali M.Sh- na ka njoftuar me email dhe ka kërkuar që të mbahet një mbledhje me mua dhe me T. dhe ka njoftuar që E.S, është

zënë nga intelgjencia, se gjatë përgjimit të telefonit të tij, të ketë thënë se “do ta vras A, dhe T”, dhe se për një kohë, do të dal nga shteti, dhe është mbajtur mbledhja, dhe është kërkuar që të mbahet mbledhja edhe me hetuesin e Policisë së Kosovës, i cili ka kërkuar bastisjen e vendbanimit e personit në fjalë, poashtu ka kërkuar që ta ndrojmë vendbanimin për mua dhe T, që të jemi më të sigurtë, po me qenë se unë kam qenë i martuar dhe T,, ka qenë në lidhje, nuk kemi pranuar të ndërrojmë shtëpinë, por në një farë mënyre e kemi bind që do të jemi të kujdesshëm. E kemi ndarë një veturë të blinduar për T, për me qenë më i sigurtë, por kjo ka ndodh, ku nuk e përmenda rastin e “S.C”, ku unë kam qenë i lënduar, kjo mbledhja ka ndodhur pas rastit të “S.Casino”. Rasti i “S.C”, ka ndodhur në natën e krishtelindjeve, ku unë pas meshës me familjen time, e poashtu edhe me Tn”, i cili i ka pas ftesat për “S. Casino”, i cili na ka ftuar, për të festuar “Natën e Krishtelindjeve” së bashku.

Duke mos ditur, që aty ka qenë një përcjellje që na ka ndodhur, ku jemi nxënë në një pikë ngulfatëse, mu në hyrjen e lokalit, në korridor ku unë jam plagosur pa asnjë arsye, edhe poashtu të njëjtën kohë kanë qenë të rrezikuar shumë njerëz, si familja ime dhe shume njerëz, që kanë qenë të pranishëm në korridor, që “Grupi i E, ka qenë mbrenda dhe jashtë lokalit, ku ne e kemi gjet veten në mes të “grupit” edhe jemi sulmuar pa asnjë paralajmërim apo diçka, edhe aty unë nuk jam vetëm dëshmitar por edhe viktimë.

Ka pasur edhe raste të tjera tek “G”, që me ka tregu T,, që ka pasur me vetura, poashtu kanë qenë në Stacionin numër-4 , ku janë zënë dy persona nga Hajvalia, që janë zënë me armë dhe antiplumb, kur janë marrë në pyetje kanë thënë “që janë të paguar nga E, për ta vrasë T”. Pastaj rasti i fundit, kur T, më ka treguar në telefon, kur unë kam qenë në Kroaci, ku disa persona afër fshatit të tij në S”, kanë krijuar një pengesë në rrugë, ku kanë dashtë me ja bërë një lloj atentati. Për me e ditë që T, ka pasur problem me E.S, nuk është dashur që të jesh shok i ngushtë me të, sepse edhe fëmijët e lagjës e kanë ditur që E, ka problem me të, dhe jo T me E. Ka qenë një fakt i ditur, kulmi i asaj ka qenë kur e kemi marrë informatën prej inteligjencës, që janë vërtetuar të gjitha ato. Sa i përket incidentit tek Shkolla e Mjekësisë ka theksuar se ka ndodhur rreth viteve 2000-2001 në fillimet e karrierës së tij si polic. Lidhur me arsyet se pse kanë ndodhur këto incidente ka shtuar se mendoj që meqenëse T, ka qenë një djal i Prishtinës dhe polici më i mirë në atë kohë është mundur që të i bëhet një lloj presioni që të dominojnë Prishtinën, e nëse një presion të tillë dhe nëse përkulet një polic që është elitare, pastaj policët tjerë nuk bënin rezistencë, po ashtu këto presione janë rritur në jetën e T, kur në jetën e tij është ardh A.

Sa i përket Grupit S, pjesë e tij ka qenë E,, vëllau i E.S, S., A.B që e ka plagosur, Rr.A, L, F.H F.M. Pastaj i njëjti është pyetur sërish nga prokurori special lidhur me rastet e përcjelljes së T.R dhe rastin e Ss.C”, ku i njëjti ka deklaruar se ka pasur shumë raste kur kemi qenë bashk kur kanë qenë së bashkur kur i kanë përcjellë Grupi S, dhe ka pasur shumë raste kur T, ka qenë vetë. Lidhur me rastin e “S.C” ka deklaruar se kemi qenë në hyrje të lokalit saktësisht në korridorin, dhe se personin e parë që e ka identifikuar ka qenë E, i cili e ka sulmuar me krahë T, dhe po të njëjtën kohë ka filluar sulmi prej disa anëve që ka qenë një pikë ngulfatëse aty, ku kanë qenë të atakuar në të njëjtën kohë, në sekonda ka ndodhur ajo, ku A.B e ka plagosur në këmbën e djathtë dhe që E, ka qenë aty dhe E, e ka fillu, ka shtuar se nuk ka pasur fjalosje ka pasur atak direkt prej tyre në drejtimin e tyre. Ndërsa lidhur me ndërrimin e vendbanimit të T. ka shtuar se pasi që kanë marrë informacione nga shefi i shtafit që e ka mbajtur mbledhjen ku janë informuar që E.S është duke e planifikuar vrasjen e A dhe T,, i është ofruar vendbanim i ri prej policisë sepse ka qenë serioze deklarata, por që të njëjtit nuk e kanë kuptuar aq serioze dhe që nga ajo kohë kanë vendosur që T, me iniciativën e tij të ja ndajnë një veturë të blinduar që të udhëtoj nga shtëpia për në punë. Po ashtu duke marrë parasysh se kohëve të fundit pas që janë intesifikuar përcjelljet dhe kërcëimet T, ka kaluar më shumë kohë në fshatin S” nga vjen familja e tij, ai ka shkuar në S. për arsye se e ka ndi vetën më të sigurt. Sa i përket kontakteve para vrasjes së T, ka shtuar se ka qenë një javë apo dy javë, pasi që i njëjti fizikisht ka qenë në Koraci, është dëgjuar me T, ku përmes telefonit i ka treguar që i është bërë një atentat në fshatin St, i cili si rast ka

ndodhur një javë apo dy para vrasjes. I njëjti ka shtuar se para vrasjes së T.R ka qenë në Amerikë për 2 javë, pasi që është kthyer një javë në Kosovë, ku kanë ndejtur shpesh me T, që edhe kanë punuar bashkë, pastaj ka shkuar në pushim në Kroaci ka qenë vera, me të kuptuar që T, është privuar nga jeta është kthyer në Kosovë për tri ditë dhe ditën e katërt është nisur për Amerikë.

I njëjti është marrë në pyetje edhe nga avokatja mbrojtëse e të akuzuarit E.S, Avokatës K.K, ku ndër të tjera ka deklaruar se: kur është privuar nga jeta T.R nuk ka qenë në Kosovë nuk e din se kush është vrasësi, dorasi është lajmëruar vet, por e din që kush e ka dhënë urdhërin dhe kush e ka orkestruar urdhërin, e që është E.S dhe jo që këtë e din vetëm ai, por këtë informatë e ka marrë edhe prej inteligjencës. Ai ka shtuar se ka deklaruar se meqë nuk ka qenë aty, ai e di emrin e personi që e ka orkestruar vrasjen mirëpo nuk e ka ditur emrin e personit i cili e ka kryer vrasjen. Ai ka shtuar se është lehtë me kuptu se E, e ka orkestruar vrasjen duke filluar prej të gjitha atyre incidenteve të cilat i ka përmendur më herët, kërcënimeve, të cilat nuk mundet me i dokumentu për momentin, por duke e kuptuar se T, ka qenë shumë i dashur prej krejt Prishtinës, përveq grupeve që e kan thyer ligjin, duke u bazuar në mbledhjen e cila është mbajtur enkas për punë, që personi e ka pohuar që është duke u planifikuar me e vra A, dhe T, dhe me u largu për një kohë prej Kosove. Sa i përket mbledhjes të mbajtur nga M.Sh ka theksuar se është organizuar mbledhja me Shefin e Hetimeve Regionale të Prishtinës e që nuk e din se kush ka qenë shef i hetimeve të asaj kohe, ai ka shtuar se ai ka qenë personalisht iniciatori dhe ka marrë përsipër për mbajtjen e mbledhjes dhe me i fitua të gjithë ata që duhet me qenë aty, ku ai dhe T. kanë marrë pjesë si mysafirë në një farë mënyre për mu njoftu për atë se çfarë është duke ndodhur, ai ka shtuar se nuk i kujtohet se kush ka qenë në mbledhje tjetër përpos atyre të dyve pasi që nuk e konfiguron hierarkinë policore, aty kishte informata që ka marrë për jetën time, për të mos gabuar nuk e din saktësisht emrat dhe mbiemrat e tyre. I kujtohet që është incizuar si mbledhje dhe po ashtu është mbajtur si procesverbal. Ai ka shtuar se Zotri.H, e ka marrë memon nga intelegjenca, i cili e ka organizuar mbledhjen me personat e duhur të asaj kohe, ku pasi që ka përfunduar mbledhja, përfundimi ka qenë që shtëpia e E.S të bastiset, dhe ajo ka ndodhur një javë apo dy javë mrapa. I njëjti është pyetur lidhur me atë se a ka njohuri se T.R ka refuzuar sigurimin apo mbrojtjen nga policia, dhe që i njëjti ka kërkuar të pajisjet me një armë MP-5 dhe një makinë të blinduar dhe që të dyja janë refuzuar, ai ka deklaruar se nuk e besoj që është e njëjta nuk e din se çka po i referohet ai ka shtuar se ka dhënë deklaratë në vitin 2008, deklaratë e cila është zhdukuar për MP-5, që nuk ka dëgjuar ndonjëherë por e din që veturën e blinduar i'a kanë referuar.

Tutje i njëjti është pyetur edhe lidhur me deklaratën e datës 19.05.2008 të cilën e ka dhënë në SHBA ku ka ardhur hetuesi M.M për të marrë deklaratën e tij, ai ka theksuar se është e saktë, po në të njëjtin vend dhe të njëjtën ndërtesë. I njëjti ka shtuar se M.M më ka kontaktuar si hetues i rastit të vrasjes së T, pjesëmarrës në hetime, meqenëse nuk ju ka jap viza hetuesve të asaj kohe, ai ka qenë me nacionalitet amerikan, i njëjti ka qenë i dërguar nga organet e Kosovës dhe tani nuk është i sigurtë është e njëjta procedurë sikurse janë duke e realizuar tani, ai ka shtuar se e ka parë dokumentin me shkrim me të cilin është autorizuar M.M për të marrë ata në deklaratë. Ndërsa pasi që është ardh në Kosovë, ku ka qëndruar për tri ditë pasi që është vrarë T, ka shtuar se nuk është lajmëruar te hetuesit e rastit për arsye se rrethanat në Kosovë nuk kanë qenë të sigurt për të me u ndal dhe me u marr me dëshminë dhe prej të kaluarës së tij që ka pasur në rastin "S.C" që është kthyer mrapa disa herë dhe kur "memo e intelegjencës", doli e vërtetë dhe u realizua dhe në bazë të kërcënimeve që ka qenë i dyti pas tij, as familja e tij as ai nuk ka qenë i sigurt që të jap dëshmi atje, për atë edhe në vitin 2008 kanë qenë të gatshëm të japin deklaratën e tyre ashtu siç është dhe të njëjtën kohë po e bën tani.

Përgjatë deklaramit të tij i njëjti është pyetur lidhur me atë se a ka dëgjuar që në SHBA në vitin 2015 të jetë dorëzuar vullnetarisht E.S dhe që ka filluar gjykimi ndaj tij. I njëjti ka deklaruar se ka dëgjuar që është dënuar me 37 vite dhe çdo gjë ka përfunduar, me të kuptuar që E, është dënuar 37 vite ka menduar që gjithçka ka përfunduar, ndërsa tash kohëve të fundit është

interesuar dhe ka kërkuar edhe deklaratën e tij që e ka dhënë në vitin 2008. I njëjti ka shtuar se e ka telefonuar vëllaun e T. me pa se çka ka ndodhur me deklaratën e tij dhe si është e mundur se nuk ka përfunduar rasti ende, dhe se vullnetarisht e ka kontaktuar dhe është interesuar se çfarë ka ndodhur me deklaratën e tij. Lidhur me rastin e “S.C” ka theksuar meqë sulmi është bërë nga brenda dhe ka pasur të shtëna edhe prej jashtë, ai thekson se është përcjellur për me ardh në pikën ngulfatëse të korridorit, dhe se E. e kanë gjetur në “S.C”, len për të kuptuar se kur janë parkuar me vetura, këta janë organizuar dhe riformuar për me i zënë në pikën ngulfatëse në korridor pasi që nuk ka pasur paraprakisht ndonjë fjalosje, por menjëherë janë sulmuar dhe kjo tregon që kanë qenë të organizuar. Ka shtuar se personat e tij që kanë qenë tek veturat, e kanë lajmëruar këtë që janë në ardhje aty dhe pak a shumë është ditur se sa kohë merr sigurimi derisa të hyjnë brenda, kështu që këta janë organizuar. Dëshmitari është pyetur edhe lidhur me rastet të cilat i ka cekur se T, ka pasur probleme a i ka lajmëruar, i njëjti këto raste në polici dhe rastet e përcjelljes kur ka treguar që ka qenë prezent i njëjti, ai ka deklaruar se disa prej tyre janë të lajmëruara e disa prej tyre ka theksuar se nuk mundet me i dokumentu. Po ashtu i njëjti përgjatë deklaramit të tij ka deklaruar se E. ka pasur probleme me T, dhe jo T, me E, është pyetur se çfarë probleme ka pasur E, me T, i njëjti ka shtuar se E ka pasur probleme me ligjin, T ka qenë zbatues i ligjit, ka qenë siç e ka cekur më herët polic që edhe shteti përreth e kanë pasur lakmi, ka filluar me i bë presion dhe si duket konflikti i interesit që A ka qenë me T, e ka shtyrë edhe më shumë që të bëjë edhe personale edhe kriminale. I njëjti ka shtuar se këto grupe kriminale kanë pasur të kaluar kriminale edhe para T, dhe ai nuk ka qenë i vetmi i cili e ka luftuar krimin, nëse hulumtohen dosjet e policisë do të shohim se ka pasur edhe shumë raste të cilat kanë ndodhur, ndërsa T, ka qenë më i miri dhe për këtë ka qenë i atakuar më shumë se sa tjerët.

Tutje është pyetur lidhur me kontaktin e tij përmes telefonit para se të vritet T. 2 javë më përpara, është pyetur lidhur me rastin e “S”, i njëjti ka shtuar se është e saktë përveç tjerash aty e ka përmendur rastin që ka ndodh, ka shtuar meqë se këto ishin shëndrruar në normale, nuk i kujtohet saktësisht se më ka treguar se kur dhe në çfarë kohë ose ore i ka ndodhur ajo dhe lidhur me banimin në fsh “S” ka shtuar se ai kohë pas kohe ka shkuar atje, se e ka ndi vetën më të sigurtë, i njëjti ka punuar në Prishtinë. Në fund është pyetur edhe për emrin Gj.K, i njëjti ka deklaruar se ka dëgjuar për emrin Gj, ai ka shtuar se bashkëshortja e tij nuk është në lidhje familjare me Gj.K për aq sa e din ai, ndërsa sa i përket rastit të S.Casinos, pas rastit ka pasur sikurse të ai dhe tek T, persona familjarë dhe jo familjarë, dikush me qëllim të mirë dikush me qëllim të keq, që kanë insistuar me ardh te një lloj kontakti, informata të ndryshme dhe se të njëjtit i kanë refuzuar të gjithë dhe e kanë lënë që me këtë punë të merret drejtësia sepse nuk kanë pasur diçka personale. Ndërsa dëshmitari në pyetjet e trupit gjykues ka deklaruar si në vijim: lidhur me orkestrimin e vrasjes së T.R ka potencuar se e di se kush e ka orkestruar dhe se fakti kryesor është prej inteligjencës dhe të gjithë faktet që i ka përmendur më herët. I njëjti ka shtuar se T ka qenë në ndjekje nga Grupi S. por ndjekja ka qenë enkas prej Grupit S, por secili polic ka probleme me grupe të ndryshme kriminale, lidhur me rrezikshmërinë nga Grupi S. ka shtuar se mban mend shumë biseda, konkretisht kur ka qenë kur i është djegur vetura, që T. atë kohë ka biseduar me të njëjtin, se është tu ju bo me qëllim që i njëjti është me A. , tani ka pasur raste të ndryshme dhe se T. ka qenë i bindur që ai person që është sot në gjykatë i ka bërë këto, ndërsa sa i përket rrezikut për jetë i njëjti shpjegon se T. është ndier i rrezikuar kur e ka marrë deklaratën në mbledhjen që kanë mbajtur në Shtab të Operativës në Prishtinë, dëri në atë qast ka shtuar se ka qenë aludiv ndërsa pas kësaj informate ka shtuar se kanë qenë të rrezikuar për jetë posaqërisht T. Lidhur me organizimin e dhjetërave problemeve të cilat i ka rrëfyer për gjykatën ka shtuar se shumica prej tyre kanë qenë të organizuara nga Grupi S, e po ashtu edhe njëherë e potencon faktin lidhur me rastin në fshatin S” ë ku T personalisht e ka telefonuar dhe i ka treguar. Sa i përket shpërnguljes së tij në Amerikë njëra prej arsyeve se pse ka shkuar në Amerikë ka qenë kërcënimet që i ka marrë në atë kohë që ka qenë i dyti në rradhë për tu vvarë, në bazë të bindjeve të tij por edhe në bazë të informatës së inteligjencës që kanë dalur të jenë të vërteta. I njëjti ka

deklaruar se T” nuk ka pasur probleme të atij niveli si me Grupin S, ku secili polic ka probleme por jo të atij niveli, ndërsa lidhur me vrasësin e T, A.B ka theksuar nuk e beson që T, e ka njohur personalisht, është i dyshimtë nëse T. e ka njohur si fytyri duke u bazuar në atë se i njëjti nuk e ka njohur më herët dhe as që ka dëgjuar për të në të kaluarën.

40.Deklarata e Gj.K

I njëjti në pyetjet e mbrojtëses së të akuzuarit E.S, Avokatës K.K ka deklaruar se: për rastin e S. Casinos ka dëgjuar nëpërmjet mediave se E.S, që ka ndodhur një rrahje me plagosje në atë lokal, ka dëgjuar më vonë nuk mund ta dijë sakt ndoshta pas një muaji, apo muaji e gjysmë që ka ndodhur rasti, që është A.S dhe T.R, ndërsa e ka njohur A.S dhe E.S. E.S e njuh pasi që i njëjti po ashtu merret me hotelieri dhe se E, e ka pasur musafirë, rastësisht janë njoftuar dhe prezantuar dhe i ka ofruar një kafe të cilën E, e ka prezantuar dhe aty i njëjti e ka marrë lokalin e tij kafën që e ka shitur E.S dhe prej aty ka fillu me u shoqëru. Ndërsa sa i përket njohjes me A.S ka shtuar se është dhëndër në fshatin e tij në V.. në Komunën e Prizrenit, ku bashkëshortja e A. është kumar e familjës së tyre, emri dhe mbiemri i gruas së A. është B.C. ndërsa emri i babait të saj është L.. I njëjti ka theksuar se pas rastit të S.Cainos, A.S dhe T.R e kanë thirr në një restoran sa i kujtohet ka qenë restorani Piknik, aq sa i kujtohet në telefon e ka thirr A, sepse A, e ka njohur dhe qëllimi i takimit ishte rreth punës së E, dhe se çfarë kishte ndodhur me rastin, ai ka shtuar se e ka ditur se rasti ka pasur të bëjë me polic po se ka dit që ka pasur të bëjë me T, dhe A. Ka shtuar se në ditën kur janë takuar në Restoranin P”, ka qenë ditë dhe është hapur biseda “se kanë pasur një problem me E.S”, ku më shumë ka biseduar A. he i njëjti i ka thënë se “kam dëgjuar se ti rrinë me E.S dhe se ke kontakt” dhe se e kanë qitë si ndërmjetësues me u pajtu A, T dhe E.S, ata i kanë thënë se ata e kanë rrah E. dhe se kërkojnë pajtim, sa i kujtohet Arbeni i ka thënë se “në shkallë janë cakërruar me supe të krahut pra A dhe Ei”, dhe se pastaj janë rrahur dhe rrahja ka zgjat derisa janë lodh. I njëjti ka shtuar se sipas tij ndërmjet A dhe T, ka qenë kërkim falja që e kanë rrahur E.S dhe se i njëjti kishte pranuar këtë kërkesë dhe se i kishte thënë T dhe At “aq sa kam mundësi shpirtërisht kam me u mundu për me ju pajtu”. Pas kësaj ka potencuar se E, pas rastit të S.Casinos ka qenë në spital dhe se ka shkuar tek shtëpia e E, djalin e tij Xh, e kanë fillu bisedën ku të pranishëm kanë qenë, ai, djali i tij dhe vëllau i E i quajtur N.S. I njëjti i ka treguar E, t se është takuar me T., dhe A., kanë biseduar, kanë folur me të dhe kanë kërkuar falje dhe mundësisht ne jemi ardh deri te pajtimi për tu pajtuar dhe se E, i i ka thënë “a kanë treguar Gj. ndonjë arsye, pse e kanë bërë këtë”, i njëjti është përgjigjur se “jo nuk më kanë thënë ndonjë gjë”, dhe se E i ka thënë “do t’i ndjekë penalisht”. Po ashtu i njëjti ka shtuar se pas kësaj bisede me E. , është takuar me A dhe bashkëshorten e tij në Prizren por pa T, nuk e din saktë por kujton që A, e ka thirrë dhe e ka pyetur për bisedën, dhe ky e ka njoftu që është taku me E, dhe kanë lënë takimin në Prizren, ku A, ka qenë tek miqt e tij në V., dhe i njëjti i ka treguar se E, e ka pyetur të njëjtin se a të kanë treguar se pse e kanë rrahur të njëjtin, ai ka treguar se nuk më kanë dhënë kurrfarë arsye dhe kanë pirë nganjë kafe me bashkëshorten e tij, ndërsa përgjatë bisedës sa e ka kuptuar nuk ka pasur kurrfarë shqetësimi. I njëjti është pyetur se ku jeton A.S ku ka deklaruar se jeton me familje në Amerikë, nuk e din saktësisht kur është shpërngul në Amerikë, me të dëgjuar e di se pas rastit, më sa është i informuar A vetëm para rastit ka filluar pas letrave me shku në Amerikë, sa i përket arsyes së shpërnguljes së tij ka theksuar se unë jo se kam dëgjuar vetëm prej kumarisë, por ne e kemi vajzën e axhës së A. edhe axhallarët e A edhe vet A/. kanë punuar në Institucionet e Kosovës, mendon se janë një familje shumë e fortë dhe moralisht janë të fortë dhe të ndershëm dhe nuk mendon që A ka pasur arsye që shkaku i E.S për me e lëshu Kosovën.

Përgjatë deklaramit të tij i njëjti është marrë në pyetje edhe nga Prokurori special është pyetur lidhur me njohjen e E.S, e që ka shtuar se nuk i kujtohet saktësisht kur ka filluar të marr kafe nga ai, por mendon se ka qenë viti 2010 deri në vitin 2012 saktësisht si kujtohet por që në gastronomi i njëjti ka qenë nga viti 2010. I njëjti është pyetur se a i bie që para vitit 2005 nuk ka pasur njohje

me E.S pasi që rasti “S.Casino” ka ndodh në vitin 2005, i njëjti ka deklaruar se E.S e ka njohur si person por në vitin 2005 të cilin e ceku prokurori nuk mendon se ka nderjetur me të. Po ashtu i njëjti është pyetur rreth deklaramit të tij të mëhershëm ku ka deklaruar se me E.S nuk janë takuar më që i bie viti 2006 po që biznesin e ka filluar 2010 cila është e vërteta, i njëjti ka potencuar se “unë e thash se saktësisht nuk e di se kur janë taku dhe kur është njoftuar me E.S por e ka njoft para vitit 2005, por se ka nderjet me të nuk e beson”. Pastaj i njëjti është pyetur rreth A.S se a ka nderjetur me të para rastit të “ S.Casinos”, ai ka shtuar se betohem se e njoh A. S dhe ka pasur kontakt me të njëjtin edhe më herët, I njëjti është pyetur se si nuk e ka dit që A.S është plagosur pasi që ka pasur me të njëjtin lidhje paraprake familjare, ai ka deklaruar se “mua A.S kurr nuk ma ka dokumentuar me gojë të vet se jam i plagosur as nga E.S, as nga dikush tjetër dhe sa herë janë takuar nuk e ka qelë bisedë”. I njëjti nga prokurori special është pyetur thatë që nga vini është kërkuar të shkoni dhe të kërkoni nga E kërkim falje, duke u nisur nga mendimi i juaj personal duke e respektuar moshën që e kanë nga trevat që vini duke i’ a shtuar edhe nga feja që vini sipas mendimit tuaj a ka mundësi që një person të kërkon ndërmjetësim dhe kërkim falje për një ngjarje kur ai është vet i plagosur dhe ka ndodh rrahja, i njëjti është përgjigjur se “unë e ceku se shkaku i moshës jam 63 vjeq, jam shqiptar i besimit krishter dhe regjionit siç e ceku prokurori, jam 7 herë gjysh, betohem para trupit gjykues se të gjitha këto që i thashë janë të vërteta. Jo E.S por vëllau im me qenë mos me më pas thirrë A.S dhe i ndjeri T.R kurrë në jetën time nuk kisha ardh këtu me e dhënë këtë dëshmi dhe me keqardhje me mish e me shpirt nuk kam pasur dëshirë me ardh me e dhënë këtë deklaratë. Por këto pyetje të cilat mi keni bërë dhe të gjitha këto çfarë i kam thënë janë të vërteta. Tjetër nuk di se çfarë të them, unë betohem se nuk e kam ditur se është i plagosur, e as nuk më ka qelur ndonjëher këtë temë”.

I njëjti në pyetjet e trupit gjykues ka deklaruar si në vijim: lidhur me atë se a janë falur A.S, T.R nga E.S ka theksuar se kanë qar me kërkim falje, zakonisht ndodh këto raste për me kërkim falje, unë e kam cek edhe më herët se E çka më ka thënë “është shtet dhe do t’i ndjeku pernalisht, ku i njëjti është pyetur nese ma thua këtë përgjigje i bie që nuk janë falë, i njëjti ka deklaruar se Po. Lidhur me rastin e “S.Casinos ka potencuar se informatën e parë lidhur me këtë rast e ka marrë nga mediat ndërsa nuk e din periudhën kohore sipas të kuptuarit nga mediat se kur është takuar me Tdhe A.

Procedimi i provave materiale

Gjykata kishte vazhduar shqyrtimin gjyqësor më datën 29.09.2023 ku është vazhduar me leximin-administrimin e provave materiale, e po ashtu në seancën e datës 08.11.2023 është bërë plotësimi i procedurës së provave materiale të propozuara nga mbrojtësja e të akuzuarit E.S, avokates K.K

Gjykata në këtë seancë ka vazhduar me administrimin e provave materiale, ku si prova materiale ka administruar:

1. Aktakuzën kundër A.B, F.A dhe A.E PP.602/2007, e datës 21.02.2008,
2. Procesverbalet e Gjykimit të A.B dhe administrimin e provave,
3. Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kundër A.B, F.A dhe A.E të datës 28.04.2010,
4. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme AP.nr.336/2020 kundër A.B, F.A dhe A.E të datës 28.04.2011,
5. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i plotfuqishëm kundër A.B, F.A dhe A.E të datës 09.02.2012,
6. Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i përpiluar nga Drejtorati i Teknikës Kriminalistike i datës 30.08.2007, vendi ku është vrarë T.R: me përshkrimin e pozitës së gëzhgojave, veturës së viktimës, etj.

7. PK Drejtorati i Teknikës Kriminalistike, foto-album i vendit të ngjarjes dhe raporti me përshkrimin e vendit të ngjarjes i datës 30.08.2007, vendi ku është vrarë T.R,
8. Skicat e vendit të ngjarjes të përpiluara nga Njësia Regjionale e Teknikës Kriminalistike,
9. Fotografi të A.B duke u larguar nga vendi i ngjarjes më datën 30.08.2017, pas vrasjes së T.
10. Procesverbali i bastisjes i datës 30.08.2007, në shtëpinë e F.S
11. Procesverbali i bastisjes i datës 30.08.2007, në shtëpinë e E.S dhe H.S në rrugën “ G. LI” 2 Prishtinë
12. Procesverbali i bastisjes, i datës 30.08.2007, në shtëpinë e O.B , në rrugën “V.F” nr.// Prishtinë.
13. Raporti i bastisjes i datës 31.08.2007, në “Kafe Bar S”, në Bulevardin “B.K”, ku janë sekuestruar disa sende si :37 CD, telefona, 1 vulë, jelek antiplumb me ngjyrë të bardhë, radiolidhje, etj.
14. Procesverbali i bastisjes i datës 31.08.2007, në shtëpinë e A.B , ku janë sekuestruar sendet si : kese me foto, telefon “Nokia”, kaset 8 mm dhe 9 kaseta 6 mm,
15. Procesverbali i bastisje i datës 21.09.2007, të veturës së E.S, në Bulevardin ”B.K”, afër lokalit “S” në prezencë të H.S, ku janë sekuestruar disa CD, kartela telefonit, letra me shënime, etj.
16. Procesverbal i bastisjes i datës 28.09.2007, në vendbanimin e familjes A, në rrugën “V.F” nr.285, ku janë sekuestruar disa filma të aparatit fotografik, kartelë të telefonit, telefon “nokio”, foto të ndryshme, etj.
17. Procesverbal i bastisjes i datës 28.09.2007, në vendbanimin e familjes A, në rrugën “V/ F.” nr.286, ku janë sekuestruar disa dëftesa për blerje të sim kartelave, i l fopi disk, telefon mobil, motorolla, etj.
18. Dokumente lidhur me kontrollin e të burgosurit N.S në qendrën e paraburgimit në P. ku i është sekuestruar një sim kratel- //////,
19. Raporti i policit M.M, Id81818 i datës 31.08.2007, lidhur me veprimet e ndërmarra pas vrasjes së T.R.
20. Raporti policor I. D ID1552, i datës 13.08.2007, lidhur me masat e hetimeve që kanë ndërmarrë me datën 30.07.2007.
21. Raporti i ngjashëm i policit Sh.M – 7361, i datës 31.08.2007.
22. Raporti i oficerëve të policisë A.D dhe A.I i datës 30.08.2007.
23. Raporti i mjekësisë ligjore mbi autopsinë e trupit të T.R, përfshirë raportin e toksikologjisë dhe fotografitë.
24. Raporti i ekzaminimit të veturës “Landrover //-Ks-//”, e cila ka qenë në parkingun e “Flamurtari” në dardani në kohën e kryerjes së vrasjes dhe fotoalbumi lidhur me dëmtimet e shkaktuara nga gjuajtja me armë zjarri,
25. Raporti i ngjashëm i ekzaminimit të veturës “Opel ascona 137 //” dhe fotoalbumi,
26. Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve nga dëshmitarja E.Z 2 telefona, dhe dy sim kartela,
27. Raporti i policit B.G në lidhje me rrethimin e vendit të ngjarjes, veturat e dyshimta, fishekët e gjetur, kërkimin e kryerësit dhe bastisjen e “Cafe Bar S”, gjërat e sekuestruara, të dyshimtë e arrestuar dhe bastisja e shtëpisë së A.B
28. Raporti i policit E.T, lidhur me vendin e ngjarës dhe bastisjen e shtëpisë së E.S
29. Raporti i policit N.B, lidhur me vendin e ngjarjes dhe bastisjen e shtëpisë së S.
30. Raporti i policit Z.K lidhur me vendin e ngjarjes dhe bastisjen e shtëpisë së E.S
31. Raporti i policit M.K lidhur me gjeten e dy veturave “Opel dhe “ëv” golf 3”, të cilat i ka përdorur grupi i të akuzuarit si dhe përshkrimi i fjalëve të dëshmitarit.
32. Bastisja e veturës “Jeep” me nr.të targave //// te lokali “Cafe Bar S”, në prezencë të H.S

33. Raporti i bastisjes së veturës “Jeep”, me nr.targ, tek lokali “Cafe Bar S”, nga teknika kriminalistike dhe fotoalbumi,
34. Raporti nga Drejtoria e Teknikës Kriminalistike mbi ekzaminim e veturës “Opel, cikup i kuq, me targa ///, lista e dëshmime të gjetura dhe fotoalbumi,
35. Raporti i policisë për konfiskim të veturës opel, pikcup i kuq me targa...
36. Raporti i teknikës kriminalistike mbi ekzaminin e veturës golf 3 me targa...
37. fotoalbumi,
38. Drejtoria e teknikës kriminalistike – lista e dëshmime të gjetura në vendin e ngjarjes (gëzhoja, njolla, mostra të ADN, vija papilare...),
39. Raporti i laboratorit qëndror të kriminalistikës, lidhur me ekzaminin e gëzhojave dhe armës Glock-19, dhe vërtetim mbi konfiskimin e armës nga A.B,
40. Raporti i policit hetues M.K – përmbledhje e masave hetimore,
41. Raporti i hetuesit B.O, lidhur me komunikimet mes grupit të dënuarve me mesazhet telefonike nga data 01.08.2007, deri më datën 11.10.2007, duke përfshirë edhe ditën e vrasjes,
42. Raporti i shkurtë i hetuesit B.O lidhur me intervistimin e dëshmitarës B.M
43. Raporte policore rreth vendit të krimit.
 - Raport i shkurtër nga policia regjionale Prishtinë në vendin e ngjarjes 2007 AD02397,
 - Raporti informues hetimor, nga polici B.B, i datës 30.08.2007,
 - Raporti informues hetimor, nga polici H.j, i datës 30.08.2007,
 - Raporti informues hetimor, nga polici O.G, i datës 30.08.2007,
 - Raporti informues hetimor, nga polici N.R – lidhur me masat e ndërmarra në vend të ngjarjes të datës 30.08.2007 i datës 30.08.2007,
44. Raporti i policit L.K, lidhur me bastisjes e lokalit (opium) dhe shtëpisë së A.B dhe arrestimin e N.S dhe Sh.G,
45. Raport i policit për konfiskimin e veturës pickup me tabela ///,
46. Raport i UNMIK, për ekzaminimin e pajisjeve elektronike të konfiskuara në S” Bar,
47. Provat nga Drejtoria e Forenzikës Kriminalistike me fotoalbum të internet caffè opjum, (128),
48. Raporti Hetues M.K në lidhje me kontrollin e veturës “opel kombo”, me targa //-KS-//,
49. Raporti shtesë i hetuesit M.K për veprimet hetimore pas dorëzimit të Kallëzimit Penal, si :rastet e mëhershme, deklaratat e dëshmitarëve, sms, të rëndësishëm etj,
50. Raporti i oficerit D.N.
51. Raporti hetues B.O.
52. Raport i policisë – plani operativ “Kthetrat e Ariut” i datës 27.09.2007 (plan për kontroll dhe arrestim të dyshuarve) ,
53. Raport shtesë i hetuesit M.K i datës 03.10.2007, për veprimet hetimore të ndërmarra,
54. Mendimi i ekspertit të arkitekturës lidhur me shtëpinë e të dënuarit A.B
55. Raport i verifikimit të gjendjes materiale të familjes së A.B, i datës 21.01.2015, ref.
56. Ekstrakti nga “Ëëstrn union”,
57. Raporti mbi hartografinë e numrave- antenat ref.2008-AB-3046, i datës 15.04.2015,
58. Shënim zyrtar nga policët B.O dhe B.G.
59. Raporti analitik i policisë në lidhje me dëshmitë e mbledhura në rast, analizimi i provave dhe lidhshmërinë mes tyre,
60. Raporti i analizimit të deklaratave të të dyshuarve, i përpiluar nga hetuesi F.H,
61. Shënim zyrtar i gjykatës themelore në Prishtinë i datës 03.03.2014, me të dhënat për 4 raste penale të hapura kundër të pandehurit E.S, Rr.A
62. Të dhënat personale të E.S dhe e kaluara kriminale – gjithsej 22 raste të siguruar nga policia :

- Rasti i Policisë nr.2006Cf-2009, Caffë D'' ne F'' – posedim ilegal i armës, kanosje dhe pengim i drejtësisë me datën 22.05.2006,
- Rasti i Policisë nr.2004-AB-2931-Gjuajtje me armë, vrasje(një person ka vdekur), posedim ilegal i armëve,
- Rasti i Policisë nr.2007-AD-2397 –Vrasje e T.R,
- Rasti i Policisë nr.2005-AB-3670- Sulm,
- Rasti i Policisë nr.2007-AB-2728-Pengesë e rendit publik,
- Rasti i policisë nr.2005-AD-1416- sulm i rëndë, ngacmim/kanosje,
- Rasti i policisë nr.2007-1706-N/A, Aksident trafiku,
- Rasti i policisë nr.2003-TA3-94 – pengimi rendit publik,
- Rasti i policisë nr.2005-AT-557- zbrazje e armës,
- Rasti i policisë, nr2003-AH-_1783- zvarritje e qëllimshme,
- Rasti i policisë, nr.2005-AD-1281 – sulm,
- Rasti i policisë, nr.2006-Ab-3570-ngacmim-kanosje,
- Rasti i policisë nr.2003-TA1-130- sulm,
- Rasti i policisë nr.2001-PA-4754- Tentim vrasje,
- Rasti i policisë nr.2006-AB-1458- Ngacmim-kanosje,
- Rasti i policisë nr.2005-AB-4528- I është gjetur eksploziv/UXO,
- Rasti i policisë- nr.2005-AD-2949- Sulm, shpërthim me granatë/ minë,
- Rasti i policisë- nr.2005-AB-5133-Tentim vrasje,
- Rasti i policisë- nr.2006-CF-1007- Ngacmim/kanosje,
- Rasti i policisë- nr.2006-CF-1009- Pengim i drejtësisë, ngacmim kanosje, posedim ilegal i armëve,
- Rasti i policisë- nr.2001-PA-3- Ngacmim/kanosje, sulm,
- Rasti i policisë nr.2005-AB-4189- i është gjetur municion.

63. Të dhënat personale dhe e kaluara kriminale e siguruar nga Policia, për të pandehurin I.A.

- Rasti i policisë nr.2007-AB-1353,
- Rasti i policisë nr.2005-Ad-1416,
- Rasti i policisë nr.2006-AB-1894,

63. Të dhënat personale dhe e kaluara kriminale e siguruar nga policia për të pandehurin Rr.A

- Rasti i policisë nr.2007-AB-1353,
- Rasti i policisë nr.2005-AD-1416,
- Rasti i policisë, nr.2007-AD-195,
- Rasti i policisë, nr.2007AD-194,
- Rasti i policisë, nr.2004-AB-2931.

64. Raporti mbi ekzaminimin e dëshmimeve, nr.ITF-2013-048, i datës 11.11.2013.

65. Raporti i policës, nr.OCIU/2012/28 i datës 21.02.2014.

66. Përgjigje nga IPKO. i datës 07.11.2013, lidhur me abonent e disa numrave të telefonit,

67. Raporti policor nr.06/1-01-SA-023/2014, i datës 25.03.2014.

-lidhur me 6 raste të kryera nga i akuzuari dhe grupi i tij ku viktimë ka qenë T.R nga viti 2003 deri më 2006, të kanosjeve, sulmi fizik, vrasje në tentative(sëiss casino),

- I është djegur vetura, i janë shpuar gomat me thikë, është përcjell me motoçikleta
- I akuzuari i'a ka bllokuar rrugën dhe ka tentuar ta godas me veturë
- Rasti nr.2003-Ta1-618(T.R) – kërcënim,
- Rasti nr.2004-AD-1827(T.R) – sulm,
- Rasti nr.2005-AD-3264 (T.R) – zjarr vënie e qëllimshme,
- Rasti nr.2005-ADF-5113(T.R)- tentim vrasje,

- Rasti nr.2006 –AB-1457 (T.R) – kërcënim.
- Lidhur me disa raste ku A.I ka qenë e kanosur nga grupi i të akuzuarit
- Rasti Nr.2005-AC-935(A.I) – zjarrëvënien e qëllimshme,-
- rasti Nr.03246/2005-AD-447(A.I) -kërcënim,
 - rasti nr. 2005-AD-1281, (A.I) – kërcënim
 - rasti nr.2005-Ad-1416 (A.I). Sulm ndaj personit zyrtar(bashkuar me rastin Nr.2005-Ad-1281),
 - rasti nr.2005-TA3-0937 (A.I)- ngacmim/kërcënim.-
- 68.** Raporti i Policisë së Kosovës, ref.06/1-01-SA-025/2014, i datës 02.04.2014
- 69.** Informata nga PTK, ref.PTK/831/07, i datës 19.11.2007.
- 70.** Informata nga PTK, ref.PTK/887/07, i datës 03.12.2007, lidhur me abonent,
- 71.** Raport i regjistrimit të thirrjeve telefonike dhe mesazhet, pa datë,
- 72.** Njoftim nga ARBK, i datës 27.03.2014, lidhur me DPH ”S. Bar”,
- 73.** Raporti i policisë së Kosovës, ref.06/1-01, SA-028/2014, i datës 17.04.2014.
- 74.** Cd.ex#1.1:
- 75.** Fotografi të nxjerra nga dëshmitë Ex1.1, dhe Ex.1.7, dhe Ex1.9:
- 76.**Raporti shtesë i sektorit të fotografisë kriminalistike dhe fotolaboratorit i datës 30.08.2007,
- 77.** Raporti nga drejtoria e teknikës kriminalistike mbi analizimin e CD, videokasetave dhe filmimet e kamerave.
- 78.** njoftim nga ARBK, i datës 02.04.2014, sipas të cilit pronar i biznesit “B” SHPK;.
- 79.** Rezultati I zbatimit të masave të fshehta - regjistrimet e thirrjeve telefonike dhe Sms.
- 80.** Të gjitha shkresat e rastit “S.Casino”
- Akvendim për fillim të hetimeve PP.nr.850-4/2005, I datën28.12.2005, kundër: A.B, E.S, S.S, Rr.A, A.C, A.S, K.K, F.M dhe V.H (rasti S. Casino),
- Aktakuza në rastin “Sëiss Casino# dhe vendimin mbi konfirmimin e aktakuzës,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit J.S i datës 25.12.2005,
- Procesverbale mbi intervistimin e të pandehurit E.S të datave 26.12.2005 dhe 16.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B.S, i datës 11.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B.T, i datës 11.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitares B.C, i datës 11.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit V.R, i datës 31.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B.Z, i datës 27.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit A.S, i datës 31.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit P.S, i datës 31.01.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit A.S, i datës 01.02.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit A.B, i datës 07.02.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B. M, i datës18.01.2006, dhe datës 13.02.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e të pandehurit N.S, i datës 13.02.2006,
- Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit T.R, i datës 26.12.2005, dhe 11.02.2016,
- Raporti i oficerit policor T.R, i datës 25.12.2005,
- Raporti i oficerit policor F.Z, i datës 25.12.2005,
- Raporti i policit – Njësia Regjionale e Krimeve- Prishtinë, i datës 25.12.2005,
- Raporti i policit mbi shikimin e vendit të ngjarjes i datës 25.12.2005,
- Kallëzimi penal i policisë i datës 27.12.2005 dhe kallëzimi penal shtesë, i datës 06.02.2006,
- Fletëlëshimi nga QKUK, për A.S, i datës 28.12.2005,
- Mendimi i ekspertit ass.Dr.A.G, për dëmtimet trupore të: T.R, E.S, V.R, A.B dhe A.S i datës 10.05.2006,
- Shënimi për ekspertizë kimikale-nga Zagrebi i datës 04.12.2006,

Raporti i datës 12.11.2007, dhe raporti i ekspertizës nga Drejtoria e Laboratorit të Policisë Kriminale -në Ankara.

Njoftim i gjykatës nga prokuroria në lidhje me mostrat e dërguara në Ankara për ekzaminim i datës 09.02.2009,

Shënim zyrtar i prokurorit në lidhje me rastin “.Casino”, i datës 14.02.2007.

81. Shkresat e rastit “Ferizaj”,

Aktakuza kundër E.S, Xh.D dhe B.M, PP.nr.333-04/2006, i datës 05.06.2006,

Aktakuza kundër A.B, PP.nr.333-04/2006, i datës 15.06.2006,

Aktvendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër E.S, Xh.D dhe B.M(në gjuhën angleze),

Aktgjykim i gjykatës së qarkut i datës 27.10.2006, kundër E.S, Xh.D, B.M dhe A.B,

Aktgjykimi I Gjykatës Supreme i datës 27.12.2007.

82. Njoftimi i Avokatit R.K dorëzuar në gjykatë më datën 26.01.2015

83. Sqarimi i PTK-së i datës 20.09.2007

84. Prova materiale me shkrim, lëshuar nga ing.Q.Q i punësuar në PTK, personi përgjegjës menaxher i lartë për komunikime ,”TR. Disciplinary cases”, dhe

85.Dosja me nr.467/09.

Meqë palët nuk kishin propozime tjera për plotësimin e provave materiale, gjykata tutje kishte proceduar me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor, me deklarinimin e të akuzuarit E.S

Deklarimi i të akuzuarit

Në pyetjet e avokates K.K, E.S ka deklaruar: se qëndron pranë çdo deklaratë që e ka dhënë dhe që e ka nënshkruar dhe nuk ka asgjë për të ndryshuar dhe shtuar për atë çka ka thënë dhe e ka nënshkruar. Avokatja mbrojtëse duke pasur parasysh se i mbrojturi i saj ka dhënë shumë deklarata e që edhe sot deklarohet që qëndron pranë këtyre, mbrojtja nuk ka pyetje për të akuzuarin sepse për këto pothuajse 14 vite asgjë e re nuk është paraqitur dhe as nuk ka rezultuar ndonjë provë apo deklarinim që gjerë më tani nuk është administruar.

Prokurori special: ka deklaruar se pasi që kjo çështje disa herë është kthyer në rigjykim, i akuzuari çdo herë kur është deklaruar në bazë të procesverbaleve ka mohuar veprën penale, kryerjen e veprës penale, nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e re, prandaj mohimi dhe besimi i trupit gjykues në deklaratat e mëparshme të të akuzuarit, do të elaborohet në kuadër të fjalës përfundimtare, e në këtë kuptim nuk ka pyetje për të akuzuarin.

Në pyetjet e trupit gjykues i njëjti ka deklaruar: fillimisht i njëjti është pyetur lidhur me raportet-afërsinë me të dënuarin A.B, ku i akuzuari ka deklaruar se unë e kam cekur edhe më herët A.B nuk e kam njohur thuajse fare, ai ka qenë një gjeneratë shumë më e re se ai dhe që atë nuk e ka lidhur me të kurrfarë pune apo biznesi, apo pazare apo lidhje familjare, ka shtuar se mund ta vërtetoni dhe e ka vërtetuar edhe policia edhe kundër vullnetit që kanë pasur të falsifikojnë dhe të montojnë lloj lloj prove përshembull dëshmitarin D2. Ka shtuar se me A.B nuk është shoqëruar kurrë, me A janë shoqëruar dajti e tij, kusherinjtë e dajve, si Rr.A (R) si dhe I.A (L), pra A.B ka ndejtur edhe me D.S-djalin e axhës së tij i cili e ka pasur shtëpinë ngjitur me shtëpinë e tij, poashtu me A. e kanë një foto, ku shihet dhe për të cilën kanë dhënë sqarim, të detajuar. Në atë rast e kanë thirr dy vëllezërit D-me mbiemër, K, ka qenë njëri prej tyre, ndërsa vëllai i tij M, në atë rast shihet ku janë pesë ose gjashtë persona, aq persona sa ata janë edhe karriget pa mua, ata e kanë bërë një foto pak minuta më herët, ku nuk shihet asnjë karrige e zbrazët, çka nënkupton se nuk ka pasur person tjetër në atë tavolinë përveç tyre, ku kanë qenë duke konsumuar alkool, e që shihet në foton e rradhës ku i njëjti është në mes të dy vëllezërve D., dhe ku shihet se është ulur në karrigen e M, ku e kishte ai jaknen e tij.

Tutje i njëjti pasi ka potencuar faktin se ska pasur asnjë lloj raporti me A.B, është ballafaquar me një deklaratë të tij të datës 09.03.2016 ku përgjatë pyetjes së prokurorit të shtetit ka deklaruar

si vijon: “si do ta merrja A.B...”, e që pyetja që i është parashtruar ka qenë se ku ka pasur njohuri i akuzuari se A.B nuk ka pasur leje duke marrë parasysh faktin se i njëjti ka mohuar të ketë pasur ndonjë lidhje me të, i njëjti ka dekalruar se duke marrë parasysh që i njëjti prej vitit 2007 ka pasur, jo akuzë zyrtare të prokurorisë por nga gazetatat të cilat kanë shkruar më shumë se 500 herë, emisionet televizive, i njëjti është interesuar për fatin e tij dhe është pregaditur sa ka mundur për t’i demantuar montimet, falsifikimet. Ka theksuar se i ka pyetur dajtë se është përfolur A., se a ka leje se i njëjti është përfolur si punëtor i “ B Kafe” pronë e cila ëshët e E dhe e vëllaut të tij si biznes familjar të cilën e posedojnë edhe sot e që në këtë firmë nuk mundet të punojë askush për asnjë ditë të vetme nëse se posedon patentshoferin dhe nëse nuk e njeh zanatin për të cilën duhet kryer një kurs, për t’i riparuar aparatet e kafesë dhe mullinjtë të cilët nuk janë të lehtë për t’i rregulluar. Po ashtu i njëjti është pyetur lidhur me atë se a ka pasur probleme me T.R ku i njëjti ka deklaruar se, problem me të ndjerin T.R në të cilin problem ka marrë pjesë ai, është problemi i S.Casinos, i cili rast ka ndodh kah fundi i vitit 2005 ku atë problem e ka filluar A.S-kolegu i tij. I njëjti ka shtuar se e keni dëgjuar dhe e keni parë ju në këtë seancë të gjyqimit që z.Sh.R, kur a thënë “djali im ka hy me i ndihmu A.R, se djali im nuk ka pasur punë me E.S, dhe se tregoj se “i ka mbetur hatri në A.S pse nuk po vjen me dëshmu në këtë rast”, po ashtu lidhur me këtë rast ka shtuar se edhe para trupit gjykues tjetër dhe prokurorit ka pranuar se i ndjeri T.R, në atë rast e ka shpëtuar nga më e keqja nga plumbat dhe se i njëjti asnjëherë nuk ka pasur problem me T.R mirëpo në problemin e ndodhur në “S.C” të cilën e ka filluar A.S ndërsa T. ka qenë vetëm pjesëmarrës dhe se atë nuk e ka parë nëse ka gjuajtur me armë apo jo, është kohë e gjatë dhe nuk i kujtohet.

Lidhur me deklarinimin e tij në kuadër të shqyrtimit gjyqësor kur është pyetur lidhur me incidentin që kishte ndodhur në “S Casino” është pyetur lidhur me atë “se a keni pasur ju personalisht konflikt me tani të ndjerin T.R” ndërsa përgjigja e juaj ishte “se nuk keni pasur asnjë konflikt me tani të ndjerin”, madje duke specifikuar se ka qenë pikërisht i ndjeri T. që i’u ka shpëtuar jetën atë ditë në “S.Cazino”, e tutje në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë me dëgjimin e dëshmitarit Gj.K, ku i njëjti para trupit gjykues ka theksuar se “ishte ardhur në shtëpinë e juaj për t’ju pajtuar juve me T dhe A dhe sipas tij në këtë takim, ju i kishit thënë se natën në S.Cazino, ka qenë T dhe A që ju kanë rrahur deri në vdekje dhe nuk e dini as vet se si keni shpëtuar”, e që i akuzuari është pyetur se a mund t’i tregoni trupit gjykues cila është e vërteta ajo që ka deklaruar në shqyrtim gjyqësorë apo atë se çfarë ka thënë dëshmitari Gj.K, i akuzuari ka deklaruar se unë kam thënë ashtu duke menduar se nuk kam pasur kurrfarë problemi para rastit S.Casino, ku këtu pyetjen e anëtarit të trupit gjykues, e kam shtuar edhe një rast, kur më pyeti se ”a pate apo nuk pate problem” dhe unë thashë se “pata problem dhe atë të madh dhe serioz, se kur kërcasin armët diku përafërsisht 20 deri 30 plumba, kemi të bëjmë me problem serioz”, dhe kam qenë i rrahur dhe kam qenë pa vetdije. Ajo që është thënë aty që me ka shpëtuar T mua, nuk mund të mohohet dhe as unë nuk e mohoj kurrë. Me e nisur atë telashe, atë bela e ka nisur A.S, këtë e ka konfirmuar edhe Sh.R, para jush, ku thotë se: ”djali im ka ndërhyrë me e ndihmu A.S”. Mua A.S më ka ra me revole në kokë, në pjesën e prapme të kokës, në të cilin rast unë e kam humbur vetdijen, dhe çka ka ndodhur më pastaj unë nuk e di, vetëm se kur e kam parë veten në spital, dhe unë kam thënë se T ma ka shpëtuar jetën prej plumbave më ka ngrehë mbrapa shankut. Përgjatë deklarinimit të tij është pyetur se a i ka thënë Gj.K se e ka rrahur T deri në alivansoje në S.Cazino, i njëjti ka deklaruar se jo nuk e ka thënë kurr atë, as atij as askujt.

I njëjti është pyetur edhe lidhur me deklarinimet e dëshmitarës A.I , ku përgjatë deklarinimit të saj e njëjta ka rrëfyer se T.R ka qenë i kërcënuar i përcjellur nga i ashtuquajturi “Grupi S, si dhe ka përmendur edhe rastin e “S Casinos” si problem mes juve dhe T e madje ka qenë prezente që sipas saj është përcjellur dhe kërcënuar T.R nga “Grupi S” madje janë qitur edhe bllokada në rrugë për të aksidentuar veturën dhe përcjellur nga persona të armatosur. I akuzuari ka deklaruar se bllokata në katund i cili është fshati i tij në Komunën e K, ku ne të gjithë përfshirë edhe atë kanë disa vite edhe nuk janë të rinjë dhe vijnë nga vende rurale, ku zotri Sh këtu ka dëshmuar se

në atë fshat e kanë pasur një vikendicë dhe pesë ari truall, dhe të gjithë këto ka shtuar se i deklaroi me kushtin nëse ka ndodhur ajo bllokadë ndonjëherë për të cilën i njëjti nuk e beson, dhe se nuk ka ndonjë shënim zyrtar askund, nuk është punë e vogël kjo me arë me ta bo një barrikadë tek dera e shtëpisë, duke marrë parasysh se T ka qenë person zyrtar-polic dhe e ka ditë se si shkojnë procedurat, punë të ligjit dhe lidhur me këtë rast nuk ka ndonjë shënim zyrtar sepse nuk ka ndodhur kurr, ka shtuar se e thotë me kushtin nëse ka ndodhur për një arsye të vetme, ajo ka mundur me ndodhë shkak të fermës së dhive, të cilën Z.Sh ka thënë se e kanë pasur në atë fshat, disa dhejtra dhi, të cilat janë kafshë shtëpiake më të dëmshme dhe ka mundur ndonjë bashkëfshatar me ja blloku rrugën, pasi që i kanë bërë dëm në tokën e tij, e që i njëjti ka shtuar poashtu që kurr një herë të vetme në jetën e tij nuk ka qenë në Komunën e K. sepse nuk e lidh asnjë send me atë pjesë, as nuk kanë të afërm, as shok e as nuk njih njëri të vetëm atje, dhe i vetmi send që ka pasur me atë komunë ka qenë Kushtetuta e Kaqnikut, ndërsa sa i përket deklaratës së dëshmitarës A.I ka shtuar se nuk qëndron lidhur me këtë çështje, ndërsa sa i përket rasti të S.Casinos A.I nuk ka qenë fare aty, tutje lidhur me përcjelljet e të ndjerit T.R një përcjellje e tillë ka deklaruar se nuk ka ndodhur nga askush, as nga familjarët apo shokt e tij sepse T nuk ka qenë një person i cili ka mundur të përcillet sepse i njëjti ka qenë ekspert i sigurisë dhe ka qenë shumë agresivë çka e vërtetojnë disa dëshmitarë dhe disa lëndë në gjykatë ku edhe është shpallur fajtor.

Tutje nga anëtarja e trupit gjykues është pyetur se a ka kërkuar A.B punë tek E.S, i njëjti ka deklaruar se nuk është marrë me punën e punëtorëve hiq, është marrë N. vëllau i tij, i njëjti ka paguar rrogat, mirëpo punëtorët i ka njohur të gjithë, të cilët i njih edhe sot, kurse A.B nuk ka punuar asnjë ditë të vetme dhe asnjë orë të vetme në firmën B.Kafe, sepse në firmën e kafes nuk mundesh të fitosh nëse nuk e njih atë profesion, A.B ska kërkuar dhe nuk ka punuar asnjëherë te na dhe lidhur me atë se a ka qenë i gatshëm të punoj tek ai i njëjti ka deklaruar se nuk ka fol asnjëherë lidhur me këtë gjë. Po ashtu i njëjti është pyetur lidhur me atë se si ka ardhë deri tek diskutimi se a i përmbush kriteret i njëjti ose jo përderisa i njëjti ka deklaruar se nuk ka kërkuar punë tek ai, i njëjti ka deklaruar se më herët e shpjegova hollësisht se është interesuar për këtë çështje marrë parasysh nga rastet e montuara se ai ka qenë punëtor i B.Kafe sepse policisë nuk i ka mjaftuar edhe pse e ka ditur, nuk ka dashur me u marrë me realitetin me punëtorët e B.Kafes të gjithë kanë qenë të regjistruar dhe siguruar me dokumente zyrtare të firmës. E kreu në fund i akuzuari është pyetur sërish lidhur me atë se a mundet me sqaruar fotografinë ku shihet A.B me personat e tjerë, lidhur me atë se cila ka qenë dëshira, motivi, kërkesë për ta bërë një fotografi me të njëjtin pasi që nuk njihen mes vete, i akuzuari ka deklaruar se A.B ka ndejt me daj të tij, dhe ka theksuar se këta kanë qenë të rinjë dhe nuk i ka lidh asgjë me të njëjtin, nuk kanë pasur as buxhet, as financa asfarë vetura, as prona apo banesë dhe nuk ka kurrfarë biznesi me ta dhe sikurse të ishte shoqëruar me A.B do të figuronte numri i telefonit tek ai ose anasjelltas, lidhur me fotografinë ka shtuar se ka qenë i ulur tek vitrina kah rruga kryesore në lokal, zakonisht dhe 99 % sa herë që kam qëndruar në lokal, jam ulur në atë tavolinë, në ato momente ka ardhur M.D, nipi i Xh.D, të cilin e njoh shumë më mirë, i cili është dy gjenerata para meje, dhe me ka thënë “a bënë me bë një foto”, unë i kam thënë “bon”, unë kam menduar se po don me bo foton aty ku isha unë ulur, ai me tha “jo, po kam qef që këtë foto me bo në tavolinën e tyre” e cila ishte në cepin tjetër të lokalit dhe për afërsisht distanca prej vendit ku isha ulur e deri tek tavolina ku kërkohej të bëhej fotografia, ishte diku 10-12 metra, sepse lokali diku i ka rreth 20 metra. Kam shkuar dhe jam ulur në karrigen e tij ku me tha ai, dhe e ka marrë një karrige tjetër shtesë në një tavolinë aty pari, është ulur në të dhe e ka shkrepë atë foto, në të cilën foto nuk më kujtohet saktësisht, pasi që ka kaluar një periudhë e gjatë kohore, janë dy vëllezërit D., një kojshi i tyre me mbiemrin T., të cilin unë nuk e kam njohur atëherë, mirëpo familjarët e tij të gjerë i njohë si familje, dhe e di banimin dhe shtëpinë e tyre aty ku janë, janë kanë edhe dy dajtë e mijë, Rr.dhe I., për njërin prej tyre jam i sigurtë, dhe ka qenë A.B, tjetër kush sa e di unë nuk u konë, por fati im, ata e kishin pas bërë një foto më herët të njëjtën ditë, mirëpo unë lidhur me këtë foto nuk

kam ditur asgjë. M/ siç e ceka më herët më është ofruar në tavolinë dhe me mirësjellje ka kërkuar nga unë që të bëjë një foto me të, ndërsa sa i përket njohjes me A.B ka shtuar se pas pak ditësh para se me ndodh rasti për të cilën akuzohet, pak javë më herët ose edhe dy tre muaj maksimum, A.ka nis me ardh në lokal in e tij “Bar S” me dajt e tij, ku ai zakonisht ka ndejt me Rr., herë pas here. I akuzuari përgjatë deklaramit të tij është pyetur pas ndodhjes së incidentit në S.Cazino lidhur me vizitën e dëshmitarit të tyre Gj.K, ku i akuzuari ka deklaruar se siç e ka shpjeguar edhe vetë dëshmitari Gj.K, ka ardhur i deleguar, e ka qu A.S dhe T/, atëherë kur ka ardhur i njëjti i ka thënë se ka lidhje familjare me A.S dhe po don me mshel me bo mirë këtë punë, ku i njëjti ka deklaruar se tekstualisht i ka thënë “skam punë as me njërin as me tjetrin dhe me asnjë tjetër, se këta kanë qenë shtatë-tetë deri në dhjetë veta, aty kanë ardhur të përgaditur se dikush i ka lajmëruar që ata janë aty. I njëjti ka shtuar se unë kur i kam thënë se nuk kam punë me asnjërin dhe as me tjerët dhe se këtë punë i’a lënë drejtësisë, ajo punë u krye në atë moment dhe kushdoqoftë në çfarëdo rasti, se ti kish thënë të njëjtit dhe anasjelltas se “i lë drejtësisë” dhe “nuk kam punë më ty” ka shtu se e lë të përfunduar atë punë për njëqind vjet. I njëjti është pyetur edhe lidhur me atë se ka deklaruar se T.R i ka shpëtuar jetën, por cila ka qenë arsyeja që i ndjeri ka dërguar tek ju Gj.K, i akuzuari ka deklaruar se ai ka thënë se “më qoj A.S, të cilin e ka mik shtëpie dhe njihen shumë mirë në mes vete, dhe jam ardh me u pajtu dhe për këtë punë po ju kërkon falje”, tutje është pyetur dhe tani deklarata e juaj se po thoni se “ka ardhur me kërku falje” përputhet pjesërisht edhe me dëshminë e dëshmitarit, a keni fal ju?, I njëjti ka deklaruar se puna e faljes është në shumë mënyra, mundesh me e fal, dhe me shku me marrë ngrykë, mundesh me falë dhe mos me u pa me të hiq dhe për mua është mshelur ai kapitull në momentin që i kam thënë se “këtë punë i’a la drejtësisë”.

Në atë moment që nuk ke punë me kërkend kjo i bjen që i’a ke falur dhe kjo është punë e mshelur, nëse nuk i’a fali unë i them “ruju, më ke borxh, nuk ke besë, veç mos mujsha se kom me ta kthye, e plotë të tjera” unë asnjërin prej këtyre nuk i kam thënë kurrë as Gj.K as njerit të gjallë.

Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues lidhur me organizmin e ahengut familjar është pyetur se a i kujtohet se para sa kohe para se me ndodh ngjarja ka qenë ky aheng, i njëjti ka deklaruar se nuk ka qenë kurrfarë ahengu, aty ka qenë M.T, anëtar i familjes, ku ata kanë ardhur tek lokali ka ardh edhe D. kanë ardh dhe disa pesona të tjerë që emrat smë kujtohen, ku pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe i ka thënë “hajde po shkojmë te D., se kena me pjek një qingj dhe i kanë thirrë disa këngëtar, sharkia”, dhe i njëjti ka shtuar se 2-3 ditë më herët ka qenë te D., shtëpia e të cilit është larg nga shtëpia e tij dhe duke marrë parasysh se D. ka jetuar me 4 vëllezër dhe vëllezërit e tij kishin secili nga 3-4 fëmijë, ka vendosur që kjo mbledhi të bëhet në shtëpinë e tij, e që kjo mbledhi para se me ndodh ngjarja nuk mund ta thot me saktësi por mund të jetë 6 muaj deri 1 vit, ndoshta edhe veq për dy muaj, po më saktë ka shtuar se mund ta dinte kur ta shihte videon, ndërsa ka shtuar se nuk ka thënë asnjëherë se A.B, nuk e ka njohur gjashtë muaj apo një vit apo edhe 10 vite, Rr.A dhe D.S, vetëm se ka thënë që A.B ka filluar ta frekuentoj lokal in e tij për afërsisht 2 muaj para se me ndodh vrasja, disa herë herë pas here. Ndërsa ditën kur ka ndodh vrasja ka qenë në lokal in “Bar S” ku zakonisht ka shkuar në lokal në ora 10:00, 11:00 dhe 12:00 sepse lokali para orës 09:00 nuk është qelur kurrë, e që atë ditë ka qëndruar me Y nga Mazgiti së bashku në një tavolinë, e që krejt çka i kujtohet është se ka qëndruar atë ditë vetëm me Y dhe gjatë gjith kohës nuk është afruar askush në tavolinë, por më sakt ka shtuar se është deklarata të cilën e ka dhënë atëherë. I akuzuari është pyetur edhe lidhur me atë se a ka pasur ndonjë arsye që ta nxitë A.B me e kry vrasjen ndaj të ndjerit T.R, i njëjti ka shtuar se nuk ka pasur asnjë arsye, as motiv, as shkak për asnjë send më të vogël, me pas problem çfarëdo të vogël me të ndjerin T. aq më larg, larg qoft me mendu me nxit apo me organizu vrasjen e një polici të Kosovës, ku ka shtuar se motivi ja do kish me ekzistu për B.H-policin nga Ferizaji i cili e ka rrahur pa asnjë arsye dhe që i ka montuar proces gjyqësor ku është dënuar me 2 vite burgim, pa kryer asnjë akt dhe dënim të cilin e ka mbajt.

Po ashtu është pyetur edhe lidhur me incidentin në “S Casino” pasi që i akuzuari E. ka deklaruar se në mes të T. dhe tij nuk ka pasur përlëshje përveç që i njëjti e ka tërhequr fizikisht dhe e ka vendosur mbrapa shankut, i njëjti është pyetur lidhur me atë se a ka pasur vetëdije në atë moment, sa ka zgjatur ajo tërheqje dhe se a ka pasur ndonjë komunikim verbal mes tij dhe T, ku i njëjti ka deklaruar se ka pasur vetëdije, bile është koqitur pak aty ku tërheqja ka zgjatur për afërsisht dy deri tri metra, dhe se nuk e beson që ka pasur ndonjë komunikim verbal mes tij dhe T sepse ka qenë kohë shumë e shkurtë, ku në njërin anë dëgjoheshin armët dhe ka pasur ushtimë të madhe edhe sikurse të kishin fol me T. nuk do të ishte dëgjuar prej krismave.

Në fund i akuzuari është pyetur lidhur me atë se a ka diçka për të shtuar në mbrojtjen e tij e që ka deklaruar se: A.B ka qenë këtu dëshmitar i propozuar nga avokatja mbrojtëse dhe ka dëshmuar shumë qartë dhe bindshëm, se ka pasur probleme dy herë me të ndjerin T., e ka cekur edhe vendin ku ka ndodh problemi. Një ka thënë se ka ndodhur në “market”, në lagjen e T.R, në “marketin” e nipit të avokatit M.S, dhe me siguri se është në shkresat e lëndës, emri i të cilit nuk me kujtohet, i njëjti ka thënë se ka pasur problem T. me A.B në lokalit e tij, në kacë, ku A, i ka qenë duke paguar, dhe që pronari i lokalit i ka thënë T “si nuk po të vjen marre, po e nguc myshterinë pa të bo kurrigjo”, ndërsa në pyetjen e gjyqtarit se çka të tha T., ai është përgjigjur se “asgjë, vetëm është skuqur dhe ka ikur”. A.B ka treguar këtu qartë dhe shumë bindshëm se i ka ra pishman për atë se çka i ka ndodhur me T.R dhe se është penduar, por se ka qenë i ri dhe i ngutshëm, gjaknxehtë, A.B ka thënë se edhe policia konkretisht me emra edhe avokati i tij e ka vërtetuar atë me shkresë dhe e ka njoftuar trupin gjykues se policia dhe M.K kanë shkuar te shtëpia e tij dhe i kanë thënë familjes së tij, “ti e ke mbajtur burgun për këtë punë, mundesh me shku në shtëpi, akuzoje E.S”. Një njeri që kish me u nxitë nga dikush dhe i ka ra pishman, është penduar për atë çka ka bërë, dhe i ofrohet të jetë i lirë dhe të rrijë në shtëpi, dhe mos t’i vuaj edhe 27 vite -28 vite burg, ai do të kish me tregu se kështu ka ndodhur, me ka nxitë filani dhe si ka rrjedhur rasti, porse kurrë nuk ka ndodhur ajo, më së miri e din A.B dhe unë, që nuk kemi folur kurrë asnjë fjalë të vetme për këtë punë, as me atë e as me njeri të gjallë.

I ndjeri T.R, mua ma ka dërguar personin F.S-inspektor i lartë në policinë e Kosovës, ai vet me ka thënë se ”janë shoqëruar shumë, e ka pasur shok të mirë dhe kanë dalur për gjah, dhe se a ka ndonjë problem ai me ty po don me ditë” dhe unë i kam thënë se nuk kam punë fare me të.

Meqë palët nuk kishin pasur propozime për plotësim të provave, gjykata kishte kaluar në fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori special, në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar si vijon: prokuroria speciale mbetet pranë akuzës dhe provave që mbështesin këtë aktakuzë si dhe provave tjera materiale e të cilat edhe janë elaboruar në shqyrtim gjyqësorë, e me të cilat vërtetohet përgjegjësia e të akuzuarit E.S, ku në shqyrtim gjyqësorë janë administruar provat me dëgjimin e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve si dhe me rastin e administrimit të provave materiale. Tutje ka shtuar se mos pranimi i fajësisë për veprën penale të përshkruar në dispozitiv I të aktakuzës, nga ana e të akuzuarit është i orientuar në ikjen e përgjegjësisë juridiko-penale, e që është në kundërshtim të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës e të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësorë. Gjendja faktike se i akuzuari ka kryer veprën penale është vërtetuar nga provat të cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësorë e të cilat e vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet e kësaj vepre penale që përbëhen prej shumë dëshmive të të dëmtuarve, dëshmitarëve, përgjimeve, hartografisë si dhe provave tjera. Fakti se tani i akuzuari ka kryer

veprën penale për të cilën është akuzuar është vërtetuar gjatë administrimit të provave të nxjerra gjatë shqyrtimit gjyqësorë e që do të elaborohen gjatë fjalës përfundimtare.

I njëjti fajësinë e të akuzuarit E.S fillimisht e mbështetë në deklaratat e të dëmtuarve-dëshmitarëve Sh.R, V.R, e më pastaj të dëshmitarëve G.H, B.Sh, B.H, F.Sh, B.M, K.B, A.I, M.I, E.I, Z.I, Sh.Q, M.K, F.G, L.M, Dëshmitari D2, A.S.

Fillimisht nga deklarata e dëshmitares K.B është vërtetuar se e njëjta kishte lidhje me personin Rr.A, se e njëjta edhe I.A, E.S, A.B dhe F.A dhe që ajo ka poseduar telefoni me numrin 044-///-///dhe se me datën 30.08.2007 asaj i kujtohet se kishte folur në telefon mobil me të pandehurin Rr.A, i cili ka poseduar numrin e telefonit 044-///-/// dhe ka bërë elaborimin e SMS të këmbyer mes dëshmitares K dhe Rr. A e përmes të cilave vërtetojnë përfshirjen e Rr.A në atentatin e T.R. Fillimisht më datën 30.08.2007 dëshmitarja i ka dërguar sms Rr.A duke i thënë “Lock kush e vrajti T be”, ndërsa Rr. është përgjigjur “nuk është punë për ty ti kqyri punt e tua a po nin”, ndërsa e njëjta i’a ka kthyer “osht osht se ti munesh me pas lidhje me ta, e me ra në burg qa boj un a”, ndërsa Rr i ka kthyer sms “Lock të kallxova që fjetun kesh edhe lem rahat a po nin”, ndërsa e njëjta i’a ka kthyer “Loqk um fal po pej tutës e kam”. Prokurori ka shtuar se pse Rr.i është përgjigjur të dashurës së tij në mëyrë të tillë në ora 17:56, kur e gjitha ajo që ka bërë është se kishte pyetur nëse ai e dinte se kush kishte vrarë T.. Një njeri i pafajshëm ka mundur të përgjigjet duke thënë “Unë nuk e di, unë jam duke u përpjekur për të zbuluar, policia mund të më fajësojnë mua duke pasur parasysh hështorinë e njohur mes nesh dhe T”. Por ai tha “nuk është kjo punë e jotja, kqyri punt e tua, ok a është Rr. duke urdhëruar në atë të mos ndërhyjë në punën e tij, sepse ai ishte i përfshirë thellë në biznesin e vrasjes së T.R.

Sa i përket deklaratës së A.I që kishte dhënë më herët para gjykatës e njëjta ka vërtetuar faktin se ajo dhe T. ishin përcjellur nga E.S dhe grupi i tij, duke thënë në një rast derisa ishin duke u përcjellur: “Mos u kthe prapa! Mos i provoko! Janë pas nesh!”. Ajo ka pohuar se ka pasur edhe shumë raste tjera për të cilat i kishte treguar T. që ishte përcjellur nga E.S dhe grupi i tij duke thënë se këtë e ka dëgjuar shumë herë prej tij. Ajo e ka pranuar se është e vërtetë çfarë ajo i ka thënë policia gjatë marrjes në pyetje, përkatësisht se T i ka thënë se Grupi i E.S e ka vrarë qenin e tij dhe se Grupi i S. e ka përcjellë dhe e ka kërcëntuar. Ajo po ashtu ka thënë se ka qenë e pakënaqur me autoritetet, meqë më parë kishte parashtruar ankesa në polici për këtë grup, të cilat nuk ishin marrë parasysh. Në deklaratën e saj të datës 10.09.2007, ku ajo kishte thënë “Jam e bindur se E.S e ka nxitur A.B, ose e ka paguar për ta vrarë T.”, kurse në shqyrtim gjyqësor i ishte shmangur përgjigjes në këtë pyetje.

Lidhur me deklaratat e dëshmitarës M.I e njëjta kishte deklaruar se i kujtohej që T.R dhe A.S i’u kanë ofruar atyre mbrojtje nga E.S dhe grupi i tij. E përse zyrtarët policorë do të duhej të ofronin atyre një mbrojtje të tillë nëse nuk besonin se familja I, kishin nevojë për atë mbrojtje? Ajo gjithashtu ka deklaruar se A dhe E.S kanë qenë në lidhje. M. gjithashtu kishte ushtruar ankesë në polici më 12 Maj 2005, ku ishte ankuar për sjelljen e grupit. Ajo në shqyrtimin e kaluar gjyqësorë kishte mohuar se deklaratat e saja të dhëna pranë hetuesisë, të datës 08.01.2008 edhe ato që ka thënë gjatë gjykimeve paraprake përkundër se ato përputheshin saktësisht me provat tjera.

Sa i përket deklaratës së dëshmitarës E.I përkundër se ishte tërhequr nga deklaratimet e mëparshme, ajo kishte deklaruar se A. dhe T, i kishin treguar asaj se ishin përcjellë nga “E dhe grupi i tij”, një grup që kishte reputacion të keq. Ajo gjithashtu ka konfirmuar se A, i kishte treguar asaj për tentativën e vënies në pritë afër fsh S” dhe se A, ishte tejet e brengosur.

Nga deklarimi i dëshmitarës Z.I vërtetohet fakti se e njëjta kishte dëgjuar se problemet e T.R kanë filluar prej se kur T.R e kishte ndalur E.S në komunikacion dhe prej aty fillon problemi mes tyre, problemet kanë vazhduar prej aty e tutje dhe ajo i referohet incidentit të dhunshëm në S. Casino ku thotë “është fakt se ata kishin një armiqësi”. Kur dy persona e luftojnë njëri tjetrin ata janë armiqë e jo shokë. Ajo gjithashtu ka vërtetuar se në deklaratën e saj ajo e kishte përdorur termin Grup i S, shumë herë dhe se ajo e dinte se një grup i tillë ekzistonte. Ajo e vërtetojë një pjesë të deklaratës saj ku kishte thënë “Unë nuk e njihja A. por F.Sh më ka thënë se A.B ka qenë pjesë e Grupit S, dhe se ai më së shumti shoqërohej me L, Në dëshminë e saj para gjykatës, ajo është pyetur nëse L, ishte pjesëtar i Grupit S, dhe ajo përgjigjur “me siguri se po”.

Lidhur me dëshminë e dëshmitarit N.S ka shtuar se në dëshminë e tij, shumicën që e ka thënë nuk qëndrojnë as deri në shkallën më të lehtë. Ai ka mohuar se vëllau i tij kishte pasur ndonjë problem me T.R, ai madje ka fajësuar A.S për S.Casino jo T.. Për të akuzuarin vëllanë e tij E. e ka cilësuar si një person të qetë, i cili në një farë mënyre të pa drejtë duket se ka tërhequr probleme edhe pse ai nuk ishte “i prirur për të shkaktuar probleme”. Ai tha për A.B prerazi se B. “kurr” nuk ka vozitur veturën B. Caffee e as nuk ka punuar për S. Kjo nuk është e vërtetë. Arsyeja pse asnjëri prej tyre nuk mund të pranojnë se B, ka vozitur për S, është për shkak se kjo do të thotë se B, ka punuar për ta dhe për këtë arsye se ai ishte njeriu i tyre. Të vetmës pjesë, që duhet falur besimin në deklaratën e N.S është ajo se E, I, Rr, i, A.B, të gjithë ishin në kafiterinë S, para se të fillojnë të largohen dhe të shkojnë në aksion, ku pasoj vrasja e T.R

Ndërsa sa i përket deklaratimit të dëshmitarit A.B ka shtuar se këtij dëshmitari nuk duhet falur besimin duke ditur rolin e tij në këtë rast pasi ai është kryersi i vrasjes i shtytur nga i akuzuari E.S, nuk duhet besuar historisë së tij për kinse konfliktin në mes tij dhe T.R që shkaktoi vrasjen e tij nga ana e A., po të kishin ndodhur ato ngjarje si i ka përshkruar ai, sigurisht një person normal do të kishte raportuar këto akte të dhunës në polici, por ai nuk e bërë këtë nga fakti se me shumë gjasë ato raste nuk kanë ndodhur kurrë, atij duhet falur besimin vetëm në pjesën ku deklaron se ka shkuar në lokalin S dhe nga aty më vonë me të pandehurit Rr. dhe I.A, me veturë të I, janë nisur në drejtim të lagjes D, dhe më vonë i njëjti e ka kryer vrasjen. Marrëdhëniet e tij me të akuzuarin E.S dhe pjesëtarët e grupit të tij edhe pse mundohen të tregohen si jo shumë të ngushta vërtetohen në mënyrë shumë bindëse nga fotot që shihet në shoqëri me ta, nga video incizimi në ahengun në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit dhe nga transkriptet e bisedave të siguruara me masa të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, në mes tij dhe grupit dhe dëshmitarët F.Sh. dhe Z.I. Ka shtuar se A.B jo vetëm që ka shkatërruar T.R dhe familjën e tij, por ai gjithashtu ka dërguar vetën në burg për një pjesë të konsiderueshme të jetës së tij. Ai këtë e ka bërë nga një besnikri e gabuar dhe e çmendur për shefin e tij E.S. Kjo ishte një vrasje frikacake dhe e turpshme, duke shtënë në të pafajshmin T.R nga prapa pa asnjë paralajmërim. E.S ka zgjedhur këtë ushtar të veçantë besnik për të bërë punë, sepse ai e dinte se T.R nuk do të njohë B. dhe se T.R, pra nuk do të ishte në gatishmëri.

Tutje lidhur me dëshmitarin D2 ka shtuar se është një dëshmitarë i rëndësishëm, i njëjti ka dhënë dëshmi të drejtpërdrejta se i pandehuri ka urdhëruar vrasjen e T.R, duke e dëgjuar atë në ditën e vrasjes duke fol me anëtarët e tjerë të bandës, e që dëshmia e tij është deklaruar e pranueshme dhe është në përputhje të plotë të KPPK-së, pasi që në një seancë të mbyllur, në pajtim me dispozitat e KPPK-së, kritrere të ndryshme janë vlerësuar nga gjyqtari kompetent. Dëshmitari D2 është gjetur të jetë nën kërcënim të rëndë, të jetë i besueshëm dhe kredibil dhe dëshmia e tij të jetë e rëndësishme, i njëjti i ka njohur anëtarët e ndryshëm të Grupit S, e ku më e rëndësishme është që dëshmitari ishte i pranishëm në kafiteri në ditën e vrasjes dhe për këtë arsye ishte në gjendje për të dhënë dëshmi të drejtpërdrejtë për tubimin e bandës, për disa pjesë të bisedës që ata kishin mes tyre, kur ata ishin duke u përgatitur për të kryer ekzekutimin, për largimin e tyre të armatosur me armë me tytë të gjatë, për kthimin e tyre gjithashtu duke mbajtur armë, dhe

ekzaltimi i tyre triumfues i hakmarrjes së marrë. Lidhur me ditën e vrasjes dëshmitari D2 ka deklaruar se ai e ka parë E.S rreth orës 08:00 të mëngjesit, në deklaratën e tij të shkruar, ai ka deklaruar se ishte rreth orës 07:00 të mëngjesit, kujtesa e dëshmitarit që i pandehuri ka qenë në kafiteri që herët në mëngjes është vërtetuar plotësisht nga të dhënat e hartografisë së abonentit që tregojnë se i pandehuri ka përdorur telefonin e tij me numrin 044-//// nga ora 06:36:55 e mëngjesit në zonën e kafiterisë: ku D2 kujtoi fillimisht duke parë të pandehurin edhe më vonë, ndërsa D2 ishte i pranishëm në kafiteri, Rr.- Rr.A, L,- I.A, A. N, dhe F, ishin aty. Kjo përsëri është vërtetuar nga provat e N.S dhe vetë A.B dy prej të cilëve kanë pranuar se ata ishin aty atë ditë, ndërsa ai ishte atje, D2 tha se ai ka parë të gjithë ata hyjnë në zyrën e E. dhe ai e pa se diçka po zihej me të cilën ai po i referohej vrasjes, ai u largua për shkak se ai tha me vete se diçka jo e rregullt po ndodhte. Ata ishin të armatosur, e një rëndësie të veçantë dhe provë e drejtpërdrejtë është edhe fakti se i pandehuri ka qenë në komandën e planit për të kryer vrasjen, ku dëshmitari D2 dëgjoi fjalët e përdorura nga i pandehuri “kjo gjë duhet të bëhet sot”. Nga deklarata e tij po ashtu vërtetohet se i njëjti i ka parë të gjithë kur janë larguar nga kafiteria dhe që kanë pasur armë me tyta të gjata me vete në çanta e po ashtu këtë skenë ai e ka parë nga jashtë kur ai është ul në automjetin e tij, ai tutje ka vërtetuar se kur janë larguar nga kafiteria të armatosur kanë qenë L,, A, dhe Rr,. I njëjti ka shtuar se janë të bindur se mbrojtja do të përpiqet të argumentoj se D2 është një dëshmitar i pabesueshëm mbi bazën se ata nuk kanë mundur ta identifikojë se kush ishte, ndërsa prokuroria është e bindur se dëshmitari D2 është një dëshmitarë i besueshëm mbi bazën se gjyqtari kompetete ka shqyrtuar dëshminë e tij në mënyrë që të kontrolloj besueshmërinë e tij, ai ishte i besueshëm pasi që vërtetoi disa gjëra të rëndësishme sidomos ato që lidhen me personin A.B, ku D2 i tha gjykatës se B, ishte i pranishëm në kafiteri për çdo ditë, ku kjo është vërtetuar nga fotografitë që tregojnë marrëdhëniet që B, ka pasur me të pandehurin, Rr, dhe L, dhe të tjerët në kafiteri, kur dëshmitari u pyet në lidhje për marrëdhëniet që B. ka pasur me E.S, i njëjti deklaroi se “unë e kam vënë re se E, do t’i jepte atij një urdhër dhe A. do t’i bindej, E., i thoshte atij që të bëjë këtë apo atë dhe ai do të bënte këtë”. D2 deklaroi “Ai jepte urdhra në mënyrë të tillë që të gjitha punët që ai donte për të kryer ai do të urdhëronte të tjerët për t’i kryer ato”. D2 ka dhënë dëshmi të drejtpërdrejtë që ka parë dhe ka dëgjuar të pandehurin shpesh duke qenë në kafiterinë e tij, duke shikuar nga dritarja në drejtim të banesës së T.R dhe duke thënë se në shumë raste duke i’u referuar T, “tani ky qeni po largohet nga banesa e tij dhe ja ku është ky idioti, ky qeni po del tani”.

Tutje sa i përket provave materiale ka shtuar se janë administruar prova të cilat janë siguruar me masa të fshehta hetimore – përgjimi i telekomunikimeve e që janë nga burime të ndryshme, ku secila prej tyre janë të sakta dhe vërtetuese. Fillimisht nga provat e konfiskuara në “Bar S” janë të rëndësishë së jashtëzakonshme provuese, ku një numër i këtyre provave janë shumë dënuese për të pandehurin veçanërisht kur vijm tek çështjet e kontaktit të tij me A.B , një marrëdhënie që i pandehuri në deklaratat e tij thotë që nuk ka ekzistuar, ndërsa dëshmitë zbulojnë që e kundërta e kësaj është e vërtetë.

Nga prova #1 që konsiston në një numër të CD-ve e cila është ndarë në 17 klipe tregojnë se i pandehuri kishte siguruar xhirimin që ishte bërë, ku këto tregojnë se i pandehuri kishte siguruar xhirimin që ishte bërë nga kamerat e S.Casinos, ku një klip L, shihet T.R duke hyrë në S.Casino, në një klip tjetër Policia T.R është incizuar përsëri, është edhe një klip tjetër të quajtur T që incizon T, në këmbë në S.Casino, e të cilat video vërtetojnë të kundërtën e pretendimit të të pandehurit që ai kurr nuk kishte ndonjë interes në T.R, e që është dëshmi e mëtjeshme për inatin e hidhur që i pandehuri e ka mbajtur ndaj T.R pas dhunës në S. Casino, fakti që ai kishte marrë kopje të filmimeve dhe atë fakt se CD-të fokusohen në T.R.

Prova tjetër 1.7 janë disa fotografi që tregojnë të pandehurin dhe shokët e tjerë, ku fotografia 0152 tregon A.B në kafiterinë S, në shoqëri të Rr.- Rr.A, I.A –L, dhe të A.B, ku nga pamja vërtetohet se fotografia është bërë në kohë të nxehtë duke marrë parasysh rrobat e lehta në të cilat ishin veshur që të gjithë, dhe kalendarin në murin prapa që tregon vitin 2007. Tutje fotografitë me numrin 0010 tregon kopshtin e shtëpisë së tij me pishinë ku shihet edhe vetura “Jeep Cherokee” me ngjyrë të gjelbër e cila përmendet shpesh si njëra ndër veturat që shumë shpesh e ka ndjekur A. dhe T, pastaj fotografia 0163 dhe 0164 ku shihet A.B në shoqëri I.A në kafiterinë S,, e poashtu fotografia 0164 e cila tregon E.S që ishte në shoqëri së bashku me A.B që demanton thënien e të akuzuarit E, r se ai nuk është shoqëruar me A.B. Tutje prova më bindëse dhe që vërtetojnë afërsinë e të akuzuarit E.S me të dënuarin A.B është prova nr.3 ku është përmbajtje nga videokaseta Sony, e cila përmbajtje është e ndarë në gjashtë pjesë dhe tregon një ndejë që po bëhej në kopshtin e të pandehurit, ku i pandehuri është qendra e vëmendjes dhe rrin i ulur dhe i rrethuar kryesisht nga musafirë, ku është edhe A.B i cili vështron nganjëherë kamerën, ku në disa pjesë shihet edhe A.B duke i’u afruar të akuzuarit E, dhe në pjesën kur i pandehuri i’a bënë me dorë dhe duke e thirrë dhe i jep udhëzime. E që nga këto krejt prova mund të vërejtë se ka pasur kuptim të përsosur që i pandehuri të ketë përdorur A.B si vrasës. Duke shtuar se A.B ishte i ri, i varfër, i etur për të dëshmuar vlerat e tij dhe besnik ndaj grupit dhe të akuzuarit. Siç është parë nga festa në oborr Prova #3 ai do të kryejë urdhrat e E.S pa bërë pyetje, ku në mënyrë domethënëse A.B ishte krejt i panjohur për T.R i cili nuk do të kishte dyshuar në A.B në qoftë se e kishte parë atë që po i afrohej atij.

Përpos provave të lartcekura si prova me rëndësi janë edhe SMS-sat prej të cilave shihet se i akuzuari E.S ka mbledhur fotografi inkrimuese të A.s për t’ia përdorur ato për t’i bërë shantazh asaj në rast se ajo bashkëpunon me policinë pasi që është bërë vrasja. Po ashtu rëndësi provuese të veçantë e kanë edhe SMS-at përmes të cilave vërtetojnë se në ditët para vrasjes E.S ishte në krye dhe duke i dhënë urdhra I. dhe RR.A, si dhe A.B ku mesazhi i parë i dërguar është nga Rr.A drejtuar A.B ku i ka thënë “um thirri mu Q” te sharbant po ju pres ///”, që tregon se Rr. është duke i përcjellë A.B faktin se i pandehuri ose Q” po jepte urdhra numri i përmendur ///, është i rëndësishëm sepse ky është numri i telefonit mobil të A.B. Ndërsa disa ditë më vonë një seri e mesazheve në mes I, Rr, dhe të pandehurit E. janë shkëmbyer, që janë dëshmi me rëndësi jetike pasi që ato tregojnë se grupi kishte bërë një përpjekje të mëparshme për të gjetur dhe vrarë T.R, e që fillimisht Rr.A i dërgon SMS I.A me përmbajtjen “A me nejt qitu edhe 1 or e gjys a me ardh”, ndërsa E. i dërgon SMS I.A “ka je me ka”, ndërsa Rr. i dërgon sms I. duke i thënë “Na thiri Q. tha a hajdi me nga te shpija jam qa po bajm”, tutje Rr. dërgon sms E. duke i thënë “A mu nis te kafja a te veni”, ndërsa I. i thot Rr. “ Te empijem tu tu en ne kam me B.tu kqyr per qat shokun, a o Q. asajd”, tutje I, i dërgon sms E “O vulli dhez e kam pas ton kohën dhe ne u enum me Rr. po sen spat kryen kryen e she”, ku nga të gjitha këto komunikime të rëndësishme në mes të pandehurit dhe shokëve të tij mbështeten nga provat tjera që tregojnë për urdhërat ndaj grupit që e udhëheqte i akuzuari, për faktin se A.B ka qenë pjesë e grupit të tij sikurse edhe tregohet nga dëshmia e dhënë e gjithashtu edhe nga fotografitë dhe videot së tij ku shihet duke punuar drejtpërdrejtë për E.S sikur një punëtor i tij e po ashtu dëshmi shumë e rëndësishme se i ndjeri T.R ishte tani në përcjellje intenzive për gjetjen e tij. Kjo në mënyrë decisive dëshmohet nga SMS-et e shkëmbyer në mes I. dhe Rr. më datën 27.08.2007 kur Iliri e jofton Rr. që kanë përcjellë T.

Tutje i njëjti ka përshkruar edhe provat mbi pozicionimin gjeografik që paraqesin E.S dhe grupin e tij duke ndjekur T.R, e që nga deklarimi i A.B dhe N. ku të dy kanë deklaruar se A, I dhe Rr të gjithë janë larguar nga Kafiteria S” së bashku në fillim të pasditës, e që nga dëshmia e V.R ka dhënë detaje se në ditën kritike ai dhe vëllau i tij T, i kanë shkuar në Hotelin G”në mënyrë që të bëjë pagesën e djathit, ndërsa përveç RR. një anëtar tjetër i banesës tashmë i dënuar F.A

gjithashtu kishte sytë mbi automjetin në të cilin T. dhe V. ishin duke udhëtuar, e që kjo vërtetohet nga sms të cilin F.A në ditën kritike i'a ka dërguar I.A duke i thënë "Parking te G"kojshia e kish dramën", e po ashtu sekuenca e komunikimit pas atentatit që ka ndodhur ka qenë në mes Rr.A dhe A.B, që fillimisht kanë komunikuar në telefon për 18 sekonda, ku ky kontakt është shumë i rëndësishëm ku nëse do të ishte e vërtetë që A, papritmas kishte hyrë në përleshje me T.R dhe e vranë në një moment të çmendurisë, pa përfshirjen e ndonjë personi tjetër, me siguri do të kishte pritur që A, ta thërras I ose Rr. shumë shpejt pas vrasjes dhe që A. të kishte folur në panik për më gjatë se 18 sekonda, duke përshkruar për shumë më gjatë atë që kishte ndodhur, se si kishte qenë në shok dhe duke ikur, se ai nuk kishte ditur se ku të shkoj dhe çka të bëjë, por kjo nuk ndodhi, e që i njëjti komunikoi me Rr.A përmes telefonit dhe sms.

Ndërsa sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit E.S ka shtuar se i njëjti ka mohuar dhe vazhdon të mohoj absolutisht gjithçka, ai nuk pranon në fakt asgjë, e veçanërisht mohimi i tij se ai kishte pasur njëfarë historie të keqe me T.R, e që njëra prej fjalive që ai ka përdorur vazhdimisht gjatë gjykimit është "me përgjegësi të plotë dhe një milion përqind i sigurt i'u garantoj se unë s'kam pasur të bëj fare me të". Ai ka deklaruar se dinte shumë pak për T.R, ka thënë se nuk kishte pasur asnjë hatër mbetje apo armiqësi me T.R dhe as nuk ka pasur arsye për ta urreyer fare he natyrisht nuk kishte pasur asnjë arsye për ta lënduar T.R, ai ka deklaruar se mezi e njipte A.B dhe se ai asnjëherë nuk kishte qenë i punësuar tek ky dhe se nuk ishte shoqëruar me të, ai ka shkuar aq larg bile edhe ka thënë se nuk ekziston diçka si grupi S, se ai nuk ishte një lider i vetshpallur i ndonjë grupi apo bande, dhe asnjë nga fotografitë apo video incizimet e sekuestruara nga Kafeneja S. nuk kishin të bënin me të fare, nuk e ka urdhëruar apo nxitur A.B për ta vranë T.R. Ai ka thënë se kjo ishte krejtësisht një çështje personale në mes të A.B dhe T.R, sidoqoftë provat tregojnë që ai ka urdhëruar ekzekutimin, e ka planifikuar, e ka aranzhuar dhe e ka nxitur A.B për ta tërhequr këmbëzën e armës.

Në fund në fjalën përfundimtare prokurori ka shtuar edhe pse mbrotja do të thirret në atë se në këtë rast nuk ka prova direkte që vërtetojnë se i akuzuari E.S ka nxitur vrasjen e T.R por nga të gjitha provat e mësipërme që janë elaboruar më lartë vërtetojnë pa mëdyshje se ai është shtytës për kryerjen e vrasës së të ndjerit T.R pasi që nuk ka asnjë dëshmi që e vërtetojnë se i ndjeri kishte ndonjë problem me tani të dënuarin A.B, ai thjeshtë ishte një ekzekutues i urdhërit të E.S, pasi të gjitha problemet T.R i kishte pasur me E.S dhe grupin e tij e për të cilat raste ai kishte bërë njoftime në polici si dhe i kishte njoftuar shumë persona familjar dhe shokë e të cilët kanë dëshmuar edhe në këtë shqyrtim gjyqësor. E ku nga provat e prezantuara për të cilat propozojnë që t'ua falin besimin vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit E.S manifestohen të gjitha elementet e veprës penale "Nxitja të kryerjes së vrasjes së rëndë" nga neni 147 paragrafi 3 dhe 9 lidhur me nenin 24 të KPK-së, për të cilën është akuzuar, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë e tij penale, ai është penalisht përgjegjës, veprën penale e ka kryer me dashje dhe dijeni dhe i propozojnë trupit gjykues që të akuzuarin ta shpall fajtorë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe si rrethana rënduese me rastin e matjes së dënimit duhet marrë parasysh të dhënat se i akuzuari edhe më parë ka pas të kaluar kriminale.

I dëmtuari Shefqet Riza në fjalën përfundimtare ishte deklaruar si vijon: vrasës i T.R është E.S, i njëjti është shtytësi dhe nxitësi për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë ky e ka paguar vrasësin A.B për ta kryer atentatin ndaj birit të tij. Lidhur me T ka shtuar se ka qenë polic elitar dhe nuk ka pasur me askënd probleme përpos me të akuzuarin E.S dhe atë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në mbrotje të rendit dhe ligjit, po të kishte pasur probleme vetë institucioni i policisë do të merrte masa ndaj tij dhe nuk do të pajtohej që i ndjeri T të shpallej Hero i Kosovës për luftën e guximshme kundër kësaj bande kriminale të njohur në Kosovë. Ka shtuar se mbrotja e të akuzuarit gjatë procesit të gjykimit vazhdimisht është përpjekur ta relativizoj apo të mos e

pranojë se ka ekzistuar grupi kriminal i E.S, ku dihet botërisht se ka ekzistuar dhe ka vepruar grupi kriminal i E.S para luftës dhe pas luftës në Kosovë madje edhe sot vepron, e që këtë e ka dëshmuar Prokuroria e Kosovës dhe vetë shërbimi hetues i Policisë së Kosovës, madje këtë e dinë tërë qytetarët e Kosovës dhe sidomos qytetarët e Prishtinës të cilët në vazhdimësi janë terrorizuar nga kjo bandë kriminale, ka theksuar se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë e tij penale, madje ai në të kaluarën ka shumë vepra kriminale të kryera dhe këto i disponon hetuesia dhe Policia e Kosovës, më shkurt ai është fajtor kryesor për vrasjen e T.dhe këtë e ka bërë me dashje, me dijeni dhe me përcjellje të vazhdueshme nga ai dhe grupi i tij deri në ditën e kobshme të likuiduar fizik, prandaj prej nga trupi gjykues ta shpallë fajtor për veprën penale të kryer dhe si rrethanë rënduese të majtës së dënimit duhet marrë parasysh të dhënat se i akuzuari edhe më parë ka pasur të kaluar kriminale.

I njëjti në fjalën e tij përfundimtare ka shtuar se polici A.S i cili ka ikur në SHBA nga frika për të mos u vrarë nga E.S, menjëherë pas vrasjes i kishte thënë në telefon një shokut të tij se T. e vrau E.S, i cili dy ditë pas vrasjes së T. nga frika e kishte lëshuar policinë dhe kishte ikur në SHBA, ku edhe sot jeton atje, e që i njëjti ka qenë rëndë plagosur me armë zjarri në S. Casino nga vetë E.S dhe grupi i tij, e që aty është sulmuar bashkë me T. po fati ka dashtë që atë ditë të mos jetë vrarë. Ndërsa nga dëshmia e fundit e A. kuptohet se i ndjeri, ndonëse nuk ka qenë fajtor për rastin e S.Casinos i kanë dërguar Gj.K për t'u pajtuar por i akuzuari vetë ka deklaruar në dy seancat e këtij procesi gjyqësorë që nuk ka pranuar t'ua falë asesi, sidomos T e që madje ka deklaruar se edhe ish polici S i'a ka dërguar për t'u pajtuar, por i akuzuari E.S kishte vendosur gjithsesi ta vrante T, gjë që edhe e ka bërë. E që poashtu edhe Prokuroria dhe Shërbimi i Inteligjencën me anë të provave të pakontesueshme kishte paralajmëruar një javë para vrasjes se po pregaditet atentat mbi T.R nga E.S, e që këtë e deklaroi dëshmitari A.S nga SHBA-ja e që kjo dëshmon se E.S ishte prapa vrasjes së T. së bashku me bandën e tij, e që madje Shërbimi i Inteligjencës kishte informacione përmes vijës zyrtare se do të ndodh vrasja, prandaj ka informuar zyrtarët që t'i ofrohet mbrojtje T, e që vetë T, kishte bërë katër kërkesa në polici se ka qenë i kërcënuar nga E.S dhe banda e tij, e përpos kësaj i akuzuari E.S ka qenë i shtruar në spital pas ngjarjes së S. Casinos ka deklaruar me pezmë para mjekut dhe pacientëve se nuk e lë pa e vrarë T.R, e që pas kësaj ngjarje edhe vëllau i tij N.S në qendër të Prishtinës në Hotel "I" dhe ndërtesa e kombinatit "Ramiz Sadikut" e kishte kërcënuar T.me fjalët "Ik nga Kosova se pa ta ... nanën e më të vra se lamë, Kosova është shumë e vogël ja ti ja na".

Tutje dëshmitari A.C kishte deklaruar se E.i kishte pasur rolin kryesor te grupi i tij, se secili anëtar i këtij bande i bindej urdhrave të tij, sepse gjithë anëtarët e grupit të tij i mbante me të mira materiale, madje dorasit A.B i kishte ndërtuar edhe shtëpi. Ndërsa lidhur me dorasin A.B T. fare nuk e ka njohur, prandaj i akuzuari e kishte angazhuar dhe e ka paguar pikërisht këtë person për ta vrarë T, e vret tinëzisht pas shpine, e që deklaratat e dorasit A.B janë të sajura dhe qëllimin e kanë të shpëtojë të akuzuarin E.S nga akuza për nxitjen e vrasjes së T., ku i njëjti ka frikë të tregojë të vërtetën sepse mund t'i kërcënohet edhe jeta meqë banda e E.është në gjendje ta likuidojë fizikisht. Deklaratat e tij kontradiktore, të sajura për të krijuar një profil të rrjeshëm për policin T.R, duke e përshkruar atë si agresor, majde edhe si të dehur janë të pavërteta, kjo përpjekje e tij edhe një herë shton se bëhet me të vetmin qëllim për ta shpëtuar nga akuza për të akuzuarin E.S. Gjithashtu lidhur me raportin e përpiluar nga toksikologia N.Naka kishte dhënë raportin se ditën kritike T ka qenë i dehur, por Prokuroria e Eulexit nuk i besoi këti raporti dhe e dërgoi lëndën në Institutin e Toksiologjisë në Zagreb për të dhënë superekspertizë, prej nga dëshmohet se i ndjeri nuk ka qenë i dehur, pra hidhet poshtë Raporti i Institutit të të Pagjeturëve në Kosovë si gënjeshtër.

Sa i përket vrasjes së T.R ka shtuar se në mënyrë permanente, me paramendim, është planifikuar vrasja e policit T. R e që nga përlejsja me armë në S. Casino prej datës 25 dhjetor 2005 deri në ditën e vrasjes me 30 gusht 2007 E.S me bandën e tij e kishte përcjellë T. për ta likuiduar fizikisht,

e që Prokuroria me provat e siguruara nga Kafe Bar S., fotografitë, videoincizimet në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit E.S, hartografia e telefonave të përdorur nga ky dhe grupi i tij para vrasjes tregojnë se E. ishte përfshirë direkt në vrasjen dhe kjo më së miri vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit D2 i cili në ditën kritike i kishte parë anëtarët e grupit kriminal në Kafe S. dhe që kishte dëgjuar E.S të ketë thënë “kjo punë duhet të kryhet sot” dhe përnjëmend është kryer atë ditë vrasja e T.

Ndërsa me rastin e vendosjes Trupi gjykues duhet të marrë parasysh të gjitha provat personale dhe materiale, pra të gjitha faktet që dëshmojnë se vrasës ishte A.B (të cilin i ndjeri T. nuk e ka njohur), ndërsa shtytës pa kurrfarë dyshimi ishte i akuzuari E.S, ku organet e sigurisë, Agjensisë Kosovare për Intiligjencë kishin informacione të bollshme se i akuzuari E.S kishte paguar dhe nxitur A.B për të vrarë T.R. E që në fund kërkon nga trupi gjykues i kësaj gjykate të nderuar dhe të respektuar edhe një herë duke theksuar se kërkon dënimin shembull, dënimin maksimal për të akuzuairn E.S në mënyrë që askush të mos ketë guximin të ngritë dorë mbi Policët e Kosovës pa të cilët nuk ka mbrojtje, të rendit, ligjit e shtetit.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.S, Avokatja K.K në fjalën e saj përfundimtare ishte deklaruar si vijon: kemi arritur deri në përfundim të shqyrtimit kryesor për herë të tretë të një gjykimi i cili, për nga kohëzgjatja ndan vendin e parë në gjykimet maratonike, ku keni pasur rastin të gjykoni për 4 vite çështjen e kthyer dy herë në rigjykim ndaj tani këtu të akuzuarit E.K, i cili ka kaluar plot 12 vite që është privuar nga liria, duke u vetëdorëzuar apo vetëparaqitur për tu përballur me një akuzë për nxitjen e vrasjes së tani të ndjerit T.R, të vrarë para 17 vitesh ndërkaq që po kaq vite dënim është duke i vuajtur kryesi i veprës penale tani i dënuari A.B. Me shpresën që trupi gjykues në këtë çështje penale tani shpreson përfundimisht të vendos në drejtësi në çështjen penale të tani të akuzuarit E.S, ku dy vendimet e gjykatës së Apelit, kanë paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet për çka edhe çështja është kthyer në rigjykim por përkundër kësaj prokuroria dhe përfaqësuesit e akuzës, përkundër obligimit ligjor të veprojnë sipas udhëzimeve dhe sugjerimeve të cilat rrjedhin nga vendimi i gjykatës së Apelit, asnjëri nga ata nuk ka mbushur obligimin ligjor, duke shtuar se në këtë rigjykim nuk është paraqitur asgjë e re e që nuk ka ekzistuar në gjykimin e kaluar dhe madje as që është pritur diçka e re, përveç veprimeve përkatësisht eliminimeve sipas detyrimeve që kanë rrjedhur nga Gjykata e Apelit, e që në cilësinë e mbrojtëses i paraqet arsye që të mbetet pranë fjalës përfundimtare të cilën e ka paraqitur në gjykimet e kaluara, por vetëm do të analizoj disa fakte vendimtare dhe esenciale në bazë të të cilave gjykata duhet ta shpall aktgjykimin e bazuar në ligjin procedural dhe material.

Fillimisht është thirrur në sugjerimet e Gjykatës së Apelit dhe vërejtjet e saj që ishin lidhur me dispozitivin e aktakuzës në raport me emërtimin ligjor të veprës penale, duke shtruar pyetjet se a përmban ky dispozitiv i aktakuzës, kohën dhe vendin e saktë të kryerjes së veprës penale?, a ka ndryshuar ndonjë gjë me përshkrimin në dispozitiv?, A është paraqitur në dispozitiv të aktakuzës përshkrimi konkret i shtytjes? Si dhe a përmban aktakuza rrethanat e nevojshme për përcaktimin e veprës penale?, pra Prokurori nuk ka plotësuar asnjë nga këto kërkesa të parashtruara nga ana e gjykatës instanciale, e që tutje ka cituar edhe vërtetjen e Gjykatës së Apelit të paraqitur në faqën 17 të Aktvendimit të datës 19 tetor 2017 e cila vërejtje ka konstatuar-citon “Dikush nuk mund të akuzohet dhe të dënohet për shtytje për kryerjen e veprës penale, pa dhënë ndonjë përshkrim të duhur për atë se cilat akte (veprime apo mosveprime) ka kryer ky person i caktuar dhe për shtytë ekzekutuesin fizik që të kryej veprën penale”, dhe përkundër kësaj dispozitivi ka mbetur i njëjti që jep një përshkrim të vrasjes së rëndë, të kryer nga ana e A.B, po në asnjë mënyrë nuk saktëson veprimet apo mosveprimet e të akuzuarit E.S, se si ai e shtyri A.B për të vrarë të ndjerin T.R”.

Ndërsa sa i përket fjalës përmbyllëse të prokurorit në esencë dhe në përmbajtje ka shtuar se është e paqëndrueshme, për arsien se sepse ashtu sikurse edhe aktakuza e ngritur fillimisht, ashtu edhe vetë fjala përmbyllëse e prokurorit të rastit, ka mbetur e pa bazuar dhe e pa argumentuar, e që i tërë procesi gjyqësorë është duke u zhvilluar në mungesë të provave direkte, duke trajtuar dhe shqyrtuar jo provat rrethanore por thashethemet e një grupacioni njerëzish lidhur me të akuzuarin E.S, duke shtuar se mbrojtja në këtë pikë do t'i përgjigjet Prokurorisë Speciale lidhur me gjuhën që e ka përdorur prokurori aktual në fjalimin përmbyllës sikurse dhe asaj që është përdorur në aktakuzën e trashëguar.

Duke shtuar që fillimisht se mbrojtja nuk do të tërheqë nëpër baltë emrin e tani të ndjerit e as nuk do të lavdëroj, por sidoqoftë në aspektin profesional, aq më tepër për shkak të një motivi inekzistent mbi të cilin mbështetet aktakuza, është e pashmangshme të mos përmendet dosja edhe jo aq e varfër e tani të ndjerit, e cila është konstatuar gjatë shqyrtimit kryesor si e lexuar, ndërkaq që është administruar detajisht në gjykimin e parë e madje edhe janë dëgjuar dëshmitarë, që kanë dëshmuar se tani i ndjeri kishte pasur disa raste të inicuar kundër tij, në fakt kishte pasur goxha raste të mosmarrëveshjes me qytetarët dhe atë, jo në detyrë zyrtare apo vijë zyrtare. Ndërkaq, motivi i aq përfolur si i vetmi shkas, jo shkak, por shkas, pra si arsye e rrejshme për ngritjen e aktakuzës ndaj E.S, se kinse ky ishte i vetmi që ka pasur motiv që i ndjeri të mos jetojë më, tashmë me pamëdyshje u vërtetua që nuk ka ekzistuar. E që ky gjykim ka shkuar shumë largë, përtej objektit të akuzës, përtej çdo kufiri ligjor dhe përtej çdo gjëje relevante lidhur me akuzën që përballat E.S me qëllimin e vetëm që të sajohet ndonjë provë direkte e cila do të mund ta mbështeste aktakuzë, dhe përkundër të gjith atyre përpjekjeve nga ana e prokurorit të parë, përkundër të gjithë instrumenteve ligjore dhe atyre të kundërligjshme, përkundër hetimeve të cilat prokurori pati zhvilluar në kontinuitet gjatë mbajtjes së shqyrtimit kryesor, ja edhe sot nuk ka provë, madje asnjë të vetme se E.S ka nxitur vrasjen e tani të ndjerit T.R

Lidhur me objektin e akuzës ka shtuar se në këtë çështje penalo juridike nuk kemi të bëjmë as me prova direkte as me prova rrethanore të cilat do të vërtetonin tezën e akuzës se E.S ka porositur, nxitur, organizuar apo urdhëruar në çfarëdo mënyre apo forme vrasjen e tani të ndjerit T.R. Duke theksuar se mbrojtja sikurse në fillim ashtu edhe në fund të këtij procesi gjyqësorë konsideron se në këtë çështje penale është gjykuar personaliteti i atëkohë të riut E.S dhe jo veprimet e tij inkriminuese për të cilat do të duhej të përgjigjej penalisht sepse veprime të tilla nuk kanë ekzistuar fare, dhe për një dekadë vazhdon të gjykohet dhe akuzohet epiteti që koloaret dhe thashethemet prishtinase i'a kanë vu të akuzuarit. I vetmi dënim të cilin e ka vuajtur dhe për të vetmen vepër që është shpallur fajtor, është rasti i montuar i Ferizajit i cili rast është i montuar me sulm ndaj personit zyrtar B.H dhe për motiviin e tij të ulët lidhur me A ish dashnoren e E.S, e cila në këtë rast ka bërë një krahasim; Rasti i Ferizajit dhe ish e dashura e E.S A.M e cila menjëherë më pas bëhet femra e B.H janë identike me rastin e S.Casinos dhe A.I, që sipas prokurorisë kanë qenë motivet kryesore që E.S të ketë urrejtur dhe më tutje nxitur vrasjen e tani të ndjerit T., por në rastin e lartpërmendur, B.H nuk u vra, E.S asnjëherë nuk organizoi, urdhëroi apo nxiti ndokënd për ta vrarë B.H, edhe pse, nëse i referohemi fjalëve të prokurorit do të duhej të kishte pasur motiv për ta bërë këtë sepse sipas prokurorisë një motiv i tillë identik ka ekzistuar edhe lidhur me T.R.

Tutje lidhur me thelbin direkt të akuzës, ku E.S komandant i një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga 3-4 familjarë të ti dhe nxitës i një vrasje të kryer nga A.B, përse A.B, jo, A.B sipas asnjë dëshmitari të prokurorisë nuk ishte ushtar i E. apo grupit kriminal, madje as prokuroria nuk e mohon një fakt të tillë, pasi që i njëjti ishte anonim për të gjithë, i pa njohur edhe për policinë dhe hetuesinë por edhe për të gjithë që të tjerët që e njifnin E.S për të keq, gjersa prokuroria pretendon se A.B ka marr përsipër fajin dhe është dorëzuar në mënyrë të parapragaditur. Tutje ka shtuar se prokuroria jo rastësisht nuk e ka dashur për dëshimitar A.B, por edhe F.A, po në

veçanti A, pasi që i njëjti paraqet dëshmitarin crucial në këtë çështje penale, e që përgjatë dëgjimit të A.B në cilësi të dëshmitarit, ra në gjendje pothuajse afektike ku i erdhi në shprehje edhe impulsiviteti i tij befasues dhe është përgjigjur-citon “po kush është ai njeri që do t’i vuante 35 vite burgim për të kryer vrasje për E.S, me vite të tëra më keni mveshur blerje të banesës, ndërtim shtëpie, shumë të hollash të gatshme prej 50,000 euro, a jam budalla unë që ta humb jetën për E.S? Unë jam penduar për atë çka kam bërë, sepse kam vra një njeri dhe e kam humbur edhe jetën time, por vrasjen e kam kryer vetë dhe për arsye të mia, e nuk më ka shtyer as E. dhe askush”. Shtrohet pyetja se pse E.S do të angazhonte A.B për vrasjen e T.R duke i pasur 3-4 familjarë besnik dhe kuptimisht të dëgjueshëm të cilët i paskan kryer çdo detyrë të caktuar nga E.S edhe pse asnjëherë nuk u kuptua se cilat kanë qenë veprimet e kundërligjshme, e pse nuk është ekzekutor Rr.A i cili sipas aktakuzës përdorues permanent i armëve siç është parë në CD e S.Casinos para dyerve të këtij objekti, apo N.S, përmes ushtarit A.B nuk duket askund në atë incizim gjersa ishte “ushtar” apo “truproje” apo “shërbëtor” i E.S, përse mungon ai i “dëgjueshmi” gjersa bossi i tij po rifet brenda, sepse A.B nuk kishte apsolutisht kurrfar lidhje me E.S.

E njëjta ka shtuar se edhe pse nuk është çështje e këtij gjykimi nuk mund të potencohet një fakt shumë interesant se F.A, është dënuar për këtë vrasje me 10 vite burgim vetëm për një sms me përmbajtjen “kojshia e kishte makinën e parkuar te G”, e që sipas aktakuzës kundër tij dhe A.B, këtë sms e kishte dërguar në ora 13:02 minuta, ndërsa nëntë vite më vonë, rezulton se ky sms të ishte dërguar në ora 14:04 minuta, ndërsa në atë kohë i ndjeri T.R nuk kishte qenë tek G”, por kishte qenë në lokalin “A..”, e që këtë dëshmitari i prokurorisë S.H kamarier ka deklaruar “Unë kam ardhur në punë në 7 të mëngjesit, në ora 13:40 minuta i ndjeri T. erdhi në kafiterinë ku punë punoja, sbashku me shokun G. dhe aty qëndroi, respektivisht ka dalur nga kafiteria në ora 15:40 mint”, tashmë i dënuari F. e ka vuajtur dënimin pavarësisht që gjendja faktike rezulton të jetë ndryshe. Është vërtetuar me disa ekspertë, se sms është dërguar një orë prapra, respektivisht një orë para vrasjes së T. dhe mbi këtë bazë Prokurori i Eulexit e bërë të vetmin ndryshim në aktakuzë, kohën e dërgimit të sms.

Lidhur me objektin e akuzës ka shtuar që duhet të analizohet përshkrimi i pikës I të aktakuzës faqe 2, ku sipas këtij dispozitivi nuk është e qartë as a është fjala për hakmarrje, apo ndonjë motiv tjetër, dhe nga ana tjetër këtu theksohen edhe katër persona, A.B, F.A, Rr.A dhe I.A në bashkëkryerje dhe për motive personale kanë kryer vrasjen, që rezulton të kuptohet se A.B, F.A, dhe Rr.A. e I.A kanë pasur motiv personal të hakmarrjes, porse nuk qartësohet a që të gjithë bashkarisht apo ndonjëri nga këta katër persona ka pasur motiv të hakmarrjes personale kundër të ndjerit T.R, gjersa në kontekst të kësaj hakmarrje personale apo motive tjetër nuk përmendet fare i akuzuari E.S. Po ashtu shtrohet pyetja se pse pas 4 muajve më datën 24.12.2007 prokuroria ka marr aktvendim për zgjerimin e hetimeve kundër E.S, Rr.A dhe I.A për veprë penale të vrasjes së rëndë të kryer në bashkëveprim nga neni 147 paragrafi 1 nën paragrafi 3 lidhur me nenin 24 të KPPK-së, si është e mundur që E.S të dyshohet 4 muaj pas vrasjes e jo menjëherë pasi që sipas pretendimeve të prokuroisë dhe në veçanti sipas dëshmitarëve kyq – që sot janë ish polic të dënuar, paska qenë fakt notorn se T.R i ndjerë dhe E.S për vite me rradhë kanë pasur probleme mes vete dhe kinse i vetmi që ka pasur motiv për privim nga jeta tani të ndjerin T ka qenë E.S. Përse babai i të ndjerit T.R edhe publikisht në media por edhe në gjykimin e A.B e F.A ka deklaruar se djalin e ti e ka vararë politika, përse Sh.Q i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit në gjykimin e Rr.A ka deklaruar se “ne, ish pjesëtarët e policisë speciale kemi qenë në dijeni 1 javë më herët se T.R do të vritet dhe se kjo vrasje është organizuar nga krerët e lartë”, pse këta nuk e paraqitën dhe denoncuan këtë planifikim të vrasjes pasi që kanë qenë në dijeni. Përse i përmenduri Z.B në aktakuzën e ngritur nga M.B, në rastin e eksplozivit në lokalin S. pas vrasjes së T.R ofron shumë prej 300.000 euro për atë që vret E.S?, përse ka marrë kohë 4 muaj pas vrasjes së T për përfshirjen e E.S, përgjigja në të gjitha këto pyetje dhe dubioza është se këta 4 muaj janë nevojitur që të

krijohen opstruksione, montime, presione në dëshmitarë dhe të ashtuquajtura të dëmtuara për të nxjerr aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve për E.S, i cili ishte a i cak i eliminimit nga një grup i caktuar njerëzish për shumë arsye të mëhershme ku ai kishte qenë fatkeqësisht dhe ka mbetur i vetmi dëshmitar okular i disa krimeve të luftës.

Pra sipas mendimit të mbrojtjes nuk mundet që dikush të akuzohet dhe të konsiderohet penalisht përgjegjës nese vetëm dyshohet se kinse ai person paska pasur një motiv që dikush të jetë i vrarë pa ndërrmarë asnjë veprim konkret dhe inkriminuese, pra shtytja mund të kryet në mënyrë të ndryshme dhe atë më sa vijon: bindja kryesit të veprës penale, shtytja me forcë kryesin e veprës penale, premtimin e dhuratës apo shpërblimit kryesit të veprës penale, shfrytëzimi i ndonjë raporti të varshmërisë ndaj kryesit dhe sjellja në lajthim kryesin e veprës penale, e që me rastin e analizimit e të gjithave që janë cekur më lartë lidhur me format dhe mjetet e kryerjes së shtyetjes mbrojtja me të drejtë konstatonte se Prokuroria Speciale në kohën e ngritjes së aktakuzës ka dështuar në tërsi dhe nuk ka asnjë grimcë të dëshmisë që të vërtetojë faktin se E.S e ka shtyt-nxit A.B që ta kryej veprën penale. Tutje ka theksuar se jo rastësisht e ka përmendur intervistën e ish hetuesit M.K i cili ka dhënë një intervistë lidhur me rastet e vrasjeve dhe vetëvrasjeve më të njohura në Kosovë, ku ka deklaruar se është shumë e vështirë pothuajse e pamundur të vërtetohet shtytja apo nxitja. E.që Prokuroria në këtë rast ska lënë gur pa lëvizur, ku investoi shumë prokuroria për të gjetur “një fije floku” të lidhjes në mes A.B por përsëri dështim, asgjë e përbashkët, asnjë lidhje mes tyre, asnjë bisedë, asnjë takim, asnjë kontakt, asnjë premtim, asnjë shpërblim e asgjë të vetme.

Po ashtu përgjatë fjalës përfundimtare e njëjta është ndalur tek pjesa e motivit të S, sepse sipas saj këtu do flitet vetëm për motiv e jo për prova. Fillimisht Prokuroria pretendon që ka dëshmi që E.S ka pasur urrejte për T.R e që përkatësisht është bërë fjalë për një ndodhi të vitit 2000 apo 2001 që nuk dihet saktë viti kur i ndjeri është kërcënuar me granat dore nga i akuzuari dhe që bashkë me të ndjerin ka qenë edhe një polic ndërkombëtar i UNMIK-ut, ndërsa për këtë ngjarje ska asnjë raport zyrtar, asnjë rast i paraqitur në polici, vetëm fjalë goje, e pastaj përcjelllet të cilat kanë ndodhur kinse nga i pandehuri dhe miqtë të tij, dhe se duhet të shikohet me vëmendje se prokuroria posedon dëshmi të pakontestueshme, dëshmi të V.R, ku i njëjti tregon për një rast që kinse i pandehuri i ka përcjell me makinë të blinduar rrugës në V.. autostradës për Shkup, e tutje edhe rastet që i ndjeri i ka paraqit siç është prita në S, djegia e makinës, vrasja e qenit dhe të gjitha raste që i kishte paraqitur në polici, të gjitha janë raste të paraqitura ndaj NN personave, raste të pazgjdhura dhe të pasqaruara, andaj nuk janë prova relevante.

Tutje në vazhden e motiveve, motivi i dytë, rasti i Ferizajit e që akterët kryesor të këtij incidenti B.H dhe Sh.Q janë dëgjuar edhe si dëshmitarë, e që lidhur me dëshminë e tyre i ka bojkotuar sepse dëshmia e tyre sipas saj është pa vlerë dhe se nuk ka asnjë nuancë objektiviteti. E lidhur me këtë rast as B. H as Sh.Q asnjë pjesëmarrës tjetër të njësisë speciale të përfshirë në këtë incident nuk u vra. E.S nuk u hakmorr dhe disa vite më vonë, ky incident i atribuohet të akuzuarit Enver si motiv për vrasjen e T.R

Motiv tjetër është edhe S.Casino dhe kinse A.I, e që ky rast është ende si rast i pagjykuar ku E.S akuzohet për pjesëmarrje në rrahje edhe pse ishte i rrahur dhe i dëmtuar. Edhe atëherë edhe sot E.S nuk e ka shfajësuar të ndjerin nga pjesëmarrja e tij në rrahje ndaj të akuzuarit, porse gjithnjë ka theksuar se incidentin e ka filluar dhe shkaktuar A.S, dhe se i ndjeri T.R e ka goditur atë. Prokuroria qëllimisht i jep konotacion tjetër deklaramit të S. kur i njëjt ka deklaruar se “Fati në fatkeqësi që unë isha prapa stubit ku më goditi T.R, sepse sikur të kisha qenë në ndonjë vend tjetër në atë hapësirë, sigurisht se do të mund edhe të vritesha”, ky deklarim nuk e ka kuptimin e lavdërimit të të ndjerit nga ana e të akuzuarit por është vetëm një spjegim real dhe i sinqertë i asaj se çfarë kishte ndodhur në S. Casino. E që nuk është kontestuese se E.S dhe shoqëria e tij kishin shkuar në S.Casino, e nuk është kontestuese se duke dalur nga Casinoja, A.B dhe A.S janë

ndeshur dhe fillojnë të përleshën dhe aty e tutje vazhdohet edhe me shkrepje të armëve, po përsëri E.S pa e goditur askënd, pëson lëndime nga A.S dhe T.R dhe askush nga shoqëruesit e tyre e as A.S e as T.R për dy vite me rradhë deri në vitin 2007 nuk vriten. Dhe fakti se A.S është larguar nga Kosova, mbrojtësja ka shtuar se trupi gjykues nuk duhet të bie në lajthim se i njëjti ka ikur për shkak të frikës nga E.S sepse në këtu jemi mësuar që në të kaluarën, çdokush që ka vendosur të ik nga Kosova për një jetë më të mirë në përendim, ka shfrytëzuar adute dhe arsyetime të ndryshme e që është e kuptueshme që është larguar nga Kosova për qëllime të veta personale e që për këto vite atij largimi i është dhënë një kahje tjetër.

Sa i përket A.I si copëz e mozaikut lidhur me rastin e S. Casinos, nëse A. ka qenë motiv shtesë, si lloj xhelozje nga ana e S, ju keni lexuar deklaratimet e familjarëve të A, por edhe vet të saja, se pas lidhjes me E.S dhe para lidhjes me të ndjerin, në jetën e saj kishte ekzsituuar një person tjetër i njohur në shkresat e lëndës, të cilit kurr si kishte ndodhur asgjë. Prokuroria pretendon se e njëjta ka vuajtur shumë nga ana e të akuzuarit e që keni parë edhe prova materiale dhe janë dëgjuar dëshmitarë të prokurorisë madje edhe vetë A.I, se një gjë e tillë nuk ka ndodhur asnjëherë. Familja I. qysh në vitin 2007 kanë deklaruar se të gjitha ishin të pavërteta, të njëjtit i kanë përsëritur edhe në gjykatore në gjykimin e kaluar dhe ato janë konstatuar si të lexuara. M.I nëna e A. përgjatë deklaratimit të saj një fjali e cila sipas saj është majftë domethënëse është ajo që ka deklaruar “sikur të kisha pasur probleme me këtë këtu, duke u drejtuar me dorë nga i akuzuari E.S, këtë do ta kisha rahatuar me dy duar të mija, por çka tju bëjë atyre me grada” e ku pikërisht at ditë të njëjtës i ishin thyer xhamat e makinës. Po ashtu edhe deklaratat e motrave të A, përkatësisht E.I e cila sinqerisht ka treguar verzionin e saj ndaj të akuzuarit E.S si të përzgjedhur të motrës së saj për të dashur, por siç ka thënë e njëjta asnjëherë nuk kanë pasur probleme me të personalisht, e po ashtu edhe Z.I e cila ka treguar për raportet e saja me motrën A. dhe familjes në përgjithësi për gjendjen financiare dhe për mosnjohurinë e saj se A.ka vuajtur nga i akuzuari. Kujtojeni pendesën dhe një formë turpin e A.I për njohurinë e saj me të akuzuarin para 10 viteve kur ajo ishte fare e re, por kujtojeni edhe ironizimin e saj rreth zhvatjes dhe kinse ndihmës apo mbrotjes se ajo kishte kërkuar nga tani i ndjeri. Kujtojeni se e njëjta para jush ka deklaruar se ajo para 9 viteve kishte menduar se e kishte njohur mirë të dashurin e saj tani të ndjerin T.R, porse gjatë këtyre viteve ajo kishte kuptuar shumë e shumë gjëra dhe të vërteta të cilat nuk dashti ti shpalos para trupit gjykues të kaluar.

Në fjalën përfundimtare ka shtuar se pika I dhe II e aktakuzës fillimisht sipas prokurorisë janë të ndërlidhura në mes vete, sepse supozohej se për shkak të zhvatjes ndaj A.I, paraqitet në jetën e saj i ndjeri T.R, po tani, meqë pika II respektivisht zhvatja e detyrimi nuk ekzistojnë më atëherë çfarë po ndodh me pikën I pra ata të nxitjes, ku do e gjen mbështetjen kjo vepër pasi që tani nuk ekziston ajo kinse i’ a shtronte rrugën. Në gjykim A me motrat e saj dhe nënën nuk doli asnjëherë asgjë nga dëshmitë e tyre se A kishte kërkuar ndihmë nga i ndjeri për ta mbrojtur nga S, kur e njëjta kishte pasur të angazhuar sigurimin personal, pse i ndjeri T.R kishte ra në kontakt njëherë me E.I të cilën e kishte njohur më herët dhe përmes saj kishte arritur tek A, sepse A.asnjëherë nuk kishte kërkuar ndihmë nga i ndjeri apo kushdo tjetër, por se, i ndjeri për arsye personale-emocionale i ishte afruar A, kinse me atë preteks, në fakt ajo kishte një lloj vardisje apo preteksi i një të riu për të ndërtuar raport me një femër të parapëlqyer. Ajo edhe para 9 viteve por edhe në gjykimin e kaluar ka deklaruar se një gjë e tillë i’ a kishte thënë tani i ndjeri T. sikurse që e nxjerr nga konteskti prokuori fjalinë “mos u kthe, mos provoko, janë pas nesh” dhe “a po e sheh këtë, ky është Rr”, por shtrohet pyetja a ka pasur nevojë që i ndjeri t’i tregojë A,qoftë të akuzuarin, qoftë këdo nga familja e tij, kur ajo më herët se të ndjerin i kishte njohur ata, pastaj përse ata të dy së bashku si një çift në lidhje, nuk kishin bërë asnjëherë të vetmë një ankesë apo paraqitje zyrtare në stacion policor se ndjeheshin të kërcënuar, se janë të përcjellur dhe se thjeshtë po i bezdisnin, sepse kjo ska ndodh fare. Mbrojtja qysh në fillim ka qenë e bindur se edhe vetë

prokurori i rasis në esencë ka qenë i vetëdijshëm se një storie e tillë është e pakapshme, por ajo pika II- zhatja është sajuar vetëm e vetëm për të pasur një lidhje kinse edhe një motiv të quajtur A, e cila do të përputhej bukur me motivin e nxitjes për vrasjen e të ndjerit T.R ku e njëjta ka treguar një detaj se pas vrasjes të tani të ndjerit T, banesa e saj ka qenë e shëndrruar në taki selimesh të B.H dhe shokëve të tij pothuajse mezi kishin pritur që të vritet T. R dhe t'ia ngushëllonin të dashurën dhe familjen e saj.

Prandaj për të përmbledhur dëshmitarët e prokurorisë A, M, Z, dhe E.I pastaj B.M të cilat pastën rastin të dëgjoheshin drejtpërsëdrejti, pataj lexoni deklaratën e F.M, sikurse edhe të dëmtuarës – dëshmitarës A, rastësisht të gjitha femra, janë dëshmitare vërtetë të frikësuar, kërcënuara dhe maltretuara ashtu siç kanë deklaruar ato drejtpërsëdrejti, sepse sipas deklarimeve të tyre, këto u'a kishte shkaktuar ish hetuesi B.O, këtë nuk e ka shpikur mbrojtja, këto janë prova të referuara nga prokurori i rastit (shih procesverbalet e shqyrtimit kryesor të gjykimit të A.B në dosjen XIV). Ndërsa lidhur me dëshmitarët ka shtuar se të lartpërmendurit kanë qenë dëshmitarë të prokurorisë, e që mbrojtja ka pasur fare pak dëshmitarë e një numër i dëshmitarëve janë ftuar ex officio meqë trupi gjykues i kaluar ka konsideruar si të nevojshme një gjë të tillë, e që të themi se që të gjithë dëshmitarët e mbrojtjes kanë gënjyer siç pretendonte prokurori i kaluar mu me këtë shprehje, të themi se dëshmitarët e ftuar ex officio kanë gënjyer këtu para jush, por çka ka rezultuar me dëshmitarët e prokurorisë, edhe ata rezultuan sipas prokurori të rastit të kenë gënjyer këtu në gjykatore dhe përfundimisht çfarë mbeti nga gjith ai arsenal provash të prokurorisë sipas të cilave prokurori pretendon se ka arritur të argumentoj besueshmërinë e aktakuzës.

Përgjatë fjalës përfundimtare e njëjta ka vazhduar me analizën dhe elaborimin e provave materiale dhe një personale për të cilat Gjykata e Apelit ka dhënë vërejtje dhe sugjerimet e saj që janë bastisja e lokalit S. hartografitë dhe dëshmitari D2.

Lidhur me Bastisjen e Lokalit Bar “ S” marr parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e njohura, të cilat janë konstatuar lidhur me bastisjen e këtij lokali e që janë theksuar disa herë nga ana e mbrojtjes edhe gjatë gjykimit të parë edhe në rigjykim, duke kërkuar shumë herë përjashtimin - veçimin e këtyre provave të konfiskuara gjatë bastisjes si prova të paligjshme dhe të papranueshme në këtë procedurë penale, sipas bindjes së mbrojtjes, janë rrethanat kryesore dhe fakte që dëshmojnë se bastisja në lokalin Bar S” më datën 30.08.2007 është kryer pa urdhër të Gjykatës dhe në kundërshtim me Konventën Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KPPRK-së. Nuk ka urdhër me shkrim në shkresa të lëndës e madje policia dhe prokurori nuk deklarojnë që ai ndonjë herë është dhënë, e që prokurori në këtë procedurë deklaroi që është dhënë urdhri verbal nga ana e gjyqtarës së procedurës paraprake D.H e cila atëherë ishte në detyrë, por asaj nuk i kujtohet asnjë urdhëresë verbale për bastisjen konkrete. Po ashtu edhe prokurori kujdestar O.M nuk dinte asgjë lidhur me këtë urdhëresë, respektivisht se gjyqtarës D.H i është dhënë propozim për dhënien e urdhërit verbal dhe më tij shënimet për urdhërin verbal të Gjykatës nuk ekzistojnë në asnjë dokument formal në shkresat e lëndës. Aq më tepër, dëshmitarja D.H qartë dhe saktë ka dëshmuar se nëse ajo do të jepte urdhër verbal për bastisje, atëherë në shkresë do të duhej të ekzistonte raporti policor në bazë të të cilit gjykata në mënyrë retroaktive do ta vërtetonte ligjshmërinë e kryerjes së bastisjes në bazë të urdhërit verbal, i cili do të duhej t'i dorëzohej gjykatës në afat prej 12 orësh pas bastisjes, se që kështu kërkohet decidivisht në bazë të nenit 245.6 të KPPRK-së i cili ka qenë në fuqi në kohën e kësaj bastisjes.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 36 paragrafin e 2 qartë e përcakton se kontrolla e çdo banese apo hapsire private e domosdoshme për kryerjen e hetimeve rreth krimeve mund të bëhet vetëm sipas shkallës së paraparë dhe vetëm në bazë të vendimit gjyqësorë pas sqarimit të arsyes për ndërrmarjen e asaj kontrole. Largimi nga kjo rregull është e lejuar vetëm nëse është

i nevojshëm lidhur me arrestimin ligjor të kryesit të veprës penale, mbledhjen e dëshmime të cilat mund të humben më rast të evitimit të rrezikshmërisë serioze dhe të atëçashtme për njerëz dhe pasuri të përshkruara me ligj, e që gjykata është e obliguar t'i lejoj këto veprime në mënyrë retroaktive. Ndërsa bastisja në lokalin Bar S'' është kryer në mënyrë eklatante të kundërligjshme, prandaj edhe aktgjykimi i atakuar nuk mund të bazohet në asnjë dëshmi të konfiskuar në atë mënyrë. Në këtë mënyrë është shkelur edhe neni 111 i KPPRK-së i cili e definon se dëshmitë e konfiskuara në këtë lloj bastisje nuk mund të shfrytëzohen në rastet e mëtejme'' 1.1 Dëshmitë e marra gjatë kontrollës pa leje të Gjykatës, janë të papranueshme nëse kontrolla nuk merr pëlqimin gjyqësor retroaktiv në përputhje me dispozitat kushtetuese, dhe 1.2 Bastisja e ndërrmarë pa urdhëresë të gjyqtarit përkatës paraqet shkelje të dispozitave të këtij ligji, e po ashtu neni 257 i KPPK-së përmban edhe rregullat e përgjithshme të prezantimit të dëshmime: 1.Rregullat e prezantimit të dëshmime të theksuara në këtë dispozitë ligjore, aplikohen në të gjitha procedurat penale para gjyqtës edhe kur janë të rregulluara me këtë ligj në procedurat para prokurorit shtetërorë dhe policisë, 2.Dëshmitë e mbledhura me shkeljen e dispozitave të procedurës penale nuk janë të pranueshme kur këto decidivisht i përshkruan ky ligj ose dispozitat tjera ligjore, dhe 3.Gjykata nuk mundet vendimin e vet ta bazojë në dëshmitë e papranueshme. Po ashtu mbrojtja edhe më herët dhe në këtë gjykim përsëri se janë shkelur edhe dispozitat tjera të KPPRK-së të cilat i përcaktojnë kushtet për ligjshmëri të bastisjes dhe lidhur me këtë çështje mbrojtja i ka propozuar kolegjit penale të lexojë parashtresën – kërkesën për përjashtimin e dëshmime të datës 18.05.2015 të cilat duhet që të konsiderohen si pjesë përbërse në fjalën përfundimtare dhe kërkesë e përsëritur për përjashtimin e të gjitha dëshmime të marra më rastin e bastisjes në Bar S'', e që në kërkesë detajisht janë përcaktuar shkeljet e nenit 107.1 KPPRK-së dhe nenit 111, pika 1.6 të KPPRK-së dhe shkelje nga neni 111 pika 1.2 të KPPRK-së. Me këtë mbrojtja thekson se nuk ka asnjë arsytim apo përgjigje në argumentet e mbrojtjes së gjatë bastisjes, dëshmitarët nuk kanë qenë në gjendje ta kontrollojnë bastisjen, se bastisja ka filluar më herët se sa fillimi i evidentuar formalisht, që policia ka qenë në Bar S'' shumë kohë vetëm, pa prezencë të dëshmitarëve, që pronarit nuk i'u është garantuar e drejta për prezencë të avokatit, që me dëshmi nuk është vepruar në përputhje me ligjin e kështu me rradhë.

Sa i përket pranimit dhe vlerës dëshmuese të dokumenteve të PTK-së përkatësisht relevanca e të dhënave hartografike ka shtuar se këtu në fakt fare nuk është fjala për zbatimin e nenit 87 të KPK-së apo përgjimin e telefonave mobil në numrat siç theksohet në urdhëresën e Gjykatës së Eulexit të vitit 2015, por për të dhënat dhe lokacionin e telefonave në bazë të të cilave është bërë hartografia apo (trekëndëzimi) i cili kinse, vërteton rrjedhën e ngjarjes më datën 30.08.2007. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligji i cili është në fuqi, decidivisht e përcakton kufizimin kohor dhe gjatësinë e mbajtjes së të dhënave, që kanë të bëjnë me të dhënat dhe lokacionin apo lëvizjen e pajiseve telekomunikuese – dmth edhe në të ashtuquajturat Meta të dhënat, sipas kësaj gjerë më tani gjykata e shkallës së parë dy herë ka shkelur nenin 68 të Ligjit për Komunikime Elektronike në lidhje me nenin 104 të Ligjit në fjalë dhe në bazë të saj është shkelur edhe neni 36 paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili garanton të drejtën në mbrojtje të të dhënave personale. Jashtë çdo dyshimi mund të konsatohet se mbajtja e Meta të dhënave për lokacionin e telefonave mobil për datën 30.08.2007 në kohën kur gjykata e Eulexit ka urdhëruar PTK-në që ato të dhëna t'ia dorëzojë policisë për përpunimin e trekëndëzimit apo hartografisë ka qenë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 68 lidhur me nenin 104 të Ligjit për Komunikimet Elektronike, i cili ligj ka hy në fuqi në Janar të vitit 2013 dhe i cili ka lejuar mbajtjes-ruajtjen e këtyre të dhënave jo më shumë se 1 vit që nga momenti kur janë nxjerrë 0 do të thotë të gjitha Meta të dhënat nga viti 2007 nëse kanë mundur të ekzistojë ende në 2015 në bazë të dëshmime të zyrtarëve të PTK-së edhe fizikisht ka qenë e pamundur të sigurohen, sepse ato është dashtë të jenë të shkatërruara apo të fshira nga baza e të dhënave më së voni në Janar të vitit 2014.

Çdo ruajtje e të dhënave më gjatë se një vit, është e kundërligjshme konform nenit 257 të KPPRP-së dhe kjo dispozitë qartë e përcakton se provat e nxjerra me shkeljen e dispozitave të procedurës penale nuk janë të pranueshme dhe se gjykata nuk mundet vendimin e vet ta bazoj në prova të papranueshme. Më tutje provat për të cilat është fjala, jo vetëm që janë të papranueshme sepse janë të paligjshme por janë edhe plotësisht jo kredibile – të pabesueshme, parashtrohet pyetja prej nga vijnë këto të dhëna në fakt, prej nga e kanë prejardhjen, sepse dëshmitarët -punëtorët e PTK-së janë dëgjuar në këtë procedurë penale dhe gjatë shqyrtimit kryesor, në mes tjerash kanë deklaruar se në bazën e të dhënave ka mundësi të mbaj të dhënat vetëm tre muaj.

Sa i përket dëshmitarit D2 i njëjti e ka gënjyer gjykatën kinse 19 ditë pas ngjarjes kritike, ai ka shkuar vullnetarisht në polici për të dhënë deklaratë vullnetare lidhur me ngjarjen kritike. Ky pretendim i mbrojtjes vërtetohet me faktin se në bazë të raporti policor të M.K, rezulton se policia e kishte zbuluar dhe kontaktuar këtë dëshmitarë më datën 3 Shtator 2007, por asokohe ishte e qartë se ky dëshmitar nuk dinte asgjë me relevancë rreth rastit. Në raportin policor përmbledhës të datës 6 Dhjetor 2007, policia kishte paraqitur Drejtorisë për Krime Serioze analizën e tyre duke përfshirë 9 deklaratata me shkrim të 9 të dyshuarve, 23 deklaratata të dëshmitarëve dhe dy deklaratata të dëshmitarëve të mbrojtur me kodet D1 dhe D3, shtrohet pyetja përse këtu nuk ishte përfshirë dëshmitari D2, nëse do të ishte me relevancë deklaratata e tij 19 ditë pas ngjarjes kritike. Tjetra sikurse ky dëshmitar të ishte i vërtetë dhe të ekzistone kjo sajese e tij si një deklaratë e vërtetë qysh në vitin 2007, atëherë shtrohet pyetja, përse ky dëshmitar dhe dëshmia e tij pra, nuk u propozuan nga prokurori i parë R.M në gjykimin kundër A.B dhe më tutje Rr.A deklarata apo ky dëshmitarë as që ka ekzistuar në shkresat e lëndës të njërit apo tjetrit të akuzuar, respektivisht të dënuar.

Ndërsa dëgjimi i dëshmitarit M.K gjatë gjykimit 2015, konfirmon këtë konkluzion; B.P - Zotëri K. sikurse dëshmitari D2 të kishte deklaruar në shtator 2007 kur edhe keni intervistuar se ai kishte qenë prezent në lokalin S. kur i kishte parë personat që kanë marrë pjesë në vrasje duke hy në zyrën e E.S dhe se kishte dëgjuar E. duke ju dhënë urdhëra si të veprojnë si dhe si ai i kishte parë armët e gjata në qese të zeza duke i bartur për tu kryer aksioni, a do ta kishit kosntatuar ju këtë në raportin tuaj policor si dhe në deklaratën e këtij dëshmitari dhe a do të konsideronit të rëndësishme një deklaratë të tillë?, ku dëshmitari ka deklaruar se: po, natyrisht sepse kjo do të ishte shumë e rëndësishme. Po ashtu trupi gjykues u' a rikujtoj shkurt lidhur me një rrethanë tepër me rëndësi nga deklaratata e dëshmitarit D2, "D2... ishte ora 14:00 apo 14:10 kur dëgjova se polici T.R është vra, dhe kjo është arsyeja se përse unë paraqita për të dëshmuar, sepse ishte vra një polic i mirë i Kosovës". Përse ky dëshmitar nuk e paralajmëroi këtë para se të ndodhte? Madje kishte mundur edhe ta parandalonte pra, e më pastaj përse ai nuk e raportoj në deklaratën e tij të 19 Shtatorit 2007, natyrisht e vërteta është se dëshmitari D2 nuk ka parë asgjë nga ato që ai ka sajuar 8 vite më vonë. Tutje dëshmitari D2 fillimisht ishte deklaruar se ditën kritike kishte shkuar në punë në ora 7, më vonë gjatë gjykimit kishte deklaruar se ka shkuar në punë në ora 8, natyrisht mbrojtja e ka pasur të ndaluar ta sfidoj në këtë drejtim për të mos e bërë njohur se ku kishte qenë vendi i tij i punës, më tutje ai kishte deklaruar se lokali S. ishte i hapur në ora 7, ndërkaq që të gjithë dëshmitarët kanë deklaruar se lokali S. asnjëherë nuk është hapur para orës 8 e 30 apo 9. Më tutje kishte deklaruar se ishte F.A ai i cili në paraditën e ditës kritike i kishte parkuar dhe rregulluar veturat në parkingun e lokalit S., gjersa nga shkresat e lëndës është vërtetuar se F.A ishte paraqitur në lokalin S. atë ditë në orët e pasditës, respektivisht në orarin e pasditës, e që tutje D2 kishte deklaruar se ai e kishte pa A.B duke vozitur veturat Pick up të bardhë dhe të kuqe. D2 e kishte gënjyer gjykatën, sepse së pari, A.B nuk ka punuar fare për "B. Kafe", pastaj, A.B nuk ka poseduar fare leje të vozitjes dhe e treta se është se deklarimi i D2 se kinse A.B e ka vozitur Pick up të bardhë, kjo u demantua me dokumentin-dudin doganor si provë materiale i cili dokument gjendet në shkrsat e lëndës dhe i cili ka vëretuar se kjo veturë është sjellë nga Italia në Kosovë më datën 16 tetor 2007, në kohën kur A.B veç ishte në paraburgim për një muaj e

gjysëm dhe këtë e ka vërtetuar edhe hetuesi M.K se me rastin e konfiskimit është konfiskuar vetëm Pick Up i kuq. Argumenti tjetër i cili e demanton tërësisht deklarin e rrejshëm të këtij dëshmitari është edhe rrethana lidhur me armët e gjata të cilat kinse ai i kishte pa ditën kritike, para dhe pas ngjarjes dhe në pyetjen e mbrojtjes se përse këtë nuk i'a ka deklaruar policisë, përgjigja ishte nuk më ka ra në mend, dhe nuk ka çka të flitet më tepër për këtë dëshmitarë dhe dëshmitë e tij. Do të ishte shokuese nëse trupi gjykues do të mund t'i besonte një sajese të tillë aq qesharake dhe sureale.

Tutje në fjalën përfundimtare ka shtuar se pason elaborimi edhe i dy dëshmime – provave personale, njëra e pikur nga qielli pas 17 vitesh dhe tjetra e imponuar si pasojë e kësaj të parës.

Lidhur me dëshminë e A.S ka shtuar se i njëjti i apostrofuat si shok i ngushtë i fëmijërisë së tani të ndjerit T.R dhe bashkëpjesëmarrës në rastin e quajtur S. Casino, rast ky që kishte ndodhur 2 vite para se të vritej tani i ndjeri T.R, rasti ky i cili për ato dy vite, as që kishte arritur të fillonte ndonjë procedurë gjyqësore për të. Normalisht të pyesni palën e dëmtuar, do të thoshte se kjo ka ndodhur për shkak të ndikimit aq të lartë që tani i akuzuari E.S ka pasur në organet e drejtësisë, por nëse do të pyesni të akuzuarin E, kur ai ishte vetëm i dëmtuar në këtë incident apo përlëshje, do të thoshte diçka tjetër se me këtë rast ku ai ka qenë i dëmtuar nuk është marr askush sepse ai ka qenë i dëmtuar, ai ka qenë viktimë, prandaj nuk është marrë askush, rikurse nuk është marr askush me 7 atentatet kundër tij. E as i ndjeri T, aq më pak dëshmitari A.S nuk kanë qenë të interesuar më tepër se i akuzuari E që kjo çështje penale të shkonte deri në fund dhe të merrte epilog dhe të vërtetohej në tërësi jo vetëm se çfarë vërtetë kishte ndodhur në S. Casino, por edhe atë çfarë kishte ndodhur pas S. Casinos, çfarë kishte ndodhur në spital ku kishte qëndruar i akuzuari për dy jave, si ishte sjellur një grup i policëve me avokatin e tij mbrojtës M.S, me prokurorin e rastit atëkohë S.K, e shumë e shumë gjëra tjera të cilat sot as me mend nuk mund t'i merrni. Dëshmitari A.S, u'a rikujtoj si erdhi tek propozimi i tij si dëshmitar ne shprehemi figurativisht në 1 minut në 12, 17 vite pas vrasjes së tani të ndjerit T.R dhe 19 vite pas S.Casinos. Ku ish prokurori në këtë çështje i cili përfaqësoi aktakuzën vetëm për 3 seanca gjyqësore, kur pritej të jepej fjala përfundimtare propozon në cilësi dëshmitarin A.S e në po të njëjtën seancë gjyqësore i dëmtuari këtu babai i të ndjerit T.R, deklaroi-citat "A.S vullnetarisht është lajmëru te djali im V. për të dëshmuar", i njëjti për 17 vite po frigohet por tani nuk frigohet ka vendos të dëshmojë, dëshmitari përgjatë deklarinimit të tij kur po flasim në kontekst të frikës, kujtojeni deklaratën e tij që deklaroi madje me shumë trimëri dhe i indinjuar e hidhëruar se përse askush, kurrë, për 17 vite nuk e kishte kontaktuar e as ftuar për të dëshmuar diçka lidhur me rastin e vrasjes të tani të ndjerit T.R, 6 prokuror vendor dhe ndërkombëtar nuk e kishin pa jo vetëm relevante, por as të arsyeshme apo të logjikshme që A.S ta dëgjonin për 2 dekada si dëshmitar. I kishin intervistuar dhjetra shok të të ndjerit T, lidhje e palidhje, por nuk e kishin pa relevante që të sigurinën dëshminë e A.S, shok i ngushtë i të ndjerit, shkollës dhe punës, shoku i ngushtë i cili, nuk e di se kush i'a ka vra shokun e ngushtë, i cili e kishte shoqëru në fëmijëri, shkollim e punë si polic. Shoku i ngushtë me të cilin kishin nda të mirën dhe të keqen sikurse kishte deklaruar ky dëshmitarë. Por, fatkeqsisht, nuk i'a din emrin dhe nuk e din as kush është vrasësi i tani të ndjerit. Sa i përket kësaj dëshmie ka shtuar se nuk do ta elaboron në detaje, sepse është vërtetë zhgënjyese t'i besohet dhe kushtohet analizë e thellë deklarinimit të tij, do ta përmbledh në pikat kryesore të cilat dëshmojnë se i njëjti jo vetëm që nuk është dëshmitarë okular e as i tërthortë, porse i njëjti nuk i din as në vija të trasha detajet e vrasjes së shokut të tij të ngushtë. A. nuk ka njohuri se një A. tjetër, të cilit fare lehtë e ka pas që t'ia mbaj mend emrin, pasi e kanë të njëjtë, nuk di se kush e ka vra T., por e din se kush e ka orkestru vrasjen. Ai nuk e din se kur si dhe në ç'farë mënyre E. e ka shtyt A.B për ta vvarë të ndjerin, por ai përgjigjet kështu – citat "Po është e lehtë me kuptu, duke filluar prej të gjitha atyre incidenceteve të cilat i përmenda më herët, kërcënimeve të cilat nuk mund t'i dokumentoj për momentin, duke e kuptuar se T. ka qenë shumë i dashur për

krejt Prishtinën, përveç grupeve që e kanë thyer ligjin, duke u bazuar në mbledhjen e cila është mbajtur enkas për këtë punë, që personi e ka pohuar që është duke planifikuar me e vra A. dhe T. dhe me u largu për një kohë prej K Një grup kriminal e din, pra ky këtu ka pasur edhe grupe tjera kriminale, për të cilat unë nuk kam mbajtur shënime, por besoj që Prokuroria dhe Policia e Kosovës i kanë këto të dhëna”, e përmend një mbledhje me z.M.Sh, të cilit i referohet si shef i zyrës operative, i njëjti ishte pjesëtar i policisë së UNMIK-ut e që në fakt nuk ishte fare mbledhje, por ishte një takim jozyrtar, ku A.S dhe i ndjeri T, kishin kërkuar takim për të kërkuar i ndjeri armë M5. A.S as nuk i kujtohet kush tjetër ka marrë pjesë në takim (sepse nuk ka marrë pjesë askush tjetër), nuk i kujtohet se kush u’ka ka mundësuar atë takim, vetëm e di se përmes Shefit të Hetimeve Regjinale të Prishtinës. Pjesa më ironike për të mos thënë më qesharake, që ky dëshmitar deklaroi është se ky Z.Sht. i njofton se e kanë përgjuar E.S dhe e kanë dëgjuar duke thënë se do t’i vras dhe as nuk e arrestojnë policia e UNMIK-ut për një kërcënim kaq serioz, as nuk janë siguruar kurr këto përgjime, por e tëra që ky Shtofman ka bërë ka qenë propozimi që A dhe i ndjeri të ndërrojnë vendbanim.

Po ashtu përgjatë deklaratimit të tij i njëjti i referohet dhe shërbehet madje, duke u lejuar nga trupi gjykues me një deklaratë të tij të dhënë në Amerikë në vitin 2008, nga hetuesi amerikan M.MMen i cili sipas tij kishte ardhur apostafat për të marr deklaratën e A. lidhur me këtë rast. A.polic elitar, nuk e din as numrin e rastit dhe asgjë lidhur me këtë deklaratë që e ka dhënë kinse apostafat për këtë rast. I pyetur se a ka dëgjuar ndonjëherë se E.S është paraqitur vullnetarisht për tu pastruar me këtë akuzë ndaj tij dhe shikoni përgjigjet “Kam dëgjuar se është dënua me 37 vjet dhe se aty ka përfunduar gjithçka”, pra nga viti 2007 e deri kur çështja është kthyer në rigjykim për herë të tretë, e që A.S ka menduar për herë të dytë, ai nuk e ka pa të arsyeshme as të lajmërohet tek organet e drejtësisë për të kërkuar të dëshmoj, as nuk e ka kontaktuar familjen e të ndjerit-shokut të ngushtë, asnjë interesim të vetë. Por, kur tani pas 17 viteve, ka kuptuar se ka rreziku që drejtësia të vihet në vend për E.S, ose më mirë të shprehem, kur i kanë thënë o hajde se akuza ka gjasa me ra se nuk ka prova, supermeni shpëtimtarë i akuzës pas 17 viteve në 1 minut pa 12, vendos që me një të pavërtetë, të mjerë, të varfër dhe absolut të pabesueshme, të mundohet t’i jap disi mbështetje akuzës dhe të lahet apo pastrohet moralisht para familjes së tani të ndjerit T. të cilët për 19 vite e kishin akuzuar për tradhëti shoqërore sipas tyre.

Dhe si pasojë e këtij dëshmitari të opstruktuar, nëse e keni mbajt në mend, menjëherë në sekondat e parë të propozimit të dëgjimit të A.S si dëshmitar, mbrojtja në po të njëjtën seancë ka propozuar dëshmitarin Gj.K, për të cilin i akuzuari dhe mbrojtja ka qenë në dijeni për 19 vite, por se, ky dëshmitarë ka qenë i nevojshëm për rastin e “S.Cainos”, për çka A.S e kishte filluar incidentit me A.B. Relevanca e dëshmisë së këtij dëshmitari, qëndron vetëm lidhur me një rrethanë, se i njëjti demanton tërësisht deklaratën e A.S, e njëjta ka shtuar se nuk do t’i përsërisë ato që veç i keni dëgjuar drejtpërsërdrejt, e tëra që ju duhet të krahasoni deklaratën e A. me këtë të Gj. A.deklaron se rastin e kishin të montuar, respektivisht se kishin rënë në kurthë të E. me shoqëri, ndërsa që vet deklaroi se E. ishte duke dal nga kazino. gjersa A. me të ndjerin ishin duke hy në kazino. Pra kjo paska qenë kurtha? E kishte qenë shumë kohë para se A. dhe i ndjeri të vinin në Kazino, ai veç po e lëshonte kazinon kur këta po hynin në kazino, dhe sipas A, E.i e paska prek me krah të ndjerin. A qenka bërë kijamet a edhe nëse ka ndodh kështu? A. kishte filluar i pari përleshjen dhe për këtë është plagos nga A.B e jo E. E kishin rrahur keq, a ishte kjo sjellje e policëve elitar profesional, a mund të cilësohet kështu pra, dhe pikërisht pse A.S e kishte filluar këtë incident është pika ku A. sot mundohet ta laj apo pastron disi borxhin moral ndaj familjes së T. të ndjerë. Sepse, incidenti në “ S.Casino” nga akuzatori ngarkohet kinse si motivi i E.S për kinse dëshirën e tij për ta privuar tani të ndjerin T, kjo është pika e dobët dhe ndërjegjja e A.S dhe mllefi i të dëmtuarit Sh.dhe ish kolegëve ndaj A. Ku A. dhe i ndjeri kishin dërguar Gj.K si ndërmjetësues për t’i kërkuar falje dhe pajtesë E.. Dy policë elitarë të cilët zyrtarisht deklarojnë se ishte E. ai i cili e kishte planifikuar dhe filluar sulmin ndaj tyre, ndërkaq që privatisht e dërgojnë Gj.K që t’i kërkojë falje dhe pjesë në emër të tyre dhe fakti më i rëndësishëm për të

cilin Gj.K dëshmojë për këtë rrethanë ishte: Gj.K, kishte shkuar tek E.S i ishte përgjigjur “Gj, si i fala si nuk i fata ata janë shtet dhe si shtet ma kan bo dhe une shtet kom me i ndjek”, pra E.S nuk i’a kishte falur “shtetit” dhe këtij “shteti” pretendon ti përgjigjej me “shtet”, pra me organe të drejtësisë dhe me një proces dhe fer dhe të drejtë gjyqësorë, të cilin nuk arriti kurr ta realizonte.

I akuzuari E.S në fjalën e tij përfundimtare ishte deklaruar :se mbështet në tërësi fjalën e avokates së tij.

VLERËSIMI I PROVAVE

Gjykata në vazhdim do të analizoj secilën provë si vijon:

Provat personale dhe materiale

1.Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – Sh.R

2.Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit – V.R

3.Dëshmia e dëshmitarit – G.H

4.Dëshmia e dëshmitarit – B.Sh

5.Dëshmia e dëshmitarit-B.H

6.Dëshmia e dëshmitarit – F.Sh

7.Dëshmia e dëshmitarit-Sh.Q

8.Dëshmia e dëshmitares – B.M

9.Dëshmia e dëshmitarit – M.K

10.Dëshmia e dëshmitarit – F.G

11.Dëshmia e dëshmitarit – L.M

12.Dëshmia e dëshmitares – D.H

13. Dëshmia e dëshmitares – K.B

14. Dëshmia e dëshmitarit –Xh.B

15. Dëshmia e dëshmitarit –O.M

16. Dëshmia e dëshmitarit –N.R

17. Dëshmia e dëshmitares – A.I

18. Dëshmia e dëshmitares – E.I

19. Dëshmia e dëshmitares –Z.I

20. Dëshmia e dëshmitarit –A.B

21. Dëshmia e dëshmitarit –D2

22. Dëshmia e dëshmitarit –B.M

23. Dëshmia e dëshmitarit –A.H

24. Dëshmia e dëshmitarit –R.B

25. Dëshmia e dëshmitarit –A.D

26. Dëshmia e dëshmitarit –F.A

27. Dëshmia e dëshmitarit –J.T

28. Dëshmia e dëshmitares-M.I

29. Dëshmia e dëshmitarit – A

30. Dëshmia e dëshmitarit –A.B

31. Dëshmia e dëshmitarit –S.L

32. Dëshmia e dëshmitarit - F.G

33. Dëshmia e dëshmitarit –N.S

34. Dëshmia e dëshmitares – F.M

35. Dëshmia e dëshmitarit –Q.Q

36. Dëshmia e dëshmitarit L.L

37. Dëshmia e dëshmitarit B.D
38. Dëshmia e dëshmitarit –A.C
39. Dëshmia e dëshmitarit –A.S
40. Dëshmia e dëshmitarit –Gj.K
- 42.Aktakuza kundër A.B, F.A dhe A.E PP.602/2007, e datës 21.02.2008
- 43.Procesverbalet e Gjykimit të A.B dhe administrimi i provave
- 44.Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, kundër A.B, F.A dhe A.E i datës 28.04.2010
- 45.Aktgjykimi i Gjykatës Supreme AP.nr.336/2010 kundër A.B, F.A dhe A.E i datës 28.04.2011
- 46.Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i plotfuqishëm kundër A.B, F.A dhe A.E i datës 09.02.2012
- 47.Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i përpiluar nga Drejtorati i Teknikës Kriminallistike i datës 30.08.2007
- 48.PK Drejtorati i Teknikës Kriminallistike, fotoalbum i vendit të ngjarjes dhe raporti me përshkrimin e vendit të ngjarjes i datës 30.08.2007, vendi ku është vrarë T.R
- 49.Skicat e vendit të ngjarjes të përpiluara nga Njësia Regjionale e Teknikës Kriminallistike,
- 50.Fotografi të A.B duke u larguar nga vendi i ngjarjes me datën 30.08.2007
- 51.Procesverbal i bastisjes 30.08.2007, në shtëpinë e F.S
- 52.Procesverbal i bastisjes i datës 30.08.2007, në shtëpinë e E.S dhe H.S në rrugën “//” në P.
- 53.Procesverbal i bastisjes, i datës 30.08.2007, në shtëpinë e O.B, në rrugën “//” nr.// në P
- 54.Raporti i bastisjes i datës 31.08.2007, në “Kafe Bar S”, në Bulevardin “//”.
- 55.Procesverbali bastisjes i datës 31.08.2007, në shtëpinë e A.B.
- 56.Procesverbal i bastisjes i datës 21.09.2007, të veturës së E.S, në Bulevardin “//”, afër lokalit “S”.
- 57.Procesverbal i bastisjes i datës 28.09.2007, në vendbanimin e familjes A. në rrugën “//” nr./
- 58.Procesverbal i bastisjes i datës 28.09.2007, në vendbanimin e familjes A, në rrugën “//”
- 59.Dokumente lidhur me kontrollin e të burgosurit N.S në qendrën e paraburgimit në P. ku i është sekuestruar një sim kratel- 38101041015172583,
- 60.Raporti i policit M.M, ID8181 i datës230-31.08.2007.
- 61.Raporti policor D.I ID1552, i datës 13.08.2007.
- 62.Raporti i ngjashëm i policit Sh.M – 7361, i datës 31.08.2007.
- 63.Raporti i oficerëve të policisë A.D dhe A.Sh i datës 30.08.2007.
- 64.Raporti i mjekësisë ligjore mbi autopsinë e trupit të T.R.
- 65.Raporti i ekzaminimit të veturës “Land Rover ///-KS-//.
- 66.Raport i ngjashëm i ekzaminimit të veturës “Opel Asocona 1.6s” ////” .
- 67.Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve nga dëshmitarja E.Z
- 68.Raporti i policit B.G
- 69.Raporti i policit E.T
- 70.Raporti i policit N.B.
- 71.Raporti i policit Z.K
- 72.Raporti i policit m.K lidhur me gjeten e dy veturave Combo e tipit “Opel” me targat //KS-// që shkruante B- Cafe dhe vetura “VË” Golf 3” me targat //-KS-//.
- 73.Bastisja e veturës “Jeep” me nr.të targave ////, te lokali “Cafe Bar S”.
- 74.Raporti i bastisjes së veturës “Jeep”, me nr.targ. //-Ks_//, tek lokali “Cafe Bar S”.
- 75.Raporti nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike mbi ekzaminim e veturës “Opel-Pickup i kuq”, me targa ////,
- 76.Raporti i policisë për konfiskim të veturës opel, pikcup i kuq me targa ////,
- 77.Raporti i teknikës kriminallistike mbi ekzaminin e veturës “Golf III” me targa ///, dhe fotoalbumi.
- 78.Drejtorata e teknikës kriminallistike – lista e dëshmive të gjetura në vendin e ngjarjes (gëzhoja, njolla, mostra të ADN, vija papilare...),

- 79.**Raporti laborator qendror të kriminalistikës, lidhur me ekzaminimin e gëzhjojave dhe armës Glock-19, dhe vërtetim mbi konfiskimin e armës nga A.B
- 80.**Raporti i policit hetues M.K – përmbledhje e masave hetimore.
- 81.**Raporti i hetuesit B.O, lidhur me komunikimet mes grupit të dënuarve me mesazhet telefonike nga data 01.08.2007, deri me 11.10.2007, duke përfshirë edhe ditën e vrasjës
- 82.**Raporti i shkurtër hetues B.O, lidhur me intervistimin e dëshmitares B.M
- 83.**Raportet policore rreth vendit të krimit.
- Raport i shkurtër nga policia regjionale Prishinë në vendin e ngjarjes 2007 AD02397
 - Raporti informues hetimor, nga polici H.J, i datës 30.08.2007
 - Raporti informues hetimor, nga polici O.G, i datës 30.08.2007
 - Raporti informues hetimor, nga polici N.R – lidhur me masat e ndërmarra në vend të ngjarjes i datës 30.08.2007.
- 84.**Raporti i policit L.K, lidhur me bastisjes e lokalit (opium) dhe shtëpisë së A.B dhe arrestimin e N.S dhe Sh.G.
- 85.**Raport i policit për konfiskimin e veturës “opel kombo” me targa 505 KS 211.
- 86.**Raport i UNMIK, për ekzaminimin e pajisjeve elektronike të konfiskuara në S bar,
- 87.**Provat nga Drejtoria e Forenzikës kriminalistike me fotoalbum të internet caffè opjum,
- 88.**Raporti hetues M.K në lidhje me kontrollin e veturës “opel kombo”, me targa ///-KS-//
- 89.**Raporti shtesë i hetuesit M.K për veprimet hetimore pas dorëzimit të Kallëzimit Penal.
- 90.**Raporti i oficerit D.N, sipas të cilit me datën 26.09.2007.
- 91.**Raporti hetues B.O, lidhur me dyshimin se me datën 25.09.2007.
- 92.**Raport i policisë – plani operativ “Kthetrat e Ariut” i datën 27.09.2007
- 93.**Raport shtesë i hetuesit M.K i datës 03.10.2007.
- 94.**Mendimi i ekspertit të arkitekturës lidhur me shtëpinë e të dënuarit A.B.
- 95.**Raport i verifikimit të gjendjes materiale të familjes së A.B i datës 21.01.2015, ref.06001-35/5,
- 96.**Ekstrakti nga “Ëestrn union” i datës 28.08.2007
- 97.**Raporti mbi hartografinë numrave- antenat ref.2008-AB-3046, i datës 15.04.2015,
- 98.**Shënim zyrtar nga policët B.O dhe B.G
- 99.**Raporti analitik i policisë në lidhje me dëshmitë e mbledhura në rast, analizimi i provave dhe lidhshmërinë mes tyre
- 100.**Raporti i analizimit të deklaratave të të dyshuarve, i përpiluar nga hetuesi F.H
- 101.**Shënim zyrtar i gjykatës themelore në Prishtinë i datës 03.03.2014
- 102.**Të dhënat personale të E.S dhe e kaluara kriminale
- 103.**Të dhënat personale dhe e kaluara kriminale e siguruar nga Policia, për të pandehurin I.A
- 104.**Të dhënat personale dhe e kaluara kriminale e siguruar nga policia për të pandehurin Rr.A
- 105.** Raporti mbi ekzaminimin e dëshmimeve, nr.ITF-2013-048, i datës 11.11.2013
- 106.** Raporti i policës, nr.OCIU/2012/28 i datës 21.02.2014
- 107.** Përgjigje nga IPKO. e datës 07.11.2013, lidhur me abonent e disa numrave të telefonit, -
- 108.** Raporti policor nr.06/1-01-SA-023/2014, i datës 25.03.2014.
- 109.** Raporti i Policisë së Kosovës, ref.06/1-01-SA-025/2014, i datës 02.04.2014, lidhur me numra të telefonave të personave të afërt me të akuzuarin të cilët i ka përdorur i akuzuari E.S si dhe numrat të cilët kanë përdorur anëtarët tjerë të grupit të tij, analizë e të gjitha dëshmimeve nga sektori ITM.
- 110.** Informata nga PTK, ref.PTK/831/07, të datës 19.11.2007, lidhur me abonent për disa numra të telefonave.
- 111.** Informata nga PTK, ref.PTK/887/07, i datës 13.12.2007, lidhur me abonent.
- 112.** Raport i regjistrimit të thirrjeve telefonike dhe mesazhet, pa datë,
- 113.** Njoftim nga ARBK, i datës 27.03.2014, lidhur me DPH ”S Bar”.
- 114.** Raporti i policisë së Kosovës, ref.06/1-01, SA-028/2014, i datës 17.04.2014.

115. Cd.ex#1.1:

116. Fotografi të nxjerra nga dëshmitë Ex1.1, dhe Ex.1.7, dhe Ex1.9:

117. Raporti shtesë i sektorit të fotografisë kriminalistike dhe fotolabororit i datës 30.08.2007,

118. Raporti nga drejtoria e teknikës kriminalistike mbi analizimin e CD, videokasetave dhe filmimet e kamerave.

119. Njoftim nga ARBK, i datës 02.04.2014

120. Rezultati i zbatimit të masave të fshehta - regjistrimet e thirrjeve telefonike dhe Sms.

121. Të gjitha shkresat e rastit “S.Casino”

Aktvendim për fillim të hetimeve PP.nr.850-4/2005, i datës 28.12.2005, kundër: A.B, E.S, S.S Rr.A, A.C, A.S, K.K, F.M dhe V.H (rasti S.Casino),

Aktakuza në rastin “S.Casino# dhe vendimin mbi konfirmimin e aktakuzës,

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit J.S i datës 25.12.2005.

Procesverbale mbi intervistimin e të pandehurit E.S të datave 26.12.2005 dhe 16.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B.S, i datës 11.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B.T, i datës 11.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitares B.C, i datës 11.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit V.R, i datës 31.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B.Z, i datës 27.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit A.S, i datës 31.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit P.S, i datës 31.01.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit A.S, i datës 01.02.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit A.B, i datës 07.02.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit B.M, i datës 18.01.2006, dhe datës 13.02.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e të pandehurit N.S, i datës 13.02.2006.

Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit T.R, i datës 26.12.2005, dhe 11.01.2006.

Raporti i oficerit policor T.R i datës 25.12.2005.

Raporti i oficerit policor F.Z, i datës 25.12.2005.

Raporti i policit – Njësia Regjionale e Krimeve- Prishtinë, i datës 25.12.2005.

Raporti i policit mbi shikimin e vendit të ngjarjes i datës 25.12.2005.

Kallëzimi penal i policisë i datës 27.12.2005 dhe kallëzimi penal shtesë, i datës 06.02.2006.

Fletëlëshimi nga QKUK, për A.S, i datës 28.12.2005.

Mendimi i ekspertit Ass.Dr.A.G, për dëmtimet trupore të T.R.

Raporti i datës 12.11.2007, dhe raporti i ekspertizës nga Drejtoria e Labororit të Policisë Kriminale – në Ankara.

Njoftim i gjykatës nga prokuroria në lidhje me mostrat e dërguara në Ankara për ekzaminim i datës 09.02.2009,

Shënim zyrtar i prokurorit në lidhje me rastin “S Casino”, i datës 14.02.2007.

122. Shkresat e rastit “Ferizaj”.

Aktakuza kundër E.S, Xh.D dhe B.M, PP.nr.333-04/2006, e datës 05.06.2006,

Aktakuza kundër A.B, PP.nr.333-04/2006, e datës 15.06.2006.

Aktvendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër E.S, Xh.D dhe B.M(në gjuhën angleze).

Aktgjykim i gjykatës së qarkut i datës 28.10.2006, kundër E.S, Xh.D, B.M dhe A.B.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 27.12.2007.

123. Njoftimi i Avokatit R.K dorëzuar në gjykatë më datën 26.01.2015.

124. Sqarimi i PTK-së i datës 20.09.2007.

125. Prova materiale me shkrim, lëshuar nga ing.Q.Q i punësuar në PTK, personi përgjegjës menaxher i lartë për komunikime,”TR. Disciplinary cases”, dhe

126. Dosja me nr.467/09.

Gjykata në vazhdim do të trajtoj se cilën provë veç e veç dhe do nxjerr përfundimet për çështjet dhe faktet që i ka vërtetuar për gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë lidhur me rastin, gjykata gjatë analizimit të deklaratave, si dhe administrimit të të gjitha provave tjera do të koncentrohet në fragmentet të cilat ndriçojnë objektin e çështjes. Kjo gjykatë tërheq vëmendjen, se deklaratat e lartcekura të dëshmitarëve janë përshkruar në mënyrë të shkurtuar vetëm si përmbledhje kryesore, pasi që të njëjtat përmbajnë material voluminoz. Për më tepër, gjatë trajtimit të provave sa i përket fakteve kontestuese, kjo gjykatë do të lëshohet vetëm në fragmentet e deklaratave që vërtetojnë faktet kryesore mbi objektin e çështjes.

Faktet jo kontestuese

Për të mos krijuar huti përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë fillimisht konstaton se për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se me datën 30.08.2024, në Prishtinë, tek vendi i njohur aso kohe si parkingu tek “F”i në lagjen D”, ishte privuar nga jeta tani i ndjeri T.R

Për gjykatën nuk ishte kontestuese as faktin se A.B ishte autori i vrasjes që kishte privuar tani të ndjerin nga jeta, e për gjykatën nuk ishte kontestues as fakti se F.A ishte i përfshirë po ashtu në vrasjen e tani të ndjerit, për faktin se një konstatim të tillë e ka dhënë Gjykata Supreme me atkgjykimin me shenjën API.nr.9/2011 të datës 09.02.2012.

Për gjykatën ishte kontestuese të vërtetonte se a ekzistonte një mend i ashtuquajtur grupi S, a vepronin personat aty nën urdhrat e E.S, a kishte datuar konflikti mes E.S dhe T.R në periudhën e vitit 2000-2001, a ishte kërcënuar, përcjellur në vazhdimi T. nga E.S dhe personat që identifikoshin si pjesëtar të grupit të tij. A kishte një raport të afërt E.S me A.I dhe a morri një hov tjetër konflikti mes E.S dhe T.R pasi që T. dhe A kishin filluar lidhjen. A ishte rasti “S.Casino” një shtysë edhe më e madhe e konfliktit. A e akuzonte E.S, T për konfliktin në mes E dhe Njesise Speciale në rastin Ferizaji. A ishte shpërngulur T. në periudhën para vrasjes në Stagovë nga intesifikimi i përcjelljeve dhe sulmeve ndaj tij dhe frika se mund t’i ndodhte diçka e keqe dhe a ishte organizuar atentat ndaj T rreth dy javë para vrasjes, pikërisht nga E.S me gурpin e tij. A ishte A.B punëtor i E.S në “B”Kafe” dhe a ishte i njëjti person i identifikuar me gурpin S, respektivisht cila ishte lidhja mes E.S dhe A.B. Cila ishte lidhja e E.S me personin tjetër të denuar për vrasjen e T.R, respektivisht F.A. Cila ishte lidhshmëria e E.S me Rr.A. me nofkën Rr. e cila me I.A me nofkën L. dhe cila ishte lidhshmëria e tyre me A.B. A u takuan A.B dhe E.S ditën kritike në “Kafe Bar S”, a ishte kjo vrasje e planifikuar apo e rastësishme, si dhe a e kishte shtytr E.S, A.B që ta privonte nga jeta T.R dhe cili do ishte motivi që do ta lidhte me këtë shkak.

Faktet kontestuese

Lidhur me faktet kontestuese të lartshënuara, që lidhen domosdoshmërisht me rrjedhën e ngjarjes dhe hallken zingjirorë të provave për nxjerjen e përfundimit, kjo gjykatë në vijm do të jap arsye se si e ka trajtuar gjykata çdo provë veç e veç, cilës provë ja ka falur besimin dhe cilës jo dhe arsyet mbi këto shkaqe, e po ashtu do të nxjerren përfundimet në lidhsmëri të të gjitha provave së bashku.

1.Nga deklarata e dëshmitarit Sh.R, kjo gjykatë fillimisht ka vërtetuar faktin e zanafillës së problemit në mes tani të akuzuarit E.S dhe të ndjerit T.R. Incidenti i parë mes tyre kishte ndodhur rreth vitit 2000, kur tani i ndjeri ishte emëruar si Zyrtar Policor. T.R ishte në detyrë dhe kishte ndalur veturën në të cilën ishte E.S. Nga provat e administruara e të cilat do të elaborohen në vijim, rezulton se ekzistonte një grup njerëzish e që pretendonin të determinonin aso kohe Prishtinën e që nga provat që do të paraqiten në vijim në krye të këtij grupi ishte E.S Nga kjo

çështje rezulton fakti se për tani të akuzuarin ishte e pa pranueshme që një zyrtar policor edhe ta ndalonte, andaj edhe të njëjtin e kishte kërcënuar me granatë dore. Kjo pjesë e deklaratës së tani dëshmitarit, gjen përputhje të plotë edhe me deklaratën e dëshmitarit tjetër V.R (vëllai i tani të ndjerit), G.Hi (shok i tani të ndjerit), B.Sh (koleg i tani të ndjerit), B.H (koleg i tani të ndjerit), A.S (shok i ngushtë dhe kolegë i tani të ndjerit). Pra gjykata i fali besimin deklaratimit të Sh.R, duke akceptuar kështu problemin e parë mes të T.R dhe E.S, andaj kjo gjykatë i fali besimin kësaj deklarate në këtë pjesë, për faktin se deklaratat e dëshmitareve të lartcekur janë identike përkitazi me këtë çështje, aq më tepër të lartcekurit ishin njerëzit më të afërt të T.R që i dinin të gjitha problemet e tij.

Pas këtij rasti, nga dëshmitarët që janë dëgjuar, janë identifikuar përcjellje e kërcënime të vazhdueshme nga i ashtuquajti “Grupi S” shfryrje e shpërthime gomave gjë që vërtetohet nga familjarët e të ndjerit të dëgjuar si dëshmitar, por edhe dëshmitari A.S që ishte njeriu mbase më i afërt i T.R.

Më tej gjykata i falë besimin deklaratës së dëshmitarit Sh.R edhe përkitazi me përcjelljet e vazhdueshme që i bënte E.S me njerëzit e tij T.R ku dëshmitari kishte rrëfyer një rast kur T. ishte përcjellë nga E.S dhe njerëz të tij me tre vetura pranë gjimnazit në rrugën për G” ku në veturë kanë qenë T. dhe A dhe A e kishte vërejtur se T. ishte shumë i shqetësuar dhe se po e mbante armën gjatë gjithë kohës dhe në momentin kur ajo e ktheu kokën për të parë prapa ajo kishte vërejtur se ata po përcilleshin nga njerëzit e tij dhe në atë moment kanë dalë nga rruga. Ky fragment i deklaratës së dëshmitarit dhe arsye që gjykata e morri për bazë dhe të vërtetë, është për faktin se një konkludim i tillë mbështetet edhe në deklaratat e dëshmitarit V.R që rrëfen në mënyrë identike ngjarjen. Ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmitarja A.I që pohon faktin se T. shte i përcjellë nga i ashtuquajti “Grupi S” e po ashtu nga dëshmitarët vërtetohet se E.S me xhipa të blinduar përcillte tani të ndjerin dhe këto përcjellje shumicën e kohës i bënte me Rr.A me nofkën (R) dhe I.A me nofkën (L).

Nga deklarata e këtij dëshmitari, është vërtetuar edhe fakti se tani të ndjerit në vazhdën e kërcënimeve dhe përcjelljeve të vazhdueshme i ishte djegur edhe vetura e tipit LandRover. Një fakt i tillë dhe arsye pse gjykata i’ a fali besimin të njëjtit konsiston në faktin se ky deklaratim i dëshmitarit Sh., gjen përputhje edhe me dëshmitë e dëshmitarëve V.R, Sh.Q dhe dëshmitari B.Sh dhe se konstatohet se prapa këtij veprimi ishte E.S me njerëz të tij. Për këtë rast ishte iniciuar edhe procedure pranë organeve të rendit por që nuk kishte marr verdiktin final.

Dëshmitari Sh.R, ka rrëfyer edhe për rastin e njohur si “S.Casino” ku kishte pasur gjuajtje me armë dhe të plagosur. Ky ishte një incident i radhës i përmasave të mëdha dhe pasoja në njerëz ku kishte pasur edhe të plagosur, me ç’ rast ishte plagosur shoku i T – A.S por edhe ishin rrezikuar të gjithë personat e pranishëm. Kjo gjykatë nuk do të lëshohet në detaje në ecurinë e rastit “S. Casiono” për faktin se është rast i hapur në gjykatë. Megjithatë lidhur me rrjedhën e ngjarjes është rast tepër domethënës në bindjen e kësaj gjykate, për faktin se këtu vihet në pah një fakt i qartë se incidenti në mes të E.S dhe T.R po eskalonte, respektivisht kishte marr përmasa edhe më të mëdha – gjuajtje me armë ku potencialisht mund të kishte edhe të vdekur. Vlen të specifikohet edhe një fakt, se pavarësisht sa persona ishin të përfshirë në incidente, e gjithë arsyeja pse ndodhnin këto raste ishte E.S dhe T.R – ku gjithherë caku ishte Te prapa sulmeve ishte E.S

Lidhur me rastin “S. Casino” që ishte nga rastet që qoj në një stad tjetër konfliktin, kjo gjykatë do të lëshohet përsëri më vonë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimit e duke nxjerrë përfundime edhe nga dëshmitarë të propozuara nga mbrojtja e E.S, dëshmitari Gj.K, ku kishte specifikuar se pas gjuajtjeve me armë, sipas vet E.S, T.e kishte rrahur të njëjtin gati deri në vdekje për çka ishte angazhuar ti pajtonte të njëjtit, por E. S nuk i’ a kishte falur – gjë që në bindjen e gjykatës, por

edhe nga rrjedh e ngjarjes në vijim, rezulton fakti se konflikti vazhdonte dhe se E.S bënte përpjekjet e radhës për eliminimin e T.R.

Nga deklarimi i dëshmitarit Sh.R, kjo gjykatë ka vërtetuar edhe faktin se T. ishte përcjellë në vazhdimësi nga njerëz të E.S gjë të cilën i'a kishte rrëfyer vet djali i tij T. Përcjelljet e të njëjtit përveç rasteve specifike me gjipa të blinduar që u specifikuan më sipër, i njëjti ishte përcjellë edhe me skuter e me vetura. Sipas këtij rrëfimi, këto përcjellje të tani të ndjerit vinin nga E.S dhe njerëz të tij si Rr.A (R), I.A (L), e N.S, ku T ishte kërcënuar disa herë me fjalët “ja ti ja na se Kosova është shumë e vogël”

Gjykata i fali besimin dëshmitarit edhe përkitazi me këto çështje, për faktin se faktet e tilla të lartshënuara konfirmohen në mënyre identike edhe nga njerëzit më të afërt të T aso kohe e që tani janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve, si vëllai i T, V.R, shoku i ngushtë i T, A.S, e dashura tij aso kohe dëshmitarja A.I

Të gjithë pa dallim ishin të informuar nga vet T, se ai kërcënohej e përcillej në vazhdimësi nga i ashtuquajti “grupi S” parapa të cilës ishte E.S e ku nën urdhrat e tij vepronin një grup i njerëzve e në veçanti Rr.A (R), I.A (L) (këtë e konfirmonin këta dhe të tjerë dëshmitarë e ku deklaratat e tyre do të elaborohen në vijim të arsyetimit të aktgjykimit).Lidhur me lidhshmërinë e rrjedhës së ngjarjes dhe funksionimin e të lartcekurve, gjykata këto fakte do t'i trajtoj në mënyrë të veçantë në konkludimet e saja për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Rast tjetër për të cilin T. i kishte treguar kishte qenë rasti kur i kishin bllokuar rrugën në fshat. Bëhej fjalë për një atentat në fshatin S, ku vetëm rreth dy javë para vrasjes së T, ishte tentuar që përmes bllokimit të rrugës të njëjtit t'i rrokulliset vetura me qëllim që ta privojnë nga jeta. Fakti se ishte organizuar ky atentat, vërtetohet jo vetëm nga deklarata e dëshmitarit Sh nga vet rrëfimi i T, por edhe nga deklaratat e dëshmitarëve, V.R, G.H, B.Sh, A.I, A.S, Sh.Q. Të gjithë dëshmitarët pa dallim, kishin rrëfyer se prapa ngjarjes ishin njerëz që punonin me urdhra hirarkik të tani të akuzuarit E.S. Pra nga deklarata e dëshmitarit Sh.R e cila deklaratë gjenë përputhje edhe me deklaratat e dëshmitarëve të lartshënuar, gjykata duke i'a fal besimin kësaj deklarate për shkak të përputhjes me provat e tjera, ka vërtetuar një fakt thelbësor që lidhet me zingjirin e rrjedhës së ngjarjes, që rezulton në faktin se, vetëm për rreth dy javë para vrasjes së T. i akuzuari kishte ndërmarr veprime përmes njerëzve të tij për ta privuar tani të ndjerin nga jeta. Lidhur me këtë ngjarje, gjykata do të lëshohet edhe më në detaje për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, e po ashtu përgjatë deklaramit të vet të akuzuarit përkitazi me këtë çështje, në bindjen e trupit gjykues i njëjti vet-inkriminon veten duke u përfshirë në dijeninë për rastin (e duke dhënë arsye se ky nuk ishte atentat), por kjo deklaratë e tij do të elaborohet më vonë përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Krejt në fund një çështje thelbësore që vërtetohet nga deklarimi i këtij dëshmitari e që gjene përputhje me deklaramin e secilit dëshmitar që është dëgjuar e që aso kohe kishte raporte me T, rezulton faktin se, asnjëherë nuk kishte përmendur T se kishte ndonjë problem me dikë tjetër përveç E.S, e aç ma pak me personin A.B

Për gjatë deklaramit të tij e nga rrëfimi i djalit të tij, dëshmitari kishte specifikuar se vrasjen e djalit të tij e kishte urdhëruar E.S, konkludim të cilin e ka nxjerr edhe ky trup gjykues por jo vetëm nga deklaramet e këtij dëshmitari por nga hallka zingjirore e të gjitha provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor -por hallka e zingjirit të provave që nxjerrë këtë përfundim do të trajtohet në një pjesë të veçantë në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

2.Nga deklarata e dëshmitarit V.R, kjo gjykatë ka ri-konfirmuar faktet e vërtetuara nga dëshmitari i lartcekur. Fillimisht është ri-konfirmuar fakti që gjykata ka vërtetuar faktin se si ka ndodhur incidenti i parë mes tani të akuzuarit dhe të ndjerit. Edhe ky dëshmitar ka specifikuar se

ku në ditët e para të punës deri sa T ka qenë në detyrë tek rrethi, afër shkollës së mjekësisë e ka ndalur një veturë siç e ka shpjeguar në të cilën veturë kanë qenë vëllezërit E dhe N.S, ku të njëjtit posa kanë ndalur veturën, E nxjerrë një granat dore dhe e ka kërcënuar T, dhe pastaj është largua. Siç është specifikuar edhe më sipër ky fakt është konfirmuar edhe nga dëshmitari Sh.R, G.H, B.Sh, B.H e A.S. Fakti se deklarata e dëshmitarit V. në këtë fragment gjene mbështetje të plotë në deklaratat e të lartcekurve gjykata i'a falë besimin dhe vërtetoi faktin se si ka ndodhur incidenti i parë mes tyre.

Më tej, sipas deklaramit të dëshmitarit, i njëjti ka specifikuar se po ashtu rasti tjetër që i kujtohet ka qenë edhe kur ky, T. nëna dhe vajza e tij duke shkuar me xhip nga Prishtina në fshatin S. kur kanë dalë në Veternik kanë vërejtur dy persona që po i përcillni, dhe T, i ka thënë se këta persona që po na përcjellin janë "Rr" dhe "L", ku së bashku me E, në xhip ka pasur edhe persona të tjerë por i njëjti ka njohur vetëm E. Nga kjo pjesë e deklaratës së dëshmitarit, kjo gjykatë vërteton edhe njëherë faktin se tani i ndjeri T.R ka pasur kërcënime dhe përcjellje të tjera nga i ashtuquajtimi "Grupi S". Fakti se i njëjti ka pasur përcjellje të vazhdueshme vërtetohet nga cilido dëshmitar i cili e ka njohur T. dhe ka pasur raporte të afërta me të. Nga kjo pjesë e deklaratës së dëshmitarit, ri-konfirmohet edhe njëherë fakti shumë i rëndësishëm që E.S ka pasur një grup njerëzish që kanë ndërmarr veprime nën urdhrat e tij, fakt që dëshmohet nga deklaratat e thujse të gjithë dëshmitarëve të dëgjuar. Më tej, nga deklarata e këtij dëshmitari, por edhe dëshmitarëve A.I, G.H, A.S e të tjerëve, vërtetohet fakti se nga njerëzit kryesor që përcjellin e kërcënonin T, bashkë me E.S, ishin Rr.A (R) dhe I.A (L).

Nga deklarata e dëshmitarit V.R, gjykata vërteton edhe njëherë faktin se tani të ndjerit T.në vazhdën e kërcënimeve dhe përcjelljeve ndaj tij i ishte djegur edhe vetura e tij e tipit "Land Rover". Sqarojmë faktin se në dijeni për djegien e kësaj veture kanë qenë edhe Sh.R Sh.Q dhe dëshmitari B.Sh, andaj edhe një herë ri-konfirmohen kërcënimet, përcjelljet dhe sulmet e vazhdueshme ndaj T.R, e ku edhe për këtë rast vet vëllai i tij T. i kishte thënë se në krye të saj ishte E.S me njerëz të tij.

Se trysnia, përcjelljet e kërcënimeve ishin të vazhdueshme, dëshmitari rrëfen edhe momente kur ka qenë edhe vet i pranishëm e ku rrëfen rastin ku ka qenë rrugës për në fshat, respektivisht ka qenë në rrugën e Veternikut, i kanë përcjellë prapa me vetura dhe skutera dhe pasi që kishte qenë ulur në anën e djathtë, në ulësen e pasagjerit, kishte identifikuar personin me pseudonimin "Rr" Rr.A, ndërsa tjetri kishte qenë vëllai i tij "L" emrin e të cilit nuk e dinte. Pra edhe njëherë vërtetohet fakti se i ndjeri ka qenë në përcjellje të vazhdueshme nga E.S dhe njerëz që kryenin veprime nën urdhrat e tij, e siç është specifikuar më sipër në veçanti Rr.A (Rr) dhe I.A (L).

Më tej nën vazhdën e përcjelljeve të vazhdueshme, dëshmitari specifikon edhe një rast se, derisa A së bashku me T. me veturën xhip ishin duke shkuar rrugës për "G" te kisha katolike, "grupi S", e kishin përcjellë me dy vetura, njëri xhip i gjelbër dhe tjetra veturë e vogël, e ku pjesë e këtij grupi kanë qenë Rr (Rr.A), L (I.A) dhe vëllai i tij. Ky fakt vërtetohet jo vetëm nga deklarata e tani dëshmitarit V.R, por edhe nga deklarata e Sh.R dhe deklarata e dëshmitares A.I.

Po ashtu dëshmitari specifikon edhe përcjellje të tjera të vazhdueshme në lokalitetin AM/PM ku kishin shkuar shpesh me të ndjerin vëllain e tij ku në vazhdimësi ishte përcjellë nga E.Sh dhe njerëz të tij.

Nga dëshmia e dëshmitarit, vërtetohet edhe lidhja dashurie që kishte T.R dhe A.I por ky fakt tani ishte jo-kontesutes pasi që një raport të tillë e kishte pohuar edhe vet e lartcekura.

Dëshmitari V., vërteton edhe njëherë faktin e incidentit në "S. Casino" që është elaboruar edhe më sipër, me ç'rast vërtetohet fakti i eskalimit të incidentit mes T, dhe E që tani kishte marrë një hov e një kahje tjetër. Një fakt tjetër shumë të rëndësishëm në hallkën zingjirore të rrjedhës së ngjarjes është rasti kur i ishte bllokuar tani të ndjerit rruga në fshatin S. Nga dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, siç është specifikuar edhe nga dëshmia e dëshmitarëve Sh R, G H, B.Sh, A.I, A.S, Sh.Q, rreth dy javë para vrasjes së T, ndaj të njëjtit ishte

bërë një atentat me urdhër të E.S për privimin nga jeta të tani të ndjerit duke tentuar që t'i rrokulliset vetura. Lidhur me rastin ishin të njoftuar të gjithë njerëzit e afërt të tij nga vet T. ku aj kishte rrëfyer që prapa rastit ishte E.S. Andaj, kjo gjykatë edhe njëherë ka vërtetuar faktin se vetëm dy javë para vrasjes së T, ishte tentuar privimi i tij nga jeta që qon në argumentin e mos heqjes dorë nga E.S për ta eleminuar tani të ndjerin.

Një rrëfim crucial lidhur me rrjedhën e ngjarjes, respektivisht për ditën kritike jep ky dëshmitar ku ka specifikuar se, me datën 30.08.2007, në parkingun e Hotel G", kishte parë Rr.A, duke qëndruar jashtë Hotelit duke i shikuar ata direkt derisa ishte duke biseduar në telefon. T e kishte marrë dhe e kishte dërguar në punë. Më vonë, për afërsisht pas 30 minutave kishte pranuar një thirrje telefonike nga një shok i tij i cili i kishte treguar se T. ishte plagosur ku më vonë kishte kuptuar se kishte vdekur. Fakti thelbësor që i ndjeri ishte përcjellë ditën kritike vërtetohet nga kjo provë e drejtë për drejtë, pra dëshmia e dëshmitarit V, e që lidhet me provën materiale, respektivisht nga provat materiale të përgjimit të telefonave mes F.A dhe I.A (L) që kontaktojnë mes vete për të specifikuar faktin se janë në përcjellje të T. atë ditë. Në sms pjesë përbërëse të shkresave të lëndës, rezulton se F i kishte shkruar I si vijon: "*Vetura e kojshive është në parkingun e G*". Nga kjo rrjedhë saktë fakti se ata ishin duke e përcjellë tek G" ashtu siç ka rrëfyer dëshmitari e për çka kjo gjykatë i'a fali në tërësi besimin për faktin se çdo fragment i tij gjene mbështetje në provat e administruara. Rrjedhën e ngjarjes në një pjesë të veçantë të këtij aktgjykimi do ta ndërlidhë kjo gjykatë edhe me faktin e takimit pastaj të A.B me E.S dhe me Rr.A (R) dhe I.A (L) pikërisht në ditën kritike para vrasjes së T. në "Kafe bar S", pikërisht kur i ndjeri atë ditë ishte në përcjellje të vazhdueshme e që në bindjen e kësaj gjykate shihet haptazi organizimi i vrasjes, megjithatë tani për tani po nxjerrim vetëm fragmentet nga dëshmia e dëshmitarit V.R në lidhje – mbështetje me provat tjera.

Një fakt tjetër që ri-konfirmohet edhe nga dëshmitari V e që është konfirmuar nga çdo dëshmitar që kishte lidhje të afërta me T., është fakti se T. nuk kishte probleme me dikë tjetër përveç E.S dhe të gjitha sulmet, kërcënimet e përcjelljet vinin nga ai ose njerëz të tij nën urdhrat e tij. Sa i përket A.B edhe nga V.R vërtetohet fakti se i ndjeri asnjëherë se ka përmendur faktin se kishte ndonjë problem me tani dorasin A.B

Sa i përket A.B, dëshmitari ka theksuar se para ndodhjes së vrasjes si fytyrë e ka parë disa herë para lokalit "S" në lagjen Dardania duke ndenjur së bashku e E, vëllain e E dhe me "L" dhe "Rr

Fakti se A.B frekuentonte lokalit "S" e kishte pohuar edhe vet i njëjti dhe faktin se shoqërohej me "L" e "Rr" po ashtu. Fakti se i njëjti ishte edhe ditë kritike në bar "S" pohohet po ashtu nga vet A.B e fakti se nga aty para vrasjes kishte dalë me "L" e "Rr" konfirmohet e vërtetohet po ashtu.

Andaj, nga rrethanat e lartcekura, kjo gjykatë i'a fali në tërësi besimin dëshmitarit V.R dhe kjo gjykatë vërtetoi faktet e lartshënuara.

3. Se sa të ndërlidhura janë provat në mes vete, që shpërfaqin faktet e kërcënimeve e përcjelljeve të vazhdueshme nga E.S e njerëz të tij ndaj T vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit G.H i cili ishte njëri nga shokët më të afërt të T. (ishin shokë nga shkolla e mesme). Problemin e parë rreth vitit 2000 kur T. kishte filluar të patrullonte si zyrtar i policisë së Kosovës e specifikon edhe dëshmitari G.H i cili ishte në dijeni pikërisht nga rrëfimi i T. se në atë kohë ishte sulmuar nga E.S me granatë dore – shtojmë faktin se këtë shpjegim të ngjarjes i njëjti e rrëfen në mënyrë identike si dëshmitarët e lartcekur, me ç'rast kjo gjykatë edhe një herë ri-konfirmon incidentin e parë në mes të E.S dhe T.R.

Më tej shoku i T, dëshmitari G, në cilësi të dëshmitarit ka shpjeguar se i ndjeri është përcjellë dhe ka pasur kërcënime të vazhdueshme nga njerëz të E.S dhe për këto probleme është vënë në njohuri nga vet T, pasi që shumë shpesh kanë qenë së bashku përfshi edhe ditën kritike.

Dëshmitari ka shpjeguar se si E.S dhe njerëz të tij, i kanë shfryer gomat e veturës së T. e po ashtu edhe një rast tjetër që edhe i janë shpërthyer gomat T. tek menza e studentëve. Fakti se tani të ndjerit i janë shfryer e shpërthyer gomat vërtetohet edhe nga deklaratat e shokut tjetër të T–dëshmitarit A.S që kishte shpjeguar këtë ngjarje në mënyrë identike, e që shpërfaqet edhe njëherë fakti dhe vërtetohet se në vazhdimësi, T përcillej e ndiqej nga E.S dhe personat që kryenin punë nën urdhrat e tij.

Dëshmitari G.H ishte në dijeni edhe për rastin e “S. Casinos” ku për këtë i kishte rrëfyer T ku i kishte specifikuar se incidenti kishte ardhur pas provokimeve direkt të E.S. Kjo gjykatë edhe njëherë rithekson faktin se vërtetohet që incidenti në “S Casiono” me gjuajtje me armë e të plagosur kishte ndodhur pikërisht në vazhden e kërcënimeve dhe përcjelljeve që i bënte E.S me njerëzit e tij. Incidenti i “S. Casinos” ishte një indikator i shpërthimit të konfliktit ku siç është specifikuar edhe më sipër kishte pasur gjuajtje me armë, të plagosur e të rrezikuar e ku i gjithë incidenti kishte një shkas (E dhe T).

Edhe nga dëshmia e dëshmitarit G H, është vërtetuar edhe njëherë fakti se para vrasjes së T ishte organizuar një atentat ndaj tij ku ishte në dijeni për rastin kur T. ishte duke udhëtuar në fshatin e tij S, ku rruga i është bllokuar me gurë dhe guraleca dhe se T. i ka thënë të njëjtit se prapa çdo sulmi dhe tani atentati ishte E.S. Një fakt i tillë, siç u specifikua edhe më sipër, gjen mbështetje dhe përputhje të plotë edhe në deklaratat e dëshmitarëve: Sh.R, V.R, G.H, B.Sh, A.I, A.S, Sh.Q. Pra edhe njëherë konfirmohet fakti se, diku rreth dy javë para vrasjes së T, ishte organizuar atentat ndaj tij pikërisht nga E.S

Sa i përket ditës kritike të 30 Gushtit 2007, e kujton mirë, atë ditë kishte takuar shokun e tij T dhe i kujtohej se dy herë kishin dalë me të në marketin e afërt për të blerë akullore, dhe pasi kishte dalë ta përcjellë të njëjtin, derisa ishte duke u kthyer në lokal, kishte dëgjuar disa të shtëna rafal, dhe se dikush nga stafi kishte bërë titur “T”, dhe kur kishte dalë jashtë lokalit kishte parë një person i cili mbante kapelë në kokë dhe duke ikur në drejtim të tunelit të cilin nuk kishte mundur ta identifikojë. Nga ky fragment i këtij dëshmitari, konkludohet fakti se A.B ishte duke ikur me kapelë në kokë që qon në faktin se i njëjti ishte duke u fshehur dhe nuk ishte ndodhur vrasja në mënyrë të rastësishme siç pretendon A.B, por të organizuar. (Lidhur me veprimet e organizimit të vrasjes e në veçanti për ditën kritike – përcjelljet, takimet dhe komunikimet e njerëzve të grupit S e deri në privimin e T nga jeta, kjo gjykatë do të japë shpjegime me të hollësishme më vonë në vazhdim të arsyetimit të aktgjykimit). Një fakt tejet domethënës në hallkën zingjyrore të provave të administruara, është edhe fakti se dëshmitari ka specifikuar se muajin e fundit T ishte shumë i shqetësuar lidhur me këto probleme dhe ky fakt vërtetohet edhe nga deklaratat e dëshmitarit B.Sh e A.S.

Përfundimisht lidhur me dëshminë e këtij dëshmitari, gjykata i’ a fali besimin në tërësi të njëjtit pasi që kishte lidhshmëri të drejtë për drejtë dhe asnjë kundërthënie në raport me deklaratën e vet po edhe me deklaratat e dëshmitarëve të cilat u elaboruan dhe u ndërlidhen deri më tani mes vete për vërtetimin e fakteve të lartshënuara.

4. Siç po ri-përsëritet disa herë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, të gjithë personat që njiheshin mirë me T, dhe kishin afërsi me të, vërtetojnë e ri-konfirmojnë faktet e trysnisë, kërcënimeve e përcjelljeve që i bëheshin T nga i ashtuquajtur “Grupi S” në krye të së cilës ishte E.S, e ku të tjerët vepronin nën urdhrat e tij.

Dëshmitari B.Sh- ishte zyrtar policor i cili në polici kishte filluar të punojë nga data 12 shkurt 2000, dhe kishte shërbyer në stacionin policor numër 2, T.R e kishte njohur në kursin për trajnime

të mbrojtjes së afërt, në vitin 2001 ose 2002. T i kishte treguar se kishte pasur probleme me E.S, lidhur me detyrën zyrtare. Ky dëshmitar edhe njëherë ri-konfirmon problemin e parë që kishin mes vete T me E, ku ky i fundit e kishte kërcënuar me granatë dore ditët e para kur T ishte ngarkuar me detyrë zyrtare, e siç u konfirmua edhe më sipër nga të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve të elaboruara deri tani. Pra T i ishte kërcënuar në ditët e para të punës së tij si zyrtar policor që mos ta ndaloj më E.S, pasi që i njëjti vlerësonte se ishte i pa preکشëm nga organet e rendit aso kohe. Nga dëshmia e këtij dëshmitari e në lidhshmëri edhe me dëshmitë e dëshmitarëve Sh.R, V.R, Sh.Q, ri-konfirmohet fakti i djegies së veturës “Land Rover”, respektivisht veturës së T, ku dëshmitari rrëfen se rastin tjetër që ka njohuri që i ka treguar personalisht T lidhur me problemet me E.S ka qenë rasti që T i ishte djegur vetura e tij e si rast ishte hetuar nga njësia në të cilën ka punuar i njëjti dhe jo personalisht nga ai dhe ka specifikuar se si të dyshuarit ishin E.S, dhe njerëz të tij. Pra edhe prapa djegies së veturës së T ishte tani personi që e ndjekte e përndjekte të ndjerin në mënyrë të vazhdueshme, tani i akuzuari E.S

Edhe dëshmitari B.Sh specifikon se, rasti tjetër kishte të bënte me pritën në fshatin S, ku T, i kishte treguar të njëjtit që diku në mes të rrugës kryesore dhe fshatit S, e zuri atë në pritë, dikush i kishte vënë disa dru dhe shkëmbinj në rrugë dhe sipas tij ai tha se kishte pa disa persona të armatosur. Siç u specifikua edhe më lartë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, rasti në Stagovë kishte ndodhur rreth dy javë para vrasjes së T, Dëshmitarët A.S e A.I Sh.R, ri-konfirmojnë faktin se prapa këtij atentati për vrasje të T qëndronte E.S me njerëz të tij, e në anën tjetër E.S në shqyrtimin gjyqësor specifikonte se ky nuk ishte atentat dhe nuk ishte tentuar të rrokulliset vetura e tij e në anën tjetër specifikonte se nuk ishte prapa këtyre rasteve. Nga dëshmitë e lartcekura të dëshmitarëve të elaboruara më sipër e që do të elaborohen edhe në vijim të arsyetimit të aktgjyqimit, kjo gjykatë vërteton faktin se vetëm rreth dy javë para vrasjes së T, me urdhër të E.S ishte planifikuar likuidimi i tani të ndjerit.

Tutje, nga dëshmia e dëshmitarit ri-konfirmohet edhe njëherë se kush ishin personat kryesor që kryenin këto kërcënime, sulme, përcjellje e atentate nën urdhrat e E.S. Dëshmitari ka specifikuar se T kishte treguar se kohët të fundit ishin duke e përcjellë nga Rr.A dhe I.A. Një fragment thelbësor që kjo gjykatë ka nxjerrë nga dëshmia e këtij dëshmitari është fakti se kohën e fundit T (pra para vrasjes) përcillej në mënyrë të vazhdueshme nga njerëzit e lartcekur të E.S që gjë që ndërlihet në mënyrë të plotë edhe nga dëshmia e dëshmitarit G. i cili ka specifikuar se kohëve të fundit T, ishte shumë i shqetësuar, sepse po përcillej në vazhdimësi.

Fakti që qon në bindjen e gjykatës, që hallka zingjirore e provave dhe rrjedhës së ngjarjes është dukshme e qartë dhe nuk lë asnjë mëdyshje të vetme se “grupi S” nën urdhrat e E.S tani më kishin vendosur që ta privonin nga jeta T.R, vërtetohet nga fakti se pas kërcënimeve e përcjelljeve e problemeve të vazhdueshme me vite të tëra, vetëm rreth dy javë para vrasjes u organizua atentati ndaj tij e kohën e fundit para vrasjes ishin intensifikuar përcjelljet ndaj tani të ndjerit.

Më tej, edhe kolegu i tij A.S e që ishte shoku më i afërt i T. (po ashtu personi që ishte i plagosur në rastin S.Casino) ka dhënë dorëheqje nga Policia e Kosovës për arsye se kishte qenë i kërcënuar prej Grupit të E.S, një fakt të tillë e konfirmon vet A.S, por që specifikojmë edhe njëherë faktin se edhe të gjithë të përfshirët e tjerë në këtë incident ishin për shkak të një arsyeje , sulmeve të E ndaj T.

Dëshmitari B.Sh, lidhur me A.B është pyetur se a do të thotë ndonjë gjë emri i A.B para vrasjes së T., i njëjti ka theksuar se kurrë nuk e ka parë atë person dhe se për herë të parë e ka parë në TV, dhe se T, para se të ishte vrarë asnjëherë nuk e ka përmendur A.B

Edhe nga dëshmia e dëshmitarit B.Sh, sikurse nga dëshmia e çdo dëshmitari të elaboruar deri më tani, vërtetohet fakti se T.R nuk kishte asnjëherë problem me A.B dhe nuk e kishte përmendur asnjëherë të njëjtin.

Kjo gjykatë i fali në tërësi besimin deklarimit të këtij dëshmitari, për faktin se faktet të cilat u ri-konfirmuan më lartë nga deklarata e tij, gjejnë përputhje të plotë e identike me provat tjera të administruara, respektivisht dëshmitarët e tjerë të lartcekur.

5. Si provë e administruar në shqyrtimin gjyqësor ishte edhe deklarata e dëshmitarit B.H, I njëjti për gjatë dëshmisë së tij, ndër të tjera kishte theksuar se kishte qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës që nga viti 2000 deri në vitin 2008. T.R e kishte njohur si kolegë, por kishte pasur edhe raporte shoqërore me të njëjtin, mirëpo nuk kishin punuar bashkë. T, gjithnjë gjatë bisedave që kishte pasur me të i kishte treguar rreth problemeve që kishte pasur me E.S dhe grupin e tij, dhe me aq sa kishte njohuri, nuk kishte pasur probleme me persona tjerë përveç atyre. Pra edhe nga dëshmia e dëshmitarit B.H edhe njëherë vërtetohet e konstatohet fakti se T.R kishte probleme me E.S e njerëz të tij. Edhe nga dëshmia e këtij dëshmitari sikurse edhe nga dëshmitarët e lartshënuar, përmenden emra të njerëzve që kryenin veprime nën urdhrat e E.S e ku në mesin e tyre edhe nga ky dëshmitari përmenden për veç të tjerëve edhe Rr.A (R) e I.A (L). Pra edhe njëherë vërtetohet fakti se ekzistonin një grup personave në krye të së cilës ishte ES e që kërcënonin dhe e përcillnin T.R.

Dëshmitari më tej përmend konfliktin e parë mes E, dhe T, kërcënimin me granatë dore që u specifikua disa herë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe disa raste që T, është përcjellë nga Rr.A (Rr) dhe I.A (L), e po ashtu faktin e djegies së veturës së T. Këto dy faktet e fundit janë vërtetuar edhe nga dëshmitarët e tjerë të dëgjuar në këtë shqyrtim gjyqësor (shih deklaratat e lartshënuara).

Siç u specifikua edhe më sipër, rasti tjetër kishte ndodhur në “S. Casino”, ku policët T dhe A, S, sipas dëshmitarit kishin qenë në rroba civile, dhe me sa kishte njohuri, T, kishte qenë vetëm, kurse A, me gruan e tij B, që shpërfaq faktin se konflikti nuk mund të ishte iniciuar nga ta siç pretendon mbrojtja, megjithatë ky rast është në procedim e sipër.

Dëshmitari më tej rrëfen se ditën kritike kur është vrarë T, A.S e kishte thirrë në telefon dhe i kishte thënë “e vrajtë E.S, T – gjë që e konfirmon edhe vet A.S në dëshminë e tij, pasi që vet A, kishte thënë se prapa vrasjes është E.S.

Për emrin A.B nuk i kujtohet ta ketë përmendur T, ndonjëherë, të cilin as vetë nuk e kishte njohur.

Nga deklarimi i fragmenteve të fundit të dëshmitarit dhe deklarimit të të gjithë njerëzve të afërt të T,, konstatohet dhe vërtetohet fakti se T.R nuk kishte probleme apo shqetësime nga dikush tjetër, përveç E.S dhe të gjitha përcjelljet, kërcënimet e atentatet ndaj tij vinin pikërisht nga E.S dhe njerëz që funksionin nën urdhrat e tij, se T, dhe të tjerët asnjëherë se kishin përmendur A.B. Lidhur me këto çështje, gjykata i fali besimin këtij dëshmitari për faktet e lartcekura, pasi që dëshmia është në përputhje të plotë me dëshmitë e dëshmitarëve të lartcekur dhe nuk le hapësirë për interpretim, andaj gjykata vetëm i ri-konfirmoi këto fakte.

Nga rrëfimet e lartcekura, të gjithë familjarët, e shokët e afërt të T, që ishin në dijeni për gjitha problemet e tij, drejtojnë gishtin tek E.S si urdhërdhënës i vrasjes së T.

6. Siç është specifikuar edhe më sipër për gjatë rrjedhës së procedurës, si dëshmitar ishte dëgjuar edhe F.Sh, dëshmitar i cili kishte pasur raporte-afërsi edhe me T edhe me E.

Se T.nuk kishte probleme me dikë, përveç E.S, vërtetohet përsëri edhe nga deklarimi i këtij dëshmitari ashtu siç është vërtetuar nga secili dëshmitar që është trajtuar deri më tani.

Për këtë gjykatë, dëshmia e këtij dëshmitarit ishte kryesore për të vërtetuar tani faktet tjera thelbësore e që lidhet me lidhshmërinë e dorasit A.B, me të ashtuquajturin “Grupi S”, në krye të së cilës ishte E.S.

Nga deklarata e dëshmitarit F.Sh, vërtetohet fakti se A.B, rreth 1 vit para se të ndodhte vrasja e T, veç se ishte identifikuar si person i “grupit S”, ku i njëjti specifikon se ka qenë e pa mundur në atë kohë me kalu kah lokali S, e mos me e pa A, aty. Nga dëshmitari vërtetohet edhe fakti se A.B ishte shumë i afërt me dy njerëzit kryesor e të cilët ishin protagonist në përcjelljet e kërcënimeve ndaj T, e që ishin Rr.A (Rr) dhe I.A (L), madje sipas dëshmitarit A, ishte edhe si truproje e “L” që shfaq haptazi mënyrën hierarkike të funksionimit.

Një çështje po ashtu e një rëndësie të veçantë që vërtetohet nga deklarata e dëshmitarit, specifikon faktin se pronar të biznesit “B. Kafe” ishte E.S (gjë që nuk e ka kontestuar as vet i akuzuari) e që konfirmohet edhe nga deklarata e dëshmitarit Gj.K.

Se A.B ishte punëtor pikërisht i E.S, ani pse edhe E edhe A. këtë gjë janë munduar ta fshehin, vërtetohet nga deklarata e dëshmitarit F.Sh i cili specifikon se nga grupi S”, në “B.Kafe” ka punuar A.B.

Fakti se F.Sh e dinte se A.B ishte punëtor i E.S në “B Kafe” vërtetohet edhe nga provat materiale, respektivisht sms që F i kishte dërguar dëshmitares Z (atë kohë të dashurës së tij) ku lidhur me vrasjen e T, dorasit A.B iu kishte referuar si personi që voziste veturën me mbishkrimin “B. Kafe”

Dëshmia e dëshmitarit F.Sh në këtë fragment, ka lidhshmëri identike me deklarinin e dëshmitarit D2 që po ashtu ka specifikuar se A.B ishte punëtor në “B. Kafe” dhe voziste veturën me këtë mbishkrim.

Nga provat e administruara dhe lidhshmëria identike mes deklaratave të F.Sh dhe dëshmitarit D2 e po ashtu komunikimeve të sms si prova materiale mes F.Sh e Z.I, kjo gjykatë vërteton dhe konstaton se A.B ishte pjesë e të ashtuquajturit “grupi S.” dhe njëherit punëtor i “B.Kafe” biznes ky që e udhëhiqte E.S, që shpërfaq haptazi afërsinë dhe hierarkinë që kishte E.S me tani dorasin A.B.

Nga deklarimi i dëshmitarit e që gjen përputhje edhe me deklaratat e gjithë dëshmitarëve të elaboruar deri më tani, por edhe atyre të ardhshëm që do të elaborohen në vijim si A.I, A.S e të tjerë, vërtetohet një fakt se i emnonin si grupi S, një grup njerëzish që ishin jo të pakt në numër e që specifikohen edhe me emra e mbiemra, që vepronin dhe kryenin punë në emër të këtij grupi, në krye të së cilës ishte E.S. Gjykata nuk do të lëshohet më shumë për veprimtarinë e gjithsecilit brenda grupit, megjithatë specifikojmë faktin se personat kryesor me të cilët E, kryente shumicën e sulmeve e kërcënimeve ndaj T, ishin Rr.A (Rr) dhe I.A (L).

Dëshmitari F.Sh, konfirmon që kishte pasur shoqëri me E.S dhe se kishte ndenjur bashkarisht me të dhe A.I. Nga ky fragment i kësaj deklarate, gjykata vërteton faktin se para lidhjes së A dhe T, e lartcekura kishte pasur raporte me tani të akuzuarin, gjë që konfirmohet edhe nga dëshmitaret Z e M.I., Në këtë drejtim, kjo gjykatë konkludon faktin se pas lidhjes së T. me A., niveli i konfliktit mes E.S dhe T.R, respektivisht sulmet e kërcënimeve e E, ndaj T, kalojnë në një dimension tjetër, që qon në motivin e të akuzuarit për ekzekutimin e tani të ndjerit. Çështje e raporteve në mes të akuzuarit E, me dëshmitaren A, dhe motivi i të akuzuarit për privimin nga jeta të tani të ndjerin, do të trajtohen më poshtë për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi.

Edhe dëshmitari F, që kishte raporte të afërta me gjithë akterët e përfshirë në këtë rast, specifikon se, edhe pse i kishte njohur të gjithë dhe kishte qenë në dijeni përkitazi me problemet dhe konfliktet nuk ka qenë asnjëherë në dijeni se po që se kishte pasur ndonjë problem mes T, dhe A,dhe një fakt të tillë nuk i’a kishte përmendur asnjëherë as T.

Kjo gjykatë i’a fali besimin deklarinimit të dëshmitarit F.Sh, përkitazi me faktet e lartcekura për faktin se deklarinimet e tij kishin mbështetje të plota në dëshmitarët e lartshënuar, nga ku për veç tjerash është vërtetuar se T. kishte probleme me E.S dhe ndaj tij kishte sulme të vazhdueshme nga E.S dhe grupi tij dhe nuk kishte probleme me dikë tjetër. Një fakt thelbësor që u vërtetua nga deklarimi i dëshmitarit, gjithnjë në përputhje me deklarinin e Dëshmitarit D2 rezulton se u

vërtetua se A.B ishte pjesë e “grupit S” dhe punonte në “B.Kafe” udhëheqës i së cilës ishte E.S, e po ashtu u vërtetua se para vrasjes së T, A dhe E, kishin një raport mes veti që vërtetohet edhe nga dekaratat e dëshmitareve Z. dhe M.I.

7.Për gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruara edhe deklaratat e dëshmitarit Sh.Q.

I njëjti ndër të tjera ka theksuar se nga fillimi i vitit 2002 kishte filluar punën në Policinë e Kosovës, ku kishte punuar në sektor të ndryshëm, ndërsa T.R e kishte njohur nga viti 2003. Ndër shqetësimet kryesore të T. kishte qenë hierarkia e policisë për faktin se ai kishte bërë shumë raporte lidhur me disa kërcënime nga Grupi i E.S si dhe nga vetë ky i fundit, mirëpo menaxhmenti nuk kishin ndërmarrë asnjë nga masat parandaluese.

Edhe nga deklarimet e këtij dëshmitari, ri-konfirmohen faktet tani më të vërtetuara nga kjo gjykatë, si kërcënimi me granat dore i E.S ndaj T, djegia e veturës së T, rasti “S. Casino”, e po ashtu edhe atentati në fshatin S.

Një fakt tjetër që vërtetohet nga deklarata e dëshmitarit e që gjenë mbështetje edhe në deklarinimin e dëshmitarit A.S, por edhe në vet kuptimin e rrjedhës së ngjarjes, është fakti se sulmet, kërcënimet e përcjelljet ndaj T, kanë marrë një hov dhe intensitet tjetër nga E.S me njerëzit e tij pasi që T, kishte filluar një lidhje me tani dëshmitaren A.I. Pra kthesa e madhe në këtë konflikt, respektivisht që qon në hakmarrjen e E.S në T.R është edhe për këtë shkak e që përbën njërin nga motivet – kështu vërtetohet nga rrjedha e ngjarjes e që do të ilustruhet edhe në vijim të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Edhe nga kjo deklaratë ri-konfirmohet fakti se njiheshin si “grupi S”, E.S i cili ishte në krye dhe shumë persona të tjerë që përmenden me emra e në mesin e tyre I.A me pseudonim “L”, Rr.A me pseudonim “R”.

Se sulmet kërcënimet e frika se T. mund të përballlet me më të keqën, vërtetohet edhe nga fakti që specifikon dëshmitari Sh, e që është fakti se në periudhën e fundit për shkaqe sigurie T. jetonte shumicën e kohës në fshatin S, fakt ky i konfirmuar edhe nga dëshmitari tjetër A.S, A.I por edhe nga dëshmitaret e tjerë që janë elaboruar më sipër shokë e familjarë të T.

Për personin me emrin A.B kishte kuptuar vetëm pasi që i njëjti ishte dorëzuar, e që kurrë as T.R e as A.S nuk e kanë përmendur që të njëjtit kanë pasur problem me personin e quajtur A.B.

Siç është specifikuar nga secili dëshmitar deri tani, ri-konfirmohet edhe nga ky dëshmitar fakti se T.i nuk kishte pasur kurrë probleme me A.B.

Një fakt tjetër që vërtetohet nga deklarimi i këtij dëshmitari e që gjen përputhje të plotë edhe me deklarinimin e dëshmitarit A.S, është fakti se në atë kohë si zyrtar policor kishin informacione se po përgatitet vrasja e T.R. Gjykata nuk do të lëshohet më tej se si dhe nga kush i kanë marrë këto informacione të lartcekurit për faktin e thjeshtë se ky fakt vërtetohet fare lehtë nga rrethanat tjera faktike. Fakti se T, ishte shpërngulur tani në fshatin S, është fakt i këtyre indikacioneve, fakti se dy javë para vrasjes ishte organizuar prita pikërisht në S. (atentati ndaj tij) është fakt i këtyre indikacioneve, fakti se dëshmitaret e lartcekur G.H dhe B.Sh specifikonin se T, kohët e fundit ka qenë i frikësuar-shqetësuar tej mase, është fakt i këtyre indikacioneve e që qon në besueshmërinë e gjykatës se indiciet që po përgatitet diçka fatale ndaj tani të ndjerit ishin indikative.

Një fakt tjetër që vërtetohet nga deklarata e këtij dëshmitari, është fakti se në një rast kur E.S ishte arrestuar në F, E.S kishte drejtuar gishtin se prapa kësaj ngjarje është T. Një fakt të tillë nuk e përmend vetëm ky dëshmitar, por edhe dëshmitari R.B që kishte akuzuar T.R se ishte prapa këtij rasti e që shpërfaq hptazi bindjen e E.S që edhe prapa veprime tjera policore ishte T.R e që e lidhë këtë drejtë për së drejti me motivin tjetër hakmarrës. E.S edhe pse me ndryshime deklaratash herr se T, e ka rrahur në “S.Casiono” e her që ia ka shpëtuar jetën, po ashtu e kishte akuzuar T edhe për rastin e “S.Casino”s duke mos ia falur atë që kishte ndodhur që qon edhe në një motiv tjetër të tij për hakmarrje.

Pra nga deklaratat e këtij dëshmitari, gjykata vërtetoi faktet e lartcekura dhe të njëjtit i'a fali besimin vetëm për fragmentet e lartshënuara pasi që të njëjtat gjenin mbështetje në dëshmitë e dëshmitarëve të lartcekur - ishin në përputhje të plotë mes vete për faktet vendimtare. Gjykata dëshmisë të këtij dëshmitari por edhe të tjerëve, ua fali besimin vetëm atëherë kur fragmentet e tyre që gjejnë përputhje në prova të tjera të administruara.

8. Nga deklaratat e dëshmitares B.M të dhëna në shqyrtimin kryesor të datës 31.03.2015, si dhe e datës 22.01.2019 ku ndër të tjera ka theksuar se kishte qenë në lidhje me të akuzuarin E.S dhe se këtë lidhje e kishte filluar dy tri javë para ngjarjes kritike të datës 30.08.2007. Në deklaratën e dhënë me datën 17.01.2008, faqen 3 të procesverbalit të marrjes në pyetje kishte deklaruar se: para se të vritet T.R, me E, ishte takuar çdo dy-tri ditë, por në telefon ishin dëgjuar çdo ditë, ndërsa ditën kur është vrarë T, po sa ishte kthyer nga vendi i ngjarjes i kishte dërguar një SMS E.S, në numër telefonit 044 ///,, por ai nuk i ishte përgjigjur” dhe kjo deklaratë nuk i kujtohej. Pas ngjarjes kritike, ishte takuar një herë ose dy me E.S dhe kishin qenë në V,. Në një rast derisa ishte duke ndenjtur në shtëpi ku ishte me E, ai i kishte thënë se: nëse do të kërkonin policia prej saj për të dëshmuar, do duhej të deklarojë se kishte parë T.R duke e sulmuar A,, ashtu që A. në vetëmbrojtje ka shtënë me revole në të”. Me E, nuk ishte takuar më pas dhënies së deklaratës në polici, por pastaj specifikon se këtë çështje nuk e kishte lidhur me A, nuk e kishte diskutuar me të dhe se ishte ndjerë në presion në Polici dhe se nuk i kujtohet se çka kishte thënë saktësisht.

Nga deklarata e dëshmitares rezulton një fakt që ajo nuk e mohon – por vetë specifikon se nuk i kujtohet pra është fjala kur pyetet për deklaratat e saj të mëhershme e ku e njëjta kishte specifikuar se ajo ishte dëgjuar me E.S çdo ditë në telefon, por i njëjti nuk i ishte përgjigjur saktësisht ditën kritike, që nga ky fragment i deklaratës, trupi gjykues ka konceptuar faktin se pikërisht për shkak të përfshirjes së drejtë për drejtë të tani akuzuarit lidhur me rastin, i njëjti nuk i është përgjigjur të njëjtës për dallim nga ditët e komunikimit të zakonshëm.

Një fakt crucial që përmend dëshmitarja është fakti si vijon: pas ngjarjes kritike, ishte takuar një herë ose dy me E.S dhe kishin qenë në V,. Në një rast derisa ishte duke ndenjtur në shtëpi ku ishte me E, ai i kishte thënë se: nëse do të kërkonin policia prej saj për të dëshmuar, do duhej të deklarojë se kishte parë T.R duke e sulmuar A ashtu që A, në vetëmbrojtje ka shtënë me revole në të”. Dëshmitarja në shqyrtim gjyqësor kishte specifikuar se nuk i kujtohet kjo ngjarja dhe se nuk e ka biseduar këtë me E.

Në bindjen e këtij trupi gjykues, është indikativ fakti se kur ka deklaruar dëshmitarja aso kohe në Polici ka qenë para ngritjes së aktakuzës ndaj A.B dhe se pretendimet e A. aso kohe kanë qenë në fazën e hetimeve dhe si është e mundur që dëshmitarja ta jap pikërisht këtë version të cilin e kishte dhënë A.. Në bindjen e gjykatës, dëshmitares pikërisht i është kërkuar ky fakt nga E.S, sepse ky ishte inskenimi dhe ideja e vet “grupit S” e që e kishte paraqitur në gjykimin ndaj tij A.B dhe që është përgënjeshtuar ky version me aktgjykimin e formës së prerë nga Gjykata Supreme.

Gjykata nuk e beson faktin dhe nuk e merr të mirqenë pretendimin e disa dëshmitarëve se ata janë kërcënuar e kanë pasur presione në Polici, për aq kohë sa as njëri prej tyre nuk i ka paraqitur këto raste në instanca përkatëse dhe këto raste nuk kanë marrë ndonjë verdikt. Në një logjikë të tillë, në çdo rast do të mund të aludonin dëshmitarët se janë kërcënuar me qëllim që deklaratat e tyre të mos merreshin për bazë. Në atë kohë janë dëgjuar me dhjetëra dëshmitarë që konfirmojnë këto fakte në gjitha fazat e procedurës, por ata që ishin të afërt me “grupin e S” pretendojnë se deklaratat e tyre u sajuan duke i ndryshuar ato në shqyrtim gjyqësor pasi që ishin kuptuar pretendimet e aktakuzës. Kjo gjykatë specifikon, se dëshmitari që në momentin e parë kur merret në pyetje informohet me të drejtat e veta, e po ashtu për faktin se mund të parashtroj vërejtje, si dhe e gjithë deklarata konfirmohet me nënshkrimin e tij/saj. Të gjitha këto rrjedha procedurale

janë ndjekur dhe se dëshmitaret nuk kanë paraqitur asnjëherë vërejtjeje e për më tepër nuk kanë iniciuar ndonjë rast të mos trajtimit adekuat apo trysnisë nga ana e policisë.

9.Për gjatë shqyrtimeve gjyqësore është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit M.K.

I njëjti përgjatë deklaratave të tij të dhëna ka shpjeguar përvojën e tij dhe ka specifikuar se nuk është njohur personalisht me T.R. Me datën 30.08.2007, ditën kritike, kishte qenë duke punuar në Drejtorinë e Krimeve të Rënda ku edhe aktualisht punon. Provat të cilat ishin mbledhur gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe pranimit të tyre janë bërë në përputhshmëri të plotë me zingjirin e ruajtjes dhe shënimit të tyre. Kishin pranuar informata të shumta nga Drejtoria e Analizës së Inteligjencës lidhur me grupin që atë kohë e udhëhiqte E.S, i cili kryente vepra të ndryshme penale.

Pra edhe nga deklarata e M.K vërtetohet se në atë kohë ekzistonte grupi i ashtuquajtur "S" e të cilin e udhëhiqte E.S.

Edhe nga informatat zyrtare që posedonte aso kohe M.K, vërtetohen faktet që i ka vërtetuar më sipër kjo gjykatë përgjatë deklaratimit të dëshmitarëve. Sipas informacioneve të cilat i kishin, ky grup përbëhej prej E.S, I.A (L), Rr.A (Rr), F.A po ashtu tani i përfshirë në vrasje dhe shumë të tjerë. Sa i përket T.R, disa raste kishin qenë të hapura në cilësi të viktimës, lidhur me E.S dhe grupin e tij, dhe këto shënime ishin marrë nga raportet policore dhe sistemi i bazës së të dhënave policore, dhe në ato raporte asnjëherë nuk përmendet ndonjë rast mes T, dhe A.B.

Në mënyrë të përsëritur për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, ri-konfirmohet fakti se prapa sulmeve e kërcënimeve ndaj T, ishte E.S.

Dëshmitari më tej kishte specifikuar se pas marrjes së rastit dhe ekzaminimit të dëshmisë dhe të gjitha informacioneve, është vërtetuar saktë se A.B është pjesë e "Grupit S" dhe kjo vërtetohet me shumë dëshmi.

Pra edhe dëshmitari M.K vërteton faktin që kishte vërtetuar kjo gjykatë nga deklarata e F.Sh e Dëshmitarit D2, se A.B ishte pjesë e "grupit S". Më tej faktin që e kishte specifikuar dëshmitari F.Sh e specifikon edhe dëshmitari M. se në bazë të informacioneve që kishte, A.B kishte punuar për E.S duke punuar në biznesin e tij "B.Kafe".

Se A.B ishte pa-mëdyshje pjesë e "grupit S.", vërtetohet edhe nga provat materiale e të cilat do të trajtohen më poshtë përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi – komunikimet me sms.

Edhe nga deklarata e këtij dëshmitari, gjykata ka ri-konfirmuar faktet e deri tanishme, se ekzistonte "grupi S." dhe në krye të së cilës ishte E.S, po ashtu se prapa çdo sulmi, kërcënimi ndaj T ishte E.S me njerëzit e tij dhe se pjesë kryesore e grupit ishin shumë persona e në veçanti, I.A (L), Rr.A (Rr), F.A e të tjerë. Kjo gjykatë edhe me këtë dëshmitar, vërtetoi edhe njëherë faktin se A.B ishte pjesë e "grupit S" dhe punonte në biznesin që udhëhiqte E.S "B.Kafe". Gjykata përkitazi me faktet që i ka vërtetuar edhe nga ky dëshmitar, të njëjtit i'a falë në plotni besimin për fragmentet e lartshënuara, për faktin se të njëjtat kishin mbështetje të plotë në dëshmitë e lartshënuara.

10.Nga deklaratimet e dëshmitarit F.G, është specifikuar se funksioni i tij gjatë vitit 2007, kur edhe kishte ndodhur ngjarja kritike e datës 30.08.2007, kishte qenë shef i sektorit për hetimin e krimeve të rënda, në të njëjtën drejtori. Ditën kritike, ishte informuar nga zingjiri komandues Qendra Operative – Prishtinë, se në lagjen "D" kishte ndodhur një vrasje dhe viktimë ishte zyrtar policor (fakt ky jo kontestues). Pas marrjes së njoftimit kishte shkuar në vendin e ngjarjes ku kishte qenë prezent edhe prokurori i rastit O.M, dhe dëshmitarët që ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes kishin dëshmuar se personat që kishin kryer vrasjen ishin nga "Grupi S". Pra edhe njëherë ri-konfirmohet nga ky dëshmitar se të gjitha informatat dërgonin se prapa vrasjes së T. ishte "grupi S".

Më tej dëshmitari ka specifikuar se si ishte informuar që kishin marr urdhër gojor për bastisje dhe mënyrën se si kishin ndërruar veprime, por këto veprime nuk zbulojnë rrjedhën e ngjarjes në kuptim të fakteve kontestuese – gjendjes faktike, andaj kjo gjykatë nuk do të lëshohet më tej në elaborimin e këtij dëshmitari dhe se çështjen e pranushmërisë së këtyre provave si vërejtje e Gjykatës së Apelit, kjo gjykatë do ta trajtoj në një pjesë të veçantë përkitazi me të gjitha vërejtjet që ka konstatuar Gjykata e Apelit e po ashtu edhe lidhur me vendosjen e kësaj gjykate tani, përkitazi me këto prova.

11.Për gjatë deklaratave të dëshmitarit L.M, i njëjti ndër të tjera ka theksuar se në vitin 2007, ka punuar në Drejtorinë e Krimeve të Rënda, në nivelin Qendror në Drejtorinë e Policisë me gradën nën kolonel, thujse e tërë karriera e tij ka qenë në fushën e hetimeve. Ditën kritike, me datë 30.08.2007, kur është vrarë oficeri policor T.R, kishte qenë në detyrë. Për shkak të historikut pothuajse të njohur që T.R kishte pasur problem me E.S, sigurisht se mendja e të gjithëve ka mundur të shkojë se mund të ketë lidhje me E.S.

Edhe nga deklarimi i dëshmitarit L.M i cili ishte me gradë nën kolonel, konfirmohet se e kaluara në mes të konfliktit të E.S ndaj T, tani më ishte çështje e ditur.

Dëshmitari i lartcekur duke shpjeguar rrjedhën e ngjarjes dhe veprimet hetimore që kanë ndërmarrë, specifikonte se personi i cili kishte shtënë në T, ishte i panjohur dhe rrethanat se si kishte shtënë në të tregojnë se ka dalë pikërisht për të kryer vrasjen pasi që nuk kishte pasur ndonjë konflikt aty për aty. Fakti se të shtënat me armë ndaj T nuk ishin të rastësishme por të planifikuara, konfirmohet edhe nga aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Supreme ndaj dorasit A.B, që përgënjeshtrojnë pretendimet e A.B.

Deklarimi i dëshmitarit më tej shpjegon rrjedhën e ngjarjes se si kanë ndërmarr veprimet hetimore dhe bastisjet, megjithatë kjo gjykatë këtë çështje do ta trajtoj tek provat materiale të cilat janë marrë nga bastisjet, pasi që kjo çështje është ngritur nga Gjykata e Apelit e që është kërkuar që kjo gjykatë të shqyrtoj ligjshmërinë e tyre, andaj lidhur me këto prova dhe vërejtjet e Gjykatës së Apelit, kjo gjykatë do të jap sqarimet e veta në vijim të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë nga deklarata e L.M ka vërtetuar faktin se kush ishte E.S dhe se problemet që kishte ai ndaj T. e dinin të gjithë, fakt ky që tani është vërtetuar nga çdo dëshmitar i elaboruar, andaj në këtë fragment kjo gjykatë i'a fali besimin. Nga deklarata e të njëjtit që gjen ndërlidhet edhe me aktgjykimin ndaj dorasit A.B, por edhe provat tjera që do të trajtohen për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, konfirmojnë faktin se vrasja e T nuk kishte ndodhur rastësisht, por ishte e planifikuar.

12.Në cilësi të dëshmitares ishte dëgjuar edhe dëshmitarja D.H: e njëjta tani me profesion avokate, ish gjyqtare Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në këtë çështje penale kishte udhëhequr procedurën paraprake hetimore lidhur me vrasjen e policit T.R që kishte ndodhur më datën 30.08.2007. Lidhur me urdhrat dhe urdhëresat në ditët e para të vrasjes së T.R, është vërtetuar se në kallëzimin penal të parashtruar nga Policia e Kosovës, ishin disa emra të pandehurve për të cilët seanca e paraburgimit ishte mbajtur në ndërtesën ku ndodheshin zyrat e Prokurorisë Speciale, mirëpo emrat e të pandehurve, të mbrojtësve, të prokurorëve dhe policëve nuk i kujtoheshin. Me siguri të plotë kishte deklaruar se kishte lëshuar urdhra sa i përket këtij rasti mirëpo në pyetjen specifike të prokurorit lidhur me bastisjen e lokaleve, pronave, lokalit “S,” nga Policia e Kosovës, në mbrëmjen e datës 30.08.2007, nuk i kujtohej të ketë lëshuar urdhër verbal dhe as se kishte lëshuar urdhrin verbal të cilin i'a kishte komunikuar gojarisht përmes telefonit zyrtarit të lartë të policisë L.M, mirëpo nëse policia e kishte kontaktuar në telefon për ndonjë urdhër verbal për bastisje për ndonjë rast urgjent, me siguri se do ta lejonte këtë dhe do të kërkonte nga policia që brenda afatit 12 orësh, t'i dorëzonin në zyrën e saj kërkesën me shkrim për bastisje, të cilën kërkesë do ta kontrollonte dhe verifikonte, që bastisja (kontrolli) të kryhej në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtë do ta vërtetonte me anë të nënshkrimit të saj që do të

vërtetohej se kërkesa është shqyrtuar në zyrën e saj dhe ishte njoftuar, edhe sikur ndonjë nga zyrtarët policor do ta kontaktonte përmes telefonit, për të kërkuar lëshimin e një urdhri verbal si rezultat i një situatë emergjente, pa i përmendur hapësirat e ndryshme për bastisjen e hapësirave të ndryshme, sigurisht se nuk do të lëshonte një urdhër të tillë pa i ditur specifikat e rastit dhe mënyra tjetër përmes së cilës do t'i nënshkruante dokumentet e policisë do të ishte e mundur të bëhej në formë të një shënimi zyrtar i cili do të vërtetonte se një urdhër i tillë kishte ekzistuar. Lidhur me urdhrin për ekzaminimin e 6 (gjashtë) telefonave, për dëshmitë e gjetura në kafenenë "S" si dhe me aktvendimin me të cilin ishte urdhëruar zbatimi i masës së paraburgimit, përveç kërkesës së prokurorit kishte edhe dëshmi tjera bashkëngjitur kërkesës në fjalë, mirëpo ishte e bindur se urdhrin e kishte lëshuar vetëm duke u bazuar në kërkesën e prokurorit dhe se nuk kishte pasur kohë që t'ia hidhte një sy dhe të lexonte tërë dosjen e rastit për të parë nëse ato ishin aty, pasi që policia ishin duke pritur me urgjencë një urdhëresë të tillë dhe atë javë kishte qenë gjyqtare në kujdestari dhe kishte pasur 20-30 raste, gjykata atë kohë ishte e stërngarkuar.

Pa u lëshuar në detaje në deklaratën e lartcekur edhe pse e njëjta deklaratë ka disa kundërthënie, kjo gjykatë specifikon se deklarata e dëshmitares nuk kishte relevancë lidhur me gjendjen faktike por vetëm me rrjedhën e procedurës, respektivisht me bastisjen. Pa hyrë në specifika të komunikimeve gjyqtar – zyrtar policor (dhe pa u lëshuar edhe në faktin se pse nuk është urdhri retroaktiv pjesë e shkresave të lëndës), për gjykatën mjafton që pjesë përbërëse e shkresave të lëndës nuk rezulton të jetë urdhri retroaktiv nga gjykata e që ka shpërfaqur nevojën e domosdoshme ligjore për të ri-konfirmuar po që se këto prova janë ose jo të pranueshme, e që në detaje do të argumentohet kjo pjesë në vijim të arsyetimit të aktgjykimit.

13.Përgjatë rrjedhës së procedurës është vazhduar tutje edhe me deklaratën e dëshmitares K.B dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësorë të datës 07.10.2021 e cila kishte deklaruar se mbetet pranë deklaratave të dhëna më herët dhe me këtë rast janë lexuar deklaratat e saj të dhëna më datë 17.01.2007, 21.11.2014 dhe 22.01.2019.

Rr.A është bashkëshorti i saj, të cilin për herë të parë e kishte takuar në muajin nëntor të vitit 2006, atë kohë punonte në një shitore në lagjen D, dhe kishte shkuar për të blerë kafe në "Kafe Bar S." në të cilën kalonte kohën edhe Rr, aty ku edhe ishin njoftuar. Rr. kishte nofkën "Rr", të cilin e takonte thujse për çdo ditë e shumë shpesh në "Kafe Bar S". Rr, shoqërohej shumë me kushëririn e tij I.A.

Në këtë fragment të deklaratës së dëshmitares, konfirmohet tani fakti i vërtetuar se Rr.A kishte nofkën "Rr" dhe e i njëjti frekuentonte thujse çdo ditë "Kafe Bar S" dhe se personi me të cilin ai shoqërohej më së shumti ishte I.A me nofkën "L".

Për personin me emrin A, e njëjta kishte deklaruar se ishte A.B, shok i Rr të cilin e kishte parë në kafenenë e S.s derisa e njëjta shkonte për ta takuar R.A edhe para vrasjes së T.R. Në gusht të vitit 2007 ka theksuar se të njëjtin e ka parë tri- katër herë në përgjithësi ndërsa kur e njëjta është ballafaquar nga ana e prokurorit me deklaratën e dhënë në prokurori në të cilën kishte deklaruar se "Unë shpesh e kam parë A.B në kafenenë e S, para vrasjes së T.R" dhe se a është e vërtetë e njëjta ka deklaruar se "po". Me A.B ishte shoqëruar derisa ishte me shogën e saj Sh.I e cila ishte dashnorja e tij. Pas ngjarjes kritike, Rr. e kishte parë në shtëpinë e tij për 5-10 minuta pas disa muajve, sepse i njëjti ishte në arrati. Në dëshminë e saj kishte pranuar faktin se ditën kritike e kishte kontaktuar A.B në numrin e telefonit 044 ///, me të cilin kishte biseduar dhe e kishte pyetur për Rr. Në "Kafe Bar S" ishte shoqëruar me Rr. I dhe A, ndërsa me N.S dhe E.S asnjëherë dhe atë akuzuarin as që e kishte përshëndetur dhe as që kishte pasur ndonjëherë kontakt me të. Me Rr, I, E.Z dhe A.B kishin shkuar edhe në lokale tjera si :restorant P, në Gj. Në Qamërlia, në M dhe fshatin S. E.Z ishte e dashura e I.A.

Nga secili dëshmitar deri tani që është elaboruar ishte vërtetuar një fakt thelbësor, që Rr.A (Rr) dhe I.A (L) ishin njerëzit më të afërm të E.S dhe ata njiheshin si “grupi S” dhe se prapa sulmeve e përcjelljeve ndaj T.R qëndronte E.S me të lartcekurit.

Intenca e vrasësit të T.R (të dënuarit – e në rastin tonë dëshmitarit) A.B, ka qenë fillimisht që të shmangë faktin se ka qëndruar gjithherë në “Kafe Bar S”. Fakti se ai dilte shpesh në “Kafe Bar S” vërtetohej edhe nga deklaratat e dëshmitarit V.R, e një fakt i tillë konfirmohej edhe nga deklaratat e dëshmitarit F.Sh që deklaronte se ishte e pa mundur të kaloje kah “Kafe Bar S” e mos ta takoje aty A.B dhe ky fakt tani konfirmohet edhe nga dëshmitarja K.B që specifikon të njëjtin fakt madje të njëjtin e ka parë aty gjatë gjithë kohës e edhe gjatë muajit Gusht pak para se të vritej T.R

Se A.B ishte pjesë e “grupit Sekriaqa” tani më është konstatuar nga provat e mbledhura dhe se fakti se sa i afërm ishte A.B me Rr.A (R) dhe I.A (L) vërtetohet pikërisht edhe nga dëshmitarja K.B e cila rrëfen disa raste e ndenja që kanë qenë bashkërisht.

Andaj edhe njëherë nga dëshmia edhe e kësaj dëshmitare, vërtetohet fakti se A.B qëndronte shpesh në “kafe bar S” dhe shumë shpesh edhe për gjatë muajit Gusht dhe se tani ai ishte identifikuar si pjesëtar i “Grupit S” dhe se ai ishte personi më i afërt i Rr.A (Rr) dhe I.A (L) personat të cilët së bashku me E.S në krye ishin prapa çdo sulmi ndaj T.R.

14.Dëshmitari Xh.B kishte dhënë deklaratë në polici më datën 05.09.2007 dhe në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë më datën 19.01.2022.

Në deklaratën e tij në polici, kishte theksuar se ditën kritike të datës 30.08.2007 kishte shkuar në lokalin S, rreth orës 14:15, ku aty kishte takuar personat N, A. N.S dhe dy kamarierët që ishin në lokale. Ai ka potencuar shkuarjen në lokal se N, i i kishte mbetur disa euro borxh dhe kishte shkuar për t’ia kërkuar dhe më pas kishte vazhduar të qëndroj në lokale, kishte pirë kafe dhe sipas tij N, ja kishte përmën borxhin dhe ma pas rreth orës 15:10, ai ishte qar dhe ishte dal nga lokali, ku kishte shkuar në një lokal tjetër. Dëshmitarit i ishte prezantuar fotoja me numër evidence T-1 dhe më pas ai e ka identifikuar si A.B që e njihete kohë më parë në shkollë dhe se atë ditë e kishte parë në parking para se të hynte në lokalin S, ku A. e kishte ngushëlluar për babgjyshin që i kishte vdekur dëshmitarit kohë më parë. Dëshmitari po ashtu është pyetur se a e kishte parë me kënd shoqërohej A, i dhe ai është përgjigjur se A, ishte shoqëruar pikërisht me personin “Rr” dhe ishte gjithnjë sipas dëshmitarit me veturat e “grupit S”.

Një fakt të tillë se ditën kritike A.B kishte qenë në “Kafe Bar S” e kishte konfirmuar edhe nga vet ai, por ishte konfirmuar edhe nga dëshmitari i lartcekur D-2 ku kishte konfirmuar faktet e njëjta e nga arsyet e të cilës gjykata ka nxjerr fragmentet e besueshme.

Tutje ky dëshmitar ndryshon deklaratën e tij në shqyrtimin gjyqësor duke aluduar faktin se nuk e ka parë A.B atë ditë në “Kafe Bar S.

Se deklarata e tij tani në këtë fragment ishte haptazi e ndryshuar në favor të të tjerëve ,vërtetohet nga vet fakti i pohimit përfundimtar të A.B, se para vrasjes së T, ditën kritike i njëjti ishte në “Kafe Bar S”, që rezulton se deklarata e parë e dëshmitarit ishte versioni i vërtetë.

Dëshmitari ka specifikuar edhe faktin se kinse ishte keqtrajtuar nga Policia kur është marrë në pyetje, por gjykata nuk i’ a fal besimin në këtë fragment për faktin se deklarata e tij e parë në Polici rezulton haptazi të jetë e vërtetë, sepse faktet ashtu siç i ka konstatuar vetë dëshmitari në deklaratën e tij të parë, janë fakte që i ka konfirmuar vet A.B në shqyrtimin e fundit gjyqësor, andaj kjo gjykatë tani ka vërtetuar faktin se A.B ditën kritike pak para se të vritej T.R ishte në “Kafe Bar S” dhe nga aty kishte dal i armatosur dhe i kishte shkuar në pritë tani të ndjerit për ta privuar nga jeta.

15,16.Në shqyrtimin gjyqësor janë dëgjuar edhe dëshmitaret O.M që ishte prokuror ditën kritike e po ashtu edhe dëshmitari N.R që aso kohe ishte zyrtar policor dhe kishte qenë në disa lokacione në bastisje lidhur me ngjarjen.

Të dy dëshmitaret vetëm kanë shpjeguar rrjedhën e ngjarjes me veprimet procedurale që të njëjtit i kanë ndërmarrë e që janë kontestuar nga Gjykata e Apelit, e siç është specifikuar edhe disa here për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, gjykata këto prova do ti trajtoj në mënyrë të veçantë në një pjesë të arsyetimit të këtij aktgjykimi. Meqë deklaratat e tyre nuk lidhet me çështjet faktike të objektit të aktakuzës, gjykata nuk do të lëshohet më tej në vlerësimin e këtyre deklaratave pasi që provat e marra me bastisje do të trajtohen në mënyrë të veçantë nga kjo gjykatë.

17.Nga dëshmitarët po ashtu kryesore në këtë shqyrtim gjyqësorë ishte A.I. Dëshmitarja konfirmon se me T.R kishte filluar një lidhje me datë 27.09.2005. E njëjta fillimisht në seancën kur ajo është marr për herë të fundit në pyetje (është fjala për këtë shqyrtim gjyqësor) është pyetur lidhur me lidhjen e saj dhe T.R se a ishte e njëjta në lidhje me T.R kur ka ndodh rasti i “S.Casinos”, e njëjta ka theksuar se besoj që po, edhe pse në momentin kur ka deklaruar nuk i kujtohet a ka qenë në paralidhje apo në lidhje, sepse në fillim kanë qenë shok, i kujtohet se kur ka ndodhur rasti i “S.Casinos” kanë qenë Krishtlindjet, dhe se lidhur me këtë rast ka deklaruar se T. si ka dhënë detaje, por i ka treguar që ka ndodhur diçka ka insistu me ditë më shumë rreth këtij rasti por nuk i ka treguar T, me siguri mos ta shqetësonte, ajo ka potencuar se e ka ditur që bëhet fjalë për “Grupin S.”, e njëjta po ashtu është pyetur se kush ka qenë pjesë përbërëse e këtij grupi ajo ka deklaruar se E.S dhe plotë të tjerë që nuk i kujtohen, sepse kanë pasur edhe nofka. Para ngjarjes kritike të datës 30.08.2007, ajo kishte deklaruar se ka qenë në dijeni se T. ka pasur probleme me “Grupin S”, probleme me profesion me ta që ka qenë i ngacmuar nga ata, e njëjta ka theksuar se T. kishte ndjenjën se po përcillej dhe si rast specifik ishte kur T, ishte duke e dërguar tek shtëpia e gjyshes së saj, atë kohë quhej rruga “S.M” dhe këtë e kishte kuptuar në një moment kurë T, i kishte thënë: “mos u kthe prapa, mos provoko, i kemi ata prapa po na ndjekin” dhe ata që po i ndiqnin ishin nga “Grupi S.”. Ndjekje të tjera kishte edhe te Qafa, mandej në lagjen e T., dhe përgjatë seancës të datës 18.11.2022 e ka përmendur edhe rastin që ka ndodhur në fshatin e T. fshatin S. ë ku i njëjti i ka treguar se sipas tij janë “Grupi S”.

Nga dëshmitarja A.I e që në periudhën kohore 2005-2007 ishte njëri nga personat më të afërm të T., vërtetohet fakti se sulmet, përcjelljet, kërcënimet e përndjekjet ndaj T. ishin të shpeshta. Nga deklaratat e saj vërtetohet fakti që e ka potencuar thujse çdo dëshmitar që është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor e që rezulton me konstatimin se aso kohe ekzistonte i ashtuquajtur “grupi S”, në krye të së cilës ishte E.S. Nga deklaratat e saj sërish vërtetohen faktet se është përcjellë T. dhe dëshmitarja përmend dy raste kur ka qenë edhe vet e pranishme e që janë konstatuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve që janë specifikuar më sipër për gjatë arsyetimit të aktgjykimit e që janë raste që dëshmitarja ka qenë dëshmitare okulare, pra rasti kur T ishte duke e dërguar tek shtëpia e gjyshes së saj, atë kohë quhej rruga “S.M” dhe këtë e kishte kuptuar në një moment kur T. i kishte thënë: “mos u kthe prapa, mos provoko, i kemi ata prapa po na ndjekin” dhe ata që po i ndiqnin ishin nga “Grupi S”. Ndjekje të tjera kishte edhe te Qafa, mandej në lagjen e T., pra prapa të gjitha këtyre ishte “grupi S” në krye me E.S.

Në bazë të deklaratës së dëshmitares, ri-konfirmohet fakti tani i vërtetuar se afërsisht dy javë para vrasjes së T. ishte përgaditur një atentat ndaj T në fshatin S., ku aj qëndronte më shumë kohëve të fundit atje pikërisht nga frika prej “grupit S”. Aty të njëjtit i ishte zënë pritë duke i vendosur gurë e druje në rrugë për të ja rrokullisur veturën. Këtë fakt, dëshmitarja si një nga personat më të afërt të T. aso kohe e ka mësuar nga vet T. ku i njëjti u’a kishte rrëfyer këtë edhe babait të tij, vëllait të tij dhe shokëve të tij të afërt e që prapa këtij sulmi ishte “Grupi S”.

Është në interes të rrjedhës së ngjarjes të specifikojmë edhe njëherë faktin se pas lidhjes së T. me tani dëshmitaren A.I, motivet hakmarrëse të tani akuzuarit E.S ndaj të ndjerit ishin të qarta

dhe sulmet, kërcënimet e përcjelljet nga E.S personalisht dhe nga grupi i tij tani më nuk kishin të ndalur, sepse dëshmitarët- njerëzit e afër të T rrëfejnë se inteziteti vetëm sa rritej dhe se rasti i S, ishte indikacion i qartë se vendimi për vrasjen e T. tani më vetëm se ishte marrë nga E.S..

Për gjatë shqyrtimit gjyqësor, anëtari i trupit gjykues e kishte pyetur dëshmitaren lidhur me atë se disa herë përgjatë deklaratës së saj në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë ka specifikuar se shumë gjëra nuk i kujtohet për shkak të kohës që ka kaluar dhe e njëjta është pyetur se: A do të duhet që kujtesa e saj në lidhje me rastin të ishte më e kthjellët në deklaratat e mëparshme se sa atë to sotmen duke marrë parasysh kohën që ka kaluar, e njëjta është përgjigjur se *“po besoj, që në kujtesën e saj ka ndikuar koha e gjatë, por edhe trajtimi mjekësor që ka marrë pas asaj ngjarje”*. Në këtë kontest, rikujtojmë faktin se në deklaratën e saj në polici e njëjta kishte deklaruar se mendon se E.S e ka nxitur A.B ose e ka paguar për ta vrasur T.

Lidhur me A.B, e njëjta ka specifikuar se nuk e ka njohur kurrë dhe se T. nuk e ka përmendur asnjëherë që ka pasur problem me të, po ashtu T. nuk ka përmendur asnjëherë se kishte problem me dikë tjetër përveç E.S me grupin e tij (fakt ky i konstatuar nga secili dëshmitar – familjar – shok - i afërm i T).

Lidhur me “Grupin S” e njëjta ka ri-konfirmuar se kishin pasur probleme edhe si familje, (fakt ky i vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitares M.I dhe Z.I që deklaratat e tyre do të trajtohen në vijim). Ka specifikuar se si familje kishin denoncuar në polici personat me nofken “Rr” dhe “L” (që tani është vërtetuar se ishin nga personat kryesor që ekzekutonin urdhrat e E.S

Përfundimisht nga deklarata e kësaj dëshmitare, gjykata ka vërtetuar faktet si vijon: se familja saj kishte probleme me grupin S, se pastaj e njëjta kishte hyrë në lidhje dashurie me tani të ndjerin, se i ndjeri prej se kishte hyrë në lidhje me të, ishte përcjellë e përndjekur nga grupi S, në krye të së cilës dhe prapa së cilës qëndronte E.S, se kishte atentate ndaj të ndjerit pikërisht nga E.S me grupin e tij, se T, nuk kishte problem me askënd tjetër përveç të lartcekurve e as me A.B. Gjykata ia fali besimin këtyre fragmenteve të dëshmitares, për faktin se të njëjtat specifike gjejnë mbështetje edhe në provat e lartcekura e të elaboruara deri më tani.

18.Në vazhden e deklaratave të dëshmitarëve, gjykata ka analizuar edhe deklaratën e dëshmitares E.I, e dhënë në seancat e shqyrtimit gjyqësorë ku ndër të tjera e njëjta ka theksuar se, gjatë periudhës kohore të viteve 2002-2003, kishte një sallon për rregullimin e flokëve, më pas kishte pasur një kompani të marketingut. T.R e kishte njohur para kohës së luftës përmes shoqes së saj, kishin shoqërinë e përbashkët. Me të njëjtin kishte pirë kafe disa herë derisa ai ishte me A. Kohën kur punonte në sallonin e bukurisë, T. e kishte takuar vetëm njëherë ndërsa kur i njëjti kishte filluar lidhjen me motrën e saj A., e kishte parë më shpesh. E njëjta specifikon edhe persona të “Grupit S” dhe një problem që kishte pasur, por që nuk ndërlihet me rastin.

Lidhur me T, kishte specifikuar se, po ai më tha atë që është duke u përcjellë nga dikush prej “Grupit S”, ku e ndiqnin me makina të njëjtin. E po ashtu e njëjta ka potencuar faktin se ka qenë në dijeni që T, dhe A. kanë pasur probleme me “Grupin S” por asnjëherë me vrasësin e T.R A.B. Lidhur me rastin e “S. Casinos” e njëjta ka deklaruar se ka dëgjuar për këtë rast pasi që ka ndodh rasti, T. e ka thirr në telefon dhe i ka treguar por jo në detaje. Ditën kritike kur është vrasur T.R ka deklaruar se ka qenë në qytet, dhe se i kujtohet se dikush nga fqinjët i ka telefonuar lidhur me rastin dhe ka shkuar drejt në spital, lidhur me vrasësin e T.R, A.B ka deklaruar se kurrë nuk ka dëgjuar më parë për emrin e tij, e qoftë T, e qoftë A, asnjëherë nuk e kanë përmendur se kanë pasur ndonjë problem e të njëjtin. Në fund e njëjta ka potencuar edhe njëherë faktin se e njëjta kishte qenë në dijeni për problemet që ka pasur A me T, me të ashtuquajturin “Grupin S.” por asnjëherë me personin e quajtur A.B.

Nga deklarata e tani dëshmitares E.I, vërtetohen faktet tani të konstatuara nga kjo gjykatë se: ekzistonte i ashtuquajturi “Grupi S”, se T kishte probleme të vazhdueshme me ta dhe se s’kishte

probleme me dikë tjetër dhe se asnjëherë nuk është përmendur nga askush A.B se kishte T, ndonjë problem me të. Në këto fragmente gjykata ia fali besimin dëshmitares, për faktin se faktet e vërtetuar nga e njëjta janë konstatuar disa here nga gjykata në mbështetje të provave të administruara e të elaboruara më sipër.

19.Edhe Deklarata e dëshmitares Z.I ishte kryesore për vërtetimin e fakteve thelbësore, e njëjta ishte e kurtë – konkrete dhe konsistente ndaj gjitha deklaramëve të saj. Lidhur me fragmentet e saj që kanë ndërlidhje me objektin e çështjes, e njëjta kishte rrëfyer se me F.Sh ishte takuar për herë të parë në vitin e parë të shkollës së mesme fillimi i vitit 2000, më të cilin kishte qenë në të njëjtën klasë. Në fillim kishin qenë vetëm shokë, mirëpo pas dy vitesh lidhja e tyre ishte qift, lidhje e cila kishte përfunduar një vit më parë nga koha kur deklaroi, në vitin 2014. Lidhur me T.R ka deklaruar se i njëjti ka qenë i dashuri i motrës së saj A, dhe se lidhjen ata e kanë filluar në vitin 2005, ku fillimisht T, së bashku me shokun e tij A.S kanë shkuar në sallën të ondulimit të motrës së saj E. dhe i kanë thënë a keni nevojë për ndihmë, pasi që të njëjtit ishin informuar se familja e saj kishin probleme me “Grupin S” në mënyrë që ata t’i ndihmonin.

Sa i përket problemeve me “Grupin S” ka shtuar se e din që A.ka pasur probleme me E.S dhe anëtarët e grupit të tij, ku përpos A, edhe M,dhe E, kanë pasur të raportuara raste në polici por askush nuk është dënuar.

Nga vetë deklarata e dëshmitarës Z.I, konfirmohet e vërtetohet fillimisht fakti tani më i vërtetuar se ekzistonte i ashtuquajtur “grupi S” dhe se vet familja e saj kishin probleme me këtë grup e ku mbrojtje ju kishte ofruar T.R dhe A.S.

Sa i përket problemeve të T, dhe E, ka shtuar se që nga viti 2000 të njëjtit kanë pasur probleme në vazhdimësi e deri tek rasti i “S.Casino”, ku e njëjta ka shtuar se ajo ishte në dijeni se të njëjtit ishin në armiqësi, sepse kur dy njerëz përlëshen me njëri tjetrin ata nuk janë miq por armiq. E njëjta përgjatë deklaratës së saj ka përmendur edhe personin e quajtur Gj.K (tani dëshmitar në këtë proces si ndërmjetësues për pajtim në mes të E.S e A.S, e siç u potencua më sipër kjo deklaratë e tij do të trajtohet në vijim të këtij aktgjykimi. Dëshmitarja specifikon se i dashuri saj aso kohe tani dëshmitari F.Sh, kishte pasur afërsi dhe i njëjti mirë edhe E.S dhe pjesëtarët e grupit të tij, por edhe T.R.

Tutje e njëjta është pyetur lidhur me atë se kush e ka vrarë T.R, ku e njëjta ka deklaruar se A.B e që të njëjtin nuk e njeh por vetëm përmes lajmeve është informuar, ndërsa lidhur me atë se me kënd është shoqëruar A.B, ka deklaruar se F.Sh e kishte informuar se A.B ishte anëtar i “Grupit S” dhe më së shumti ishte shoqëruar me “L”, i cili ka qenë po ashtu anëtar i “Grupit S”.

Lidhur me raportet e motrës së saj A. me E.S, e njëjta kishte specifikuar se A, nuk e kishte pohuar ndonjë lidhje të saj me E.S, mirëpo ekzistonte një lidhje me të, dhe ajo nuk dukej atë kohë e lumtur. Se A. kishte shkëputur lidhjet me E.S, ishte bindur kurë gjatë vitit 2004-2005, kur ajo filloi të dilte me T.R.

Nga deklarata e dëshmitarës e të cilës kjo gjykatë i’ a falë në tërësi besimin, për faktin se siç u specifikua edhe më sipër e njëjta në të gjitha deklaratat e saja ka qenë konsistente në rrëfimet e saj, gjykata ri-vërteton faktin tani të konfirmuar nga secili dëshmitar, se ekzistonte “grupi S” dhe në krye të këtij grupi ishte E.S. Nga deklarata e dëshmitarës vërtetohet fakti se vet familja saj kishte probleme me këtë grup dhe se kishte qenë T.R dhe A.S që ishin ofruar për t’i mbrojtur. Nga deklarata e saj, ri-vërtetohet fakti që e kishte konfirmuar edhe dëshmitarja M.I se A. kishte një lloj raporti me E.S dhe se atë kohë ajo nuk ka qenë e lumtur dhe se shkëputja e saj përfundimtare nga E.S kishte ardhur kur ajo ishte lidhur me T.R. Nga dëshmia e dëshmitares vërtetohet se A.B ishte pjesëtar i “grupit S.” dhe afërsinë më të madhe e kishte me anëtarin tjetër të këtij grupi siç i referohet me pseudonimin “L”, dhe për këtë ishte në dijeni nga dëshmitari F.Sh e që ky tregim i dëshmitarës gjenë mbështetje të plotë nga deklarimi i dëshmitarit F.Sh, që

kishte edhe raporte të afërta me vet “grupin S” që ka ri-konfirmuar faktin se A.B ishte në “grupin S”.

Nga deklarata e dëshmitarës po ashtu ri-konfirmohet fakti se T. dhe E. kishin probleme që nga vitet 2000-2001, por që eskalimi i problemeve mes tyre si aj i “S.Casinos” e tutje vijnë pas lidhjes së T me A. (që ka qar në dimension tjetër këtë konflikt).

20.Kjo gjykatë ka trajtuar dhe analizuar edhe deklaratën e vrasësit të T. tani më të dënuarit me aktgjykim të formës së prerë A.B i cili është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit. I lartcekuri përgjatë seancës gjyqësore shihet lehtë dhe qartazi se deklaratat e tij ndryshojnë nga deklarata në deklaratë për faktet kryesore.

I njëjti, përgjatë seancave gjyqësore është pyetur edhe për gjendjen e tij financiare, ku nga deklaratimet e tij nëpër shqyrtime gjyqësore ka pasur kundërthënie mes deklaratimeve të tij si në vijim: i njëjti në seancën e datës 29.10.2015 kur është pyetur lidhur me gjendjen e tij financiare ka deklaruar se “*gjendja e tij financiare ishte e varfër pra merresha me vetura i bleja veturat me çmime të ulëta dhe i shisja me çmime të larta*”, ndërsa në seancën e datës 23.01.2023 kur është pyetur lidhur me gjendjen financiare të tij në vitin 2007 i njëjti ka deklaruar se “*nuk ka qenë as e varfër, as e pasur, por ka qenë mesatare*”. (nga kjo pjesë e deklaratës vetëm se nxjerrët konkludimi i kredibilitetit të dëshmitarit se sa kontradiktor është.)

Kishte dhënë deklarata kundërthënëse me njëra tjetrën, ku në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.05.2019, ka deklaruar se me të akuzuarin E.S nuk kishte punuar asnjëherë dhe nuk ka kryer kurrfarë shërbimi për të, nuk kishte pasur raporte me të, nuk kishte njohuri se çfarë veture kishte i akuzuari dhe nuk e kishte parë asnjëherë me veturë, se nuk kishte ngasur veturën “pick-up” me mbishkrimin “B. Cafe”, se T.R e kishte njohur vetëm gjashtë muaj para ditës kritike. Më datë 01.09.2007 u kishte thënë hetuesve se ditën kritike kishte qenë në “Kafe Bar S.” dhe aty të pranishëm kishin qenë edhe I, Rr, E, dhe N., ndërsa me datën 25.09.2007, ishte intervistuar në prokurori dhe kishte mohuar se kishte qenë ditën kritike në “Kafe Bar S,” dhe duke e ndryshuar plotësisht deklaratën e tij të mëparshme me ndryshimin se fare pak e njihnte I, ndërsa për Rr. nuk e dinte së çfarë pseudonimi kishte.

Në shqyrtimin e fundit gjyqësor e kishte pranuar se kishte qenë në “Kafe Bar S” dhe se aty ka qëndruar me Rr.A (Rr) dhe me I.A (L) ku pastaj e kishin lënë ata të dy me veturë tek semaforat tek “B.C” e ku i njëjti vet kishte vazhduar pastaj dhe kishte pirë kafe një here në një lokal e njëherë në tjetrin e i vetmuar kishte qëndruar rreth 1 orë 40 minuta.

Mban mend se kishte pas armë edhe pse nuk e mbante shpesh, por e kishte marr atë ditë për ta shitur.

Në deklarata e tij i njëjti mohon se më datën 29.08.2007, në ora 21:17, kishte pranuar një SMS nga I.A me tekst: “B, Thirre R”, që nga rrethanat e rastit konkret vërtetohet se I. e kishte porositur mikun e tij të njohur më parë, duke i’u drejtuar me pseudonim B, thirre Rr. (Rr.), e që tregon se relacionet e tyre janë të afërta e ky fakt vërtetohet nga prova materiale e administruar në këtë gjykatë, pasi që kjo provë materiale (përgjimet) janë pjesë përbërëse të shkresave të lëndës e për më tepër afërsia – raporti e tij “grupin S” e në veçanti me Rr.A e I.A tani më është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve e jo rrallë herë edhe nga vet A.B

Dëshmitari më tej kishte specifikuar se rastësisht e kishte takuar E, disa herë dhe rastësisht ishte gjetur në shoqëri me të, e pastaj specifikon se rastësisht e kishte marr armën me vete ditën kritike, e rastësisht kishte qëndruar në “Kafe Bar S,” e pastaj rastësisht “ishte takuar me “Rr. e L” e rastësisht ata e kishin lënë me veturë tek “semaforat tek “B.Ci” e pastaj i njëjti përsëri rastësisht i vetmuar rreth 1 orë e 40 minuta kishte pirë kafe afër vendit ku gjithmonë rrinte T dhe përfundimisht rastësisht e takon T.. A mund të jetë e gjithë kjo rrjedhë kronologjike e ngjarjes rastësi? Për bindjen e këtij trupi gjykues, ishte haptazi dhe më se e qartë një vrasje e planifikuar

– e mbështetur në prova konkrete (hallka zingjorore e së cilave do të elabrohet në detaje në një pjesë të veçantë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi).

Dëshmitari ka dhënë një version të tijin se si kishte ardhur deri tek vrasja e “rastësishme”. Pretendimet e tij ishin se gjashtë muaj para ngjarjes kritike kishte pasur problem me T, derisa kishte qenë duke dalë nga një shitore në Dardani, T. i cili ishte në rroba civile i kishte kërkuar dokumentet dhe (dëshmitari) nuk ka qenë në dijeni se ishte polic dhe i kishte thënë: “kush je ti me ti dhënë dokumentet”, të cilit i kishte thënë: “ami dokumentet se të lidhi të rrahu dhe të dërgojë në polici e ta bëjë shpinën më butë se barkun, se T, i kishte thënë “po dukesh facë negative” dhe “mbaje në mend se ku të takojë, kështu e ke” dhe “mos të të shoh këtej pari”, se e kishte takuar edhe njëherë tre muaj para se të ndodhë rasti, i cili duke ecur rrugës “F.A” në P, T kishte qenë duke ngasur një veturë xhip të bardhë dhe ishte në rroba civile, e kishte ndalur veturën dhe kishte dalë nga vetura dhe e kishte ndalur të njëjtin derisa ishte vetë, i kishte thënë - e kishte pyetur T: “për çfarë arsye po më ndalë” dhe T. ishte përgjigjur: “çka të kam thënë ty” dhe i kishte rënë shuplakë dy herë duke i thënë: “kështu e ke sa herë të takojë, ik prej këtu”, se T, ka qenë polic, këtë e kishte kuptuar vetëm pasi që kishte ndodhur rasti.

Përkundër këtyre veprimeve që sipas dëshmitarit i kishte ndërmarr T ndaj tij, i njëjti kur nuk i kishte treguar askujt për këto incidente dhe kur nuk e kishte paraqitur në polici asnjë rast dhe në anën tjetër as që e kishte njohur T si polic.

Në vazhden e analizës së deklaratave të tij shfaqet haptazi tendenca e dëshmitarit (dënuarit) për ta shmangur kontaktin me personat e përfshirë në vrasjen e T.R.

Pse duhet që dëshmitari ta thoshte të pa vërtetën, që nuk kishte raporte me E.S, kur vërtetohet nga provat se ishte pjesë e “grupit S” dhe se punonte në “B. Kafe (fakt i vëretuar nga dëshmitari F.Sh, dëshmitari D2 dhe smst si prova materiale mes dëshmitareve F.Sh e Z.I. Pse duhet dëshmitari (i dënuari) të thoshte të pa vërtetën se nuk kishte qenë në “Kafe bar S” ditën kritike, e pastaj kur u kuptua se ka qenë ta pranoj këtë fakt. Pse duhej dëshmitari ta thoshte të pa vërtetën që nuk kishte raporte të afërta me R.A (R) dhe I.A (L) e pastaj ta pranonte që ditën kritike ishte takuar në “Kafe Bar S” me të njëjtit.

Si mund të rrinte dëshmitari me R.A (R) dhe I.A (L) të cilit ishin prapa çdo sulmi - kërcënimi e atentati ndaj T, e prapa të cilit problem të gjithë ishin në dijeni se ishte E.S, e vetëm dëshmitari (i dënuari nuk e dinte as konfliktin e as nuk e njihte se kush ishte T). Të gjitha këto përpjekje e ndryshim deklaratave të dëshmitarit, në bindjen e trupit gjykues, ishin vetëm përpjekje për të shkëputur zingjirin e provave në raport me përfundimin, se prapa vrasjes ishte tani i akuzuari.

Nga deklarimi i tij edhe pse i pretenduar për të shtrembëruar të vërtetën, gjykata ka arritur të konstatoj gjendjen faktike që lidhet me kronologjinë e ngjarjes në përfundimin që ka nxjerrë kjo gjykatë, gjithnjë në lidhshmëri me provat e tjera të administruara. Fillimisht gjykata kishte konstatuar nga dëshmia e dëshmitarit F.Sh e V.R që vrasësi i T.R, A.B kishte ndenjur gjatë gjithë kohës në “Kafe Bar S” (madje dëshmitari F.Sh kishte specifikuar se ishte e pa mundur të kalojë andej pari e mos ta shihte A) dhe përkundër se i njëjti tentonte ta fshehte këtë fakt. Se ai kishte lidhshmëri me E.S dhe se punonte në “B. Kafe” vërtetohet po ashtu nga deklarata e F.Sh që ishte person që kishte afërsi me E.S dhe po ashtu njihte në detaje njerëzit e të ashtuquajturit “Grupi S” pjesë e së cilës ishte A. U vërtetua po ashtu se A ishte në shoqëri të vazhdueshme me “Rr.” e “L” ani pse fillimisht e mohoi, në fund e pohoi raportin me ta e madje pohoi edhe për faktin se me ta ishte ditën kritike (rikujtojmë faktin se personat me nofkën “Rr” e “L” ishin njerëzit më të afërt të E, në raport me sulmet, kërcënimet e atentatet ndaj T).

Gjykata nga vet deklarata e dëshmitarit vërteton faktin se ditën kritike i njëjti kishte dalë nga shtëpia i armatosur. Po ashtu nga vet deklarata e tij edhe pse e ndryshuar disa herë vërtetohet se i njëjti atë ditë qëndroi me Rr.A (Rr) dhe I.A (L) në “Kafe Bar S.” para se ta kryente vrasjen, madje nga vet deklarata e tij vërtetohet se me dy të lartcekurit kishte shkuar me veturë deri tek

vendi i ngjarjes. Se ishte takuar ditën kritike edhe me E.S e kishte pohuar vet në deklaratat e tij fillestare e pastaj të ndryshuar, por ky fragment i deklaratës së tij gjen mbështetje edhe në deklaratën e dëshmitarit D2 i cili e kishte parë edhe A edhe E. që ishin takuar ditën kritike në “Kafe Bar S” që ndërlidhet me vet deklarinimin e parë të A.B.

Fakti se ngjarja nuk ishte e aty për aty dhe se nuk ishte e rastësishme dhe se nuk kishte vepruar në vetëmbrojtje i dënuari por e kishte pritur e goditur me armë nga prapa tani të ndjerin, tani më ka marr epilog dhe vërtetohet nga prova materiale e administruar Aktgjykimi i Gjyaktës Supreme i plotfuqishëm me shenjë API.nr.9/2011 i datës 09.02.2012 me anë të se cilës janë vërtetuar Aktgjykimet e mëparshme.

Me aktgjykimin e lartcekur është më se i kjartë fakti se vrasja ishte e planifikuar, pra ky ishte konstatimi i gjykatës Supreme. Në anën tjetër, vet A. kishte specifikuar se nuk rrinte i armatosur dhe atë ditë e ka marr armeë për ta shitur e në anën tjetër ka dështuar të specifikoj se po se ka tentuar ta shet ose jo. Në anën tjetër nga sms që gjenden në shkresat e lendes e që do të elaborohen më vonë, T. atë ditë ishte në përcjellje. Lidhur me faktin se do të kishte ndonjë arsye për ta privuar nga jeta tani i dënuari T, kishte dështuar ta ofroj duke specifikuar se kinse është rrahur e kërcënuar nga ai, por se ka njohur se kush është T e as nuk e ka ditur se është Polic e as nuk i ka treguar as kujt. Një argument i tillë, në bindjen e gjykatës është një trillim që nuk gjenn mbështetje në provat e administruara, pasi që paraprakisht është vërtetuar se A qëndronte gjatë gjithë kohës me njerëz të “grupit S” e që kishin për detyrë ta përcillnin çdo lëvizje të pikërisht T. Fakti se i ndjeri ishte përcjellë ditën kritike dhe fakti se A kishte qëndruar i vetëm rreth 1 orë e 40 minuta duke pirë kafe i vetmuar, është argument i qartë që ai ishte në pritë që ta privonte nga jeta dhe e ka pritur deri sa i njëjti ka mbetur vet, sepse atë ditë T. fillimisht kishte qenë me vëllain e vet e pastaj me kolegun B.Sh dhe shokun e tij G.H dhe në momentin që ishte ndarë nga shoku i tij G.H dhe kishte mbetur vet, ishte ekzekutuar nga personi që kishte marr tani obligimin për ta privuar nga jeta e që ishte në pritë, personi A.B pjesëtar i “grupit S” grup ky që funksiononte në urdhrat e E.S, e po ashtu punëtor i E.S në biznesin e që aj e udhëhiqte “B.Kafe”.

21.Dëshmitari D2, ishte një nga dëshmitaret e mbrojtur dhe okular që kishte parë nga afër veprimet në “Kafe Bar S” ditën kritike. Në deklaratën e tij të dhënë në polici nën kushte anonimiteti, me datën 19.09.2007 – si dhe deklaratat e dhëna në shqyrtimin gjyqësor të datave 02.06.2015 si dhe 18.11.2015 është specifikuar se me datën 30.08.2007, kishte qenë në vendin e tij të punës (vendi i punës i njohur për policinë). Në mëngjes rreth orës 07-08, kishte parë E.S, i cili kishte shkuar në lokalin e tij Bar S, me veturën e tij Golf III, ngjyrë e zezë, me supozimin se ishte i blinduar. E.S kishte qenë i vetëm, kishte hyrë brenda në lokal dhe pas pesë minutave kishte dalë nga lokali dhe kishte ecur këmbë në drejtim të bastoreve “Toto Sport” dhe “Lluka”, në drejtim të stacionit të autobusëve për Fushë Kosovë që ndodhet afër agjencionit “//”, në “Dardani”. Derisa i njëjti ecte nëpër rrugë, tërë kohën kishte biseduar me dikë në telefon dhe pastaj kishte shkuar në drejtim të lokalit të vet. Nuk e kishte vërejtur se kur kishte dalë nga lokali mirëpo rreth orës 11:15, kishte vërejtur se veturën nuk e kishte aty të parkuar ku zakonisht e parkonte. Atë ditë, E.S kishte pasur të veshur një maicë të zezë me vija të bardha, pantallona (farmerka ngjyrë e kaltër), patika ngjyrë të kaltër dhe të zezë, kishte qenë i rruar në fytyrë. Në këtë këndvështrim gjykata vëren se dëshmitari shpjegon në detaje faktin se E.S ishte në “Kafe Bar S” ditën kritike dhe se një fakt të tillë e kishte pohuar edhe vet A.B që kishte specifikuar se atë ditë kishte takuar të njëjtin aty e për më tepër vet i akuzuari kishte pohuar se ditën kritike ka qenë në “Kafe Bar S, andaj gjykata nga ky fragment i dëshmitarit e në lidhshmëri edhe me deklarinimet e A.B dhe vet E.S, vërteton faktin se E.S ditën kritike ishte në “Kafe Bar S.”.

Pas ngjarjes kritike, kishte vërejtur disa persona si: N.S, një person të cilin e quajnë G kamarieri i quajtur Sh, F, i cili ruan veturat e E, A, i si dhe dy persona tjerë të cilët nuk i kishte njohur, të

cilët bartnin disa çanta të zeza dhe qese të mëdha ngjyrë të kuqe me të bardhë në të cilat qese kishte vërejtur tyta të armëve të gjata, të cilat i kishin bartur nga lokali “S”, deri në parkingun e veturave i cili gjendet mbrapa “Kafe Bar S”. Pasi që të njëjtit ishin kthyer nga parkingu i veturave dhe ishin ndalur para lokalit në fjalë, dhe qeshnin me zë të lartë, ku njëri nga ta për të cilin nuk e di se cili ishte por vetëm e kishte dëgjuar të ketë thënë: “Kjo është hakmarrje”. Derisa ata bartnin armët, kishte vërejtur N.S i cili mbante një revole në brez. Në parkingun e veturave mbrapa lokalit S, kishte vërejtur disa vetura të grupit S,, një veturë pick-up ”B.Cafe”, të cilën e ngiste A.B ku të njëjtin e kishte parë me këtë veturë duke shpërndarë kafe nëpër kafiteritë e Prishtinës dhe se punon për këtë kompani, pronar i së cilës është E.S, kishte vërejtur një veturë pasat karavan, xhami i majtë i së cilës kishte qenë i thyer, ndërsa para lokalit S, kishte qenë e parkuar vetura xhip ngjyrë e gjelbër, të cilën e ngiste N.S. Atë ditë në lokalin S,, para se të ndodhte vrasja e policit, kishte vërejtur edhe personin e quajtur “L”, Rr (R) dhe N.S.

Para vrasjes së T. i njëjti kishte vërejtur se derisa E, ishte kthyer në kafiteri, aty kishin qenë edhe personat, “Rr”, “L”, A, ndërsa “F” po kujdesej për veturën. Personat e përmendur, E, i kishte dërguar në zyrën e tij dhe kishte vërejtur se diçka nuk po shkonte mirë.

Nga deklaratat e dëshmitarit e të cilës kjo gjykatë në këto fragmente i’ a fali besimin, vërtetohet edhe njëherë fakti se A.B punonte në “B. Kafe” fakt ky tani i vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarit F.Sh që e kishte specifikuar kete fakt në gjykatë dhe se fakti se F.Sh e kishte përmendur shpeshherë se ishte në njohuri se A.B punonte në” B.Kafe” e specifikon edhe dëshmitarja Z. e një fakt i tillë vërtetohet edhe nga smst mes tyre – pjesë e shkresave të lëndës, që kur dëshmitari F, flet për A, i referohet si punëtor i “B. Kafe” – personi që e voziste veturën me këtë mbi shkrim.

Kjo gjykata i’ a fali besimin dëshmitarit përkitazi me faktin se A.B ishte punëtor i “B. Kafe”, sepse kjo pjesë e deklaratës gjente mbështetje në deklaratat e dëshmitarëve të lartcekur e që ishin identike.

Fakti se atë ditë në “Kafe Bar S” ishin edhe personat me pseudonimin “Rr” e “L” është e vërtetë, sepse “Rr. e kishte parë edhe dëshmitari V.R atë ditë duke i shikuar atë dhe T dhe fakti se atë ditë A.B kishte dalë nga “Kafe Bar S” me “Rr” e “L” konfirmohet nga vet dëshmia e tij. Se personi me emrin F, siç e quan dëshmitari ishte punëtor i E.S e konfirmon edhe vet tani dëshmitari F.A e që e bënë të besueshme dëshminë e dëshmitarit për faktin se dëshmitari e ka parë edhe të lartcekurin të përfshirë në ditën kritike fakt ky që vërtetohet nga Aktgjykimi i Gjykatës Supemre i plotfuqishëm me shenjen API.nr.9/2011 i datës 09.02.2012 me anë të se cilës janë vërtetuar Aktgjykimet e mëparshme që konfirmon faktin se F.A punëtor po ashtu i E.S është dënuar tani më si i përfshirë në vrasjen e T.R.

Në këto rrethana, për aq kohë sa, gjykata i’ a ka falur besimin dëshmitarit mbi këto fragmente – pasi që kishte mbështetje në prova të tjera, i ka falur edhe besimin për faktin se ka parë atë ditë njerëz që bartnin armë tek “Kafe Bar S” për faktin se në bindjen e gjykatës të krijuar nga rrjedha e ngjarjes mbështetur në provat e administruara, por edhe nga vet aktgjykimi i lartshënuar i Gjykatës Supreme, rezulton tani i konfirmuar fakti se, vrasja e T.R nuk ishte e rastësishme dhe e atëçastshme, por e organizuar për hakmarrje nga njerëz të “grupit S, në krye të së cilës ishte E.S dhe se të tjerët vepronin nën urdhrat e tij, për më tepër konflikti ishte në mes të E.S e T.R dhe jo të tjerëve, me çka rezulton se atë ditë nën shtytjen E.S ishte privuar nga jeta T.R

Më tej dëshmitari kishte specifikuar se, koha nuk i kujtohej saktë, por kishte parë grupin që kishte shkuar atje (kafiteria), dhe dikush nga ata kishte folur për hakmarrje. Rreth orës përafërsisht 15:00 deri 15:30, ata (personat e apostrofuar më lartë), po bartnin me vete diçka si armë me tyta të gjata. Para se të vritej T.R, diku rreth orës 15:30, kishte qenë jashtë lokalit por brenda në veturë në parking, kishte parë duke dalë nga lokali A.B, “L”, “F”, N., të cilët kishin armë me tyta të gjata dhe kishin shkuar me veturat e tyre të cilat kishin qenë të parkuara në parkingun prapa kafiterisë dhe të cilët kishin shkuar në aksion dhe pas kësaj kishte dëgjuar se është vrarë polici

T.R. Vetura me të cilën ata ishin larguar kishte qenë me gjasë “jeep”, ngjyrë e gjelbër, në të cilën kishte qenë A.B Kur ata (L, Rr, N) ishin kthyer me veturën xhip në kafiteri, pohoi t’i ketë dëgjuar duke thënë se “hakmarrje” ose “gjakmarrje” dhe ishte në një distancë nga ata afër 15 metra. Kur ata ishin kthyer në kafiteri, L, mbante në dorë një çantë në të cilën shihej se kishte armë me tyta të gjata, ishin futur brenda në lokal, ishin ngjitur shkallëve lartë, kishin qëndruar aty për një kohë të gjatë, më pas kishin zbritur poshtë, kishin hipur nëpër veturat e tyre dhe ishin larguar nga aty në drejtim të panjohur.

Siç u specifikua më sipër, fakti se vrasja ishte e organizuar, fakti se i ashtuquajtimi “F (F.A ishte i përfshirë në vrasje tani është konfirmuar nga Gjykata Supreme, andaj mbi fragmentet e cituara nga dëshmitari është vërtetuar se çdo gjë atë ditë organizohej në “Kafe Bar S” për vrasjen e T. Gjykata i’a fali besimin dëshmiarit në faktin se ka parë edhe F.A aty, sepse u citua edhe më sipër që tani është konstatuar me aktgjykim të Gjykatës Supreme se i njejtë ishte i përfshirë në vrasje. Gjykata ia fali besimin dëshmiarit edhe në faktin se ata funksiononin si grup dhe ishin të organizuar. Fakti se ata ishin si grup tani është vërtetuar nga secili dëshmitar i dëgjuar, ndërsa fakti se vrasja ishte e organizuar tani e ka konstatuar Gjykata Supreme, andaj mbi këto arsye gjykata ia fali besimin të njëjtit në këto fragmente.

Pasi që gjykata ka krijuar bindjen se deklarata e dëshmiarit gjen mbështetje në provat e tjera të administruara, kjo gjykatë i ka falë besimin dëshmiarit edhe mbi faktin se ishte E.S që i kishte mbledhur në zyrën e tij “Rr”, “L”, A dhe “F”. Ky fakt vërtetohet edhe nga vet rrjedha e ngjarjes dhe funksionimi i “grupit S”, sepse ata merrnin urdhra nga E.S dhe se fakti se A.B kishte takuar po atë ditë E.S fillimisht e kishte pohuar edhe vet A në polici e që ka ndërlidhje të drejtë për drejtë me deklaratën e dëshmiarit D2, e po ashtu fakti se nga “Kafe Bar S” A.B kishte dalë me personat me pseudonimin “Rr” e “L” e kishte konfirmuar vet A.B, e fakti se F.A ishte i përfshirë në vrasje tani është konfirmuar me aktgjykim të formës së prerë.

Pra gjykata ka krijuar besimin ne fragmente specifike tek dëshmitari D2 në faktet e pohuara dhe të ndërlidhura edhe nga dëshmitaret e tjerë dhe në këtë formë pasi që ka krijuar besueshmërinë, të njëjtit i fali besimin edhe se te lartcekurit i kishte mbledhur E.S në zyre, sepse kjo kishte ndërlidhje siç u specifikua edhe me rrjedhën e ngjarjes por edhe me deklaratën e parë të A.B me ç’ rast gjykata ka vërtetuar faktin se E.S i kishte mbledhur të lartcekurit atë ditë dhe përfundimisht ka shtytur tani dorasin që të kryen veprën penale.

Andaj, gjykata ka krijuar bindjen se ditën kritike është shtyrur vrasja e T.R nga E.S ku kishte organizuar nga zyra e tij vrasjen tani të ndjerit – duke shtytur kështu A.B që ta privoj nga jeta T.R per motive e tija të ulëta personale e hakmarrëse.

22.Gjykata ka trajtuar edhe deklaratën e dëshmiarit B.M i cili aso kohe ishte zyrtar policor i Njësisë së Forenzikës në Prishtinë. Në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 17.11.2015, ndër të tjera i njëjti kishte deklaruar se: në rastin e vrasjes së policit T.R, në cilësi të zyrtarit policor nga departamenti i forenzikës, kishte ndërmarrë disa veprime hetimore lidhur me rastin. Ditën kritike, me urdhër apo kërkesë të hetuesve, kishin shkuar në “Kafe Bar S” ku është bërë fotografimi i pjesëve të provave të cilat duhej të konfiskoheshin nga policët hetues, të cilat konsideroheshin me rëndësi se do të ndihmonin në ndriçimin e rastit. Pra i njëjti dëshmitar vetëm ka rrëfyer marrjen e veprimeve e që nuk lidhet me zbardhjen e gjendjes faktike dhe si e tillë nuk kishte ndonjë ndikim lidhur me rastin e vendosjes sa i përket objektit të aktakuzës. Për më tepër dëshmitari ka rrëfyer lidhur me bastisjet e ku kjo gjykatë do t’i trajtoj këto veprime në mënyrë të veçantë tek vërejtjet dhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit.

23.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmiarit A.H të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 01.12.2015, i njëjti kishte qenë Hetues

në krimet e rënda-ekspert i IT-së, i njëjti ishte thirrë në cilësinë e hetuesit lidhur me mjetin e regjistrimit lidhur me leximin e të dhënave të cilët janë ruajtur në hard drive.

Meqë deklarata e dëshmitarit lidhet me analizimin e provës e cila është marr nga bastisjet e siç u specifikua më lartë Gjykata Apelit ka dhënë vërejtje përkritazi me to, kjo gjykatë nuk do të lëshohet më tej lidhur me deklarinimin e këtij dëshmitari pasi që në rrethanat e krijuara dëshmia tij tani është irelevante. Për më tepër dëshmia e tij ka të bëjë me hard drive që është marrë me rastin e bastisjes në “Kafe Bar S”

24.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit R.B të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 01.10.2015.

Në deklaratën e tij i njëjti ka shpjeguar se si në një rast konkret sipas tij në cilësinë e zyrtarit policor T.R e kishte fyer dhe rrahur atë, e po ashtu rrëfen edhe një rast tjetër që T po ashtu e kishte rrahur një person me emrin R. para argjendarisë së vet. Më tej dëshmitari jep versionin e tij edhe lidhur me rastin e Ferizajit, i cili sipas tij kishte ndodhur në vitin 2005 ose 2006, kishte kuptuar në media se si E.S ishte maltretuar dhe të cilin rast e ndërlidhë me pretendimin se T.R ishte i përfshirë duke aluduar se vet T kishte kërkuar që kolegët e tij të dilnin në rrugë dhe ta ndalnin E. dhe kjo ishte arsyeja që dëshmitari i ishte lajmëruar N.S për të dëshmuar tani në këtë rast. Dëshmitari kishte specifikuar se nuk kishte dëgjuar për “grupin S” por për familjen S.. se është një familje e mirë dhe punëtore, ndërsa nuk i njihte personat A.B, “L” e “Rr”.

Me anë të këtij dëshmitari, mbrojtja pretendon të vërteton faktin se tani i ndjeri kishte probleme edhe me persona të tjerë qoftë në kuadër të punës qoftë me të tjerët e në këtë këndvështrim të specifikoj se veprimet e A.B ishin në saje të këtyre problemeve. Kjo gjykatë nuk do të lëshohet në vërtetimin e një fakti se a e kishte rrahur një mend T.R dëshmitarin R.B dhe personin me emrin R, pasi që kjo çështje nuk është objekt shqyrtimi. Megjithatë, kjo gjykatë vlerëson se mbase tani i ndjeri ka mundur të ketë për gjatë punës së tij apo jashtë saj çfarëdo incidenti, por assesi në idenë që dikush ta privoj nga jeta dhe se problemet e vetme që ai i kishte dhe prapa çdo sulmi e kërcënimi e atentati ndaj tij ishte E.S me grupin e tij – gjë që u vërtetua nga secili dëshmitar që ishte i afërm i T. e që i dinte në tërësi problemet e tija.

Dëshmitari specifikonte se nuk e dinte që ekzistonte i ashtuquajtur “grupi S”, por një fakt të tillë tani kjo gjykatë e ka vërtetuar nga të gjithë dëshmitaret e tjerë (deklaratat e të cilëve janë elaboruar deri tani).

Dëshmitari shton edhe një fakt tjetër që ndërlidhet drjetë për drejtë me dëshminë e dëshmitarit Sh.Q, që E.S dhe të tjerët e kishin llogaritur si përgjegjës T.R për incidentin në Ferizaj mes E. dhe Njësitit Special atje, që qon në motivin për hakmarrje. Rasti i “Ferizajit” ishte nje rast kur ishte ndaluar E.S nga Njesia Speciale atje, e që pastaj të njëjtin e kishin rrahur, e që nga dëshmitë e dëshmitarit Sh.Q, e që tani ndërlidhet derjtë për drejtë me dëshminë e dëshmitarit R.B, rezulton fakti se mbizotëronte ideja se prapa këtij rasti ishte T. e që lidhet me motivet e vazhdueshme hakmarrëse të E.S ndaj tani të ndjerit.

25.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit A.D të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 02.10.2015, ku i njëjti ka theksuar se ka pasur një problem me tani të ndjerin T.R ku ka ndodhur para 10 viteve nga koha kur i njëjti dëshmonte, ai ka shtuar se ka qenë duke biseduar me një femër e cila ka qenë shoqe e T.R dhe ajo quhej B, ndërsa T i’ a ka marrë asaj telefonin dhe dëshironte ta takonte domosdoshmërisht, i njëjti ka shtuar se nuk e ka njohur T.R dhe se për herë të parë e ka parë tek Qendra Tregtare në Kodrën e Diellit ku i njëjti kishte ardhur së bashku me dy djem të tjerë dhe vëllaun e tij dhe e kanë takuar aty, i njëjti ka theksuar se së pari kanë diskutuar lidhur me atë se pse A e ka telefonuar B e më pastaj T e ka godit të njëjtin, sipas dëshmitarit e kishte goditur në vesh dhe në atë moment

i njëjti është rrëzuar poshtë dhe pasi që është ngritur në këmbë ka ikur dhe nuk ka pasur mundësi që më T ta godas të njëjtin.

Edhe deklarata e këtij dëshmitari përkitazi me faktin se i njëjti kishte një problem – incident me T. siç u specifikua më sipër, kjo gjykatë nuk e ka atë çështje objekt shqyrtimi, andaj edhe nuk do të lëshohet në vërtetimin e këtij fakti, por pa paragjykuar këtë situatë, e njejtja si e tillë nuk ndryshon bindjen e gjykatës përkitazi me dorasin A.B për faktin se i njëjti ishte pjesë e “grupit S”, punëtor i E.S, i njëjti e kishte përcjellë T. para vrasjes bashkë me njerëzit më të afërt të E.S, që qon në idenë e qartë se vrasja ishte e planifikuar dhe se nuk mund të tërhiqet paralele me cilin do dëshmitar që ka pasur ndonjë problem eventual të vogël me tani të ndjerin T.

26.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit F.A të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 06.10.2015.

Dëshmitari F.A ka konfirmuar vetë se ka qenë punëtor në biznesin që mbante N e E.S gjë që vërtetohet nga vet deklarata e tij ani pse i njëjti mundohet ta shfaq më të largët raportin me E, ashtu siç ishte munduar edhe punëtori tjetër A.B.

Rikujtojmë faktin se F.A, me aktgjykimin e Gjykatës Supreme API.nr.9/2011 i datës 09.02.2011 është konstatuar se ka qenë i përfshirë në vrasjen e T.R si bashkë-kryes me tani dëshmitarin – të dënuarin tjetër A.B.

Pra gjykata vërteton edhe një fakt thelbësor në rrjedhën e ngjarjes, se me aktgjykim të Gjykatës Supreme është konstatuar se vrasja ishte e organizuar dhe se për vrasjen e T.R tani janë dënuar dy punëtor që kanë punuar për E.S ndërsa ishin të përfshirë edhe personat me nofkën “Rr” e “L” që ishin në arrati pikërisht për shkak të kësaj vrasje.

Në cilësinë e dëshmitarit F.A më tej kishte specifikuar se me personat “L” e “Rr”, jeton në të njëjtën lagje, ndërsa A.B e kishte njohur vetëm si emër të cilin e kishte parë shumë rrallë kurë kalonte andej, dy apo tre herë, ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datën 01.10.2007, kishte deklaruar se A.B nuk e kishte njohur dhe nuk e kishte parë kurrë.

Nga deklaratat kontradiktore të dëshmitarit, vërehet qartë se mundohet të shmangë edhe kontaktin me A.B, por tani është konfirmuar me aktgjykimin e lartcekur se i njëjti i ka ndërmarr veprimet bashkë me të njëjtin për ta privuar nga jeta tani të ndjerin T.

Lidhur me SMS e dërguar I.A ditën kritike në ora 13:02, me tekst “fqinji e ka makinën në parkingun e G”, e arsyetoi me atë se këtij të fundit i kishte dhënë 1000 (njëmijë) euro borxh, sepse i’a kishte kërkuar dhe këtë shumë prej 1000 (njëmijë) euro, i’a kishte dhënë një të afërmi të tij, kështu që nuk kishte asgjë të bënte me ngjarjen kritike dhe as me të akuzuarin E.S me të cilin nuk kishte diskutuar asnjëherë lidhur me T.R. Ky argument i dëshmitarit rezulton të jetë i pa vërtetë për faktin se pikërisht duke u bazuar në lidhshmërin e sms-ve, Gjykata Supreme kishte konstatuar se ngjarja ishte e planifikuar, se i ndjeri T ishte në përcjellje gjatë gjithë ditës deri në ekzekutimin e tij dhe mbi këtë bazë Gjykata Supreme edhe e kishte gjetur fajtor të lartcekurin.

Lidhur me ballafaqimin e deklarimeve të dëshmitarit D2, të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 20.06.2015, se në mëngjesin e datës 30.08.2007, citim: “Unë e pashë E, L, A, Rr dhe Fishte poshtë te automjeti dhe N. ishte aty”, i njëjti mohoi këtë duke e quajtur gënjeshtër, sepse fare nuk kishte qenë atje atë kohë, por siç u specifikua edhe më sipër deklarata e dëshmitarit D-2 rezulton të jetë e vërtetë, për faktin se F.A, ishte bashkëpjesëmarrës në vrasjen e T, t, konstatuar nga Gjykata Supreme, andaj çdo pretendim për shmangie nga përgjegjësia e tani dëshmitarit f, është përgënjeshtuar me të njëjtin aktgjykim. I pyetur për fqinjin të cilin e kishte potencuar në SMS, se “automjeti i fqinjit është në vend parkimin e G”, i njëjti kishte deklaruar se fqinji ishte personi të cilit i’a kishte dhënë paratë emri i të cilit është D. Kjo ide e tij për të shmangur përgjegjësinë penale tani ka marr verdiktin e fundit të asaj që pretendon dëshmitari, pra është konfirmuar me aktgjykimin e formës së prerë roli i tij në vrasje. Sa i përket sms që i njejt

pretendon se kishte të bënte me diçka tjetër, kjo gjykatë vërteton pikërisht faktin se T, ishte duke u përcjellë atë ditë hap pas hapi deri në gjetjen e momentin adekuat që i njëjti të privohet nga jeta, gjë që është konstatuar edhe më herët nga kjo gjykatë përgjatë arsytimit të këtij aktgjykimi, pra fakti se i ndjeri ishte në përcjellje të vazhdueshme në veçanti kohën e fundit pikërisht nga “grupi S” e po ashtu edhe ditën kritike e ku pas informatave për vendndodhjen e tij, ishte A.B që e kishte pritur me rreth 1 orë e 40 minuta të njëjtin dhe e kishte ekzekutuar.

27.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023, është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit J.T të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 30.11.2015, detektiv me gradën rreshter në Byron Shtetërore të hetimeve në Finlandë, dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 30.11.2015, lidhur me rrethanat e ekzaminimit të pajisjes “DVR”, të kamerës së lokalit S, e konfiskuar me rastin e bastisjes së lokalit, si dhe kishte krijuar hartën e lokacioneve të antenave të operatorit Vala, në mënyrë manuale, që tregon numrin mobil të caktuar të përdorur në një periudhë të caktuar kohore, në një zonë të caktuar. Meqë provat materiale, qoftë nga bastisjet, qoftë nga hartografia janë vërejtje të Gjykatës së Apelit përkitazi me ligjshmërinë e tyre, kjo gjykatë nuk do të lëshohet më tej në elaborimin e kësaj deklarate.

28. Në shqyrtimin gjyqësor ishin lexuar edhe deklaratat e dëshmitares M.I: e njëjta jetonte në Prishtinë, nënë e tri vajza, A, E, dhe Z.I (po ashtu dëshmitare në këtë rast). E kishte njohur tani të ndjerin T.R, i cili së bashku me A.S disa herë në uniformë të policisë kishin shkuar në parukeri ku punonte E, të cilët kishin insistuar për mbrojtjen e familjes së saj me arsyetimin se ishin të rrezikuara nga E.S. Vajza e saj A, shumë kohë më parë ishte shoqëruar me E.S dhe për këtë e kishte kuptuar shumë vonë. Në deklaratën e saj të dhënë në polici e njëjta kishte deklaruar se: “së pari A, ka pasur problem me E.S, është thënë se ka marrëdhënie për ca kohë por A, asnjëherë nuk e kishte pranuar këtë fakt por e di se A, ka qenë shumë e frikësuar nga ai (deklaratë kjo e konfirmuar nga vet dëshmitarja në deklaratën e saj të dhënë në shqyrtimin gjyqësor).

Nga dëshmia e dëshmitares familjare e A, (nëna e saj), rezulton se A, kishte një afërsi me E.S e rëndësishme ishte fakti se e njëjta ishte e afërt me të dhe shkëputja e saj nga i njëjti vjen përfundimisht pas lidhjes së saj me T), pasi që e lartcekura ishte e afërt me të akuzuarin para se të lidhej me T. Fakti se A kishte afërsi me E.S, ky fragment gjenë mbështetje edhe në deklaratën e motrës së A, dëshmitarës Z.I e cila po ashtu ka specifikuar për afërsinë dhe raportet mes A. dhe E.S dhe kishte specifikuar se atë periudhë A, ishte tejet e pa lumtur dhe se shkëputja e saj përfundimtare nga E.S kishte ndodhur pasi që A. ishte lidhur me T.

Dëshmitarja përmend edhe faktin se në vitin 2003 dhe 2004, derisa ishte me A, në studion muzikore të A.R, kur A.po përgatiste një nga video spotet e këngës së saj me G.S pasi që kishin dalë nga studioja kishin vërejtur se katër gomat e veturës së G.S ishin therë dhe për këtë kishin dyshuar që ishte bërë nga “grupi S” pasi që kishin vërejtur “grupin S” me veturat e tyre pasi që e dinin se vetura i përkiste atij dhe duke pasur parasysh se ishte ora tre pas mesnate dhe se nuk kishte lëvizje, rastin e kishin raportuar në polici.

Nga ky fragment i deklaratës së dëshmitares, vërtetohet një fakt i rëndësishëm në rrjedhën e ngjarjes, fakti se kush do që i afrohej A, kishte probleme me “grupin S” dhe kjo është më se e qartë se vinte nga urdhrat e tani të akuzuarit E.S, (sepse lidhshmëria ishte e tij dhe jo e dikujt tjetër).

Lidhur me problemet e T, me E.S, ka theksuar se A, nuk i ka treguar shumë raste por një muaj para se të vritej T,i ka treguar se T, i’a kanë vendosur pritën në S, deri sa ai ishte duke shkuar në shtëpi.

E njëjta rrëfen edhe faktin se ishte në dijeni se Gj.K (tani dëshmitar në këtë proces) kishte ndërmjetësuar për pajtim në mes të A, e E,, këtë i’a kishte thënë vet Gj.K në një rast kur kanë qenë bashkë me të pasi që vajza saj Z kishte kënduar një ditë në lokalit e tij. Lidhur me përfshirjen e Gj.K si ndërmjetësues për pajtim, kjo gjykatë do të lëshohet më vonë kur do të

trajtohet deklarata e tij pasi që ishte dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor – sipas propozimit të mbrojtjes.

Si përfundim, nga deklarata e kësaj dëshmitare e të cilës gjykata i'a fali besimin pasi që është në përputhje të plotë edhe me deklaratën e dëshmitares Z, por sa i përket atentatit të fshatit S, edhe në përputhje me dëshmitaren A.I, gjykata vërtetoi faktet si vijon: Që A kishte afërsi me E.S dhe po ashtu ishte shumë e frikësuar nga ai, se kush do që i afrohej A. kishte problem me të ashtuquajturin “Grupi S”, se T, kishte probleme me grupin S” dhe se pak kohë para vrasjes së tij të njëjtit i është vendosur prita në S, (për të cilën kjo gjykatë e ka specifikuar disa herë për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi).

29.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitares A të dhëna në shqyrtimin kryesor të datës 16.12.2014 si dhe e datës 14.01.2015, ku ndër të tjera kishte theksuar se punën si infermiere e kishte filluar me datën 05.06.2006, dhe para kësaj periudhe kishte punuar në butikun “K”, i cili gjendet në Qendrën Sportive në Prishtinë. I.A deri në vitin 2007, ishte i dashuri i saj, që nga atëherë nuk e kishte parë më. Rr.A ishte djali i axhës së I, me të cilin nuk ishte shoqëruar asnjëherë. I, kishte pseudonimin “L” ndërsa Rr, kishte pseudonimin “Rr”. Për A.B kishte dëgjuar vetëm pas vitit 2007, ndërsa për T.R vetëm si qytetar. E.S e kishte njohur pasi që i njëjti ishte djali i tezës së të dashurit të saj, mirëpo nuk kishte pasur asnjë kontakt me të. Ditën kritike, të datës 30.08.2007, kishte qenë kujdestare në vendin e saj të punës, nga ora 07:00 deri në orën 19:00, si infermiere në QKUK. Dy polic e kishin arrestuar dhe e kishin dërguar në stacionin policor numër 4, ku aty disa polic e kishin kërcënuar se do ta vrisnin. Gjatë fazës së procedurës paraprake kishte dhënë tri deklarata dhe atë, me datën 30.08.2007, ditën edhe kur kishte ndodhur ngjarja, me datën 08.09.2007 si dhe me datën 29.10.2008. Ajo kishte deklaruar se në vitin 2004, ajo kishte pasur një lidhje me E.S e cila kishte zgjatur afërsisht dy javë dhe pas kësaj kishte hyrë në një lidhje me I.A. Atë kohë kur kishte njohur E, ai kishte pasur një numër të telefonit 044 //, Lidhur me kontaktin që kishte bërë me telefon të dashurit të saj I, në ditën kritike, kishte deklaruar se nuk e kishte kontaktuar të njëjtin për t'i konfirmuar vdekjen e T por për ta pyetur nëse dinte diçka për vdekjen e tij, pasi që e njëjta ishte në dijeni për konfliktin në mes të T, dhe E.S. Ajo kishte deklaruar se një ditë më parë, me K.B, I, Rr dhe A.B, kishin planifikuar të shkonin në Liqenin e Batllavës me veturën Passat ngjyrë e gjelbër të I, Sipas saj, A, ishte shok i I.A dhe se A, ngjiste një veturë të tipit “Vë Golf II”, ngjyrë hiri. I.A, kishte në përdorim disa numra të telefonit si: 044 //, 044 //, 044 // dhe 044 //, ndërsa E.S kishte disa lloje të veturave si: një “Xhip” me targa //-KS-// një xhip të bardhë të blinduar dhe një “Vë Golf 3”, të blinduar me numër të targave //, E, I, dhe Rr, kishin mbajtur armë me vete si dhe mbanin jelek antiplumb dhe se A.B ishte në shoqëri të tyre gjatë gjithë kohës. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.01.2015, kishte deklaruar se: për vrasjen e T.R, këtë e kishte zbuluar vetëm kur kishte shkuar në stacion policor dhe jo para se t'i telefononte të dashurit të saj I.A, dhe gjatë bisedës me të nuk e kishte përmendur T,R, por se kishte qenë vetëm një bisedë normale e zakonshme. I kujtohej dita kur së bashku me I.A (L), K dhe Rr, me makinën e saj Ford Fiesta, ngjyrë vishnje, kishin shkuar për drekë në Liqenin e B, mirëpo kundërshtoi se A.B kishte qenë së bashku me ta të cilin fare nuk e njohte dhe se deklaratat e saj të mëhershme i konsideron si të sajura nga ana e policisë nga të cilët edhe ishte kërcënuar se nëse nuk do ta nënshkruante deklaratën e saj, do të dënohej më 6 (gjashtë) vite burgim ose do ta vrisnin.

Është fare lehtë e vrejshme se të gjithë dëshmitarët që kanë pasur lidhje me “grupin S” dhe me E.S, ndryshojnë deklaratat e tyre me arsyetimin se janë kërcënuar nga Policia. Dëshmitarja në fjalë mundohet ta zhbëjë deklaratën e saj për të shmangur afërsinë që kishte I.A (L) e A.B Fakti se version i parë i dëshmitares se se bashku me I, K, e A, kishin kaluar kohë së bashku, vërtetohet edhe nga vet deklarata e dëshmitares K.B që rezulton fakti se e vërtetë ishte deklaratat

e saja të para, por pastaj ishin ndryshuar. Dëshmitarja më tej edhe pse kishte deklaruar se I.A kishte afërsi të madhe me A.B, ndryshon deklaratën e saj duke thënë se të njëjtin nuk e ka njohur. Fakti se A.B ishte më i afërmi me I.A, pikërisht kjo ishte e vërteta se një fakt të tillë siç e kishte konfirmuar vet kjo dëshmitare në fillim, konfirmohet nga dëshmitarët e tjerë të elaboruar më sipër si F.Sh të cilët kishin konfirmuar saktësisht të njëjtin fakt se A.B ishte pjesë e “grupit S” dhe ishte më i afërti me I.A, L, fakt ky që vërtetohet edhe nga sms – prova materiale të administruara.

Në bindjen e kësaj gjykate, vërehet qartë fakti se dëshmitarë të afërm me “grupin S” kanë thënë të vërtetat në deklaratat e tyre të para-fillestare, për faktin se deklaratimet e tyre janë në përputhje të plotë me deklaratat e dëshmitarëve tjerë që mbrojnë këto versione deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, por vetëm dëshmitarët që kishin raporte me “grupin S”, pas ngritjes se aktakuzës dhe kur janë bërë të ditura pretendimet e prokurorisë, kanë ndryshuar deklaratimet e tyre për të munduar të shkëpusin kështu lidhshmërinë e njerëzve të “grupit S” për brenda grupit, e rrjedhimisht të mundohen të specifikojnë se A.B nuk kishte lidhshmëri të drejtë për drejtë me E.S dhe njerëzit e tij më të afërt.

Në këtë këndvështrim, deklaratat e tyre për të munduar të shtrembërojnë të vërtetën dhe gjendjen faktike, gjykata nuk u’a fali besimin.

30.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023, është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit A.B e dhënë në kuadër të shqyrtimit gjyqësor të datës 29.05.2015, ku ndër të tjera i njëjti ka specifikuar rrjedhën në versionin e tij të ndërtimit të shtëpisë së tij duke specifikuar arsyet se pse kjo shtëpi është ndërtuar në atë periudhë kohore dhe të ardhurat se nga i ka marr. Shtojm faktin se A.B është bababi i A.B.

Fakti i fillimit të ndërtimit të shtëpisë pas vrasjes së T përgjatë vitit 2011, kur A, djali i tij po përballlej me akuza për vrasje e në anën tjetër vet dëshmitari specifikon se nuk ka mundur ta bëjë këtë paraprakisht si prijës i familjeve dhe obligimeve familjare, ndërsa pikërisht këto veprime i ndërmer kur përsëri kishin obligime familjare në një rast të madh që i kishte ndodhur në familje, qon në mëdysheje edhe me mundësitë financiare.

Megjithatë, kjo gjykatë nuk e lidhë drejtë për drejtë vrasjen e T.R me faktin se A.B e kishte kryer këtë veprim me pagesë, por arsyet se si dhe pse e kishte kryer A.B vrasjen dhe si ishte shtytur nga E.S për ta varurë T do të trajtohet në vijim të arsyetimit të aktgjykimit. Megjithatë ndikimi që kishte E.S në grupin ishte i madh dhe i njëjti edhe ju ndihmonte atyre edhe në aspektin financiar fakt ky i konstatuar më sipër nga dëshmitaret.

Gjykata konstaton se dëshmia e dëshmitarit nuk kishte relevanc me rrjedhën e ngjarjes, ndërsa sa i përket ndërtimit të shtëpisë edhe pse dëshmia e dëshmitarit kishte mos për puthje me ekspertizat përkitazi me këtë rast, kjo gjykatë nuk e ka lidhur vrasjen e T me këtë shkak, majde kjo nuk ishte as pretendim i përshkrimit faktik të vet aktakuzës.

Vrasjen e T, gjykata e ka lidhur me veprimet inkriminuese shtytëse të tani akuzuarit për motivet e tija hakmarrëse.

31,32.Për gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë lexuar edhe deklaratat e dëshmitarëve, S.L dhe F.G. Të njëjtit ishin punëtor në “Kafe Bar S” dhe se të njëjtit kishin qenë prezent në momentin kur ka ndodhur bastisja nga ana e policisë në “Kafe Bar S” ditën kritike. Të dy dëshmitaret kanë shpjeguar vetëm veprimet e policisë përkitazi me bastisjen, andaj deklaratat e tyre nuk kishin ndonjë relevancë, përkitazi me objektin e akuzës as në favor e as në dëm të tani akuzuarit, pasi që nuk kanë asnjë përshkrim lidhur me pretendimet e aktakuzës e as rrjedhën e ngjarjes objekt i këtij aktgjykimi, andaj nga ky këndvështrim, gjykata nuk do të lëshohet më tej në elaborimin e tyre pasi që nuk është kontestues fakti se kishte ndodhur atë ditë bastisja në “Kafe Bar S.

33. Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit N.S e dhënë në seancën e datës 21.07.2015, 22.07.2015, 23.07.2015 ku ndër të tjera i njëjti në seancën e datës 21.07.2015, fillimisht kishte shpjeguar rrjedhën e ngjarjes në detaje përkitazi me ditën kritike kur policia kishte hyrë në bastisje në “Kafe Bar S,” mënyrën se si ishte kryer bastisja dhe gjësendet që ishin marrë. Marr parasysht faktin se gjykata ka rekomandime të Gjykatës së Apelit të trajtoj çështjen e pranushmërisë së këtyre provave në aspektin procedural, gjykata nuk do të lëshohet më tej në elaborimin e kësaj deklarate përkitazi me bastisjen.

Ditën kritike, nga personi i njohur me emrin R (R.I), i cili zotëron zyrën e Ëestern Union, rreth orës 12:00-13:00, kishte pranuar shumën e të hollave rreth 42,000.00 (dyzet e dymijë) euro, të cilat ishin dërguar nga Spanja, e sipas një dokumenti të siguruar nga Ëestern Union në Prishtinë, të cilin prokurori prezantoi para dëshmitarit, për transferin e të hollave nga Ëestern Union në Spanjë, tregon se mes datës 28-30 Gusht të vitit 2007, kishin qenë 21 transferte në emra që dukeshin shumë të njohur përfshirë edhe emrin e dëshmitarit, e që shuma totale e këtyre transaksioneve ishte 63,000.00 (gjashtëdhjetë e tremijë) euro, shumë e cila ishte pranuar edhe nga vet deklarimi i R. në gjykatë, dhe dërguesi kishte qenë N.K, i cili këtë shumë i'a kishte dërguar për shlyerjen e një borxhi të cilin i'a kishte për të hollat që më parë i'a kishte huazuar. Të hollat i kishte vendosur në zyrën e kafiterisë në një sirtar të kyçur me çelës dhe për të hollat e kishte informuar E. përmes një SMS të dërguar me telefon të cilit i kishte thënë: “R” solli të hollat”, dhe se lidhur me këto të holla nuk dinte asgjë pasi që nuk kishte pasur çasje në kafiteri pasi që kishte qenë i paraburgosur dhe as nga policia nuk është pyetur për të hollat, ndërsa sa i përket 6 (gjashtë) telefonave mobil të konfiskuara në kafiteri, kishte deklaruar se njëri telefon kishte qenë i tij, një telefon i Sh.G, ndërsa për telefonat tjerë nuk ishte në dijeni se si ishin gjetur aty. Përveç telefonave, ishin konfiskuar edhe 37 CD të ndryshme për të cilat kishte deklaruar se ato ishin CD të muzikës, por për numrin e saktë nuk kishte njohuri. Lidhur me 55 fotografi të konfiskuara nuk i kujtohej, dy kaseta të kamerave, pajisja për incizimin e kamerave, nuk kishte njohuri për to pasi që kishte qenë në paraburgim për tre muaj, mirëpo kurë kishte dalë nga burgu, ajo DVD nuk kishte qenë aty. Lidhur me gjësendet e konfiskuara nga policia, asnjëherë sikurse edhe anëtarët tjerë të familjes nuk kishin pranuar ndonjë vendim formal apo dokument zyrtar. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.07.2015 si dhe atë datës 23.07.2015 lidhur me 9 (nëntë) fotografi për vrasjen e T.R, kishte kuptuar atëherë kur policia kishin shkuar në lokalin S, e për të cilin rast, derisa e kishin rrahur, i kishin thënë se “ju e keni vrarë atë”. Ditën kritike, kishte shkuar në “Kafe Bar S” rreth orës 10:00, bari kishte qenë i hapur dhe aty kishin qenë kamarieri, E.S, D.S (djali i axhës së tij), I.L. Atë ditë, E, kishte qëndruar në bar deri në mesditë para orës 12:00, pastaj me Imriun kishin dalë jashtë. Në bar kishte qëndruar tërë ditën, rreth orës 13:00-13:30, në bar kishin shkuar edhe persona tjerë si N.S (djali i axhës së tij), A.E (djali i tezës së tij), një fqj dhe shoku A.B, djemtë e axhës së tij I.A dhe Rr.A dhe në shoqëri me ata ishte edhe A.B, të cilët kishin qëndruar në bar një orë apo një orë e gjysmë kur edhe kishin dalë dhe më nuk ishin kthyer.

Nga ky fragment i dëshmitarit vërtetohet edhe njëherë fakti që është vërtetuar edhe nga dëshmitarët të tjerë por edhe nga vet i akuzuari e pastaj edhe nga vet dëshmitari A.B, se ditën kritike edhe E.S edhe A.B ishin në “Kafe Bar S” e po ashtu A.B atë ditë ishte i shoqëruar në “Kafe Bar S” me R.A (R) dhe I.A (L) e ku bashkë me këta të dy kishte dalë nga kafiteria.

Dëshmitari më tej mohon faktin se A.B ishte i punësuar në “B.Kafe”, por një pretendim i tillë nuk gjenë mbështetje në provat e tjera të administruara, repsetkvisiht deklarata e dëshmitarit F.Sh, Z.I, dhe dëshmitari D2, nga të cilat deklarata është vërtetuar fakti se A.B ishte punëtor në “B.Kafe” firmë kjo që udhëhiqej nga E.S.

Është theksuar dhe më herët përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi se edhe E.S edhe A.B me ndryshime deklaratash por edhe dëshmitari N.S janë munduar ta shmangin lidhshmërinë në mes E.S dhe A.B, pra faktin se i njëjti punonte në “B.Kafe”, andaj në këtë segment gjykata nuk i’ a fali besimin dëshmitarit pasi që një deklaram i tij është në kundërshtim me provat e lartcekura të administruara e që vërtetojnë të kundërtën e deklaramit të dëshmitarit.

Në sigurimin e “Kafe Bar S”, kishin punuar fqinjë të tij, F.A dhe S.R, të cilët kishin punuar jashtë barit, në zonat rreth objektit dhe të cilët për punën e kryer merrnin paga të rregullta në shumë prej 150 Euro.

Nga dëshmia e dëshmitarit vetëm ri-konfirmohet fakti se F.A ishte punëtor në “Kafe Bar S” që udhëhiqej edhe nga E.S. Rikujtojmë faktin se F.A është dënuar me aktgjykimin e formës së prerë nga Gjykata Supreme si i përfshirë në vrasjen e tani të ndjerit T.R, respektivisht, Aktgjykimi i Gjyaktës Supemre i plotfuqishëm me shenjën API.nr.9/2011 i datës 09.02.2012 me anë të se cilës janë vërtetuar Aktgjykimet e mëparshme.

Dëshmitari më tej specifikon se gjatë vitit 2003-2004, rreth orës 22:00, kishte pasur një problem me policin T.R, derisa ishte duke shkuar në shtëpi, në lokacionin te ish Gjykata e Qarkut në Prishtinë, derisa ishte në veturë me E.S dhe D.S, T kishte dalë nga vetura BMË e cila ishte ndalur në anën e djathtë të rrugës, i është afruar veturës së tyre dhe pasi E.S kishte hapur xhamin e veturës për të biseduar me të, T kishte nxjerrë sprejin me ç’rast dëshmitari kishte nisur veturën duke hyrë në semaforin e kuq, ku T kishte goditur veturën me shkelm nga prapa, dhe kishte shkuar në stacionin policor ne Vranjevc për të raportuar rastin.

Kjo gjykat specifikon faktin se është pretenduar edhe me dëshmitar të tjerë të paraqitet T si person konfliktuoz. Kjo gjykatë ka specifikuar edhe më sipër se fakti po që se i ndjeri ka pasur ndonjë problem të vogël me kënd do çoftë nuk ndryshon narrativen e rrjedhës së ngjarjes, sepse probleme i njëjti në vazhdimësi kishte nga E.S dhe grupi i tij, nga të cilët përcillej e kërcënohej në forma të ndryshme e të vazhdueshme gjë që është vërtetuar nga secili dëshmitar që e ka njohur T dhe problemet e tija.

Në deklaratën e tij të dhënë në prokurori, më datën 20.09.2007, kishte deklaruar se ditën kritike vëllain e tij E, e kishte gjetur në kafiterinë “S” në ora 10:00, pas pak në kafiteri kishin shkuar edhe A.B dhe të tjerët, E ishte larguar nga kafiteria së bashku me I, rreth orës 12:00, ndërsa rreth orës 14:00 dhe 15:00, A.B, I, dhe Rr, i ishin larguar nga kafiteria, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor deklarata e tij është kundërtënëse për faktin se kishte deklaruar se kur A.B, I, dhe Rr, kishin shkuar në kafiteri, E, nuk kishte qenë aty, i njëjti pas ballafaqimit me këtë deklaratë ka theksuar se nuk i kujtohet saktë përgjigja e tij, po siç ka deklaruar janë shkruar pas diskutimit me prokurorin e rastit, meqë ai diktonte dhe ajo shkruante.

Edhe njëherë gjykata tërheq vëmendjen se të gjithë dëshmitarët që ishin të afërt me E.S, kanë ndryshuar deklaratat e tyre më pastaj me arsyetimin se ishin nën presion kur i jepnin deklaratat para policisë apo prokurorisë, që për bindjen e trupit gjykues ky fakt ka qenë i pa vëretueshëm. Për më tepër fakti se dëshmitari në këtë fragment nuk e tha të vërtetën dhe që pretendon të mbron të akuzuarin, vërtetohet nga fakti se vetë A.B në deklaratën e tij të parë pastaj edhe ky duke e ndryshuar, kishte specifikuar se atë ditë ishte takuar në “Kafe Bar S” me E.S e që ky fragment rezulton të jetë i vërtetë, sepse deklaratat e tyre të para ishin identike edhe me dëshminë e dëshmitarit D-2, ku dëshmitari D2 kishte specifikuar se atë ditë kishte parë E.S aty, por edhe A.B, I.A e Rr.A e ku E, i kishte ftuar të njëjtit në takim në zyrën e tij.

Tutje i njëjti është ballafaquar me deklaratën e tij të dhënë lidhur me atë se sa shpesh e ka frekuentuar A.B kafiterinë S. ku i njëjti ka deklaruar "vjen shpesh", i njëjti ka deklaruar se "në polici më kanë rrahur dhe në përgjithësi këto janë fjalët e mija dhe ata kanë mundur të shkruajnë

çfarë kanë dashur, duke shtuar kam thënë njëjtë edhe këtu, që ai vinte shpesh ose nganjëherë nuk vite me javë".

Siç u specifikua më sipër, gjykata nuk u'a fali besimin dëshmitarëve kur pretendojnë se deklaratat e tyre u manipuluan për faktin se deklaratat e tyre të vërteta gjejnë mbështetje në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, ku faktin që e kishte pohuar në polici tani dëshmitari se A.B shkonte shpesh në "Kafë Bar S" e kishte specifikuar edhe dëshmitari F.Sh, andaj këto deklarata që dëshmitarët pretendojnë se janë manipuluar, po që se ishin të tilla, nuk mund të rezultojnë identike me dëshmitarët e tjerë objektiv e konkret gjatë gjithë fazave të procedurës po që se të njëjtat ishin të sajuara, andaj tendenca për të zhvlerësuar deklaratat e para për të shmangur raportet kjo gjykatë nuk u'a fali besimin.

34.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 është konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitares F.M e dhënë në seancën e datës 05.10.2015.

Dëshmitarja në fjalë më shumë kishte specifikuar lidhshmërinë që kishte me E.S dhe mendimet personale që kishte për të. Po ashtu e njejta ka shpjeguar disa probleme që kishte me B.H dhe Sh.Q

Një fakt relevant lidhur me rastin që mund të shkëputet nga fragmentet e dëshmitares është fakti që konfirmon incidentin e Ferizajit mes njësisë speciale atje dhe E.S.

Deklaratat e dëshmitarës nuk përputhen me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë lidhur me profilin e ES, megjithatë nga deklarata e kësaj dëshmitare e që përputhet me deklaratimet e dëshmitarëve të tjerë si Sh.Q dhe Rr.B, vetëm ri-konfirmohet incidenti i Ferizajit ku E.S ishte rrahur nga njësi special atje, e ku për këtë çështje tani i akuzuari e kishte akuzuar se prapa saj qëndronte T.R Marr në tërësi deklarata e saj nuk kishte të bënte lidhur me objektin e aktakuzës, përveç faktit të incidentit të Ferizajit që lidhet me motivet e kryesit karshi T.R, ndërsa pjesa tjetër që flet për raportet me B.H dhe Sh.Q tregojnë vetëm vazhden e konfliktit përkitazi me rastin e Ferizajit.

35,36,37.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 11.07.2023 janë konsideruar si e lexuar deklarata e dëshmitarit Q.Q, L.L dhe B.D, të dhënë në seancën e datës 03.12.2015.

Këta dëshmitar secili nga detyrat e tij të punës veç e veç kanë shpjeguar rolin e tyre dhe veprimet që kanë ndërmarr. Megjithatë, meqë të njëjtit flasin vetëm për procedurat e tyre të brendshme, nuk kishin relevancë përkitazi me objektin e aktakuzës dhe se provat materiale që janë nxjerrë do të trajtohen tek provat materiale, andaj mbi këtë bazë gjykata nuk u lëshua më tej në elaborimin e deklaratave të tyre, pasi që nuk lidhen me veprimet inkriminuese të të akuzuarit.

38.Deklaratë me shumë relevancë në zbardhjen e të vërtetës përkitazi me përshkrimin faktik që ka zbardhur dhe vërtetuar kjo gjykatë është edhe deklarata e dëshmitarit A.C Dëshmitari nuk kishte mundur të sigurohet përsëri në procedurë arsyet e të cilës kjo gjykatë do t'i paraqes tek vërejtjet e Gjykatës së Apelit, mirëpo kjo gjykatë ka lexuar deklaratën e tij të dhënë në Polici. Dëshmitari kishte specifikuar se mes viteve 2002-2006, ishte shoqëruar me E.S, dhe pas kësaj jo më, pasi që tek opinioni kishte reflektuar negativisht. Me të njëjtin kishte shëtitur nëpër rrugët e Prishtinës me veturat e tij "Golf III" të blinduar dhe me "Xhip" të gjelbër. Gjatë asaj periudhe kohore, E, e kishin shoqëruar edhe Rr.A (Rr), I.A (L), A.B (S), N.S (K), S.S, N.S. Derisa kishte qenë duke u shoqëruar me E.S, ky i fundit kishte pasur probleme të vazhdueshme me T.R, për shkak të Adelins. T.R e kishte njohur se kishte qenë polic si dhe kishte pirë kafe në kafiterinë AM/PM, në të cilën T, kishte qenë i rregullt. Lidhur me rolin e E.S në grupin e tij dhe njerëzit që e rrethonin, i njëjti deklaroi se E. i kishte pasur rolin kryesor të "Grupit", dhe të gjithë i bindeshin urdhrave të tij kur ata ngarkoheshin me detyra nga ai dhe se të gjithë anëtarët e tij i kishte mbajtur me të mira materiale dhe Rr, dhe I.A u kishte ndërtuar shtëpitë. I.A e kishte parë të shoqërohej me A.B me veturë në qytet.

Nga dëshmia e dëshmitarit, gjykata vërteton se dëshmitari A.C kishte qenë i afërt me E.S, andaj edhe nga dëshmia e dëshmitarit gjykata ka arritur të vërtetoj rrethana të rëndësishme faktike.

Se ekzistonte grupi i ashtuquajtur S, tani më e ka specifikuar thujse se cili dëshmitar e që janë specifikuar më sipër, e që e gjykata vërteton edhe njëherë këtë fakt edhe në bazë të dëshmisë së dëshmitarit.

Nga dëshmia e dëshmitarit, gjykata ri-vërteton faktet që janë vërtetuar edhe nga dëshmitarët e tjerë, se E.S kishte probleme me T.R.

Kjo gjykatë kishte konstatuar edhe më sipër se ndonëse problemet mes tyre kishin datuar që nga viti 2000-2001, konflikti tyre kishte marr dimension tjetër pasi që tani i ndjeri kishte filluar lidhje me dëshmitaren A.I, e që gjykata vërteton edhe njëherë faktin se motivi i problemit të E, me T ishte A, gjë që e konfirmon ky dëshmitar, por edhe dëshmitari A.S, por që vërehet edhe nga vet rrjedha e ngjarjes.

Nga deklaratat e dëshmitarit vërtetohet fakti se njerëzit e “grupit S” vepronin nën urdhrat e E.S e ku ky dëshmitar siç u specifikua më sipër ishte i afërt me E,dhe grupin dhe njihte më së miri mënyrën e funksionimit.

Nga deklaratat e dëshmitarit është vërtetuar edhe fakti se kush ishin disa nga anëtarët e këtij grupi, e që ri-konfirmohet edhe njëherë fakti që e potenconin thujse të gjithë dëshmitaret se një nga personat kryesor ishin Rr.A (Rr) dhe I.A (L). Edhe nga ky dëshmitar vërtetohet fakti se A.B ishte i afërt me I.A e që rrjedhimisht ishte pjesë e grupit S, që gjen mbështetje edhe në deklaratat e dëshmitarëve F.Sh, dhe dëshmidari D2.

Një fakt tjetër që vërtetohet nga dëshmia dëshmitarit është fakti se E.S ishte ai që mbante me të mira materiale anëtarët e grupit.

Gjykata i’a fali besimin dëshmitarit për çështjet që vërtetoi nga ky dëshmitar, për faktin se faktet që u vërtetuan nga dëshmitari gjenin mbështetje në mënyrë identike edhe nga dëshmitarët e lartshënuar për faktet e lartshënuar, andaj edhe gjykata i’a fali besimin të njëjtit, me ç’rast vërtetoi se ekzistonte “Grupi S”, pjesë e të cilit ishin edhe Rr.A (Rr) dhe I.A (L), si dhe A.B. Se anëtarët e grupit mbaheshin me të mira materiale nga E.S dhe se anëtarët e grupit i bindësin urdhrave të E.S dhe se E.S kishte probleme me T.R dhe se motivi – shkaku ishte edhe A.I

39.Në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të datës 19.03.2024 ishte dëgjuar edhe dëshmitari A.S, ku ndër të tjera ka theksuar se nga viti 2000 deri në vitin 2007 ka qenë Instruktor i Policisë së Kosovës- Instruktor i Njësisë Speciale deri në ditën kur është larguar nga aty si dhe ka qenë pjesëtar i mbrojtjes së afërt. Lidhur me njohjen e T.R ka deklaruar se T, e ka njohur prej shkollës fillore, po ashtu kanë qenë bashkë edhe në gjimnazin “Xh.D.”, pastaj të njëjtin e njeh po ashtu edhe prej sportit me të cilin është marrë me bodybulding, e ka njohur po ashtu edhe prej punës së tij në OSCE ku edhe ky ka punuar për një kohë. I njëjti ka shtuar se me T, ka punuar deri në ditën kur ka ndërruar jetë dhe me të njëjtin ka pasur një shoqëri të mirëfillt dhe kanë kaluar shumë kohë bashkë si kolegë dhe si shokë, ka shtuar se meqë kemi kaluar një kohë së bashku dhe jemi njohur familjarisht e konsideron se i kanë ndarë të mirat ashtu edhe të kqijat.

Në këtë kontekst, rezulton se tani dëshmitari A.S ishte njëri nga personat më të afërm të T.R dhe se ishte në dijeni për problemet e T, dhe prejardhjen e problemeve.

Sa i përket problemeve të T.R, ka shtuar se i ndjeri T.R, në fillimin e karrierës së tij si polic, me qenë se ka qenë polici më i mirë i Njësisë Speciale që ka pasur Kosova, shumë grupe pas luftës që kanë dashur me dominua krimin në Kosovës, kanë dashur me bo presion, e po ashtu e kemi pasur grupin “S”, që kanë bërë presion, si në rastin te shkolla e mjekësisë “Te rrethi”, në Prishtinë, ai ishte një ndër rastet e para. Pastaj kemi pas raste të përcjelljes, ku janë sjell afër lagjes ku ka jetuar. Pastaj, ka pasur shfryrje të gomave të veturës së T, jo një herë, po me shumë herë. Pastaj me një rast tjetër ka pas edhe shpuarje të gomave.

Fakti se problemi i parë ishte rasti tek shkolla e mjekësisë “Te rrethi” tani më është konstatuar nga kjo gjykatë pasi që një fakt të tillë e kanë specifikuar edhe dëshmitarët, Sh.R, V.R, A.I, G.H, B.Sh, B.H, Sh.Q, ku E.S e kishte kërcënuar T, me granatë dore. Këtu ishte filli i problemit, pasi që kishim të bënim me një grup që pretendonte ta diktonte atë kohë Prishtinën dhe një zyrtar policor që pretendonte të ishte në krye të detyrës dhe të zbatonte ligjin. Kështu fillon konflikti në mes të E.S dhe T.R. Fakti se “grupi S”, e në krye të së cilës ishte E.S, kishin vazhduar sulme e kërcënime ndaj T, duke e përcjellë e duke ja shfryer dhe shpërthyer gomat e veturës, vërtetohet edhe nga dëshmitari G.H i cili po ashtu ishte njëri nga shokët e afërt të T, e që bën deklaratën e dëshmitarit A, të besueshme për gjykatën pasi që përveç afërsisë që kishte i njëjti me T, po ashtu deklarata e tij rezulton të jetë në përputhje të plotë edhe me deklaratat e dëshmitarëve të lartcekur.

Dëshmitari më tej specifikon se, T, ka filluar një lidhje romance me A, në atë kohë, edhe pas një kohe shumë të shkurtër, i është djegur vetura, që ishte një mesazh nga ana tjetër dhe specifikon se pas lidhjes me A, presioni ndaj T, nga “Grupi S,” ishte rritur.

Nga rrjedha e ngjarjes por edhe nga dëshmitë e dëshmitares Z.I dhe M.I, rezulton se familja e tyre kishte probleme me “Grupin S”, rrjedhimisht me E.S e po ashtu nga deklaratat e të lartcekurave rezulton se A. kishte një raport me të e ku në atë kohë ishte e pa-lumtur dhe se ishte T.R që u ishte ofruar atyre për mbrojtje nga grupi dhe se shkëputja e A nga E.S kishte ndodhur përfundimisht kur ajo kishte filluar lidhjen me T.R. Nga deklarata e dëshmitarit A.S, por edhe nga rrjedha e ngjarjes dhe dëshmitë e dëshmitarëve të elaboruar më lart, rezulton se konflikti mes E.S dhe T.R pas lidhjes së këtij të fundit me A, merr një kthesë tjetër pasi që menjëherë T, ishte djegur vetura po nga ky grup që vërtetohet edhe nga deklaratat e dëshmitarëve Sh.R, Sh.Q V.R, B.Sh, që ka qar mesazhin e qartë të E.S se tani i ndjeri nuk do të lihej rahat.

Dëshmitari ka folur edhe për Rastin e “S. Casino”, ku ka specifikuar se ky rast ka ndodhur në natën e krishtlindjeve, ku unë pas meshës me familjen time, e po ashtu edhe me T”, i cili i ka pas ftesat për “S. Casino”, i cili na ka ftuar, për të festuar “Natën e Krishtlindjeve” së bashku.

Duke mos ditur, që aty ka qenë një përcjellje që na ka ndodhur, ku jemi nxënë në një pikë ngulfatëse, kemi qenë në hyrje të lokalit saktësisht në korridorin, dhe se personin e parë që e ka identifikuar ka qenë E.i, i cili e ka sulmuar me krahë T. dhe po të njëjtën kohë ka filluar sulmi prej disa anëve që ka qenë një pikë ngulfatëse aty mu në hyrjen e lokalit, në korridor ku unë jam plagosur pa asnjë arsye, edhe po ashtu të njëjtën kohë kanë qene te rrezikuar shumë njerëz, si familja ime dhe shume njerëz, që kanë qenë të pranishëm në korridor, që “Grupi i E”, ka qenë brenda dhe jashtë lokalit, ku ne e kemi gjet veten në mes te “grupit” edhe jemi sulmua pa asnjë paralajmërim apo diçka, edhe aty unë nuk jam vetëm dëshmitar por edhe viktimë.

Siç është specifikuar edhe më sipër, kjo gjykatë ka konstatuar se rasti “S. Casino” ishte një rast që shpërfaq një fakt konkret, se konflikti tani më kishte marr një hov dhe dimension tjetër, ku kishte pasur rrahje e gjuajtje me armë, ku kishte pasur të plagosur e njerëz të tjerë të rrezikuar me jetë.

Rasti i fundit që përmend dëshmitari – pra rasti i fundit para privimit nga jeta të tani të ndjerit është rasti, kur T. i ka treguar në telefon, kur dëshmitari kam qenë në Kroaci, ku disa persona afër fshatit të tij në S. i kanë organizuar një atentat.

Sa i përket kontakteve para vrasjes së T. ka shtuar se ka qenë një javë apo dy javë, - dy javë pasi që i njëjti fizikisht ka qenë në Koraci, është dëgjuar me T. ku përmes telefonit i ka treguar që i është bërë një atentat në fshatin S., i cili si rast ka ndodhur një javë apo dy para vrasjes. I njëjti ka shtuar se para vrasjes së T.R ka qenë në Amerikë për 2 javë, pasi që është kthyer një javë në Kosovë, ku kanë ndejtur shpesh me T, pasi që edhe kanë punuar bashkë, pastaj ka shkuar në pushim në Kroaci ka qenë vera, me të kuptuar që T, është privuar nga jeta është kthyer në Kosovë për tri ditë dhe ditën e katërt është nisur për Amerikë.

Dëshmitari më tej kishte specifikuar se për me e ditë që T, ka pasur problem me E.S nuk është dashur që të jesh shok i ngushtë me të, sepse edhe fëmijët e lagjes e kanë ditur që E, ka problem me të, dhe jo T.me E.

Se T, i ishte organizuar atentati pikërisht sipas vet T, familjarëve e njerëzve të tjerë të afërm të tij nga E.S me grupin e tij rreth dy javë para vrasjes së tij është vërtetuar jo vetëm nga deklaratat e dëshmitarit A.S, por edhe nga deklaratat e dëshmitarëve Sh.R, V.R, G.H, B.Sh, A.I, A.S, Sh.Q Në këtë këndvështrim, në bindjen e gjykatës, intensiteti i sulmeve ndaj T, tani më ishte i qartë, pasi që vetëm dy javë para vrasjes së tij ishte organizuar atentati ndaj tij, që krijon bindjen e qartë të kësaj gjykate, se tani E.S kishte vendosur që ta privonte nga jeta T.R

Dëshmitari ka folur edhe sa i përket “Grupit S” ku ka specifikuar pjesë e tij ka qenë E, vëllau i E, N.S, A.B që e ka plogosur, Rr.A, L, F.H, F.M.

Nga deklaratat e dëshmitarëve Sh.R, V.R, G.H, B.Sh, A.I, A.S, Sh.Q, Z.I, F.Sh, është vërtetuar se ekzistonte “grupi S” në krye të së cilës ishte E.S dhe grupi funksiononte nën urdhrat e tij gjë që e specifikon edhe dëshmitari A.C atë kohë person i afërm me E.S dhe person që ishte në dijeni për funksionimin e grupit.

Dëshmitari më tej shpjegon lidhur me ndërrimin e vendbanimit të T. ku ka shtuar se pasi që kanë marrë informacioneve nga shefi i shtabit që e ka mbajtur mbledhjen ku janë informuar që E.S është duke e planifikuar vrasjen e T., i është ofruar vendbanim i ri prej policisë, sepse ka qenë serioze deklaratat.

Po ashtu duke marrë parasysh se kohëve të fundit pasi që janë intensifikuar përcjelljet dhe kërcënimet ndaj T, i njëjti ka kaluar më shumë kohë në fshatin S, nga vjen familja e tij, ai ka shkuar në S, për arsye se e ka ndjerë vetën më të sigurt.

Fakti se kohët e fundit, pra para vrasjes, T kalonte më shumë kohë në S, ë nga frika se do ta gjente më e keqja, është vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve Sh.Q, G.H dhe B.Sh që specifikonin faktin se kohët e fundit pra para vrasjes T, ishte më i shqetësuar dhe frikësuar – që qon drejtë bindjes së gjykatës se tani sulmet për vrasjen e tij ishin intensifikuar dhe gjë që për këtë ishte i vetëdijshëm T., andaj edhe ishte i shqetësuar dhe i bindur se prapa secilit akt ishte E.S.

Dëshmitari kishte specifikuar se dorasi është lajmëruar vet, por e din që kush e ka dhënë urdhrin dhe kush e ka orkestruar urdhrin, e që është E.S dhe jo që këtë e din vetëm ai, por këtë informatë e ka marrë edhe prej inteligjencës e për më tepër specifikon se gjitha sulmet ndaj T, ishin të orkestruara nga E.S ku T. kishte me dhjetëra probleme sulme e kërcënime që vinin nga ta, andaj është i bindur se E.S ka dhënë urdher për vrasjen e T, ndërsa lidhur me A.B kishte specifikuar se T. nuk ka pasur ndonjëherë problem me të.

Në fund është pyetur edhe për emrin Gj.K i njëjti ka deklaruar se ka dëgjuar për emrin Gjon, ai ka shtuar se bashkëshortja e tij nuk është në lidhje familjare me Gj.K për aq sa e din ai, ndërsa sa i përket rastit të “S.Casinos”, pas rastit ka pasur sikurse të ai dhe tek T, persona familjare dhe jo familjare, dikush me qëllim të mirë dikush me qëllim të keq, që kanë insistuar me ardh te një lloj kontakti.

Krejt në fund dëshmitari ka specifikuar se arsyeja pse është shpërngulur në Amerikë ishte frika nga “Grupi S”.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.S gjithnjë në fragmentet që gjejnë mbështetje në mënyrë identike edhe në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë të specifikuar më lartë e ku në këto fragmente gjykata i ka falë besimin, është vërtetuar se: Konflikti i parë mes E, e T, kishte ndodhur në vitin 2000-2001, ku E.S kishte sulmuar T, gjatë detyrës zyrtare për primat që askush të mos guxonte ta ndalonte. Atë periudhë T. kishte përcjellje e përndjekje nga i ashtuquajtimi “Grupi S” duke i’a

shfryer e shpërthyer edhe gomat e veturës. Gjykata më tej vërteton edhe njëherë faktin se pas lidhjes së T me A, sulmet, përcjelljet, të “grupit S” ishin të shpeshta, qoftë në përcjellje neper rrugë e kafiterit që frekuentonte T, qoftë duke ja djegur edhe veturën. Gjykata më tej konstaton se rasti “S. Casino” kishte qar konfliktin në një nivel tjetër me plagosje e me persona të rrezikuar për jetë. Gjykata ri-vërteton faktin se kohët e fundit – pak para vrasjes, T, kohën më të madhe e kalonte në S, nga frika se do ta gjente diçka dhe fakti që ishte në përcjellje të vazhdueshme vërtetohet pikërisht nga fakti se në fshatin S, nga E.S e grupi tij ishte organizuar atentat ndaj tani të ndjerit rreth dy javë para vrasjes. Se T. nuk kishte asnjë problem me A.B e ri-konfirmon edhe dëshmitari A.S.

40.Sipas propozimit të mbrojtës, ishte dëgjuar edhe dëshmitari Gj.K. I njëjti për rastin e “S. Casinos” kishte dëgjuar nëpërmjet mediave që ka ndodhur një rrahje me plagosje në atë lokal, ka dëgjuar më vonë nuk mund ta dijë sakte ndoshta pas një muaji, apo muaji e gjysmë që ka ndodhur rasti, që është A.S dhe T.R, ndërsa e ka njohur A.S dhe E.S., E.S e njeh pasi që i njëjti po ashtu merret me hotelieri dhe se E, e ka pasur mysafir, rastësisht janë njoftuar dhe prezantuar dhe i ka ofruar një kafe të cilën E, e ka prezantuar dhe aty i njëjti e ka marrë në lokalin e tij kafën që e ka shitur E.S dhe prej aty ka filluar me u shoqëru. Ndërsa sa i përket njohjes me A.S ka shtuar se është dhëndër në fshatin e tij në V. në Komunën e Prizrenit, ku bashkëshortja e A, është kumar e familjes së tyre. I njëjti ka theksuar se pas rastit të “S. Casinos”, A.S dhe T.R e kanë thirrë në një restorant sa i kujtohet ka qenë restoranti Piknik, aç sa i kujtohet në telefon e ka thirr A, sepse A, e ka njohur dhe qëllimi i takimit ishte rreth punës së E, dhe se çfarë kishte ndodhur me rastin, ai ka shtuar se e ka ditur se rasti ka pasur të bëjë me polic po se ka dit që ka pasur të bëjë me T, dhe A.

Kishte specifikuar se A, i kishte kërkuar që për shkak raporteve shoqërore që kishte me E. të ndërmytesonte për pajtim, ndërsa sipas dëshmitarit versioni i A, ishte se “në shkallë janë cakëruar me supe të krahut pra A, dhe E, dhe se pastaj janë rrahur dhe rrahja ka zgjat derisa janë lodh. I njëjti ka shtuar se sipas tij ndërmytet A dhe T,ka qenë kërkim falja që e kanë rrahur E.S dhe se i njëjti kishte pranuar këtë kërkesë dhe se i kishte thënë T dhe A,“aq sa kam mundësi shpirtërisht kam me u mundu për me ju pajtu”. Pas kësaj ka potencuar se E, pas rastit të “S.Casinos” ka qenë në spital dhe se ka shkuar tek shtëpia e E, me djalin e tij Xh., e kanë fillu bisedën ku të pranishëm kanë qenë, ai, djali i tij dhe vëllai i E i quajtur N.S. I njëjti i ka treguar E. se është takuar me T dhe A, kanë biseduar, kanë folur me të dhe kanë kërkuar falje dhe mundësisht ne jemi ardh deri te pajtimi për tu pajtuar dhe se E i ka thënë “a kanë treguar Gj. ndonjë arsye, pse e kanë bërë këtë”, i njëjti është përgjigjur se “jo nuk më kanë thënë ndonjë gjë”, dhe se E, i ka thënë “do t’i ndjekë penalisht”. Më tej sipas dëshmitarit E, i ka treguar se E, e ka pyetur të njëjtin se a të kanë treguar se pse e kanë rrahur të njëjtin, ai ka treguar se nuk më kanë dhënë kurrfarë arsye.

Dëshmitari kishte shkuar për t’i pajtuar, respektivisht sipas tij që E, t’i fal ata, dhe kishte qenë insistim i anëtares së trupit gjykues që dëshmitari të jepte një përgjigje përfundimtare se a e kishte arritur objektivin t’i pajtonte, pra a i fali apo jo i akuzuari ata, dhe dëshmitari ishte përgjigjur me jo.

Deklarata e dëshmitarit kishte kontraditat e veta lidhur me kohën dhe njoftimin e tij me E.S, megjithatë nga deklarata e dëshmitarit ri-vërtetohet një fakt tani i konstatuar nga gjykata, se E.S ishte udhëhëqës i biznesit “B.Kafe”

Më tej nga dëshmitari ri-konfirmohet fakti se kishte eskaluar konflikti në ”S.Casino.”

Deklarimi i dëshmitarit edhe pse dëshmitar i propozuar nga mbrojtja, është në kundërshtim me vet deklaratën e të akuzuarit E.S, sepse i njëjti specifikon se T. i’a kishte shpëtuar jetën në “S.Casino”, ndërsa dëshmitari rrëfen se sipas versionit që i’a kishte thënë E. atij, ai jo që ishte

shpëtuar nga T. por gjatë konfliktit ishte rrahur aç shumë sa kishte qenë në spital, megjithatë deklarimin e tani të akuzuarit gjykata do ta trajtoj në vijim të këtij arsyetimi të aktgjykimit.

Pavarësisht si kishte rrjedhur rasti dhe çka kishte ndodhur saktësisht atë ditë, kjo gjykatë konkludon faktin se atë ditë kishte pasur një konflikt masiv e me të shtëna armësh ku protagonist ishin E. e T, i e që konflikti kishte ndodhur për shkak të konfliktit të vazhdueshëm mes tyre. Një fakt tjetër që ishte vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit ishte se E.S nuk i kishte falur T, dhe A, përkitazi me rasi të gjë që vërtetohet nga rrjedha e ngjarjeve në vijim, pasi që kishin vazhduar sulmet përcjelljet e madje edhe atentati ndaj T, pas ngjarjes së “S.Cassinòs” që qon në konkludimin se rasti “S Cassinos” ishte motivi i radhës për hakmarrje ndaj T.R, nga tani i akuzuari E.S

41.Gjykata duke i dhënë të drejtë fundamentale barazisë së palëve në procedurë, me prioritet të veçantë ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, respektivisht, deklarimin e të akuzuarit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari E.S kishte dhënë mbrojtjen e tij dhe pretendimet e tij edhe në këtë ri-gjykim. Të akuzuarit nuk i ishin parashtruar pyetje nga Avokatja mbrojtëse pasi që ato vetëm se ishin konsumuar në gjykimet e kaluara dhe se i akuzuari kishte mbetur prapa gjitha deklaratave të tij, e po ashtu pyetje nuk kishte parashtruar as Prokurori special.

Meqë trupi gjykues ishte në përbërje të re, kishin parashtruar pyetje të akuzuarit përkitazi me çështjet specifike që determinonin ngjarjen.

Paraprakisht specifikojmë faktin se i akuzuari kishte mohuar kategorikisht përfshirjen e tij në vrasjen e T.R.

Në pyetjet e trupit gjykues i njëjti ishte deklaruar: fillimisht i njëjti është pyetur lidhur me raportet-afërsinë me të dënuarin A.B, ku i akuzuari ka deklaruar se unë e kam cekur edhe më herët A.B nuk e kam njohur thujse fare, ai ka qenë një gjeneratë shumë më e re se ai dhe që atë nuk e ka lidhur me të kurrfarë pune apo biznesi, apo pazare apo lidhje familjare, ka shtuar se mund ta vërtetoni dhe e ka vërtetuar edhe policia edhe kundër vullnetit që kanë pasur të falsifikojnë dhe të montojnë lloj lloj prove për-shembull dëshmitarin D-2. Ka shtuar se me A.B, nuk është shoqëruar kurrë, me A janë shoqëruar dajt e tij, kusherinjtë e dajve, si Rr.A (Rr) si dhe I.A (L), pra A.B ka ndejtur edhe me D.S-djalin e axhës së tij i cili e ka pasur shtëpinë ngjitur me shtëpinë e tij, po ashtu me A e kanë një foto, ku shihet dhe për të cilën kanë dhënë sqarim, të detajuar. Ndërsa më tej lidhur me A.B sa i përket lejes së vozitjes kishte deklaruar se: është ballafaquar me një deklaratë të tij të datës 09.03.2016 ku përgjatë pyetjes së prokurorit të shtetit ka deklaruar si vijon: “si do ta merrja A.B...”, e që pyetja që i është parashtruar ka qenë se ku ka pasur njohuri i akuzuari se A.B nuk ka pasur leje duke marrë parasysh faktin se i njëjti ka mohuar të ketë pasur ndonjë lidhje me të, i njëjti ka deklaruar se duke marrë parasysh që i njëjti prej vitit 2007 ka pasur, jo akuzë zyrtare të prokurorisë por nga gazetatat të cilat kanë shkruar më shumë se 500 herë, emisionet televizive, i njëjti është interesuar për fatin e tij dhe është përgatitur sa ka mundur për t’i demantuar montimet, falsifikimet.

Këtyre specifikimeve të tani të akuzuarit lidhur me raportin me A.B, gjykata nuk ia fali besimin për faktin se nuk gjejnë përputhje me provat tjera të administruara. I akuzuari i quan të falsifikuara deklaratat e dëshmitarit D-2, por kjo gjykatë deklarimeve të këtij dëshmitari nuk ua fali besimin si të vetme pa mbështetje në prova tjera. F.Sh ishte dëshmitar në shqyrtim gjyqësor i cili njihet mirë edhe E.S edhe grupin e tij dhe mënyrën e tyre të funksionimit dhe kishte qenë ky dëshmitar që kishte specifikuar atë që ndërlihet pastaj dhe e bën të besueshme edhe deklaratën e dëshmitarit D-2 dhe kishin konfirmuar se A.B kishte punuar në “B.Kafe” e që tani

i akuzuari, por edhe dëshmitar të tjerë që ishin të afërm me E.S në vazhdimësi nga rrjedha e ngjarjes, ndryshonin deklaratat e tyre për të munduar të shmangnin raportin mes E.S dhe A.B dhe se çdo takim i tyre sipas E.S kishte qenë i rastësishëm. Andaj, në këtë kontekst, gjykata nuk ia fali besimin deklaramit të të akuzuarit pasi që i njëjti në vazhdimësi është munduar të shmang raportin me A.B gjë që vërtetohet e kundërta nga dëgjimi i dëshmitarëve. Siç u specifikuar më sipër, madje në një rast përgjatë përgjigjeve të të akuzuarit në gjykimet e kaluara, i njëjti kishte specifikuar se ska mundur me punu A. aty se kishte leje ta voziste veturën, e në anën tjetër specifikon se nuk e njihnte thujse fare A. e rezulton po ashtu se dinte detaje për të me arsyetimin se është interesuar pasi aktakuzat janë bërë publike. Si do që të jetë për tej deklaratave kontradiktore të tani akuzuarit me qëllim të shmangies së raportit me A.B, faktin se A.B ka punuar në "B.Kafe" biznes të cilin e udhëhiqte E.S, tani është vërtetuar nga dëshmitaret F.Sh, dëshmitari D2, por edhe nga rrëfimi i dëshmitares Z.I që këtë fakt e kishte kuptuar nga pikërisht dëshmitari F.Sh, e fakti se dëshmitari F,ia kishte thënë këtë, vërtetohet edhe nga sms (prove materiale).

Një tjetër çështje që ishte ngritur nga trupi gjykues ishte rasti i "S.Casionos". Lidhur me deklaramin e tij në kuadër të shqyrtimit gjyqësor kur është pyetur lidhur me incidentin që kishte ndodhur në "S.Casino" është pyetur lidhur me atë "se a keni pasur ju personalisht konflikt me tani të ndjerin T.R" ndërsa përgjigja e juaj ishte "se nuk keni pasur asnjë konflikt me tani të ndjerin", madje duke specifikuar se ka qenë pikërisht i ndjeri T. që i'u ka shpëtuar jetën atë ditë në "S. Casino", e tutje në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë me dëgjimin e dëshmitarit Gj.K, ku i njëjti para trupit gjykues ka theksuar se "ishte ardhur në shtëpinë e juaj për t'ju pajtuar juve me T dhe A, dhe sipas tij në këtë takim, ju i kishit thënë se natën në "S.Casino", ka qenë T, dhe A, që ju kanë rrahur deri në vdekje dhe nuk e dini as vet se si keni shpëtuar", e që i akuzuari është pyetur se a mund t'i tregoni trupit gjykues cila është e vërteta, ajo që keni deklaruar ju në shqyrtim gjyqësorë, apo atë se çfarë ka thënë dëshmitari Gj.K. I akuzuari ka deklaruar se unë kam thënë ashtu duke menduar se nuk kam pasur kurrfarë problemi para rastit "S. Casino", ku këtu pyetjen e anëtarit të trupit gjykues, e kam shtuar edhe një rast, kur më pyeti se : "a pate apo nuk pate problem" dhe unë thashë se "pata problem dhe atë të madh dhe serioz, se kur kërcasin armët diku përafësisht 20 deri 30 plumba, kemi të bëjmë me problem serioz", dhe kam qenë i rrahur dhe kam qenë pa vetëdije.

Përgjatë deklaramit të tij, është pyetur se a i ka thënë Gj.K se e ka rrahur T, deri në alivanosje në "S. Casino", i njëjti ka deklaruar se jo nuk e ka thënë kurrë atë, as atij as askujt.

Fillimisht duhet specifikuar faktin se për gjatë gjithë pyetjeve të trupit gjykues për çështje konkrete i akuzuari ka devijuar pyetjeve duke e tej zgatur përgjigjet e tija për çështje që nuk i kërkonte trupi gjykues dhe duhej insistuar disa here për tu përgjigjur vetëm në pyetjet konkrete. Më tej specifikojmë faktin se i akuzuari mundohet në vazhdimësi të shmang konfliktin me T, se kinse aj nuk ka pasur fare problem me të për tu munduar kështu të shmang arsyet e vazhdueshme të konfliktit. Ai më tej specifikon se T, ia ka shpëtuar jetën në "S. Casino" e në anën tjetër dëshmitari Gj.K i propozuar nga mbrojtja specifikon se E, i kishte thënë se T, e kishte rrahur atë në incidentin e "S.Casinos" e në anën tjetër i akuzuari specifikon se Gj.K kishte shkuar me kërkesë edhe të T. për të kërkuar falje. Për çka do duhej të kërkonte falje dhe të dërgonte dikush njerëz për pajtim po që se ia ka shpëtuar jetën dikujt, pra konteksti i përgjigjeve të të akuzuarit humbet logjikën e vet.

Kjo gjykatë konstaton se konflikti i "S.Casionos" ishte një konflikt i radhës e që gjykata nuk do të lesohet në specifikat e asaj se saktë çfarë kishte ndodhur, por T dhe A.S ishin me familjar dhe se konflikti ishte i provokuar nga "Grupi S" dhe pastaj konflikti kishte marr një dimension tjetër me gjuajtje me armë, me rrahje, me të plagosur e rrezikuar dhe krejt ky konflikt kishte ndodhur për shkak të E.S dhe T.R. Andaj, çdo përpjekje e të akuzuarit për të shmangur idenë e konfliktit

mes tij dhe T. është në kundërshtim me vet provat që i ka propozuar mbrojtja dhe me vet deklarinimin e të akuzuarit pasi që ka shpërputhje totale në raport me logjikën e fakteve vendimtare. Atëherë nga kush e shpëtoi T, E, nga A.S shoku i tij, sepse E, pretendon se u sulmua nga A.S. Më tej tek provat materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor është vet E.S që ne deklaratat e tij akuzon T, se i njëjti e kishte rrahur. Andaj përfundimisht, në këtë segment, kjo gjykatë ka konstatuar edhe më herët dhe ri-konstaton edhe njëherë faktin se ky ishte një konflikt i radhës i përpjekjeve të E.S dhe grupit të tij për ta dominuar T, dhe ky konflikt vinte pasi që “grupi S” kishte intensifikuar përcjelljet e kërcënimeve ndaj T, sepse ndodhte në kohën pasi që T kishte filluar lidhjen me A, madje ky konflikt rezultoi te ndodhte diku rreth tre muaj pasi që T kishte filluar lidhjen me A.

I akuzuari E.S ishte pyetur edhe lidhur me atentatin që i kishte ndodhur T, në fshatin e tij S, I akuzuari ishte përgjigjur si vijon: nëse ka ndodhur ajo bllokadë ndonjëherë për të cilën i njëjti nuk e beson, dhe se nuk ka ndonjë shënim zyrtar askund, nuk është punë e vogël kjo me ardhë me ta bo një barrikadë tek dera e shtëpisë, duke marrë parasysh se T, ka qenë person zyrtar-polic dhe e ka ditë se si shkojnë procedurat, punë të ligjit dhe lidhur me këtë rast nuk ka ndonjë shënim zyrtar, sepse nuk ka ndodhur kurrë, ka shtuar se e thotë me kushtin nëse ka ndodhur për një arsye të vetme, ajo ka mundur me ndodhë shkaku fermës së dhive, të cilën Z.Sh, ka thënë se e kanë pasur në atë fshat, disa dhjetëra dhi, të cilat janë kafshë shtëpiake më të dëmshme dhe ka mundur ndonjë bashkëfshatar me ja blloku rrugën, pasi që i kanë bërë dëm në tokën e tij.

Në bindjen e trupit gjykues, mënyra se si reagon dhe shpjegon i akuzuari ngjarjen për të cilën nuk do të kishte fare dijeni po që se nuk ishte i përfshirë, shpjegon qartë faktin e tendencës për të minuar atentatin. Fakti se ka ndodhë atentati në S, është vërtetuar në mënyrë të plotë e të qartë e identike nga dëshmitarët: Sh.R, v.R, G.H, B.Sh, A.I, A.S, Sh.Q. Më tej i akuzuari për diçka që fare pretendon se nuk është në dijeni fillon të “imagjinoj” duke specifikuar se kjo ka mundur të ndodhë pasi që disa dhjetëra dhi, të cilat janë kafshë shtëpiake më të dëmshme dhe ka mundur ndonjë bashkëfshatar me ja blloku rrugën, pasi që i kanë bërë dëm në tokën e tij.

Në bindjen e trupit gjykues, tendenca imagjinare e të akuzuarit për të inskenuar se si bashkëfshatar ja kanë blloku rrugën tani të ndjerit pasi që kishin bërë dëm në tokën e tij, krijon idenë e qartë se i njëjti pretendon të specifikoj se çka ka mundur të ndodhë të ndjerit atje, për diçka që ai pretendon se fare nuk është në dijeni dhe i përfshirë. Në këtë kontekst i akuzuari pretendon të përgënjeshtroj faktin se aty kishte atentat, duke krijuar një version të tij, por ky version nuk gjen asnjë mbështetje në provat e tjera të elaboruara më sipër.

Në bindjen e trupit gjykues të gjitha këto deklarime kishin të bënin për të ju shmangur përgjegjësisë përkritazi me atentatin, dhe fakti se kishte ndodhur atentati ishte konstatuar nga dëshmitarët e lartcekur dhe të gjithë kishin specifikuar se T, u kishte thënë se prapa këtij atentati ishte E.S, gjë që në bazë të provave dhe rrjedhës së ngjarjes kjo është edhe bindja e trupit gjykues, pasi pas çdo përcjellje, sulmi e atentati qëndronte E.S e po ashtu edhe deklarata e tij për të inskenuar një problem, në bindjen e këtij trupi gjykues ishte pikërisht për shkak të përfshirjes së tij dhe tendencës për të shmangur përgjegjësinë, bindje kjo e krijuar pasi që paraprakisht gjykata ka vërtetuar këto fakte nga deklarinimet shtatë dëshmitarëve.

Një çështje tjetër që e specifikon i akuzuari është fakti se lidhur me përcjelljet e të ndjerit T.R, një përcjellje e tillë ka deklaruar se nuk ka ndodhur nga askush, as nga familjarët apo shokët e tij, sepse T, nuk ka qenë një person i cili ka mundur të përcillet, sepse i njëjti ka qenë ekspert i sigurisë dhe ka qenë shumë agresivë.

Fakti se deklarata e të akuzuarit nuk qëndron, vërtetohet me thujtë të gjitha provat e administruara dhe me dëgjimin e secilit dëshmitar. Pra fakti se E.S kishte probleme e incidente

me T.R e kishte specifikuar thujtë se cili dëshmitarë që është marrë në pyetje si: Sh.R, V.R, G.H, B.Sh, B.H, A.I, Z.I, E.I, A.S, F.Sh, pra të gjithë e dinin për konfliktin mes E.S, e T.R, përveç E.S, e që qon haptazi në faktin se deklarimi i tij nuk gjenë mbështetje, sepse është në shpërputhje të plotë me rrjedhën e ngjarjes dhe deklarimin e dëshmitareve të lartcekur.

I akuzuari ka specifikuar se T nuk ishte përcjellë asnjëherë nga ai apo njerëzit – të afërmit e tij. Edhe kjo deklaratë e të akuzuarit nuk qëndron – është e pa mbështetshme, për faktin se nuk gjen përputhje me provat e tjera të administruara, sepse madje për rastet e tilla të përcjelljes kishte edhe dëshmitar okular, sepse ishte vet T që ju kishte rrëfyer familjareve dhe te afërmeve të tij se ai po përcillet nga E.S dhe grupi tij e në veçanti përmenden edhe personat e afërm të E.S, Rr.A (Rr) dhe I.A (L), ku në disa raste kishin qenë në përcjellje të T, edhe kur i njëjti kishte qenë bashkë me A.I, fakt ky që e konfirmon edhe vet dëshmitarja. Po ashtu raste të përcjelljes nga të lartcekurit konfirmon edhe dëshmitari V.R, Madje, se T ishte i përcjellur edhe ditën kritike pikërisht nga njerëz të E.S, vërtetohet fillimisht nga deklarata e dëshmitarit V.R që kishte specifikuar se “Rr” kishte qenë duke i përcjellë tek G” e që vërtetohet edhe nga sms pjesë përbërëse e shkresave të lëndës që do të elaborohen më vonë, e konstatuar edhe nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme, ku gjykata Supreme përmes këtyre sms-ve ka nxjerrë konkludimin se tani i ndjeri ishte në përcjellje nga njerëz të po këtij grupi. Andaj në këto rrethana, deklarata e të akuzuarit është haptazi në kundërshtim me faktet duke marr parasysh provat e lartshënuara, andaj, gjykata nuk ia fali besimin pretendimeve të tani të akuzuarit, pasi që pretendimet e tija ishin në kundërshtim me faktet dhe provat që i ka konstatuar kjo gjykatë.

Lidhur me vrasjen e T,, i akuzuari kishte specifikuar se larg qoftë me mendu me nxit apo me organizu vrasjen e një polici të Kosovës, ku ka shtuar se motivi ja do kish me ekzistua për b.H-policin nga Ferizajit i cili e ka rrahur pa asnjë arsye dhe që i ka montuar proces gjyqësor ku është dënua me 2 vite burgim, pa kryer asnjë akt dhe dënim të cilin e ka mbaj.

Kjo gjykatë tërheq vëmendjen edhe njëherë tek incidenti i Ferizajit, ku E.S ishte rrahur nga Njesia Speciale atje, e ku në bazë të provave, deklarimit të dëshmitarit Sh.Q rezultonte se E.S kishte akuzuar se T.R se ishte prapa kësaj çështje, e një fakt të tillë e thoshte edhe dëshmitari R.B, madje ai specifikonte se arsye pse ka ardhur të dëshmonte ishte pikërisht ky shkak, sepse sipas tij prapa këtij rasti ishte T, e që qon në indicie të qarta të të akuzuarit se aj problemin e kishte me T, dhe hakmarrjen e kërkonte përmes tij.

Marr për bazë provat e administruara dhe lindshmërinë e tyre mes veti të elaboruara më lartë, kjo gjykatë nuk i fali besimin deklarimit të tani akuzuarit.

Kjo gjykatë para se të vazhdoj me elaborimin e provave materiale dhe lidhur me ato se çka vërteton secila provë materiale, vë në dukje që lidhur me provat që mbajnë numrin rendor si: 51,52,53,54,55,56,57,58,68,70,71,84,86,87,97,107,109,114,115,116,118,125, në një pjesë të veçantë të aktgjykimit do të jap arsyetim lidhur me provat materiale të lartcekura, pasi që lidhet me vërejtjet e Gjykatës së Apelit, përkitazi me pranushmërinë e tyre.

Kjo gjykatë sqron se, për shkak se provat e lartcekura do të elaborohen në mënyrë të ndarë edhe rrjedha e tyre tani e tutje nuk mund të jetë në mënyrë kronologjike.

43.Lidhur me provat materiale me numër rendor 42,43,44,45,46, gjykata ka analizuar këto prova materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, respektivisht Aktakuzën kundër A.B, F.A dhe

A.E me shenjën PP.nr.602/2007 të datës 21.02.2008, Procesverbalet e gjykimit të A.B dhe administrimit të provave, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me shenjën P.nr.162/2008 të datës 28.04.2010, Aktgjykimet e Gjykatës Supreme me shenjën AP.nr.336/2010 të datës 28.04.2011, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i plotfuqishëm me shenjën API.nr.9/2011 i datës 09.02.2012.

Kjo gjykatë vë në dukje se A.B dhe F.A me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të lartcekur janë shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të Vrasjes së Rëndë në bashkë-kryerje me E.S, Rr.A dhe I.A, nga neni 147 paragrafi 3 dhe 9 dhe neni 23 të KPK-së e që janë dënuar si në vijim: A.B me 40 (dy zet) vite burgim ndërsa F.A me 10 (dhjetë) vite burgim.

Tutje Gjykata Supreme duke shqyrtuar ankesën e mbrojtësve të të akuzuarve ka nxjerrë Aktgjykimin AP.nr.336/2010 të datës 28.04.2011, përmes të cilit ka aprovuar pjesërisht vetëm ankesat e mbrojtësve sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimin për dënimin për të akuzuarin A.B, ku Gjykata Supreme veprimet inkriminuese të të akuzuarve A.B dhe F.A i cilëson në vrasje të rëndë në bashkëkryerje nga neni 147 paragrafi 1 pika 9 lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dhe vendimi dënimin për të akuzuarin A.B nga kohëzgjatja prej 40 viteve, e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 35 viteve. Përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme vërtetohet fakti se vrasja e të ndjerit T.R nuk ka qenë e rastësishme por që ka qenë e planifikuar, pasi Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj ka konstatuar se nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësve lidhur me atë se të akuzuarit veprën penale nuk e kanë kryer nga motivet për të cilat janë shpallur fajtorë, duke shtuar se A.B do të duhej të shpallej fajtorë për veprën penale të vrasjes, ndërsa F.A të lirohet nga akuza, ku këto pretendime sipas kësaj Gjykate nuk qëndrojnë ngase sipas shkresave të çështjes kanë dalur drejt të vërtetuar rrethanat se: Të akuzuarit A.B, F.A së bashku me të akuzuarit E.S, R.A dhe I.A janë njohur edhe para ditës kritike, ndërsa me tani të ndjerin T.R kanë pasur konflikt në “S.Cassino” në Prishtinë më datën 24.12.2005, me ç ‘rast i ndjeri T, e kishte rrahur E.S i cili ka qenë në shërim, e që nuk ka qenë kontestuese rrethanat se i ndjeri T.R njoftohet me A.I e cila më parë të akuzuarit E, i kishte dhënë reket- të holla, por më pas njoftimit me të ndjerin T, reketi ndaj të akuzuarit E ndalet sipas insistimit të të ndjerit T. Përgjatë arsytimit të këtij Aktgjykimi, kjo gjykatë ka potencuar faktin se nga provat e administruara nuk ka qenë kontestuese se i akuzuari E.S në Ferizaj është ndalur nga pjesëtarët e SHPK-se, me ç ‘rast pas kundërshtimeve nga ana e të akuzuarit i njëjti është rrahur nga pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës, e për këtë rast i akuzuari E, e konsideron fajtor të ndjerin T, E pas rasteve të ndodhura arrihet marrëveshja që të ndjerin ta privojnë nga jeta, për çka fillojnë përcjelljen e të ndjerit T,, kështu që më datën 30.08.2007, derisa i akuzuari A.B, E.S, Rr.A, I.A ishin në lokalin “S” në Prishtinë, në rrugën “B.C” akuzuari F.A përmes telefonit celular në orën 13:02 minuta i dërgon mesazh të akuzuarit I.A me përmbajtjen “parking te G” e kish dramën”, duke aluduar në të ndjerin, e që në atë kohë ishte në hotelin “G” e me të marrë në dijeni të akuzuarit A, I, e Rr.A me automjetin e I, kanë shkuar në lokalin “Q” në Prishtinë, me ç ‘rast i akuzuari A, armatoset me pistoletën e markës “G” të kal.9x19 mm , i cili hyn në një lokal, kurse të akuzuarit tjerë në lokalin tjetër për të pritur T.R - të ndjerin, meqë i njëjti çdo ditë ka qenë mysafir i lokalit “//” në Prishtinë, kështu që në orën 15:00 i akuzuari Rr.A, përmes telefonit të tij i dërgon mesazh të akuzuarit A.B, i cili ishte duke qëndruar në teracën e një lokali afër lokalit “// dhe duke i thënë “Rri qaty hin mrena se mirë je ma vonë të thirri”, e pasi që i ndjeri është parë në lokalin “//”, kur i njëjti ka dalë nga lokali dhe ishte afër automjetit të tij të tipit “Landrover” i akuzuari A, me vrap ka shkuar në drejtim të tij dhe në çastet deri sa i ndjeri T, ka qenë i kthyer me shpinë nga i akuzuari A, i njëjti në distancë prej 5 metrash me pistoletë ka shtënë 11 herë në tri rafale, duke e goditur me dy pranë shpinës, ku të njëjtit nga veprimi dinamik kanë vepruar në aortë, zemër e mushkëri nga të cilat lëndime edhe ka vdekur, ndërsa me një predhë është goditur në kofshën e djathtë. Po ashtu në arsytimin e këtij aktgjykimi kjo gjykatë ka theksuar se duke i pasur parasysht rrethanat e sipër cekura dhe rrethanat dhe arsytet në hollësi të përshkuara në aktgjykimin e ankimuar si dhe faktet e pakontestueshme se i ndjeri

T.R më 24 dhjetor 2005 në “S. Cassino” e kishte rrahur të akuzuarin E.S, ku nga kjo rrahje i njëjti kishte qenë i shtrirë në spitalin e Prishtinës, se i ndjeri T, pas njoftimit me A.I i njëjti nuk i ka lejuar që të akuzuarit E, t’i jap reket-të holla si më parë, si dhe faktin se më datën 22.05.2006 i akuzuari E.S në Ferizaj pas kundërshtimeve nga SHPK- së është rrahur nga pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës, e ku mbi këto shkaqe Gjykata Supreme kishte konstatuar motivet që e lidhnin tani të akuzuarin me vrasjen e tani të ndjerit.

Më tej në këtë aktgjykim ishte specifikuar se i ndjeri T, nga i akuzuari E.S dhe bashkë të akuzuarit tjerë ka qenë i përcjellur nga bashkë të akuzuarit e A.B, duke e njoftuar të akuzuarin A, siç u theksua në gjendjen faktike dhe në momentin kur i ndjeri T,i afrohet automjetit të tij “Landrover”, i akuzuari A. me vrap ka shkuar në drejtim të ndjerit dhe nga mbrapa në largësi prej 5 metrash ka shtënë 11 (njëmbëdhjetë) herë, duke e goditur me dy predha në shpinë dhe me një predhë në kofshën e djathtë nga të cilat lëndime vdes në vendin e ngjarjes, e që tregojnë qartë se motivi që ka shkaktuar privimin nga jeta e të ndjerit është johuman. Gjykata Supreme më tej kishte konstatuar se, në mes A, F, dhe T, nuk kanë ekzistuar kurrfarë raportesh në mes tyre, por rasti ka ndodhur për shkak të konflikteve të mëparshme në mes të ndjerit T, dhe të akuzuarit E.S, Rr.A, I.A, ndërsa A.B dhe F.A janë hakmarrë për shkak të konflikteve në “S.Cassino” më 14.12.2005 dhe 22.05.2006 për rastin e ndodhur në F.. Vlen të theksohet se tutje Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin me shenjën API.nr.9/2011 të datës 09.02.2012 ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit A.B dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

Lidhur me provat materiale me numër rendor 42,43,44,45 kjo gjykatë specifikon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme e që është evidentuar me numrin 46, konsumon provat tjera materiale, si aktakuzën, procesverbalet dhe aktgjykimet paraprake për faktin se fjalën e fundit përkitazi me rastin dhe gjendjen faktike e ka dhënë dhe konstatuar Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj, ku pjesët konkrete të veprimeve inkrimunes janë përshkruar-elaboruar më sipër.

Nga tani më aktgjykimi i vet Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, është vërtetuar dhe konstatuar, se vrasja e T.R ka qenë e planifikuar për motive hakmarrëse të E.S, ndaj tani të ndjerit, për shkak të rastit të “S.Cassinot”, rastit të F, në vitin 2006 dhe shkak i A.I. Gjykata Supreme më tej ka konstatuar se vrasja ditën kritike ka qenë e organizuar duke dhënë detaje për organizimin e vrasjes ashtu siç është specifikuar më sipër.

Kjo gjykatë tërheq vëmendjen, se gjykatat e shkalles më të ulëta, në rastin konkret ajo e shkallës së parë dhe ajo e shkalles së dytë, duhet të kenë vëmendjen në një fakt thelbësor, se është vet Gjykata Supreme si gjykata më e lartë, që ka konstatuar se vrasja e T.R është kryer në mënyrë të organizuar për shkaqe hakmarrëse të E.S ndaj tani të ndjerit.

Përfundimisht kjo gjykatë nga prova materiale – Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, vërteton edhe njëherë bindjen e kësaj gjykate të shprehur tek arsyetimi i provave personale, se vrasja e T. R ka ndodhur në mënyrë të organizuar dhe jo të atëçastshme e të rastësishme dhe kjo vrasje ka ndodhur për motive hakmarrëse të E.S ndaj T.R.

44.Lidhur me provat me numër rendor 47,48,49,50,61,62,63,64,66,69,78,82,83,89,92,93,117 edhe pse gjykata i ka administruar si prova në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë, të njëjtat prova materiale ndërlidhen kryesisht për veprimet e ndërmarra nga ana e policisë me rastin e vrasjes të të ndjerit T.R dhe të njëjta nuk zbardhin gjendjen faktike. Nga këto prova materiale vetëm mund të konkludohet që policia ka ndërmarr të gjitha veprimet hetimore e që përfshijnë: sigurimin e vendit të ngjarjes, mbledhjen e provave, identifikimi i dëshmitarëve B.Gj, G.F, S.H dhe G.Hoti të cilët kanë pasur mundësi të përshkruajnë dorasin – A.B me rastin e ikjes nga vendi i ngjarjes. Po ashtu në kuadër të këtyre provave ka qenë edhe raporti i mjekësisë ligjore mbi autopsinë e trupit të T.R që vetëm tregon përfundimin se T.R ka ndërruar jetë si pasojë e plagëve të shumëfishta depërtuese në gjoks të marra nga arma e zjarrit dhe si pasojë e shokut hemorragjik.

Pra gjykata nuk do të lëshohet më tej në elaborimin e këtyre provave, për faktin se nga provat materiale të lartshënuara nuk zbardhet asgjë tjetër përveç fakteve jo-kontesutese e që është mënyra se si ka ndërruar jetë tani i ndjeri dhe veprimet fillestare të policisë, andaj në këtë kontekst, gjykata nuk u lëshua më tej në trajtimin e tyre.

45. Provat materiale me numër rendor 94 dhe 95 ndërlidhen me dorasin-tani të gjykuarin A.B e që në cilësi të provave materiale janë administruar mendimi i ekspertit lidhur me shtëpinë e të dënuarit A.B i datës 26.10.2015 e ku nga mendimi i ekspertëve gjyqësorë të arkitekturës dhe financiar është konstatuar se shuma totale sipas para masës dhe para llogarisë ku janë të parapara materiale ndërtimi përfshirë punë e orës të cilat janë specifikuar e që arrinë shumën totale prej 33,881.36 euro. Raporti i verifikimit të gjendjes materiale të familjes së A.B me shenjën ref.06-01-35/15 të datës dt.21.01.2015, e në të cilin raport nga zyrtarët policorë është konstatuar se gjendja familjare e familjes B, është si në vijim: A.B babai i dorasit në kohën kur është përpiluar raporti ka qenë i punësuar në kompaninë e KEK-ut që 40 vite, F.B nëna e dorasit ka qenë e pa punë, motra A.B ka qenë e pa punë, ndërsa deri në muajin dhjetor 2014 ka punuar për 5-6 vite për Komisionin Evropian në Kosovë, kurse vëllezërit G.B ka qenë i pa punë, është marrë me tregti të veturave, ndërsa A.B ka punuar kohë pas kohe në Gjermani, ndërsa që dy muaj në kohën kur është përpiluar raporti ka shkuar përsëri në Gjermani.

Sa i përket gjendjes së shtëpisë ka qenë 2 katëshe, gjysmë e rregulluar brenda, ndërsa nga jashtë nuk është e rregulluar, sipas motrës së A, kjo shtëpi ka qenë e ndërtuar diku që 6-7 vite dhe nuk e din se kush e ka punuar si tërësi. Ndërsa duke i'u referuar të dhënave nga familjarët e kësaj familje nuk kanë patundshmëri të paluajtshme diku tjetër, nuk kanë vetura apo ndonjë pasuri që mund të deklarojnë.

Kjo provë materiali nuk përputhet me vlerën e investimeve që i kishte paraqitur në dëshminë e tij babai i dorasit – tani dëshmitar, megjithatë siç është specifikuar nga dëshmitaret, E.S ju ndihmonte me të holla personave që ishin të afërt me të, por kjo gjykatë lidhshmërinë e vrasjes së T, nuk e ka lidhur si vrasje me pagesë, por e ka lidhur vetëm me veprimet shtytëse të tani të akuzuarit tek dorasi A.B marr parasysht ndikimin që i njëjti kishte tek ai. Siç është specifikuar edhe më sipër, nuk ka qenë as pretendim i përshkrimit faktik të aktakuzës që vrasja ishte kryer me pagesë, por vrasja është kryer nga motive hakmarrëse të tani të akuzuarit duke shtytur A.B që ta privonte nga jeta tani të ndjerin. A.B siç është konstatuar më sipër, ishte punëtorë në biznesin që drejtonte tani i akuzuari, si dhe pjesë e “grupit S”.

46. Provat materiale me numër rendor 99 është një raport analitik përmes të cilit janë konstatuar lidhjet e telefonatave dhe SMS-ve, ku ndër të tjera në këtë raport është konstatuar se më datën 30.08.2007 në ora 13:02 F.A (roje e parkingut të lokalit S.) nga numri i tij i telefonit 044-/// i dërgon SMS I.A i njohur me nofkën “L” njëherit i njohur si një person i afërm i E.S në numrin e telefonit 044-////, ku i thot “parking te grandit kojsha e kish dramën”. Ndërlidhjen e këtij SMS dhe ngjarjes së ndodhur në ditën kritike është ndërlidhur duke u bazuar në deklaratën e dëshmitarit B.Sh shok i T.R dhe pjesëtar i SHPK-së, T.R rreth orës 13:00 ka qenë në Hotel G” dhe veturën e tij Land Rover ngjyrë të zezë e ka pas të parkuar në parkingun e Hotelit G”, dëshmitari e din këtë detaj pasi që rreth orës 13:47 kishte kontaktuar me T, në telefon dhe T, e kishte ftuar për kafe, dëshmitari thotë se dikund pas 5 minutave ka shkuar në Hotel G” dhe ka pirë kafe bashkë me T.R. Ndërsa, sipas deklaratës së dorasit A.B, dikund rreth orës 13:00 ka qenë në lokalin S, së bashku me I.A, Rr.A, N.S dhe në lokal ka qenë edhe E.S. I njëjti ka deklaruar se rreth orës 13:00 së bashku me I.A, Rr.A dhe N.S kanë dal nga lokali S, dhe me veturën “Passat” të cilën e drejtonte I.A ka shkuar deri tek semaforat afër kompleksit Santea, ku i njëjti ka thënë se ka zbritur nga vetura dhe është dal me pi kafe ndërsa tre të tjerë kanë shkuar në drejtim të semaforëve kryesor. Dhe dikund rreth orës 15:00 Rr.A i njohur me nofkën “Rr”

njëherit i njohur si preson i afër i E.S, nga numri i tij i telefonit 045-//// i dërgon SMS A.B, në numrin e telefonit 044-/// ku i thot “rri qatu hin mrena se mirë je të thirri ma von”. Ku sipas raportit analitik len hapsirë të kuptojmë që Rr.A ka pas kontakt vizues me A.B dhe të njëjtin ja terhjek vërejtjen që të mos lëviz nga lokacioni i tij dhe njëkohësisht i tregon se do të jetë në kontakt më vonë. Kurse në ora 15:00 Rr.A nga numri i tij i telefonit 044-//// e thërret A.B në numrin e telefonit 044-//// siç shifet edhe nga listingu i thirrjeve telefonika, ndërsa në ora 15:46 Rr.A nga i njëjti numër ka thirr I.A. Në këtë raport është konstatuar se deri këtu mund të vërejmë që vrasja e T.R ka qenë e organizuar mirë dhe të involvuar në këtë vrasje kanë qenë : F.A, Rr.A, I.A dhe N.S pasi që të njëjtit kanë përcjellë T.R dhe i kanë dhënë shenjë A.B për kohën kur duhet ta kryjenë vrasjen.

Kjo gjykatë konsataton se faktet e tilla që janë përshkruar në këtë raport analitik, vërtetohen nga sms-t që tani janë pjesë e shkresave të lëndës, respektivisht janë administruar si prova materiale, e ku edhe Gjykata Supreme konkludimin e saj në rrjedhën e ngajrjes i ka nxejrrur pikërkishtë nga komunikimet e lartcekura, me ç’ rast është konstatuar se vrasja është kryer në mënyrë të organizuar pasi që i ndjeri ishte në përcjellje.

Fakti se i ndjeri ishte atë ditë ishte në përcjellje ishte konfirmuar edhe nga deklaratat e dëshmitareve fillimisht dëshmitarit V.R i cili e kishte parë atë ditë Rr.A “R” duke i vështruar e po ashtu fakti se T,kishte veturën tek G” që ndërlidhet me sms që raportonte tani i dënuar F.A është fakt që vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit B.Sh që ishte me T pikërisht tek G” para se i njëjti të privoj nga jeta.

Në këto rrethana, gjykata vërteton faktin se tani i ndjeri ishte në përcjellje të vazhdueshme atë ditë nga të lartcekurit deri në privimin e tij nga jeta.

47. Prova me numër rendor 100 është provë e cila është përpiluar nga Drejtorati i Krimeve të Rënda – Hetimet Speciale, nga i cili raport janë analizuar deklaratat e personave të dyshuar përgjatë procedurës penale ku janë të përfshirë edhe persona ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuza, si dhe deklarata të dëshmitarëve.

Për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, ka qenë në domenin e kësaj gjykate që të vlerësoj se cilën deklaratë të dëshmitarit, elaborimet të cilat janë përshkruar në detaje më lart për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

48. Sa i përket provave me numër rendor 59,67,90,91,105,106,123 janë prova të cilat janë administruar në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë, por të cilat prova nuk janë relevante dhe nuk vërtetojnë asgjë lidhur me tezën e aktakuzës. Në pika të shkurta vetëm do të tregojmë përmbajtjen e tyre. Në kuadër të provës me numrin rendor 59 është administruar si provë dokumentet lidhur me kontrollin e të burgosurit N.S në Prizren e që i është sekuestruar një sim kartel e që nuk sqarohet asgjë lidhur me çështjem. Sa i përket provës me numër 67. Kjo provë materiale ka të bëjë me atë se si dëshmitares përmes vërtetimit për marrjen e përkohshme të sendeve i janë sekuestruar 2 telefona, por nga këta 2 telefona nuk ka rezultuar ndonjë gjë relevante lidhur me objektin e akuzës. Tutje prova me numrin, 90 dhe 91 janë dy prova përmes të cilave është raportuar se me datën 26.09.2007 oficeri D.N ka parë me veturën Audi A8 personat si E.S, Rr.A dhe I.A, i cili edhe ngiste veturën e sipas raportit besohet se janë ndalur në rrugën e Taslixhes në Prishtinë, e që prova 91 ka të bëjë me Raportin e hetuesit B.O lidhur me dyshimin se më datë 25.09.2007 janë përcjell nga një person me veturën “Mercedes” dhe dyshohet se janë fotografuar apo incizuar në telefon, ku sipas veprimeve të ndërmarra rezulton se pronar i kësaj veture është A.H.K. Po ashtu lidhur me provën me numër rendor 38 i cili është Raporti laborator qendror i kriminalistikes lidhur me ekzaminimin e gëzhjojave dhe armës Glock-19 dhe vërtetimi mbi konfiskimin e armës nga A.B me anë të së cilës është vërtetuar se ka pasur rezultat pozitiv me gëzhjojat nga vendi i ngjarjes, e që ky fakt është i pa kontestueshëm. Ndërsa provat materiale me

numër 105 dhe 106 janë prova materiale që kanë të bëjnë me të akuzuarin Rr.A e të cilat nuk vërtetojnë gjendjen faktike lidhur me objektin e kësaj akuze pasi që janë marrë sim kartela të tij në çeli por nuk kanë rezultuar se kanë të bëjnë me ngjarjen kritike. Ndërsa prova me numër rendor 65 është Raporti i policës, nr.OCIU/2012/28 I dt.21.02.2014, në lidhje me analizimin e informative të rezultuara nga implementimi i përgjimit të komunikimeve të bëra nga telefoni dhe sim kartelat të gjetura në qelinë e burgut të Rr.A, ku nga raportet e bashkangjitura SIM kartelat të cilat janë gjetur në qelinë e Rr.A kanë qenë në emër të E.H dhe F.N. E që nga këto numra persona të cilat kanë qenë të kontaktuar e si emra të njohur kanë qenë: A.S, N.S, F.A, si dhe A.B. Edhe ky raport nuk zbardh ndonjë çështje kontestuese.

Prova me numrin rendor 123 e cila është Njoftimi i avokatit R.K në gjykatë më datën 26.01.2015 nga e cila shihet se në atë kohë mbrojtësi i dorasit A.B, Avokat R.K ka njoftuar gjykatën se më datën 23.01.2015 në zyrën e tij është paraqitur G.B vëllai i të gjykuarit A.B dhe se në shtëpinë e tyre kanë shkuar disa persona me rroba civile e që njëri prej tyre është prezantuar si H.K, e të njëjtit kanë pyetur fillimisht për gjendjen e prindërve të tyre e më pastaj i kanë thënë se pse si familjarë nuk po ndikojnë që ai të flasë në gjykatë lidhur me veprën për të cilin është gjykuar. Gjykata vlerëson se kjo provë nuk ka ndonjë relevancë lidhur me objektin e akuzës që është duke u trajtuar pasi që e njëjtë nuk zbardh gjendjen faktike dhe nga i cili njoftim në kuadër të shkresave të lëndës nuk ka ndonjë shkresë që është proceduar tutje për marrjen e ndonjë procedure lidhur me këtë njoftim.

Pra provat e lartshënuara materiale sipas numrave rendor të lartcekur, nuk lidheshin me çështjet kontestuese, apo nuk zbardhin ndonjë gjendje faktike në favor qoftë të aktakuzës, qoftë në favor të akuzuarit, andaj edhe si të tilla nuk kishin ndonjë relevancë lidhur me determinimin e gjendjes faktike. Meqë të njëjtat janë administruar, gjykata vetëm ka specifikuar se çka përmbajnë të njëjtat, por nuk kishin efekt në vendimmarrjen e kësaj gjykatë.

49.Nga raporti i policit M.K lidhur me gjetjen e dy veturave referuar provës me numër rendor 72- nga ky raport është konstatuar se janë gjetur dy vetura Combo e tipit “Opel” me targat 505-KS-211 që shkruante “B. Cafe” dhe vetura “VW” Golf 3” me targat ///, ku identifikimin e këtyre 2 veturave është bërë në bazë të informatave të cilat i ka ofruar një qytetar. Ku pas identifikimit të saj dëshmitari ka shprehur gatishmërinë e që të tregoj për rastin dhe fillimisht ka dhënë informatat se personat që kanë qenë në lokal S, duke potencuar vëllain e E, dhe të tjerat, ku pas incidentit që ishte vrarë polici, këta kishin bartur armët dhe gjësende tjera në drejtimin e veturave të tyre në parking, ku dëshmuarit i është ofruar që të jetë i mbrojtur para gjykatës, dhe kështu kanë rënë dakord që të jepte.

Lidhur me deklaratat e dëshmitareve, kjo gjykatë tani veç se i ka trajtuar të njëjtat më sipër për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, andaj nuk do të elaborohen sërish.

50.Nga provat materiale me numër rendor 73,74,75,76,77,85,88 është bërë bastisja e veturave “Jeep” pronë e N.S, “Opel” Pick up i kuq”, “Golf III”, “Opel Kombo”, si dhe Raportet e përpiluara nga policët përkatës, por me rastin e bastisjes dhe ekzaminimit të këtyre veturave nuk është gjetur asnjë dëshmi relevante lidhur me rastin e privimit nga jeta e tani të ndjerit T.R

51.Nga Raporti i Policit hetues M.K me numër të rastit 2007-AD-02397 i datës 11.12.2007 si provë materiale e administruar me numër 80 vërtetohet se gjatë hetimit të rastit të vrasjes së viktimës T.R janë aktivizuar disa masa hetimore dhe këto me urdhëresë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe Prokurorisë Speciale në Prishtinë, e të cilat masa kanë të bëjnë: me hyrje-dalje dhe sms për numrat përkatës për të cilët është përgatitur një raport specifik me përmbajtjen e këtyre sms-ve të shkëmbyer në mes E.S dhe personave të afërm të tyre si dhe veprimet e tjera hetimore.

Masat e tilla hetimore që kanë relevancë lidhur me rastin do të elaborohen në vijim të arsyetimit të aktgjykimit.

52.Ndërlidhje me këtë, bënë pjesë Raporti i hetuesit B.O si provë materiale e administruar me numër **81**, e ku janë nxjerrë disa porosi (sms) të shkruara në mes të personave të përfshirë para vrasjes të cilët kanë marrë pjesë në forma të ndryshme në organizimin dhe planifikimin e vrasjes së viktimës T.R. Këto porosi janë nxjerrë nga regjistrimi i thirrjeve, hyrje-daljeve dhe porosive nga Posta dhe Telekomit i Kosovës, e të cilat porosi janë nxjerrë me urdhëresën nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake.

Komunikimet e nxjeruara nga masat e lartcekura kanë pasur përmbajtjen si në vijim:

Me datën 01.08.2007, në ora 12:56:30, nga numri i telefonit 044 ///- /// (dërguesi i sms – RR.A), është realizuar shkëmbimi i sms-ve në numrin e telefonit 044 ///- /// (pranuesi i sms – A.B), me përmbajtje: **“Um thirri mu Q, te Sh, po ju pres.///”**.

Përmes kësaj porosisje gjykata vërteton lidhjen në mes të Rr.A “Rr” dhe A.B “S”, ku në këtë porositi është cekur nofka “Q” e që i referohet të akuzuarit E.
Nga ky sms, gjykata vërteton faktin e lidhshmërisë që kishte E.S me Rr.A (Rr).

Me datën 03.08.2007 në ora 20:28, nga numri i telefonit 044 /// /// (dërguesi i sms – Rr.A), është realizuar shkëmbimi i sms-ve në numrin e telefonit 044 ///- ///(pranuesi i sms), me përmbajtje: **“Thuj let shkon aj te lokali. Unë jom pak ma larg me E me L”**.

Me këtë porosi gjykata vërteton edhe njëherë lidhjen e afër e të vazhdueshme mes Rr.A dhe I.A me E.S.

Me datën 24.08.2007, në ora 14:16 min nga numri i telefonit 044 ///- /// (dërguesi i sms– Rr.A), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// (pranuesja e sms – K.B), me përmbajtje: **“Zemër ok dil ti shon e thirrni A se unë nuk jom ksajde nihere. Ka 6 ose 7 vi në shehër.**

Me këtë porosi gjykata vërteton lidhja në mes të Rr.A i cili është person i afërt i E.S, si dhe njëri nga personat më të besueshëm të E.S dhe A.B, e që haptazi kuptohet lidhshmëria mes tyre.

Me datën 24.08.2007, në ora 16:05 min, nga numri i telefonit 044 ///-/// (dërguesja e sms – K.B), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-///- pranuesi i sms – A.B), me përmbajtje: **“O B ku je a ki kohë me pi kafe me mu e Sh, nëse ki kohë kallxom vina te lokali aty poshtë ku po rrina gjith ok kallxom”**.

Me këtë porosi gjykata vërteton faktin se, K.B e cila ishte e dashura e Rr.A aso kohe, fton në kafe A.B si dhe kjo porosi i tregon kontaktet e vazhdueshme në mes të Rr.A me A.B, por edhe afërsinë e këtyre dyve, sepse A.B aç i afërt ishte me ta sa që pinte kafe edhe me të dashurën e Rr.A.

Me datën 24.08.2007, në ora 17:16 min nga numri i telefonit 044 ///-/// (dërguesi i sms– RR.A), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// (pranuesi i sms – A.B), me përmbajtje: **“Pasha familjen nuk jam në Prishtinë, jam me L dhe G.Q, pak larg. Rri qatu me to lypja Sh ti se për nja 1 or vi”**.

Edhe një here ri-konfirmohet fakti i lidhjes se Rr.A me A.B, si dhe kontaktet e vazhdueshme në mes tyre.

Me datën 26.08.2007, në ora 22:06 min, nga numri i telefonit 044 ///-///(dërguesi i sms – F.A), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// pranuesi i sms – A.B), me përmbajtje: **“O daj sun rri zon të huj vet kty u a don me dal a jo a”**.

Përmes kësaj porosie, gjykata vërteton lidhjen dhe kontaktet në mes të F.A i cili punonte në lokalit S, roje e veturës dhe lokalit të E, si dhe A.B të cilit kishin kontakte edhe para vrasjes. Gjithashtu tani është konfirmuar se F.A ka marrë pjesë në përcjellje të vazhdueshme të viktimës T.R e po ashtu edhe në vrasjen e tani të ndjerit.

Me datën 27.08.2007 në ora 20:09 min, nga numri i telefonit 044 ////, (dërguesi i sms – I.A), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// (pranuesi i sms – RR.A) me përmbajtje: **“Te AM/PM jam tu tu en në kam me B tu kqyr për qat shokun. A është Q asaj”**.

Përmes kësaj porosie, gjykata vërteton faktin se I.A, i raporton Rr.A dhe ky i fundit t’i raporton E.S. Shprehja “empijem” është kafiterija “//” e cila ka qenë kafiterja më e frekuentuar nga viktima T.R. Shprehja “me beni” është fjala për A.B. Shprehja “tu kqyr për qat shokun” është fjala për viktimën T.R i cili në vazhdimsi përcillej për rreth asaj kafeneje. Ndërsa shprehja “A o qopa asajt” është fjala për E.S, pasi që për çdo përcjellje për lëvizjet e T, rezulton se E, ka qenë i informuar lidhur me përcjelljen dhe lëvizjet e tani të ndjerit.

Nga sms-t e lartcekur dhe përshkrimi i lartcekur, gjykata vërteton faktin se vetëm tri dit para vrasjes së tani të ndjerit, pikërisht I.A e tani dorasi A.B ishin duke e përcjellur T, tek kafeneja që ai kalonte kohën më të madhe, e po ashtu vërtetojmë faktin se I.A i raporton Rr.A dhe e pyet për tani të akuzuarin me qëllim që ky i fundit pra Rr.A ti raportonte E.S, me ç’ rast vërtetohet fakti se për përcjelljet dhe lëvizjet e T, informohej tani i akuzuari E.S dhe kjo përcjellje kishte ndodhur vetëm tri ditë para se i njejtë të privohej nga jeta.

Me datën 29.08.2007, në ora 20:02:24, nga numri i telefonit 044 ///-/// (thirrësi – A.B), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// (i thirruri – NN), me përmbajtje: **“Atje s’ka asgjë sonte shokut”**.

Me datën 30.08.2007, në ora 14:06:58, nga numri i telefonit 044 ///-/// (dërguesi i sms – F.A), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// (pranuesi i sms– I.A) me përmbajtje: **“Vetura e kojshive është në parkingun e G”**.

Me këtë porosi, gjykata vërteton lidhjen në mes të F.A dhe I.A si dhe përcjelljen e vazhdueshme që i kanë bërë tani të ndjerit T.R, pasi që kur përdoret shprehja “kojshia”, është fjala për T.R pasi në qastin kur është dërguar ky sms, nga F.A, T.R ka qenë në Hotelin G: së bashku me policin - dëshmitarin B.Sh, ndërsa vetura e T.R ka qenë e parkuar në parkingun e Hotel “G”.

F.A e ka mohuar se ka qenë te Hotel G” në atë kohë dhe ka përdorur alibiinë, se kishte dërguar nënën e tij në Shtëpinë e Shëndetit “Te “X.L” mirëpo pasi është verifikuar në Shtëpinë e Shëndetit, emri i nënës së F.A nuk figuronte askund që kishte bërë vizitë mjekësore.

I dënuari tani dëshmitari F.A, shihet qartë se është munduar që ti shmanget përgjegjësisë penale dhe përfshirjes së tij në rast me çka ka dështuar të argumentoj alibinë, dhe fakti se vrasja ka qenë e organizuar dhe se T.R ishte përcjellë deri në momentin e ekzekutimit, tani më është konstatuar me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, pikërisht duke marrë për bazë këtë prove material.

Me datën 30.08.2007, në ora 14:08 min, nga numri i telefonit 044 ///-/// (dërguesi i sms – Rr.A), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// (marrësi i sms – I.A) me përmbajtje: **“A po vjen ku pinum boronica at dit e pim ka nja”**.

Me datën 30.08.2007, në ora 15:00 min nga numri i telefonit 044 ///-/// (dërguesi i sms – Rr.A), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-/// (marrësi i sms – A.B) me përmbajtje: **“Rri qatu hin mrena se mir je ma von të thirri”**,

Ky sms ishte shkëmbyer, derisa dorasi A.B në këtë kohë ka qenë tek “Kompleksi Sante” duke e pritur viktimën T.R i cili ishte në kafiterinë “//” që ndodhet po ashtu në të njëjtin kompleks, dhe pasi T.R del kafiteria “//” dhe shkon te veutra e tij, qëllohet me armë zjarri nga tani i dënuari A.B. Kështu A.B i ka pranuar instruksionet nga E.S përmes Rr.A dhe I.A të cilat po ashtu kanë qenë në mbështetje të A.B gjatë ditës kritike.

Pra siç rezulton nga smst e dërguar, shihet qartazi mënyra organizaitve në vrahjen e të ndjerit, pasi që tri ditë para vrasjes i nderi ishte në përcjellje ku A, i raportonte Rr, e R, E, e së fundi ditën kritike përsëri përcillej deri në privimin e tij nga jeta.

Pra edhe njëherë ri-konstatohet fakti se T, i ishte në përcjellje dhe se vrasja ishte e planifikuar-organizuar.

Me datën 01.09.2007, në ora 11:59, nga numri i telefonit 044 ///-/// (dërguesi i sms – F.Sh), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-///- (pranuesi i sms – Z.I) me përmbajtje: **“Njo që rrike me L non stop edhe pikapin e B. Cafe e grahke”**.

F.Sh i tregon Z, për A.B, pasi A.B është shoqëruar me I.A dhe ka qenë shofer i veturës “pick-up”, që është prona e frimës “B.Caffe” që është pronar N.S vëllau i E.S, por këtë biznes e udhëhiqte edhe E.S

E.S e udhëhiqte firmën “B. Kafe” fakt ky i pohuar nga vet i akuzuari, por edhe e dëshmuar nga dëshmitari Gj.K.

Fakti se punonte në këtë firmë A.B – voziste veturën e lartshënuar, është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarit F.Sh e dhënë në shqyrtimin gjyqësor e mbështetur edhe në sms e lartshënuar, fakt ky që gjenë mbështetje edhe në deklaratën e dëshmitarin D-2, që konfirmon të njëjtin fakt, se A, voziste “pick-up” të “B Cafe”.

Me datën 01.09.2007, në ora 12:51, nga numri i telefonit 044 ///-/// (dërguesi i sms – F.Sh), është realizuar kontakti me numrin e telefonit 044 ///-///- (pranuesi i sms – A.B) me përmbajtje: **“A e di kush e ka vra aj A. që rrike me L.”**.

Përmes kësaj porosie, gjykata vërteton edhe një here faktin e lidhjes në mes të A, me I.A, e për këtë fakt kanë qenë në njohuri shumë njerëz, pasi që F.Sh i tregon edhe personit të afërt të E.Si cili në atë kohë ndodhej në Turqi, i njëjti ka qenë në cilësi edhe të dëshmitarit e ku pikërisht A i rrëfen për hierarkinë në “grupit S” ku specifikonte se të gjithë personat në grupin S, i merrnin detyrat nga E.S dhe të njëjtat i zbatonin.

Nga përmbajta e tërësishme të sms-ve të lartshënuara, gjykata ka vërtetuar faktin se: A.B kishte vozitur veturën me mbi shkrimin “B.Kafe” firmë të cilën e udhëhuqte E.S. Nga sms-t e lartshënuara, gjykata ka vërtetuar raportet e afërta të Rr.A me E.S, ku Rr. raportonte E, e po ashtu janë vërtetuar raportet e afërta në mes të Rr, e I, me A.B. Nga sms-t e lartshënuara, është vërtetuar fakti se T. ishte në përcjellje tri ditë para ngjarjes nga të njëjtit persona e ku Rr. i raportonte E, e po ashtu është vërtetuar se ditën kritike T, ishte në përcjellje dhe se vrasja ishte e organizuar, sepse i ndjeri përcillej hap pas hapi deri në ekzekutimin e tij.

Është specifikuar dhe po e specifikojmë përsëri, se fakti se T, ishte përcjellë nga të lartcekurit dhe se vrasja ka qenë e organizuar për motive hakmarrëse të E.S, është konstatuar me aktgjykimin e lartshënuar të Gjykatës Supreme.

Kjo gjykatë tërheq vëmendjen edhe në një fakt, se gjykata nuk e ka mbështetur aktgjykimin e vet vetëm në sms-t e lartshënuar, por të njëjtat vetëm kanë mbështetur-fuqizuar faktet e vërtetuara nga dëshmitë e dëshmitarëve, e që gjejnë përputhje të plotë në rrjedhën dhe kronologjinë e ngjarjes.

53.Raporti shtesë i hetuesit M.K për veprimet hetimore pas dorëzimit të Kallëzimit Penal edhe pse është administruar si provë materiale e njëjta nuk ka relevancë në zbardhjen e gjendjes faktike pasi që në këtë raport vetëm janë përshkruar veprimet hetimore shtesë që janë ndërmarrë nga ana e zyrtarëve policorë, andaj kjo gjykatë nuk do ta elabroj më tej, sepse nuk ka ndonjë lidhshmëri me faktet kontestuese, kjo provë është listuar me numër 48.

54.Lidhur me provat me numër rendor 101,102,103,104 të cilat prova janë administruar në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë ndërlidhen me të kaluarën kriminale të të akuzuarit E.S, I.A dhe Rr.A, por edhe pse gjykata i ka administruar si prova në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë të njëjtat nuk zbardhin gjendjen faktike, përveç asaj që vërtetojnë mënyrën e funksionimit si persona duke marrë parasysh numrin e madh të lëndëve, e për të cilat raste gjykata nuk paragjykon epilogun e tyre, megjithatë duhet specifikuar faktin se të njëjtit edhe kanë qenë në arrati pas rastit e që rrjedhimisht edhe procedurat penale kanë hasur në vështirësi të përfundohen, megjithatë siç u specifikua më sipër, regjistri nga rastet e tyre të hapura nuk kishte asnjë efekt në marrjen e aktgjykimimit përkitazi me këtë rast.

55.Prova me numër rendor 108 i cili është Raporti policor me numër 06/1-01-SA-023/2014 i datës 25.03.2014 vërtetohet se i ndjeri T.R kishte paraqitur disa raste përgjatë periudhës së viteve 2003-2006 që kanë pasur të bëjnë me raste të kanosjes, sulm fizik, vrasje tentativë (swiss casino), i është djegur vetura, i janë shpuar gomat me thikë, është përcjellë me motoçikleta e pastaj edhe i është bllokuar rruga dhe kanë tentuar ta godasin me veturë. Në rastet e lartcekura si të dyshuar kanë qenë; E.S,N.S, D.S, E.S, S.S, A.B, A.C, Rr.A e të cilët kanë qenë persona të afërt të E.S Pra nga këto raporte vërtetohet fakti se T, kishte probleme vetëm me persona të “grupit S,” gjë që gjen përputhje të plotë nga elaborimi i mësipërm i dëshmitarëve.

56.Si prova materiale janë administruar edhe disa raste të cilat i ka paraqitur tani dëshmitarja A.I, po të cilat nuk kanë relevancë të drejtë për drejtë me akuzën, përveç një rasti ku vërtetohet fakti se e njëjta ishte ndier e kanosur nga tani i akuzuari që e kishte kanosur me veturë dhe e njëjta e kishte raportuar rastin në polici

57.Nga provat materiale me numër rendor 110,111,112 si Informata nga PTK, ref.PTK/831/07, PTK, ref.PTK/887/07 si dhe Raport i regjistrimit të thirrjeve telefonike dhe mesazhet pa datë, edhe pse janë administruara si prova materiale, këto prova nuk kanë relevancë me objektin e akuzës, sepse në këto prova ka vetëm informacione lidhur me abonent për disa numra të telefonave duke përfshirë F.M, I.A, A.S, M.S e të cilat nuk paraqesin provë përmes të cilës do zbardhej gjendja faktike.

58.Provat materiale me numër 113 dhe 119 e që janë Njoftime nga ARBK-ja të datave 27.03.2014 dhe 02.04.2014 edhe pse janë administruar si prova materiale, këto nuk kanë ndonjë relevancë me objektin e akuzës, sepse të njëjtat vetëm se provojnë se pronar i “Bar S” është A.S ndërsa pronar i “B. Caffè” është N.S

Megjithatë, për të mos krijuar huti, kjo gjykatë ri kujton faktin se pavarësisht se në emër të kujt ishin bizneset e lartcekura, me të njëjtat biznese udhëhiqte E.S, fakt ky i konfirmuar – vërtetuar nga vet tani i akuzuari.

59.Provat me numër rendor 79-120 nuk kanë pasur të bëjnë me telekomunikimet që lidheshin me veprimet inkriminuese, andaj si të tilla nuk kishin ndonjë rol në vendimmarrjen e gjykatës.

60. Si prova materiale përgjatë shqyrtimit gjyqësorë janë administruar edhe provat me numër 121, përkatësisht të gjitha shkresat e rastit “S. Casinos”, ku këto shkresa edhe pse janë administruar në tërësi që përfshijnë Aktvendimin për fillimin e hetimeve me shenjë PP.nr.850-4/2005 i datës 28.12.2005 kundër të pandehurve: A.B, E.S, S.S, Rr.A, A.C, A.S , L.K, F.M dhe V.H, Aktakuzën dhe vendimin për konfirmimin e aktakuzës, Procesverbalet e marrjes në pyetje të të pandehurit E.S, A.B, N.S, dhe dëshmitarëve: B.S, B.T, B.C, V.R, B.Z, A.S, P.S, A.S, T.R si dhe Raporte të ndryshme policore dhe mjekësore. E që në vazhdim do të elaborohen vetëm provat të cilat kanë relevancë dhe të cilat ndërlidhen me vërtetimin e gjendjes faktike me objektin e akuzës tani objekt shqyrtimi.

Fillimisht nga procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehuri E.S të datës 16.01.2006 i njëjti përgjatë pyetjeve të prokurorit ka deklaruar “jam sulmuar nga T, me kondak të revoles me ç’rast më ka ra në pjesën e prapme të kokës për afërsisht 4-5 herë”, po ashtu ka deklaruar se “T, më ka tërhequr brenda në diskotekë të shnaku, dhe më ka qu të një shtyllë afër rrethit ku edhe aty më ka ra me boks” ndërsa i akuzuari E.S tani para trupit gjykues ka deklaruar se nuk e kishte rrahur atë ditë i ndjeri por ia kishte shpëtuar jetën.

Nga kjo deklaratë aso kohe e vet tani të akuzuarit, vërtetohet një fakt se ai tani e ndryshoj deklaratën në shqyrtimin gjyqësor duke specifikuar se T, i’a kishte shpëtuar jetën në “S.Cassino” dhe se ai nuk kishte pasur asnjëherë probleme me T.R. Këto përpjekje i akuzuari i bën me qëllimin e vetëm që të shmang motivin e tij përkitazi me konfliktet që kishte me T, e që quan në privimin e tij nga jeta. Pra edhe njëherë vërtetohet fakti se konflikti i “S.Casinos” ishte një eskalim i konfliktit që tani më konflikti kishte marr një kthesë tjetër, që qon pastaj në intensifikimin e përcjelljeve të E.S dhe personave të afërm të tij deri në privimin e T nga jeta.

Nga procesverbalet mbi intervistimin aso kohe në cilësinë e dëshmitarit T.R deklarata të datës 26.12.2005 dhe 11.01.2006 ishte deklaruar se “Gjithashtu theksojë që gjatë tërë kohës nuk e kam lëshuar E. prej dorës time të majtë. Gjatë kësaj kohe E, ka rezistuar dhe më ka goditur me grushta. Pasi që unë kam shtënë, pas disa sekondave ka shtënë me revole një ose dy herë edhe A. Pasi që ne kemi shtënë, A, është plagosur dhe është rrëzuar në dysheme dhe unë më nuk e kam vërejtur revolen e tij a ka psur në dorë apo i ka rënë në dysheme, Pasi që unë kam shtënë me revole, E i ka tentuar të ma marr revolën duke më kapur për dorë por nuk i’a ka arritur të ma merr revolën falë shkathësisë time, dhe vazhdimisht me dorën tjetër më ka grushtuar dhe unë mbroheshja njëjt duke e grushtuar atë..”, më tej në raportin e tij kishte specifikuar se “Unë e di se kam shtënë dy herë gjuajtje të njëpasnjëshme. Pastaj më ka sulmuar fizikisht personi i cili quhet E.S i cili ka tentuar të ma marr revolën, ku kam marrë disa goditje, ku edhe jam mbrojtur dhe jam kthyer në drejtim nga vinin të shtënat tjera...”

Pra vet T, kishte konfirmuar këtë eskalim të problemit e në “S.Casino”

Provat materiale të këtij rasti janë emëruar me numrin 121.

Kjo gjykatë konstaton se rreth tre muaj para rastit “S. Casino” T kishte filluar lidhjen me A.I e ku pas kësaj kishin filluar përcjelljet të vazhdueshme të E.S dhe grupit të tij ndaj tani të ndjerit, iu kishte djegur edhe vetura dhe pastaj kishte eskaluar rasti në “S. Casino” që shpërfaq haptazi eskalimin e konfliktit, rritjen e rivalitetit dhe motivin për hakmarrje.

61. Si prova materiale, në kuadër të shqyrtimit gjyqësorë janë administruar edhe prova me numër 122 Shkresat e rastit “Ferizaji” duke përfshirë Aktakuzën, Aktvendimi mbi konfirmimin si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme.

Provat materiale si të tilla nuk zbardhin ndonjë fakt, sepse flasin për ecurinë e atij rasti, por siç është elaboruar e konstatuar më sipër e që do të elaborohet edhe më vonë për gjatë arsytimit të

këtij aktgjykimi, rasti Ferizajit lidhet me motivin e kryesit pasi që pretendohet se prapa këtij rasti ishte T.

62.Sqarimi i PTK-së i datës 20.09.2007 përkatësisht prova me numër 124 nga e cila provë PTK-Zyra për veprim sipas kërkesave ligjore lidhur me shkresën “Informacioni” të datës 10.09.2007; Ref:PTK/639/07 ka lëshuar një sqarim ku ndër të tjera ka theksuar se: intervali i dërgimit të SMS-ve ndryshon për 1 orë tani, ndërsa në periodën e dimrit mund të ndryshojë për 2 orë. Ndryshimet e intervaleve kohore përkundrejt ndryshimeve sezonale janë ndryshime fikse, Ruajtja e SMS-it bëhet në UNIX format, ku matja e kohës bëhet duke u bazuar nga sistemi i Greenëich-it. Arsyeja e mos ndryshimit është për shkak të ndërrimit të kohës prej kalendarit veror në atë dimëror, prandaj kjo do të shkaktonte edhe më shumë konfuzion.

Ky sqarim nuk specifikon në mënyrë të saktë se çfarë mund të ndryshoj dhe kurrë, megjithatë për gjykatën ka qenë mese e saktë fakti se kush me kënd ka komunikuar dhe për çfarë kanë komunikuar, e që është vërtetuar se persona të “grupit S” e që u elaborua më sipër, kanë komunikuar mes vete duke e përcjellur hap pas hapi tani të ndjerin tri ditë para vrasjes dhe ditën kritike deri në ekzekutimin e tij, fakt ky i konfirmuar, vërtetuar e konstatuar me aktgjykimin e lartshënuar të Gjykatës Supreme.

Po ashtu kjo gjykatë specifikon faktin se lidhshmëria e provave materiale të lartcekura, gjene përputhje të plotë me deklaratimet e dëshmitareve që ishin prezent e që përputheshin në përpikëri edhe koha edhe veprimet e po ashtu përputhet edhe rrjedha e ngjarjes deri në privimin nga jeta të tani të ndjerit, andaj në këtë kontekst e ka vërtetuar atë gjendje faktike Gjykata Supreme dhe e ka akceptuar edhe kjo gjykatë.

63.Si provë materiale është administruar edhe dosja me nr.467/09 po nga e cila dosje kjo gjykatë edhe pse e ka administruar si provë materiale e njëjta nuk ka shërbyer për zbardhjen e gjendjes faktike, pasi që nga përmbajtja e saj ka pasur kryesisht Aktvendime procedurale që kanë pasur të bëjnë me refuzimin e kërkesës për hedhje të aktakuzës, Aktvendimet për vazhdimin e masave ndaj të akuzuarit E.S si dhe Aktakuzën dhe po ashtu edhe procesverbalin e shqyrtimit fillestar, prova këto të inkorporuara në provën me numër 126.

Kjo gjykatë specifikon se, ka pasur prova materiale të cilat nuk zbardhnin çështjet kontestuese, megjithatë, për aq kohë sa të njëjtat kanë qenë të administruara, gjykata vetëm ka specifikuar në pika të shkurta se çka përmbajnë ato e për të ilustruar kështu arsyeshmërin se pse të njëjtat nuk lidheshin domosdoshmerisht me faktet kontestuese.

Kjo gjykatë sqaron se, provat materiale nuk ka pasur mundësi që të sqarohen nga gjykata sipas numrit rendor në mënyrë kronologjike, për faktin se të njëjtat janë trajtuar sipas lidhshmërisë së tyre e po ashtu ka prova materiale që do të elaborohen tani në vazhdim të arsyetimit të këtij aktgjykimi tek vërejtjet e Gjykatës së Apelit, e që kanë pamundësuar trajtimin e tyre në mënyrë kronologjike.

Kjo gjykatë, ri-kujton edhe njëherë faktin se, provat materiale të cilave më sipër gjykata ua kishte falur besimin, nuk ishin si të vetme që zbardhin gjendjen faktike, por vetëm mbështetnin konkludimet e kësaj gjykate të vërtetuara edhe nga provat e tjera, respektivisht dëgjimi i dëshmitarëve.

Vërejtjet e Gjykatës së Apelit përkitazi me anulimin e aktgjyqimit të Gjykatës Themelore, si dhe provat që nuk janë marrë për bazë me rastin e vendosjes

Gjykata e Apelit, me rastin e anulimit të aktgjyqimit të fundit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka dhënë arsyet dhe vërejtjet e saja se pse aktgjykimi është prishur duke dhënë edhe vërejtjet përkitazi me shkeljet e konstatuara.

Gjykata e Apelit ka konstatuar vërejtjet e ndër të cilat janë:

1.Ndërmarrja e të gjitha veprimeve të nevojshme në rigjykim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për të qartësuar dhe theksuar se cilat janë veprimet inkriminuese që i akuzuari i ka kryer apo nuk i ka kryer.

2.Rivlerësimi i faktit të kontrollit në lokalin “Bar S” në përputhje me dispozitën e nenit 246 të KPP-së, duke u bazuar në rrethanat e fakteve dhe më pas të vlerësoj nëse provat e mbledhura gjatë kontrollit në lokal janë të pranueshme.

3.Rivlerësimi me saktësi dhe dhënia e arsyeve të qarta dhe të plota nëse provat e siguruar për trekëndëzimin e numrave të telefonave përkatës janë ruajtur me vendim gjyqësor dhe në mënyrë ligjore, duke përfshirë bazën ligjore për ruajtjen e tyre dhe nxjerrjen e konkludimit të drejtë dhe të ligjshëm se ruajtja e këtyre të dhënave, përkatësisht shkatërrimi i tyre a duhet të bëhet sipas vendimit gjyqësor apo ruajtja dhe shkatërrimi janë kategorizuar si Ex-lege.

4.Dëgjimi i dëshmitarëve A.C për rrethanat e dëshmisë së tij të dhënë në procesverbalin në polici lidhur me rolin e të akuzuarit në grupin e tij dhe njerëzit që e rrethonin atë si dhe dëgjimin e dëshmitarit Xh.B në rrethanat e dëshmisë së tij të dhënë në procesverbal në polici lidhur me njohuritë e tij për ditën kritike dhe takimin e tij me A.B në lokalin “S”. Gjykata e Apelit lidhur me dëshmitaret kishte specifikuar edhe faktin se gjykata e ka mbështetur një pjesë të aktgjyqimit në deklaratatave edhe që nuk ishin administruar në shqyrtimin gjyqësor, duke ju referuar deklaratave të dëshmitarit D2, e po ashtu kishte kërkuar nga gjykata e shkallës së parë, që besueshmëria e dëshmitarit D2 të vlerësohet edhe në përputhje me provat e tjera.

Në këtë këndvështrim, kjo gjykatë ka ndërmarr të gjitha veprimet me qëllim të eliminimit të të gjitha shkeljeve që i ka konstatuar Gjykata e Apelit e të cilat do të trajtohen në vijim.

1.Për veprimet inkriminuese:

Sa i përket veprimeve inkriminuese, por edhe përshkrimit faktik përkitazi me tani vërejtjet e gjykatës së Apelit, kjo gjykatë ka ndërmarr gjitha veprimet, ku në bazë të provave të administruara edhe ka nxjerrë përfundimet mbi veprimet inkriminuese të tani të akuzuarit e që përputhen në plotni me emërtimin ligjor të veprës penale për të cilën tani më i njëjti është gjetur fajtor. Gjykata konkludimin e ka nxjerrë nga rrethanat specifike të rastit, rrjedha dhe kronologjia e saj, motivet e të akuzuarit, e po ashtu lidhshmëria e të akuzuarit me personat e përfshirë në rast dhe mungesa e motivit të personave të përfshirë për ta privuar nga jeta tani të ndjerin. Përshkrimi i veprimeve inkriminuese, tani është përshkruar sakte në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjyqimit dhe këtë konstatim gjykata e ka nxjerrë vetëm atëherë kur ka përjashtuar çdo mendësi se prapa vrasjes së të ndjerit mund të ishte dikush tjetër për veç të akuzuarit E.S

Përfundimisht, gjykata ka eliminuar vërejtjen e lartcekur të dhënë nga gjykata e Apelit, ndërsa bindja e krijuar nga kjo gjykatë do të elaborohet më në detaje në vijim të arsyetimit të këtij aktgjykimi.

2.Gjykata me rastin e elaborimit të provave materiale në pjesën e sipërme të këtij aktgjykimi, ka specifikuar se lidhur me provat me numër rendor 51,52,53,54,55,56,57,58,68,70,71,84,86,87,97,107,109,114,115,116,118,125 do të jap arsyetim të veçantë përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi.

Në këtë rast, Gjykata ka marrë për bazë dhe ka shqyrtuar rekomandimet e Gjykatës së Apelit, përkatësisht rekomandimet e specifikuara në Aktvendimin me shenjë APS.nr.10/2020 të datës 06.03.2020.

Provat materiale të specifikuar me numrat rendor 51,52,53,54,55,56,57,58,68,70,71,84,86,87,97,107,109,114,115,116,118,125, kanë pasur të bëjnë me ndërmarrjen e veprimeve nga ana e policisë për gjatë bastisjes së shtëpive aso kohe të të dyshuarve lidhur me përfshirjen e tyre në rastin e privimit nga jeta të të ndjerit T.R dhe lidhur me Kontrollin e “Bar S”, e që rekomandimet e Gjykatës së Apelit në këtë rast kishin konstatuar si në vijim : *“Gjykata e Apelit gjen se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk ka dhënë arsyetim të vet sipas bindjes mbi bazën e provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, por përsërit konkludimin dhe mendimin e trupit të mëparshëm gjykues, dhe nga kjo rrjedh që gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar të mos ketë dhënë arsye të plotë dhe të qartë nëse ky fakt vendimtar është vërtetuar duke u mbështetura mbi provën konkrete respektivisht mbi procesverbalin me të gjitha të dhënat e tij me të cilën e vërteton apo nuk e vërteton faktin e ligjshmërisë së kontrollit të lokalit “Bar S” në ditën kritike, dhe më pas të arsyeve të qarta dhe të plota në lidhje me pretendimet e ngritura nga mbrojtja e të akuzuarit nëse provat e mbledhura gjatë kontrollit “Bar S”: janë të pranueshme në përputhje me dispozitën e nenit 246 të KPP-së, dhe jo vetëm të përqendrohet në arsyetimin se gjatë kontrollit ishin respektuar dispozitat ligjore të nenit 243 dhe 245 të KPP-së”* .

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (UNMIK/RREG/2003/26) tutje KPP-së i datës 06.07.2003 në kohën kur është kryer vepra penale, përkatësisht neni 246 i këtij Kodi ka përcaktuar se provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse:

- 1) Kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi,
- 2) Urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake është lëshuar në kundërshtim me procedurën e parapare me këtë Kod,
- 3) Përmbajtja e urdhrin të gjyqtarit të procedurës paraprake është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë Kod,
- 4) Kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake.
- 5) Personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit (neni 241 paragrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi), ose
- 6) Kontrolli është zbatuar në kundërshtim me nenin 245 paragrafët 1,3, 4 dhe 5 të këtij Kodi.

Kjo gjykatë, fillimisht specifikon se me rastin e marrjes se këtyre provave, nuk janë respektuar në plotni dispozitat procedurale dhe nuk mund të përdoren si prova të ligjshme gjatë këtij procesi gjyqësorë në të cilën gjykata do të mbështeste aktgjykimin, për arsyet si në vijim:

Në procesverbalet përmes të cilave është konstatuar bastisja në shtëpitë e të dyshuarve, nuk është përmbushur fillimisht kushti ligjor nga neni 243 paragrafi 2 i KPP-së i cili ka specifikuar se *“Gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve të tjera kërkohet të jenë të pranishëm dy persona të rritur si dëshmitarë. Para fillimit të kontrollit, dëshmitarët paralajmërohen që me*

kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe njoftohen mbi të drejtën e tyre për të bërë vërejtje, nëse kanë, për përmbajtjen e procesverbalit të kontrollit para se të nënshkruhet”.

Kjo Gjykatë, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se nuk ishte përmbushur nga organet relevante aso kohe edhe kushti nga neni 246 paragrafi i 6 i KPP-së ku është specifikuar se provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse “*Kontrulli është zbatuar në kundërshtim me nenin 245 paragrafët 1,3,4 dhe 5 të këtij Kodi*”, e përkatësisht me paragrafin 6 të nenit 245 që ka specifikuar se “*Kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësorë ajo brenda afatit prej dymbëdhjetë orësh lidhur me këtë i dërgon raport prokurorit publik dhe gjyqtarit të procedurës paraprake nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtarë i procedurës paraprake*”, e duke u bazuar në shkresat e lëndës edhe pse në procesverbalet e kontrollit është konstatuar se këto janë realizuar duke u bazuar në urdhrin gojor të cilin e ka lëshuar gjyqtarja e procedurës paraprake në atë kohë D.H, në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë shkresë e cila vërteton se policia brenda afatit dymbëdhjetë orësh t’i ketë dërguar raport prokurorit publik dhe gjyqtarit të procedurës paraprake, e po ashtu nuk ka ndonjë provë e cila vërteton që prokurori publik ka bërë ndonjë kërkesë të tillë tek gjyqtari i procedurës paraprake, apo që gjyqtari i procedurës paraprake të ketë lëshuar ndonjë vendim përmes të cilit të kishte vërtetuar urdhrin retroaktiv gojor të lëshuar nga ajo. Andaj, duke marrë për bazë gjendjen faktike të vërtetuar lidhur me provat materiale të lartcekura, kjo gjykatë konstaton se me rastin e marrjes se këtyre provave, nuk janë përfillur kërkesat ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës.

Kjo gjykatë vë në dukje që në momentin kur ka ndodh vepra penale, përkatësisht në vitin 2007, ka qenë në fuqi Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (UNMIK/RREG/2003/26) e që gjykata në pjesën e sipërme në mënyrë të detajuar ka shpjeguar mënyrën se si Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale në atë kohë ka përcaktuar përmes dispozitave ligjore pranueshmërinë e provave. Në kohën e gjykimit dhe përpilimit të këtij Aktgjykimi, kjo Gjykatë vë në dukje që në fuqi tashmë është Kodi i Procedurës Penale KODI NR. 08/L-032 tutje KPP-së, i cili po ashtu ka përcaktuar përmes dispozitave ligjore atë se kur provat konsiderohen të pranueshme dhe kur të papranueshme.

Dispozitat edhe këtij Kodi, përkitazi me mënyrën e marrjes së provave gjatë kontrollit janë identike, andaj kjo gjykatë, përfundimisht konstaton se provat e mara me rastin e bastisjes nuk janë legjitimuar me urdhër retroaktiv të gjykatës.

Kjo gjykatë konstaton se fillimisht këto prova kishin kaluar filtrin e Gjykatës së Apelit duke qenë prova që ishin trajtuar e administruara në shqyrtimet gjyqësore. Me rastin e kthimit në r-gjykim, në bazë të rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, është ri-shqyrtuar fakti po që se këto prova janë marrë konform dispozitave ligjore. Meqë te njëjtat ishin pjesë e shkresave në çdo gjykim, rezultojnë se ishin administruar si të tilla tek administrimi i provave në shqyrtimin gjyqësor, megjithatë marr për bazë faktin se kjo gjykatë konstaton se të njëjtat nuk janë marr konform dispozitave ligjore, kjo gjykatë nuk i trajtoi dhe nuk i morri për bazë me rastin e shpalljes së aktgjykimit.

Kjo gjykatë specifikon se, asnjë fragment nga këto prova nuk është marrë për bazë me rastin e shpalljes fajtor të tani akuzuarit e as fragmente që rrjedhin nga këto prova, por për kundër këtij fakti, provat e tjera të cilat i ka trajtuar kjo gjykatë ishin prova konkrete, lidhshmëria e të cilave ka qar në konkludimin e kësaj gjykate.

3.Sa i përket provave materiale me numër rendor 97,107,125, janë prova materiale të cilat ndërlihen me provat e siguruara nga PTK-ja për përcaktimin e hartografisë të numrave të telefonave të caktuar, që Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj lidhur me këto prova materiale kishte gjetur se “*Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar nuk ka dhënë arsye të*

mjaftueshme dhe të qarta nëse provat e siguruar nga PTK-ja për përcaktimin e hartografisë të numrave të telefonave të caktuar janë prova të pranueshme dhe nëse me urdhër të gjykatës janë ruajtur ato. Edhe pse gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e Aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se ka dëgjuar dëshmitarin Q.Q- Menaxher i Zyrës Ligjore për bashkëpunim me agjensionet për zbatimin e ligjit, por nuk ka dhënë arsye të qartë nëse nga kjo dëshmi ka vërtetuar se këto të dhëna ishin ruajtur me vendimit të gjykatës dhe nuk kanë mundur të fshijnë pa ndonjë urdhër, por në mënyrë të përgjithësuar ka theksuar dëshminë e dëshmitarë në fjalë. Për më tepër nuk ka dhënë arsye të qartë edhe lidhur me aplikimin e nenit 3 të Ligjit nr.05/L-030 mbi përgjimin e komunikimeve elektronike në raport me pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit rreth dispozitave të Ligjit për Komunikimet Elektronike nr.04/L-109, kjo pasi që gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar në faqen 75 pasuesi i parë rreshti i 3 konstaton se “këto Meta-të dhëna nuk mbrohen nga kufizimet kohore të Ligjit mbi komunikimet elektronike. Mirëpo, shikuar në dispozitën e nenit 3 të Ligjit nr.05/L-030 rezulton që jepen përkufizimet e shprehjeve të përdorura në këtë ligj, andaj në këtë drejtim është e paqartë për arsyet që gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar e ka mbështetur këtë fakt se këto Meta-të dhëna nuk mbrohen nga kufizimet kohore të ligjit mbi komunikimet elektronike.”.

Kjo gjykatë me rastin e analizimit të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr.04/L-109 të datës 09.11.2012 ka analizuar nenet që ndërlidhen me komunikimet elektronike e të cilat nene kanë përcaktuar si në vijim:

Neni 68 përkatësisht paragrafi 1 i këtij neni ka specifikuar se “Pavarësisht definicioneve tjera në këtë ligj, ndërmarrësit e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të obliguar të ruajnë dhe të administrojnë për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit skedaret e të dhënave për parapaguesit e vet duke u referuar në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo ruajtje duhet të paguhet nga fondet shtetërore në pajtueshmëri me procedurat e vendosura nga Qeveria.”

Në kuadër të paragrafit 2 të Nenit 68 është specifikuar se cilat kategori të të dhënave duhet të ruhen e që janë si në vijim: 2.20 “të dhënat e domosdoshme për të identifikuar lokacionin e pajisjes komunikuese mobil”, si dhe 2.21 “të dhënat që identifikojnë lokacionin gjeografik të celulareve duke u referuar nga emri i lokacionit të tyre (ID e celulës) gjatë periudhës në të cilën të dhënat komunikuese kanë qenë në dispozicion.”

Në nenin 104 përkatësisht, paragrafi 2 i këtij neni është specifikuar se “Ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike duhet të ruajnë informatat teknike që janë shfrytëzuar gjatë transmetimit të trafikut të komunikimeve elektronike vetëm për një periudhë kohore e cila është e domosdoshme për të siguruar veprimtarinë ekonomike të ndërmarrësve, por jo më gjatë se gjashtë muaj, përveç rasteve që i referohen në nenin 68 të këtij ligji; kur informatat e tilla janë të domosdoshme për qëllime hetimi, i’u nevojiten institucioneve që bëjnë hetime para procesit gjyqësor, prokurorëve, gjykatave, ose gjykatësve për të parandaluar, hetuar dhe zbuluar aktivitetet kriminale, ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike pas instruksioneve të marra nga ndonjë institucion (institucione që kryejnë shërbime hetimi) i autorizuar nga Qeveria duhet të ruajnë ato informata për një periudhë më të gjatë kohore, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj të tjerë. Ruajtja e tillë e informatave duhet të paguhet nga fondet shtetërore në përputhje me procedurat e vendosura nga Qeveria”.

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se, trupi i atëhershëm gjykues në vitin 2015 ka lëshuar 2 urdhëresa dhe atë të datës 17.02.2015 si dhe 12.03.2015, urdhëresa përmes të cilave ka urdhëruar Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës tutje (PTK) për t’i siguruar gjykatës hartën e lokacionit të tetë numrave mobil për datat 29, 30 dhe 31 gusht 2007, ndërsa me urdhrin e dytë

PTK-ja është urdhëruar që t'i ruan regjistrimet në lidhje me numrat e paraqitur në urdhrin e parë dhe të mos i fshin këto të dhëna deri sa të përfundon procedura penale pasi që fshirja e të dhënave të tilla mund ta rrezikon procedurën penale.

Nga analiza e shkresave të lëndës rezulton se, trupi gjykues i atëhershëm ka lëshuar urdhrat e tij në vitin 2015, më konkretisht më datat 17.02.2015 si dhe 12.03.2015, që rezulton se është pas skadimit të afatit kohorë të paraparë për ruajtjen e të dhënave, sepse sipas dispozitave të sipërcituara më lartë të njëjta të dhëna do të mund të ruheshin në kohëzgjatje maksimale prej 1 (një) viti e gjysmë, e që nëse në atë kohë pra në periudhën 2007 do të ishte lëshuar urdhri nga gjyqtari i procedurës paraprake për sigurimin e hartës së lokacionit për numrat mobil të kërkuar si dhe të ekzistonte urdhri për ruajtjen e këtyre të dhënave, vetëm atëherë gjykata do të mund ti merrte për bazë këto prova. Sa i përket respektimit të dispozitave ligjore lidhur me ruajtjen e të dhënave dhe mënyrën se si funksionon në kuadër të PTK-së, përpunet edhe me dëshminë e dëshmitarit Q.Q i cili e ka elaboruar këtë çështje para trupit gjykues të mëhershëm.

Në këtë kontekst, sikurse tek provat materiale që kishin të bënin me bastisjen, pas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, edhe pse këto prova rezultojnë të jenë administruar, kjo gjykatë nuk i morri për bazë të njëjtat me rastin e shpalljes së këtij aktgjykimi, për faktin se të njëjtat nuk ishin marrur konform dispozitave ligjore, andaj si të tilla nuk patën efekt në marrjen e këtij aktgjykimi dhe se gjykata asnjë argument të saj mbi vendosje nuk e bazoi në këto prova dhe të tillat ishin pa efekt.

4. Si vërejtje nga Gjykata e Apelit ka qenë edhe dëgjimi dhe sqarimi i deklaratave të dëshmitarëve, A.C dhe Xh.B, e që Gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit Xh.B, ndërsa lidhur me dëshmitarin A.C janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e prezencës së tij në procedurë, por sipas informacioneve të siguruara nga Policia e Kosovës dhe nga shkresa e cila është pranuar nga nëna e tij, është verifikuar se i njëjti me vite gjendet jashtë shtetit të Kosovës dhe për shkak të mos zvarritjes së procedurës - për hirë të ekonomizimit të procedurës, në seancën e datës 10.05.2022 me rastin e dakordimit të të gjitha palëve në procedurë është lexuar deklarata e të njëjtit të cilën e kishte dhënë në polici. Megjati gjykata ka analizuar edhe njëherë deklaratën e të lartcekurit dhe konkludimet janë nxjerrë duke e lidhur deklaratën e tij me provat e tjera të administruara. Sa i përket dëshmitarit Xh.B, kjo gjykatë tani ka eliminuar vërejtjet e Gjykatës së Apelit dhe se ka dhënë arsyetimet lidhur me këtë dëshmitar, arsyet e detajuar gjykata i ka sqaruar tek elaborimi i provave personale, respektivisht tek analizimi i deklaratës së të njëjtit. Lidhur me vërejtjet e dhëna nga gjykata e Apelit përkitazi me dëshmitarin D2, kjo gjykatë ka mënjeluar shkeljet paraprake, dhe në këtë shqyrtim gjyqësor ka administruar të gjitha deklaratat e tij. Ka qenë e pa mundur sigurimi i të njëjtit, me ç' rast me propozimin dhe pëlqimin e palëve deklaratat e dëshmitarit D2 ishin konstatuar të lexuara.

Siç është argumentuar kur është trajtuar nga gjykata deklaratat e dëshmitarit D2, gjykata besimin këtij dëshmitari ia kishte falur tani vetëm mbi faktet që kanë gjetur përputhje edhe me deklaratat tjera dhe mbi këtë koncept edhe ka nxjerrë përfundimet, me ç' rast kjo gjykatë ka trajtuar të gjitha vërejtjet e dhëna nga Gjykata e Apelit, ku vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit e ka ndërlidhur me provat e tjera të administruara.

Pretendimet e mbrojtjes

Kjo gjykatë, në këtë pikë të veçantë të arsyetimit të këtij aktgjykimi, do t'i trajtoj pretendimet kryesore të mbrojtjes të shfaqura në fjalën përfundimtare, e që lidhen me pikat kyçe, determinuese për bindjen e gjykatës, e që kjo gjykatë do të japë përgjigje se pse trupi gjykues ka vlerësuar ndryshe nga këto pretendime.

1. Avokatja mbrojtëse ka ngritur çështjen lidhur me emërtimin ligjor të veprës penale duke shtruar pyetjet se a përmban ky dispozitiv i aktakuzës, kohën dhe vendin e saktë të kryerjes së veprës penale?, a ka ndryshuar ndonjë gjë me përshkrimin në dispozitiv?, A është paraqitur në dispozitiv të aktakuzës përshkrimi konkret i shtytjes? Si dhe a përmban aktakuza rrethanat e nevojshme për përcaktimin e veprës penale?, pra Prokurori nuk ka plotësuar asnjë nga këto kërkesa të parashtruara nga ana e gjykatës instanciale, e që tutje ka cituar edhe vërejtjen e Gjykatës së Apelit të paraqitur në faqen 17 të Aktvendimit të datës 19 tetor 2017 e cila vërejtje ka konstatuar-citon “Dikush nuk mund të akuzohet dhe të dënohet për shtytje për kryerjen e veprës penale, pa dhënë ndonjë përshkrim të duhur për atë se cilat akte (veprime apo mosveprime) ka kryer ky person i caktuar dhe për shtytë ekzekutuesin fizik që të kryej veprën penale”, dhe përkundër kësaj, dispozitivi ka mbetur i njëjti që jep një përshkrim të vrasjes së rëndë, të kryer nga ana e A.B, po në asnjë mënyrë nuk saktëson veprimet apo mosveprimet e të akuzuarit E.S, se si ai e shtyri A.B për të vrarë të ndjerin T.R”.

Lidhur me pretendimet e lartshënuara nga mbrojtja, kjo gjykatë fillimisht tërheq vëmendjen që vërejtjet e Gjykatës së Apelit, përveç që obligojnë për veprime palët në procedurë, në rastin konkret prokurorin special, siç me të drejtë pretendon mbrojtja, obligojnë edhe gjykatën e shkallës së parë. Në këtë drejtim, kjo gjykatë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të provave të administruar në shqyrtimin gjyqësor dhe ajo gjendje faktike që është vërtetuar edhe është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Kjo gjykatë, tek pjesa e aktgjykimit kur do të jap shpjegimet për elementet e veprës penale, ka dhënë argumentet edhe mbi përshkrimin faktik që kjo gjykatë e ka vërtetuar e ku është specifikuar se ky përshkrim faktik është nxjerrë nga provat e administruara, por kjo gjendje faktike është nxjerrë po ashtu nga pretendimet e prokurorisë dhe se gjykata i ka ristrukturuar duke nxjerrë përfundimin e saktë lidhur me ngjarjen, por jo duke tejkaluar pretendimet e prokurorisë e që këtë çasje e lejon dhe ka determinuar praktika gjyqësore e krijuar nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese (për më tepër shih argumentet pasuese të gjykatës).

Në këtë kontekst, kjo gjykatë në përshkrimin faktik të gjendjes faktike të vërtetuar nga kjo gjykatë, (pa ndryshuar pretendimet faktike të prokurorisë) ka përshkruar në detaje rrjedhën e ngjarjes që i ka paraprirë vrasjes së tani të ndjerit, duke specifikuar në detaje se cilin veprim dhe sulm në drejtim të tani të ndjerit e që lidhet me motivet e kryesit dhe përfundimisht edhe veprimet inkriminuese të vet të akuzuarit, respektivisht veprimet inkriminuese në kuptim të plotësisimit të elementeve të veprës penale që kanë të bëjnë me formën e bashkëpunimit - të shtytjes, për të cilën gjykata e ka gjetur fajtorë tani të akuzuarin.

Në këtë drejtim, çështjet që ka ngritur Avokatja mbrojtëse, e që ishin edhe pjesë e vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, tani të gjitha ato mangësi që janë specifikuar, janë trajtuar nga kjo gjykatë dhe janë rregulluar sipas vërejtjeve të gjykatës së Apelit, duke precizuar tani të gjitha veprimet e kërkuara në përshkrimin faktik të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

2. Mbrojtja e të akuzuarit, ka ngritur edhe çështjen lidhur me thelbin direkt të akuzës, ku E.S komandant i një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga 3-4 familjarë të ti dhe nxitës i një vrasje të kryer nga A.B, përse A.B jo, A.B sipas asnjë dëshmitari të prokurorisë nuk ishte ushtar

i E. apo grupit kriminal, madje as prokuroria nuk e mohon një fakt të tillë, pasi që i njëjti ishte anonimus për të gjithë, i pa njohur edhe për policinë dhe hetuesinë por edhe për të gjithë të tjerët që e njifnin E.S për të keq, gjersa prokuroria pretendon se A.B ka marr përsipër fajin dhe është dorëzuar në mënyrë të parapregaditur.

Trupi gjykues, ka vlerësuar se gjendja faktike e vërtetuar e që mbështetet në dëgjimin e dëshmitarëve, por edhe provat materiale të elaboruara, respektivisht sms-t nga përgjimet, vërtetojnë pikërisht të kundërtën e asaj që pretendon mbrojtja. Fillimisht specifikojmë faktin se A.B ishte “anonimus për të gjithë” siç e citon mbrojtja, lidhur me problemet e T, me dikë, pra ai ishte i pa njohur për të gjithë dëshmitarët që njihnin T. dhe problemet e tij, pra në këtë drejtim ai ishte i pa njohur pasi që T, nuk kishte pasur asnjëherë problem me të (fakt i vërtetuar nga dëgjimi i secilit dëshmitar) përveç pretendimeve të A.B e të cilat kanë rezultuar si të pa vërteta në konstatimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

Sa i përket argumentit tjetër të mbrojtjes, A.B nuk ishte “anonimus për të gjithë”, sepse nga provat e administruara, rezulton se ai ishte i njohur si pjesë e “grupit S”, si punëtor në “BKafe”, si person siç e quante dëshmitari F.Sh se ishte e pa mundur të kaloje kah “Kafe Bar S” e mos ta shihje A, Andaj, A.B ishte i njohur si pjesë e grupit e po ashtu punëtor i biznesit që e udhëhiqte tani i akuzuari. Për më tepër vrasësi i T.R, tani i dëshmitari A.B nga provat e administruara e të elaboruara më sipër, rezulton se kishte qenë i afërt dhe gjatë gjithë kohës në kontakt e në shoqëri me Rr.A (Rr) dhe I.A (L), po ashtu personat kryesor në të ashtuquajturit “Grupi S” si dhe njerëzit më të afërm të E.S si dhe dy njerëzit thuajse kryesor që ishin parapa sulmeve, përcjellëse e kërcënimeve ndaj T.R. Andaj, në bindjen e trupit gjykues, një pretendim i tillë i mbrojtjes nuk ekziston, pasi që A.B ishte i njohur si pjesë e grupit, punëtor në “B.Kafe” biznes që e udhëhiqte tani i akuzuari E.S dhe A.B ishte edhe më i afërti me Rr.A (Rr) dhe I.A (L).

3. Mbrojtja e të akuzuarit, më tej specifikon se lidhur me përshkrimin e pikës I të aktakuzës nuk dihet se a bëhet fjalë për hakmarrje apo ndonjë motiv tjetër që theksohen edhe 4 persona A.B, F.A, Rr.A dhe I.A, a kanë pasur motiv personal të hakmarrjes kundër të ndjerit T, gjersa në kontekst të kësaj hakmarrje personale nuk përmendet fare E.S. Pse ka marrë 4 muaj kohë për të filluar aktvendimi për fillim të hetimeve për E.S pasi që ka qenë fakt notor sipas dëshmitarëve – ish policëve të dënuar se E.S dhe T kanë pasur mes vete konflikte për vite me radhë.

Fillimisht gjykata nuk mund të jap sqarime se pse dhe kur është marr aktvendimi për fillimin e hetimeve ndaj të akuzuarit. E rëndësishme është që të shikohet rrjedha e procedurës po që se e njëjta përmban shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës e që shkeljet e evidentuara tani janë mënjanuar nga kjo gjykatë në këtë ri-gjykim.

Fakti i problemeve të vazhdueshme mes E.S e T.R është pikërisht argumenti se pse policia kishte ndërmarrë të gjitha veprimet fillestare në mënyrë të ngutshme e në “KafeBar S” e që ka qar pikërisht në idenë e tyre se E.S është prapa vrasjes, pikërisht pra për shkak të problemeve të vazhdueshme, e që tani ka rezultuar të jetë e vërtetë edhe në lidhshmërinë e ngjarjes që e ka vërtetuar kjo gjykatë.

Trupi gjykues sqaron, se motivi hakmarrës ishte i E.S, dhe për motive hakmarrëse të tij kishin ndërmarr veprimet në mënyrë të organizuar A.B, F.A, Rr.A dhe I.A, të gjithë këta pjesë e “grupit S” Pra, në bindjen e këtij trupi gjykues, askush nuk kishte problem nga të lartcekurit me T, kishte probleme vetëm E.S, andaj hakmarrja ishte e E.S.

4. Mbrojtja më tej specifikon se Prokuroria Speciale në kohën e ngritjes së aktakuzës ka dështuar në tërësi dhe nuk ka asnjë grimcë të dëshmisë që të vërtetojë faktin se E.S e ka shtyt-nxitë A.B

për të kryej veprën penale. E që Prokuroria në këtë rast ska lënë gur pa lëvizur, ku investoi shumë për të gjetur “një fije floku” të lidhjes në mes A.B por përsëri dështim, asgjë e përbashkët, asnjë lidhje mes tyre, asnjë bisedë, asnjë takim, asnjë kontakt, asnjë premtim, asnjë shpërblim e asgjë të vetme.

Në fakt, në bindjen e trupit gjykues, pikërisht mbrojtja ka luftuar që të minimizoj çdo lidhje mes Enver Sekiraqës e A.B. Kjo vërehet edhe nga ndryshimi i deklaratave të A.B përkitazi me lidhshmërinë mes tij dhe të akuzuarit, pastaj edhe me ditën kritike që herë specifikonte që ishte në “Bar S” herë jo, pra të gjitha ndryshimet e deklaratave të personave që kishin qenë pjesë e “Grupit S” kishin një qëllim: që ta bënin sa më të largët raportin e E.S me të A.B Deklaratat e tyre kontradiktore veç se janë specifikuar për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi.

Trupi gjykues ka vërtetuar të kundërtën e pretendimeve të mbrojtjes.

Trupi gjykues ka vërtetuar se A.B ishte pjesë e “Grupit S”, po ashtu ka vërtetuar se i njëjti ishte punëtor në “B.Kafe” biznes që udhëhiqej nga E.S. Më tej është vërtetuar se A.B shoqërohej në vazhdimësi me Rr.A (R) dhe I.A (L) e po ashtu vërtetohet se bashkë me të lartcekurit, vetëm tri ditë para vrasjes së T, A.B bashkë me I.A ishin duke e përcjellë T, e përmes Rr.A i raportonin E.S. Trupi gjykues e ka vërtetuar se A.B ditën kritike ka qenë në “Bar S”, e po ashtu është takuar me E.S. Më tej është vërtetuar se nga “Bar S” pasi që ka marr instruksionet, i armatosur është nisur drejt vendit të ngjarjes bashkë me Rr.A (R) dhe I.A (L) e mbështetur edhe nga F.A Gjykata ka ri-konstatuar se vrasja nuk ishte e atëçastshme por e organizuar pasi që i kishin dalë në pritë tani të ndjerit, fakt ky tani i konstatuar nga Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme.

Nga ky këndvështrim, lidhshmëria e E.S me A.B është më se e qartë e konkrete dhe se pretendimet e mbrojtjes për ta zhbë një fakt të tillë janë në kundërshtim me provat e administruara e të cilave gjykata u’a ka falur besimin, që pikërisht kjo lidhshmëri me E, e A, e pastaj A, me Rr. e I, qon haptazi në konkludimin se veprimet e të dënuarit A.B kanë lidhshmëri të drejtë për drejtë në veprimet shtytëse të tani akuzuarit për motive hakmarrëse. Veprimet shtytëse, por edhe motivet hakmarrëse të të akuzuarit, janë elaboruar më sipër për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi, e do të elaborohen sërish në vijim të arsytimit të këtij aktgjykimi.

5. Mbrojtja ka ngritur edhe çështjet e motivit, duke specifikuar se motivi 1 thotë që Prokuroria pretendon që ka dëshmi që E ka pasur urrejtje për T, përkatësisht një ndodhi të vitit 2000 apo 2001 që nuk dihet saktë viti kur i ndjeri është kërcënuar me granat dore nga i akuzuari dhe që bashkë me të ndjerin ka qenë edhe një polic ndërkombëtar i UNMIK-ut, ndërsa për këtë ngjarje ska asnjë raport zyrtar, asnjë rast i paraqitur në polici, vetëm fjalë goje, e pastaj përcjelljet të cilat kanë ndodhur kinse nga i pandehuri dhe miqtë të tij, dhe se duhet të shikohet me vëmendje se prokuroria posedon dëshmi të pakontestueshme, dëshmi të V.R, ku i njëjti tregon për një rast që kinse i pandehuri i ka përcjell me makinë të blinduar rrugës në Veternik autostradës për Shkup, e tutje edhe rastet që i ndjeri i ka paraqit siç është prita në S, djegia e makinës, vrasja e qenit dhe të gjitha raste që i kishte paraqitur në polici, të gjitha janë raste të paraqitura ndaj NN personave, raste të pazgjdhura dhe të pasqaruara, andaj nuk janë prova relevante.

Çështjet të cilat i ka paraqitur mbrojtja, janë më se evidente në kontekstin e asaj se konflikti mes E.S dhe T.R ishte i njohur për të gjithë, respektivisht thujse për të gjithë dëshmitarët që janë marrë në pyetje. Është specifikuar edhe më sipër që duket hapur fakti se çdo dëshmitar ishte në dijeni për problemet mes E.S dhe T.R, por nuk ishte në dijeni vetëm E.S e madje në dëshminë e tij theksonte se nuk e dinte as A.B punëtor i tij, vrasës i T. me përcjellje - konstatuar nga Gjykata Supreme e në të njëjtën kohë personi më i afërt i Rr.A e I.A e këta dy të fundit njerëzit më të afërm të E.S në kontekstin e përcjelljeve e sulmeve ndaj T. Pra të gjithë ishin në dijeni përveç protagonistëve. Në bindjen e gjykatës është më se e qartë se kjo ishte forma se si i akuzuari dhe personat që ishin pjesë e grupit të tij, mundoheshin të shpëtonin lidhshmërinë e tyre me vrasjen.

Fakti se problemi i parë mes T. dhe E.S kishte ndodhur me kërcënim me granat dore, është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve Sh.R, V.R, G.H, B.Sh, B.H, Sh.Q, A.S, pra gjykata këtë fakt nuk e ka vërtetuar me deklaratë të një dëshmitari, por me deklaratat e shtatë dëshmitareve që e kanë njohur për së afërmi dhe të cilët i kanë ditur të gjitha problemet e T e të cilat deklarata janë në përputhje identike me tani gjendjen faktike të vërtetuar përkritazi me çështjen e ngritur. Pse duhet të gjithë këta dëshmitar të inskenonin fakte të tilla sipas mbrojtjes, pse duhet këta ta akuzonin E.S për vrasje po që se T e E nuk kishin kur probleme mes vete, pse edhe policia të gjitha veprimet e para i kishte ndërmarr aty, pikërisht për shkak se ishte një fakt që e pohonin të gjithë, se konflikti mes E.S dhe T.R ekzistonte me vite me radhë dhe këto çështje nuk ishin fjalë goje siç specifikon mbrojtja, por ishin fakte të mbështetura tani në prova. Lidhur me konfliktin mes tyre, deklarohen edhe dëshmitarët A, M, e Z.I e po ashtu edhe dëshmitari F.Sh e dëshmitari A.C. Andaj konfliktet mes E.S dhe T.R, në bindjen e këtij trupi gjykues janë vërtetuar nga dëgjimi i dhjetëra dëshmitarëve.

Sa i përket djegies së veturës që e ngrit mbrojtja, përveç dëshmisë së dëshmitarëve kishte edhe rast të hapur ku indicet qonin që prapa kësaj çështje ishte E.S dhe jo NN persona siç specifikon mbrojtja dhe fakti se këto raste nuk kanë marr epilog, assesi nuk janë prova irelevante siç pretendon mbrojtja, por janë saktësisht prova që krijojnë hallkën zingjyrore të provave të një konflikti shumë vjeçar deri në vrasjen e tani të ndjerit, andaj mbi këtë narracion është krijuar edhe bindja e këtij trupi gjykues.

Po që se për mbrojtjen fakti se këto çështje nuk kanë marrë epilog përfundimtar dhe për këtë arsye janë irelevante përcjelljet e vazhdueshme ndaj T, me skuter e me vetura të blinduara, qoftë kur ai ishte me familjar, qoftë me kolegë, qoftë me A.I, djegia e veturës, atentati në S, vetëm dy javë para vrasjes, për gjykatën janë prova që vërtetojnë fakte konkrete në rrjedhën e ngjarjes. Të gjithë dëshmitarët në tërë rrjedhën e ngjarjes përmendin një emër dhe asnjë tjetër, se prapa sulmeve, kërcënimeve e përcjelljeve ishte E.S.

Siç u specifikua edhe më sipër, për gjatë përcjelljeve kishte pasur edhe dëshmitar okular ku përveç T që u kishte rrëfyer problemet të afërmëve të vet, kishte raste se kur kishin ndodhur përcjelljet ishin prezent edhe vet V.R e A.I, të dy këta dëshmitar në këtë proces gjyqësor, andaj në këtë kontekst, në bindjen e trupit gjykues rastet e një pas njëshme janë vërtetuar nga provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, respektivisht nga dëgjimi i dëshmitarëve të lartcekur.

6.Mbrojtja më tej ngrit çështjen e motiveve. Motivi 2 është përmendur rasti i Ferizajt e që akterët kryesorë të këtij incidenti B.H dhe Sh.Q janë dëgjuar edhe si dëshmitarë, e që lidhur me dëshminë e tyre mbrojtja i ka bojkotuar, sepse dëshmia e tyre sipas mbrojtjes është pa vlerë dhe se nuk ka asnjë nuancë objektiviteti. E lidhur me këtë rast as B.H as Sh.Q asnjë pjesëmarrës tjetër të njësisë speciale të përfshirë në këtë incident nuk u vra. E.S nuk u hakmor dhe disa vite më vonë, ky incident i atribuohet të akuzuarit E si motiv për vrasjen e T.R. Në vazhden e kësaj mbrojtja mohon motivin edhe për ngjarjen e “S.Casinos” dhe A.I. Për rastin e “S. Casinos” *“Edhe atëherë edhe sot E.S nuk e ka shfajësuar të ndjerin nga pjesëmarrja e tij në rrahje ndaj të akuzuarit, porse gjithnjë ka theksuar se incidentin e ka filluar dhe shkaktuar A.S, dhe se i ndjeri T.R e ka goditur atë.”*

Fillimisht lidhur me rastin e Ferizajit dhe faktin se mbrojtja nuk i merr për bazë dëshmitë e dëshmitarëve B.H dhe Sh.Q pasi të njëjtat i trajton si jo objektive, kjo gjykatë tërheq vëmendjen se gjykata nuk u'a ka falur besimin dëshmive të dëshmitarëve si të vetme për aq kohë sa të njëjtat fragmente nuk janë mbështetur edhe nga dëshmitarë të tjerë, përveç rasteve specifike që ka mundur t'i sheh vetëm ndonjë dëshmitar okular, por me kusht që paraprakisht pjesa tjetër e deklaratës së tij ka qenë në përputhje me provat e tjera e për çka për gjykatën pastaj ka qenë e besueshme. Sa i përket rastit të Ferizajit, se E.S kishte fajësuar për këtë T.R, nuk vërtetohet vetëm nga dëshmia e dëshmitarit Sh.Q, por një fakt të tillë e potencon edhe dëshmiari R.B, dëshmitar i

propozuar nga mbrojtja, i cili kishte specifikuar se kishte kërkuar të dëshmonte në gjykatë pikërisht për faktin se Rasti Ferizajit ishte iniciuar nga T.R. Pra kjo ishte narrativa që ishte krijuar, se prapa sajë ishte T, e që lidhet pastaj drejtpërdrejt me deklarin e dëshmitarit Sh.Q e që qon edhe në një motiv tjetër hakmarrës të tani të akuzuarit ndaj tani të ndjerit.

Lidhur me çështjen e motivit përkitazi me dëshmitaren A.I, gjykata do të jap sqarime në vijim pasi që këto çështje janë ngritur edhe në pikat e radhës nga mbrojtja, ndërsa sa i përket rastit të “S.Casinos” tani pretendimet e mbrojtjes janë në kundërshtim me pretendimet e vet të akuzuarit, për faktin se në shqyrtimin e fundit gjyqësor të mbajtur para këtij trupi gjykues, vet i akuzuari ka mohuar të ketë pasur ndonjëherë probleme me T.R, madje sipas versionit të tij ai ishte mirënjohës ndaj T, sepse T, i’a kishte shpëtuar jetën. Këto fragmente të tani të akuzuarit janë thjeshtë një përpjekje e inskenuar e radhës për tu shmangur nga konfliktet me T, e në këto formë të shmangë motivin për vrasjen.

Në fakt, konflikti i “S.Casinos” në rrjedhën e ngjarjes nga provat e administrura, rezulton të jetë një hap drejt eskalimit të konfliktit, ku kishte plagosje e rrahje, por edhe rrezikim për jetën e personave e që ky konflikt vinte pas lidhjes së A, me T, e që paraprakisht kishin filluar përcjelljet intenzive ndaj T, e edhe djegia e veturës. Në këtë kontekst, në bindjen e trupit gjykues, rasti “S.Casinos” ishte motivi i radhës që qoi në vrasjen e T.R, pikërisht për shkakun se gjatë konfliktit tani i ndjeri edhe e kishte rrahur tani të akuzuarin, me ç’ rast i njëjti kishte marrë trajtim në spital.

7. Më tutje mbrojtje ka ngritur disa çështje që lidhen me motivet e kryesit, përkitazi me dëshmitaren A, ku mbrojtja ka potencuar se ska mujt me qenë si motiv xhelozie i E.S se e njëjta para se me qenë në lidhje me E ka qenë edhe me një person tjetër në lidhje po që të njëjti si ka ndodhur asgjë. Ka shtuar se as nëna e A, as motrat skanë treguar ndonjëherë se e njëjta ka vuajtur nga E, ose nëse ju ka ndodh diçka e keqe.

Në fakt, pretendimet e mbrojtjes nuk gjejnë mbështetje pikërisht në deklaratat e vet dëshmitarëve në të cilat thirret mbrojtja. Pikërisht nga dëshmitaret M, e Z.I, gjykata ka vërtetuar gjendje faktike tjetër nga ajo që po specifikon mbrojtja. Pikërisht nga këto dy dëshmitare është specifikuar fakti se A kishte afërsi me E.S dhe se në atë periudhë kohore ajo ishte e shqetësuar dhe e pa lumtur. Ky ishte konstatimi i dëshmitarëve të lartcekura dhe jo ajo që pretendon mbrojtja. Më tej dëshmitarja M, specifikon se vetëm pse A, kishte incizuar këngë me G.S, kishte qenë pikërisht “Grupi S” që i’a kishte shpuar gomat e veturës, që flet haptazi për një fakt se kush i afrohej A.I vinte hakmarrja nga E.S dhe grupi i tij, andaj pretendimet e lartcekura të mbrojtjes, nuk gjejnë mbështetje në këto deklarata, në fakt deklaratat vërtetojnë të kundërtën e pretendimeve të mbrojtjes.

Dëshmitarja Z.I madje kishte specifikuar se vetëm atëherë kur A, kishte filluar lidhshmërinë me T, e njëjta ishte bindur se tani A, ishte shkëputur përfundimisht nga E.S. Pra shkak thelbësor që kishte mundësuar shkëputjen e A, nga E ishte pikërisht T.R e që qon haptazi pastaj në eskalim të konfliktit, që vërtetohet nga rrjedha e intensifikimit të përcjelljeve, kërcënimeve, djegies së veturës e atentateve e që shpërfaq haptazi motivin për hakmarrje.

8.Mbrojtja e të akuzuarit ka ngritur edhe një çështje tjetër, duke theksuar se pika I dhe II e aktakuzës fillimisht sipas Prokurorisë kanë pasur ndërlidhje për shkak të zhvatjes së A. Po pasi që pika II zhvatja dhe detyrimi nuk ekzistojnë, atëherë çfarë ndodh me pikën I të aktakuzës të nxitjes ku e gjen mbështetjen. Ka shtuar që A, asnjëherë ska kërku mbrojtje nga T, po ndoshta T, e ka gjete si pretekst përmes motrës së A, E, t’i afrohet A,, ajo ishte një lloj vardisje apo pretekst i një të riu për të ndërtuar një raport me femër të parapëlqyer. Lidhur me përndjekjet ka shtuar se pse ka pasur nevojë i ndjeri T, t’i tregoj A, qoftë për të akuzuarin, qoftë këdo nga familja e tij, kur ajo më herët se të ndjerin i kishte njohur ata, pastaj përse ata të dy së bashku si çift në

lidhje nuk kishin bërë asnjë ankesë të vetme apo paraqitje zyrtare në stacion policor se ndjeheshin të kërcënuar se janë të përcjellë dhe se thjeshtë po i bezdisnin, sepse kjo ska ndodh fare.

Kjo gjykatë specifikon faktin se, gjykata tani nuk e ka objekt trajtimi çështjen e detyrimit, andaj edhe nuk do të lëshohet në këto specifika dhe se problemet e E.S ndaj T.R, për A.I nuk lidhen domosdoshmërisht me zhvatje apo detyrim, por edhe me lidhshmërinë që kishte A me E lidhshmëri kjo e specifikuar – konstatuar nga dëshmitarët M, e Z I, që u elaborua edhe më sipër. Mbrojtja pretendon se T, s’kishte pse ta merrte A, në mbrojtje. Por fakti se edhe vet familja I, kishin pasur probleme me E.S dhe grupin e tij e kishte specifikuar edhe vetë dëshmitarët Z, e M.I, ndërsa vetë dëshmitarja A.I kishte paraqitur raste në polici.

Fakti se A ishte e shqetësuar dhe e pa lumtur në kohën kur ishte afër E.S, tani u konstatua më lartë në përgjigjet e gjykatës në pretendimet e mbrojtjes, andaj ishte pikërisht T, që e kishte shkëputur nga këto çështje.

Mbrojtja specifikon se nuk kishte nevojë t’i tregonte T, A për të akuzuarin, sepse ajo i njihte më herët ata. Në fakt të dy palët kishin probleme edhe paraprake, ndërsa problemi eskaloj pikërisht kur T hyri në lidhje me A.

Mbrojtja specifikon se përcjelljet, kërcënimet dhe bezdisjet nuk kanë ndodhur fare, sepse po të ndodhnin do të raportoheshin. Tani këtu kemi një çështje që duhet specifikuar. Kur rastet kanë qenë të raportuara, mbrojtja specifikon se ato nuk i kishte kryer E.S, pra as në “S.Cassino”, as te rasti i djegies së veturës, as në raste të tjera të raportuara. Kur ato nuk janë raportuar, mbrojtja specifikon se sikur ishin të vërteta ato do të raportoheshin. Atëherë cili duhej të ishte standardi. Kjo gjykatë konstaton se, fakti që T.R ishte përcjellë, e kërcënuar në vazhdimësi nga E.S dhe grupi i tij tani është vërtetuar pa mëdyshje nga kjo gjykatë nga provat e administruara, respektivisht dëgjimi i dëshmitarëve Sh.R, V.R, G.H, B.Sh, B.H, A.S, A.I, Z.I, F.Sh. Pra të gjithë ishin në dijeni për konfliktin dhe të gjithë japin specifikat për kërcënimet, përcjelljet e atentatet, dhe se gjykata konkludimet nuk i ka nxjerrë në bazë provave të izoluara (rrëfimeve të ngjarjeve vetëm nga një dëshmitar), por konkludimet janë nxjerrë nga lidhshmëria e deklaratave të dëshmitarëve mes veti dhe se kur ato kanë qenë identike për faktet konkrete, gjykata vetëm atëherë u’a ka falur besimin.

Gjykata më sipër ka argumentuar për secilin dëshmitar se çka është vërtetuar me deklaratat e tyre dhe pse i’a ka falur besimin gjykata, e për më tepër në vijim të arsytimit të këtij aktgjykimi, gjykata edhe njëherë do të argumentoj se ku e mbështet gjykata çdo kërcënim, përndjekje e atentat të E.S ndaj T.R, andaj konstatimet e tilla janë nxjerrë nga provat e administruara qoftë personale qoftë materiale.

9.Mbrojtja ngriti çështjen edhe për dëshminë e dëshmitarëve te prokurorisë A, M, Z, dhe E.I pastaj B.M, F.M, sikurse edhe të dëshmitares A, rastësisht të gjitha femra, janë dëshmitare vërtetë të frikësuar, kërcënuara dhe maltretuara ashtu siç kanë deklaruar ato drejtpërsëdrejti, sepse sipas deklarimeve të tyre, këto u’a kishte shkaktuar ish hetuesi B.O, këtë nuk e ka shpikur mbrojtja.

Ky pretendim i mbrojtjes, nuk mbështet në deklaratimet e dëshmitareve të cilat mbrojtja i specifikon. Dëshmitarët A, M, Z, dhe E, I, asnjëherë nuk kanë thënë se dëshmitë e tyre janë marrë duke u kërcënuar apo frikësuar, madje dëshmitarja Z.I mbështet secilin deklaram të saj, andaj një argument i tillë nuk qëndron.

Sa i përket dëshmitarëve B.M, F.M dhe dëshmitares A, kjo gjykatë konstaton se është fakt se deklaratat e tyre pësojnë ndryshime, ashtu siç pësojnë ndryshime edhe deklaratat e A.B, deklaratat e N.S, por edhe deklarata e vet të akuzuarit E.S.

Kjo gjykatë më sipër për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi, ka argumentuar se secila deklaratë e personave që kanë pasur lidhshmëri me E.S e që janë dëshmitarët e lartcekur, kanë pretenduar

se deklaratat e tyre janë marrë me kërcënim, por të gjitha deklaratat e tyre fillestare janë në përputhje të plotë me provat e tjera të administruara qoftë personale, qoftë materiale e ku te se cili nga këta dëshmitar kur dëshmitë e tyre janë elaboruar më sipër kjo gjykatë ka dhënë argumentet e veta. Më tej të gjithë këta dëshmitar përgjatë gjykimeve kur kanë kuptuar tezën e akuzës janë munduar të shtrembërojnë vet deklaratimet e tyre, por në kundërshtim edhe me vetveten edhe me provat e tjera të administruara. Deklaratat e tyre ndryshojnë varësisht nga rrjedha e gjykimit dhe duke u munduar në veçanti qoftë të shmangin raportin mes E.S e A.B, qoftë A.B me pjesën tjetër të grupit, e pastaj E.S mbase duke e ndryshuar deklaratën e tij të dhënë për rastin “S.Casino” pretendon të shmang edhe konfliktin me T.R duke pretenduar se nuk kishte ndodhur asnjëherë.

Andaj, pretendimet e mbrojtjes se dëshmitaret A, M, Z, dhe E.I kanë qenë të kërcënuara nuk qëndrojnë, ndërsa ndryshimet e deklaratave të dëshmitareve tjera të lartcekurve janë bërë me qëllim të mjegullimit të rrjedhës së ngjarjes, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale e tani të akuzuarit.

Kjo gjykatë specifikon faktin se, dëshmitaret kur merren ne pyetje fillimisht njoftohen me të drejtat e tyre e për më tepër njoftohen edhe mbi të drejtën për të shënuar vërejtjet, gjë që nuk ka ndodhur dhe dëshmitaret kanë nënshkruar se mbështesin dëshminë e tyre. Për më tepër, rruga ligjore që mund të ndjekë se cili dëshmitar me mos trajtim adekuat për gjatë trajtimeve të tyre nga organet e rendit janë rrugët ligjore që duhet ndjekur, e që në rastin konkret nga as edhe njëra dëshmitare nuk ka ndodhur nje reagim i tillë, andaj në këtë kontekst, pretendimet e ngritura nga mbrojtja lidhur me këtë çështje nuk bazohen në argumente faktike e ligjore.

10.Një nga çështjet thelbësore që mbrojtja i kishte potencuar për gjatë gjithë rrjedhës së ri-gjykimit, por edhe për gjatë fjalës përfundimtare, kishte të bënte me vërejtjet që i kishte dhënë Gjykata e Apelit lidhur me provat materiale për hartografin edhe bastisjet e ku mbrojtja ka ofruar argumentet e tyre ligjore.

Kjo gjykatë veç se ka akceptuar vërejtjet e Gjykatës së Apelit dhe pretendimet e mbrojtjes, andaj me që gjykata tani aktgjykimin e vet nuk e ka mbështetur në këto prova, atëherë nuk do të lëshohemi më tej në elaborimin e këtyre pretendimeve të mbrojtjes, pasi që gjykata lidhur me këto prova veç se ka dhënë argumentet lidhur me mos mbështetjen e tyre në dispozitat përkatëse ligjore.

11.Mbrojtja ka trajtuar edhe deklaratën e dëshmitarit D2 ku për të njëjtin ka theksuar” Sa i përket dëshmitarit D2, i njëjti e ka gënjyer gjykatën kinse 19 ditë pas ngjarjes kritike, ai ka shkuar vullnetarisht në polici për të dhënë deklaratë vullnetare lidhur me ngjarjen kritike. Ky pretendim i mbrojtjes vërtetohet me faktin se në bazë të raporti policor të M.K, rezulton se policia e kishte zbuluar dhe kontaktuar këtë dëshmitarë më datën 3 Shtator 2007, por aso kohe ishte e qartë se ky dëshmitar nuk dinte asgjë me relevancë rreth rastit. Në raportin policor përmbledhës të datës 6 Dhjetor 2007, policia kishte paraqitur Drejtorisë për Krime Serioze analizën e tyre duke përfshirë 9 deklaratat me shkrim të 9 të dyshuarve, 23 deklaratat të dëshmitarëve dhe dy deklaratat të dëshmitarëve të mbrojtur me kodet D1 dhe D3, shtrohet pyetja përse këtë nuk ishte përfshirë dëshmitari D2, nëse do të ishte me relevancë deklarata e tij 19 ditë pas ngjarjes kritike. Tjetra, sikurse ky dëshmitar të ishte i vërtetë dhe të ekzistonte kjo sajesë e tij si një deklaratë e vërtetë qysh në vitin 2007, atëherë shtrohet pyetja, përse ky dëshmitar dhe dëshmia e tij pra, nuk u propozuan nga prokurori i parë R.M në gjykimin kundër A.B dhe më tutje Rr.A, deklarata apo ky dëshmitarë as që ka ekzistuar në shkresat e lëndës të njërit apo tjetrit të akuzuar, respektivisht të dënuar.

Rrethana tjetër lidhet me deklarimin e dëshmitarit M.K i cili është pyetur nëse dëshmitari D2 të kishte deklaruar në shtator 2007 kur e keni intervistuar se kishte qenë prezent në lokalitë e S, dhe

që kishte dëgjuar E duke dhënë urdhër si të veprojnë dhe duke i bartur për të kryer aksionin - a do ta kishit konstatuar këtë në raportin policor – I njëjti është përgjigjur se: po, natyrisht, sepse kjo do të ishte shumë e rëndësishme. Pjesa tjetër ka të bëjë me deklarinimin e dëshmitarit D2 i cili ka deklaruar “ishte ora 14:00 apo 14:10 kur dëgjova se polici T.R është vra, dhe kjo është arsyeja se përse unë paraqita për të dëshmuar, sepse ishte vra një polic i mirë i Kosovës”. Përse ky dëshmitar nuk e paralajmëroi këtë para se të ndodhte? Madje kishte mundur edhe ta parandalonte pra, e më pastaj përse ai nuk e raportoj në deklaratën e tij të 19 Shtatorit 2007, natyrisht e vërteta është se dëshmitari D2 nuk ka parë asgjë nga ato që ai ka sajuar 8 vite më vonë.” Tutje pretendimi i saj për A.B që e ka parë kinse tu vozit veturën “Pick up” të bardhë dhe të kuqe, e njëjta ka shtuar se D2 e ka gënjyer gjykatën, sepse A.B nuk ka punuar fare për “B Kafe”, A, ska posedu fare leje të vozitjes. Argumenti tjetër ka të bëjë me deklarinimin e dëshmitarit D2 i cili ka deklaruar se kinse ai i kishte pa ditën kritike, para dhe pas ngjarjes dhe në pyetjen e mbrojtjes se përse nuk e ka deklaruar këtë në polici, ai ishte përgjigj nuk më ka ra në mend, dhe nuk ka çka të flitet më tepër për këtë dëshmitarë dhe dëshmitë e tij. Do të ishte shokuese nëse trupi gjykues do të mund t’i besonte një sajese të tillë aq qesharake dhe sureale.

Fillimisht lidhur me rrjedhën procedurale se kur, si dhe pse është marrë në pyetje dëshmitari D2, kjo gjykatë konstaton se kanë qenë gjykatat e rregullta që e kanë marrë në pyetje në cilësi të dëshmitarit tani të njëjtin, ndërsa tani këto deklarata janë pjesë përbërëse të shkresave të lëndës, përbëjnë provë të rregullt dhe është në diskrecionin dhe bindjen e lirë të trupit gjykues t’i fal ose jo besimin.

Sa i përket çështjeve specifike që ka prekur mbrojtja në dëshminë e dëshmitarit, fillimisht kjo gjykatë specifikon se fakti se E.S ditën kritike ishte në “Bar S” nuk është thënë vetëm nga dëshmitari D2, por edhe nga vet dëshmitari A.B në deklaratat e tij fillestare e pastaj pohuar edhe nga vet E.S. Fakti se A.B ishte takuar me E.S atë ditë, nuk e kishte përmendur vetëm dëshmitari D2, por e kishte përmendur vet A.B në deklaratat e tij fillestare e pastaj mundohet të shmang raportin me tani të akuzuarin.

Fakti se A.B kishte vozitur veturën “PickUp” të “B/Kafe” nuk e përmend vetëm dëshmitari D2, por edhe dëshmitari F.Sh i cili kishte edhe afërsi me të akuzuarin E.S dhe njihte mirë edhe personat që identifikoheshin si “grupi S”, e ku dëshmitari F, kishte specifikuar se pikërisht A.B kishte vozitur veturën “PickUp” të “B.Kafe”. Andaj, sa do që për mbrojtjen mund të jetë shokuese konkludimi se trupi gjykues mund t’i fal besimin dëshmitarit të lartcekur, trupi gjykues i ka falur besimin vetëm në fragmentet që gjejnë përputhje të plotë me deklarinimet e dëshmitareve të tjerë edhe në këtë formë kur dëshmia e tij përputhet në mënyrë identike me deklarinimet e dëshmitarëve të tjerë, atëherë e njëjta deklaratë krijon kredibilitetin, me ç’rast gjykata krijon pasqyrë të qartë në bindjen e vet mbi gjendjen faktike.

12.Mbrojtja në fjalën përfundimtare ka trajtuar edhe deklarinimet e dëshmitarit A.S. Pretendimet lidhur me atë se A.S nuk ka njohuri se kush e ka vrarë T, por e din se kush ka orkestru vrasjen. Mbrojtja më tej specifikon se dëshmitari përmend mbledhjen me Z.M.Sh, e që A se mban mend as kush ka marr pjesë në këtë mbledhje. Mbrojtja specifikon lidhur me pretendimi lidhur me atë kinse Sh, i ka njoftuar se kanë përgjuar E.S dhe e kanë dëgjuar se do t’i vras dhe as nuk e arrestojnë policia e UNMIK-ut për një kërcënim kaq serioz, as nuk janë siguruar kurrë këto përgjime, por e tëra që ky Sh, ka bërë ka qenë propozimi që A dhe i ndjeri të ndërrojnë vendbanim. Mbrojtja po ashtu ka ngritur çështjen se A ska qenë në rrjedha të gjykimit dhe nuk është interesuar të paraqitet para organeve të drejtësisë.

Fillimisht gjykata do të specifikoj një rrjedhë të shkurtë se si ka ardhur deri tek aprovimi i propozimit të prokurorisë speciale që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet tani dëshmitari A.S. Ka qenë vet i akuzuari, që në mbrojtjen e tij ka përmendur disa herë tani dëshmitarin e po ashtu ka

përmendur edhe faktin se pse i njëjti nuk ka dëshmuar dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë prokuroria e kishte propozuar dhe gjykata e kishte aprovuar.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit A, edhe sa i përket këtij dëshmitari, gjykata i ka falur besimin si çdo dëshmitari tjetër vetëm në faktet që provohen edhe nga dëshmitarë të tjerë.

Në këtë kontekst, është fakt se dëshmitari A.S ishte një nga personat më të afërm të tani të ndjerit T, dhe i njëjti dinte çdo problem të tij, respektivisht i dinte të gjitha kërcënimet, përndjekjet e atentatet që i ishin bërë T, e të cilat deklarime të këtij dëshmitari gjenin mbështetje në provat e administruara paraprakisht. Pra dëshmia e këtij dëshmitari, vetëm se kishte fuqizuar deklaratimet e dëshmitareve të tjerë, por gjykata i ka falur besimin vetëm mbi fragmentet e gjendjes faktike që gjejnë përputhje edhe me provat e tjera të administruara e të cilat i ka elaboruar më sipër në detaje kjo gjykatë për gjatë arsytimit të këtij aktgjykimi, por asnjëherë nuk i ka falur besimin kjo gjykatë as edhe një dëshmitari, si dëshmi të vetme, përveç rasteve specifike që u theksua më sipër kur vetëm një dëshmitare ka parë një fakt specifik por që domosdoshmerisht lidhet me rrjedhën e ngjarjes dhe me besueshmërinë e dëshmitarit përkitazi me faktet tjera që bëhen të besueshme nga provat tjera.

13. Mbrojtja e të akuzuarit kishte propozuar në cilësi të dëshmitarit, dëshmitarin Gj.K. Lidhur me deklaratimin e Gj.K sipas mbrojtjes, ky dëshmitar demanton tërësisht deklaratën e A.S Mbrojtja specifikon që i ndjeri T, dhe A, e kanë dërguar Gj.K si ndërmjetësues për t'i kërkuar falje dhe pajtesë E, ku dy policët elitarë të cilët zyrtarisht kanë deklaruar se ishte E, ai i cili e ka planifikuar dhe ka filluar sulmin ndaj tyre, ndërsa privatisht e dërgojnë Gj.K që ti kërkoj falje. Mbrojtja ka specifikuar se fakti më i rëndësishëm për të cilën Gj.K dëshmoj për këto rrethana ishte: Gj.K, kishte shkuar tek E.S dhe ai i ishte përgjigjur “Gj. si i fala si nuk i fala ata janë shtet dhe si shtet ma kan bo dhe une me shtet kom me i ndjek”, pra E.S nuk i'a kishte falur “shtetit” dhe këtij “shteti” pretendon të ti përgjigjej me “shtet”, pra me organe të drejtësisë dhe me një proces dhe ferr dhe të drejtë gjyqësorë, të cilin nuk arriti kurrë ta realizonte.

Gjykata konstaton se në parim, dëshmitari A.S nuk ishte që kishte mohuar se kishte pasur njerëz që ishin përfshirë për të ndihmuar për këtë rast, por ishte shmangur të fliste specifikash për tani dëshmitarin Gj.K. Në fakt, dëshmitari Gj. më shumë demanton mbrojtjen e të akuzuarit se sa deklaratën e dëshmitarit A, për faktin se i akuzuari specifikonte se T i'a kishte shpëtuar jetën dhe kurrë nuk kishte pasur asnjë problem me T, e në anën tjetër dëshmitari specifikonte se E, i kishte thënë se T, e ka rrahur gati deri në vdekje dhe pse ma bënë këtë, e në anën tjetër i akuzuari specifikon se kurrë nuk i'a ka thënë askujt këtë fjali. Pra tregimi i dëshmitarit Gj, është i kundërt me tregimin e të akuzuarit.

Mbrojtja pretendon se konfliktin e kishte iniciuar A.S, por nga shkresat e lendes të rastit “S.Cassinos” që janë administruar si prova materiale në shqyrtim gjyqësor, (rast qe ende nuk ka marr epilog) rezulton se konflikti ishte nisur nga E.S dhe se A.S ishte me familjar të vet dhe pastaj kishte eskaluar gjithçka, ku vetë T. konfirmon se e kishte goditur dhe ishte rrahur me E, por pasi që paraprakisht aj dhe njerëz të tij i kishin sulmuar.

Dëshmitari Gj.kishte shkuar t'i pajtonte sipas adeteve dhe jo sipas ligjit, fillimisht shtrohet pyetja se pse duhet ta pajtonte dëshmitari Gj. edhe T me E, po që se sipas versionit të E, ai nuk kishte kurrë probleme me T, dhe se T,i'a kishte shpëtuar jetën.

Në anën tjetër a i kishte falur E.S, ishte pyetje insistuese e trupit gjykues në shqyrtim gjyqësor për të marr një version me po ose jo nga dëshmitari në idenë se ke shkuar për t'i pajtuar dhe për t'i falur E, ata, a i pajtove dhe a i fali, përgjigja dëshmitarit ishte jo.

Në këtë kontekst edhe njëherë vërtetohet fakti se konflikti i “S. Cassinos” ishte një eskalim i konfliktit që kishte marr një trajtë tjetër e që do të vazhdonte si i tillë deri në privimin nga jeta të tani të ndjerit T.R, pasi fakti që E.S nuk ia kishte falur, vërtetohet nga rrjedha e ngjarjeve në vijim.

Faktet e vërtetuara-Lidhshmëria e provave që qojnë në faktin se i akuzuari ka shtytur A.B të kryej vrasjen

Për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë ka dhënë sqarime veç e veç për secilën provë dhe lidhshmërinë mes tyre për faktet të cilat vërtetohen. Fillimisht vetëm do të konstatohen edhe njëherë në pika të shkurta çështjet që i ka vërtetuar kjo gjykatë, pasi që sqarimet e detajuara janë dhënë më herët tek vlerësimi i provave.

Gjykata ka vërtetuar se konflikti i parë mes E.S dhe T.R kishte ndodhur në periudhën e vitit 2000-2001, kur T.R kishte filluar punën si zyrtar policor dhe fakti se po zbatonte ligjin edhe ndaj tani të akuzuarit E.S, për këtë shkak ishte kërcënuar-sulmuar me granate dore nga tani i akuzuari, fakt ky i vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarëve Sh.Q, V.R, G.H, B.Sh, B.H, Sh.Q

Gjykata ka vërtetuar se pas këtij konflikti të parë, ndaj T.R kishin filluar përcjellje të “grupi S”, e po ashtu këto përcjellje ishin shoqëruar edhe me shfryrje e shpërthim gomash, gjë që vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve G.H, B.H, e A.S.

Kush ishte i ashtuquajtur “grupi S”: Kjo gjykatë, sqaron se emërtimi i ashtuquajtur “grupi” S, rrjedhë nga përshkrimi i dëshmitarëve – pra fakteve që ka vërtetuar kjo gjykatë. Pra kjo gjykatë nuk i referohet këtij grupi si një grup kriminal i organizuar, në kuptim të veprave penale të krimit të organizuar (sa i përket objektit të çështjes), por i referohet si emërtim siç ata njiheshin nga të gjithë dëshmitarët. Grupi i ashtuquajtur S, ishte një grup personash që rrinin e identifikoheshin së bashku që kishin biznese, por në të njëjtën kohë ishin persona të njohur për organet e rendit dhe për dëshmitarët, që kishin të hapura precedentë penale aso kohe dhe kush do që punonte me ta e për ta pastaj identifikohesh si pjesë e grupit. Personi kryesor ishte E.S dhe se të tjerët vepronin sipas kërkesave të tij. Ky fakt vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve A.C, Sh.R, V.R, B.Sh, B.H, Sh.Q, M.K, A.I, E.I, Z.I, A.S

Gjykata ka vërtetuar faktin se, E.S kishte raporte të afërta me dëshmitarën A.I dhe se atë periudhë dëshmitarja ishte e shqetësuar dhe e pa lumtur dhe se shkëputja e saj përfundimtare kishte ardhur për shkak të T.R, fakt që vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve, Sh.Q, Z.I. Ky fakt tani rrit rivalitetin e të akuzuarit ndaj të ndjerit me ç’ rast edhe konflikti ashpërsohet.

Gjykata ka vërtetuar se pas lidhjes së T. me A, E.S me njerëz të grupit të tij e shumicën e rasteve me Rr.A (Rr) dhe I.A (L) e kishin përcjellë e përndjekur T, në shumë raste e disa nga këto që citohen e identifikohen ishin një rast në rrugës për në V.. kur T, ishte me familjarët e tij, rasti tek lagja Q. dhe rasti tek lagja T. ku ishte përcjellë i njëjti deri sa ishte bashkë me tani dëshmitarën A. Më tej të njëjtit ishte djegur vetura e tipit “Land Rover” dhe të gjitha këto vinin nga E.S dhe njerëz të tij, fakt që vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve Sh.R, V.R, A.I, Sh.Q, B.Sh por edhe paraqitja e rasteve në organet e rendit.

Lidhshmëria e T.R me A.I ishte një motiv i radhës për hakmarrje.

Gjykata ka vërtetuar se në vazhden e përcjelljeve e konflikteve, në fund të vitit 2005 ndodh konflikti i njohur si “S.Cassino”, rast ky që qon në një dimension tjetër konfliktin, që përshkallëzon problemin, ku ky rast pikërisht ndodh për shkak të konfliktit në mes E.S e T.R, rast në të cilin kishte të shtëna armësh, plagosje e rrahje masive. Fakt ky që vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve Sh.R, V.R, Sh.Q, B.H, G.H, A.S, E.I, A.I, Z.I. Kjo gjykatë vërteton

faktin se rasti i lartcekur ndodh rreth tre muaj pasi që i ndjeri kishte filluar lidhjen me tani dëshmitaren A, e ku paraprakisht intensiteti i sulmeve ndaj T, ishte shtuar ku i njëjtit nga “grupi S,” përcillej me vetura të blinduara e me skuter, e ku u specifikua që të ndjerit i ishte djegur edhe vetura, ndërsa pastaj kishte eskaluar “Rasti S. Casiono” e krejt kjo në vazhden e konfliktit të vazhdueshëm.

Rasti “S. Casinos” ishte një motiv i radhës i të akuzuarit për hakmarrje pasi që i njëjti në këtë konflikt ishte rrahur dhe ishte shtrirë në spital, që rivaliteti i të akuzuarit me tani të ndjerit rritej.

Gjykata ka vërtetuar se kishte ndodhur një konflikt në mes Njësisë Speciale në Ferizaj dhe E.S në vitin 2006, ku E.S për këtë ngjarje akuzonte T.R. Fakt ky që vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarëve Sh.Q dhe R.B

Gjykata ka vërtetuar se kohët e fundit, pra para vrasjes së T, i njëjti ishte shumë i shqetësuar dhe i frikësuar nga intensifikimi i përcjelljeve e i përndjekjeve nga E.S dhe grupi i tij pak para vrasjes, e ku nga këto arsye edhe shumicën e kohës për shkaqe sigurie e kalonte në fshatin S. Gjykata ka vërtetuar se pikërisht rreth dy javë para vrasjes, T organizohet atentat pikërisht në fshatin S. Faktet e lartcekura janë vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve Sh.R, V.R, G.H, B.Sh, A.I, A.S Sh.Q.

Gjykata ka vërtetuar se në shumicën e përndjekjeve ndaj T, protagonist ishin E.S me Rr.A (Rr) dhe I.A (L) e që rezulton se një ndër personat më të afërm të E.S ishin dy të lartcekurit, fakt i vërtetuar nga Sh.R, V.R, A.I, por edhe nga provat materiale të sms-ve që shihet mënyra e komunikimit mes të lartcekurve në përcjelljet që i bëheshin tani të ndjerit.

Gjykata ka vërtetuar se, tri ditë para vrasjes së T, i njëjti ishte në përcjellje të “grupit S”, respektivisht nga I.A me nofkën (L), A.B e Rr.A me nofkën (Rr) e ku ky i fundit për këtë i raportonte E.S, ky fakt vërtetohet nga prova materiale, respektivisht sms-t e elaboruar.

Gjykata ka vërtetuar, se ditën kritike A.B (dorasi), është takuar me E.S në “Kafe Bar S, dhe nga aty ka dalë me R.A (Rr) e I.A (L) ku ishin gjatë gjithë ditës në përcjellje të T, e ku i përfshirë ishte edhe F.A tani i dënuar në përfshirjen në vrasjen e T.R, po ashtu punëtor i E.S. Fakte këto të vërtetuar nga vet deklaratat e dëshmitarit A.B, por konstatuar edhe në rrjedhën e ngjarjes në aktgjykimin e lartshënuar të Gjykatës Supreme.

Gjykata ka vërtetuar se, vrasja nuk ishte e rastësishme, por ishte e planifikuar e nën përcjellje e pritje të T deri në ekzekutim, fakt ky i vërtetuar nga kjo gjykatë në bazë të provave personale e materiale të elaboruara më sipër, tani i konstatuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme me shenjën API.nr.9/2011 të datës 09.02.2012.

Gjykata ka vërtetuar nga dëshmitari Gj.K se i akuzuari E.S e udhëhiqte biznesin “B. Kafe” por pohuar edhe nga vet i akuzuari, e po ashtu i akuzuari bashke me vëllain e tij udhëhiqte edhe biznesin “Kafe Bar S” fakt ky po ashtu i pohuar nga i akuzuari.

Këtë fakt e potencon kjo gjykatë për faktin se bizneset jo gjithëherë ishin në emirin e të akuzuarit, megjithatë ai i udhëhiqte të njëjtat, fakte këto tani jo-kontestuese pasi që vet i akuzuari i ka pohuar.

Gjykata ka vërtetuar se, A.B ishte pjesë e të ashtuquajturit “Grupi S”, dhe punëtor i firmës që udhëhiqte E.S “B.Kafe”, që shpërfaq lidhjen e të akuzuarit me dorasin dhe ndikimin që i akuzuari kishte tek ai. Gjykata ka vërtetuar se periudhën para vrasjes së T, A ishte vazhdimisht pjesë e

grupit dhe qëndronte në vazhdimësi në “Kafe Bar S” e po ashtu shoqërohej në vazhdimësi me dy personat më të afërm të E, Rr.A (R) dhe I.A (L). Fakt se i njëjti vozite veturën “B.Kafe” ky fakt është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve F.Sh, M.K, Z.I dhe dëshmitari D2, ndërsa fakti se ai shoqërohej në vazhdimësi me Rr.A e I.A vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarit F.Sh, K.B, por pastaj nuk e mohon as vet A.B, por një fakt i tillë vërtetohet edhe nga komunikimet me sms.

Gjykata ka vërtetuar se, presoni tjetër i dënuar tani për vrasjen e T, F.A ishte po ashtu punëtor në “Kafe Bar S”, fakt ky që vërtetohet nga vet deklarimi i F.A, por edhe i dëshmitarit N.S

Gjykata ka vërtetuar se, A.B nuk kishte asnjë motiv personal për vrasjen e tani të ndjerit dhe se pretendimet e tija se kishte pasur ndonjëherë problem me T. rezultojnë të pa-mbështetshme në asnjë provë dhe fakti se deklarimi i tij është i pa vërtetë rezulton nga vet rrjedha e ngjarjes dhe konstatuar edhe nga aktgjykimi i gjykatës Supreme, me shenjë AP.nr.336/2010 të datës 28.04.2011, ku është konstatuar se vrasja nuk ishte e rastësishme siç pretendonte A, por e organizuar deri në detaje, andaj gjykata ka konstatuar se nuk është vërtetuar asnjë motiv i A.B që do të qonte në motivin për vrasjen e T, dhe një pretendim i tillë nuk gjen mbështetje në asnjë provë të vetme.

Gjykata ka vërtetuar se T.R, nuk kishte asnjë problem me askënd tjetër përveç E.S që do qonte në motivin e ndonjë personi tjetër për ta privuar nga jeta tani të ndjerin. Fakt ky i vërtetuar nga se cili dëshmitar i dëgjuar.

Gjykata ka vërtetuar se prapa të gjitha sulmeve, kërcënimeve e përcjelljeve ndaj tani të ndjerit ishte tani i akuzuari E.S, fakt ky i vërtetuar nga dëshmitarët e lartshënuar për të gjitha veprimet me radhë.

Në bazë të provave të administruara, kjo gjykatë ka vërtetuar se vrasja ishte e organizuar dhe këtë vrasje e kishin kryer dy punëtorët e E.S, A.B dhe F.A, fakt ky i vërtetuar nga aktgjykimi i lartshënuar i Gjykatës Supreme.

Në bazë të provave të administruara dhe rrjedhës së ngjarjes, gjykata ka mbyllur qarkun duke përjashtuar çdo mundësi se prapa vrasjes së T do të ishte dikush tjetër, përveç tani të akuzuarit E.S.

Gjykata ka vërtetuar se ditën kritike, E.S ishte takuar me A.B, Rr.A dhe I.A në zyrën e tij, fakt ky i vërtetuar nga dëshmitari D2, por i vërtetuar edhe nga deklaratat e parë e A.B që kishte pohuar se ishte takuar me E.S ditën kritike.

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari E.S duke shfrytëzuar ndikimin që kishte në A pasi që ai ishte punëtor i tij dhe pjesë e grupit, e ka shtyrë të njëjtin në vrasjen e T.R. Pra gjykata ka vërtetuar se E.S për motive personale hakmarrëse, me ndikimin e tij ka shtyrë A.B të kryej vrasjen, konkludim ky i nxjerrë nga gjykata nga rrethanat faktike të rastit në hallkën zingjyrore të pa shkëputur të provave, e ku këto arsye do të specifikohen në vijim:

Kronologjia e rrjedhës së ngjarjes që e ka vërtetuar kjo gjykatë

Nga provat e administruara të cilat tani i ka elaboruar kjo gjykatë, rezulton se E.S për gjatë vitit 2000-2001 pretendonte të ishte i pa preکشëm nga organet e rendit dhe pasi që T me të marr detyrën si zyrtar policor e kishte ndaluar atë, i njëjti e kishte kërcënuar me granatë dore. Pra ky ishte incidenti i parë që kishte filluar armiqësinë dhe rivalitetin mes E.S dhe T.R pasi që tani një zyrtar policor guxonte ta ndalonte E.S. Nga ky moment, T, kishte vërejtur që po përcillej nga E.S

dhe njerëz të tij, ku përcjelljet ishin shoqëruar edhe me shfryrje e shpërthim gomash, kështu në këtë formë ta z'prapsin të njëjtin që mos të zbatonte ligjin karshi E.S. Pra këtu ishte thelbi i konfliktit - rivalitetit dhe motivi i parë.

E.S kishte një raport me A.I, e në kohën e këtyre raporteve e njëjta ishte e shqetësuar dhe e pa lumtur, e në të njëjtën kohë edhe familja e saj kishte disa probleme me të ashtuquajturin “grupi S”. Për gjatë kësaj periudhe, rrjedh fakti se “Grupi S” kishte shpërthyer gomat edhe të veturës së këngëtarit që është cekur më sipër, vetëm pse ai kishte incizuar një këngë me A, që ishte indikacion i qartë se E.S hakmerrej për çështjet që lidheshin me të lartcekurën. Në vazhden e rrjedhës së ngjarjes, në jetën e saj ishte paraqitur tani i ndjeri T.R, për t'i ofruar mbrojtje asaj dhe familjes se saj dhe në këtë drejtim këta të dy fillojnë një lidhje. Lidhja e tyre ishte shkëputja përfundimtare e dëshmitares A, me tani të akuzuarin E. Nga ky moment, rivaliteti rritet, me ç' rast, konflikti i lartcekur mes E.S e T.R kishte filluar të marr një hov tjetër, ku T kishte filluar të përcillej në vazhdimësi nga E.S dhe njerëz që identifikoheshin si persona të ashtuquajturit “grupi S”. Ai përcillej me vetura të blinduara e me skuter, po ashtu përcillej edhe kur ishte me familje, siç është rasti në V, por edhe kur ishte me dëshmitaren A, siç janë rastet tek lagja Qafa e tek lagja T, po ashtu ai përcillej edhe për rreth kafenesë që e frekuentonte më së shpejti “///”.

Në këtë periudhë kohore T, i ishte djegur vetura, nga E.S dhe grupi i tij.

Në vazhden e këtyre përcjelljeve e kërcënimeve, e siç u specifikua më sipër, këto veprime në veçanti kishin marr hov kur T, kishte filluar lidhjen me A.

Në fund të vitit 2005, rreth tre muaj pasi që i ndjeri kishte filluar zyrtarisht lidhjen me të lartcekurën, konflikti i tyre pra mes E. dhe T. kishte eskaluar në rastin e quajtur “S.Cassino”. Në “S.Casino” kishte filluar një konflikt i madh, ku E.S ishte me një numër personash nga grupi i tij dhe T.R e A.S ne anën tjetër. Konflikti kishte eskaluar me të shtëna armësh, me të plagosur e me rrahje masive. Edhe këtu gjithnjë shkak i çdo konflikti ishte E.S dhe T.R dhe në këto rrethana nga provat e rastit “S.Cassino” rezulton se T dhe E, ishin rrahur mes vete madje në disa deklarata E.S specifikon se T, e kishte rrahur atë ditë, e pastaj në shqyrtim gjyqësor pretendon se kurrë nuk ka pasur problem me T. Pra gjykata ka konstatuar se konflikti i “S.Cassinov” ishte edhe një motiv tjetër për hakmarrje, sepse konflikti kishte kaluar në një dimension tjetër pasi që edhe pse nga shkresat e lëndës rezulton se konflikti ishte iniciuar nga vet ai, E.S ishte rrahur deri në alivanosje. Konflikt dhe rrahja në “S.Casino” ne veçanti pasi që rivaliteti i tyre ishte rritur pasi që i ndjeri kishte filluar lidhjen me dëshmitaren A, ishte edhe një motiv për hakmarrje nga i akuzuari, pasi që ai aty ishte rrahur dhe kishte specifikuar se këtë nuk do ta falte.

Përcjelljet ndaj tani të ndjerit vazhdonin, pra dëshmitarët – personat të afërm me T, madje specifikojnë se këto tani ishin të zakonshme, andaj edhe nuk identifikojnë se cilin rast, e ku gjykata i ka konstatuar vetëm ato konkretet e që konfirmohen nga më shumë se një dëshmitar.

Në vazhden e rrjedhës së ngjarjes, kishte ndodhur konflikti i Ferizajit që kishte ndodhur mes Njësisë Speciale atje dhe E.S e ku ky i fundi kishte pretenduar se prapa kësaj çështje qëndron T.R që këto fragmente u nxjerrën më herët nga deklarimi i dëshmitarëve Sh.Q e R.B.

Periudhën para vrasjes, nga dëshmitë e dëshmitareve, rezulton se presioni ndaj T. ishte rritur nga kërcënimet e përcjelljet dhe ishte shumë i shqetësuar dhe se për shkak të këtyre rrethanave i njëjti qëndronte më shumë në fshatin S, pikërisht për shkaqe sigurie dhe këto veprime i ndërmerre pikërisht nga frika se mund t'i ndodh diçka nga E.S, sepse i njëjti nuk kishte ndonjë problem tjetër që e shqetësonte. Fakti se ai ishte në përcjellje gjatë gjithë kohës, rezulton se vetëm rreth dy javë para vrasjes, të njëjtit i organizohet një atentat në fshatin S, ku i qiten gurë e pengesa tjera në rrugë me qëllim që ta rrokullisnin dhe ta privonin nga jeta. Mesazhi ishte i qartë, se po ndërmerrej çdo veprim me qëllim që ta eliminonin. E.S në shqyrtim gjyqësor ani pse mohonte të

ishte i përfshirë në këtë atentat, deklaronte se ky nuk ishte atentat, por kanë mundur këto pengesa të ja qitinin bashkëfshatarët për shkak të kafshëve.

Tri ditë para vrasjes, Rr.A, I.A e A.B, ishin në përcjellje të T.R duke e vështruar çdo lëvizje të tij, e Rr.A i raportonte direkt E.S.

Ditën kritike, A.B, Rr.A e I.A kishin shkuar në “Kafe Bar S” dhe aty ishin takuar me E.S ku i njëjti i kishte mbledhur në takim, ku nga rrethanat faktike të ngjarjes, gjykata nxjerr konkludimin se E.S në bazë të afërsisë që kishte me A.B pasi që i njëjti ishte punëtor i tij dhe pjesë e grupit të tij, duke shfrytëzuar ndikimin e tij tek ai, aty kishte shtytur A.B që përfundimisht ta privonte nga jeta tani të ndjerin, për motive të tija hakmarrëse. Nga “Kafe Bar S” A.B, I.A e Rr.A, kishin dal drejt rrugëtimit të tyre që përfundimisht ta privon nga jeta T.R . A.B ishte i armatosur dhe atë ditë T ishte në përcjellje edhe nga F.A që raportonte se ku e kishte lënë veturën T, dhe se kah po shkonte, e Rr.A e I.A e dërguan A.B tek kafet afër “/” ku rrinte T. Gjykata nuk do të lëshohet më shumë për veprimet e Rr.A e I.A të ditës kritike pasi që këto raste ende nuk kanë marrë verdikt.

A.B ishte i ulur nëpër kafene afër “/” dhe ishte në pritë të T, tani A qëndronte vet në njërin nga kafenetë në pritë dhe pas rreth një orë e dyzet minuta që e kishte pritur, me ta parë T i shkon nga prapa e qëllon dhe e privon nga jeta.

Kjo ishte ngjarja që ka vërtetuar gjykata në fragmente kyqe, që kishte quar deri në vrasjen e të ndjerit.

Kush ishte A.B dhe cili ishte motivi i tij që ta privonte nga jeta T.R.

A.B në deklaratat e tij fillimisht pretendoj se kishte pasur një problem me T.

Deklaratat e tij janë elaboruar e janë nxjerrë përfundimet mbi faktet e vërtetuara, por edhe kundërthëniet dhe kështu duke u konkluduar se A.B nuk kishte asnjë motiv për kryerjen e vrasjes, e në anën tjetër rezultoi se vrasja ishte e organizuar e planifikuar e jo e rastësishme siç pretendonte A.B i cili thoshte se kishte pasur një problem me T, por nuk i kishte treguar askujt nga inati dhe se nuk dinte asgjë për konfliktin mes E e T e në anën tjetër punonte për E.S e shoqërohej me I.A e R.A që shihet haptazi se deklaratat e tij në këtë fragment janë të pa vërteta duke u munduar të ilustroj një rast e në anën tjetër duke u munduar ta shkëput vetveten nga E.S dhe nga grupi.

Qëllimi kryesor i mbrojtjes ishte që të shmangte raportin mes tyre, pra mes E,dhe A, por nga provat e administruara, gjykata ka vërtetuar se A.B ishte punëtor në “B.Kafe” punëtor i firmës që drejtonte E.S dhe se shoqërohej në vazhdimësi me Rr.A dhe I.A, ani pse gjithë tendenca dhe kontraditoriteti i deklaratave varionte për të shmangur raportet.

Pra A.B, ishte punëtor i E.S, e në të njëjtën kohë ishte njeriu me i afërt i R.A dhe I.A, A.B ishte pjesë e grupit dhe person që qëndronte thujse gjithë kohës në “Bar S” (veçanti në kohën e fundit.)

Pra gjykata nga rrethanat e ngjarjes, përfundimisht konstaton se asnjë motiv personal nuk lidhet që A.B ta provonte nga jeta tani të ndjerin, përveç motiveve të E.S, për shkas të së cilave nga shtytja e këtij të fundit i ka ndërmarr këto veprime, fakt ky tani i konstatuar edhe nga Gjykata Supreme.

Kush ishte F.A, i dënuar për pjesëmarrje në vrasjen e T.R.

Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme me shenjë API.nr.9/2011 të datës 09.02.2012 për vrasjen e T.R është dënuar edhe F.A

F.A ishte po ashtu punëtor i E.S në “Bar S”.

Kush ishin Rr.A e I.A

Ishin njerëzit më të afërm të E.S dhe persona të identifikuar nga vet dëshmitarët okular si përcjellës në shumicën e rasteve ndaj T.R

Tani në bazë të provave të administruara, rezulton se E.S kishte konflikt me T.R. Nga provat e administruara janë specifikuar me radhë rastet që kanë ndodhur, përndjekjet, sulmet e atentatet dhe të gjitha vinin nga E.S dhe se rezulton se T, i nuk kishte ndonjë problem me dikë tjetër të përmasave të atilla që do ta shqetësonte, të gjithë të afërmit e tij dinin vetëm për E.S. Konflikti ishte mes E.S ndaj T.R nga ndalimi që ky i fundit i'a kishte bërë atij si zyrtar policor, çështja e A.I, rasti S. Casino, rasti Ferizaj, motive këto që kishin rritur rivalitetin e që përshkallëzonin konfliktin dhe qonin në motivin për hakmarrjen.

Në bindjen e trupit gjykues, A.B nuk kishte probleme me T.R, F.A po ashtu nuk kishte probleme me të e këta të dy tani janë vrasës të T. Pra dy të përfshirëve në vrasjen e T, u mungon motivi e në të njëjtën kohë rezulton se vrasja ishte e organizuar. Në këtë vrasje të organizuar përfshihen edhe Rr.A e I.A njerëzit më të afërm të E.S – persona që ishin të përfshirë edhe në përndjekjet tjera ndaj T, në anën tjetër vrasjen e kryejnë punëtorët e E.S, pra A.B e F.A, e Rr.A i raportonte E.S për këto veprime.

Nga ky këndvështrim, për aq kohë sa vrasja ishte e organizuar, konstatuar tani më edhe nga Gjykata Supreme, rezulton një fakt, se vrasja nuk kishte ndodhur aty për aty, nuk ishte e atëçastshme, pra ishte e organizuar, andaj dikush kishte shtytur këtë ngjarje. Veprimet shtytëse vijnë nga motive të caktuara.

Kjo gjykatë ka përjashtuar çdo mundësi që shtytës në vrasjen e T, të ishte Rr.A që i raportonte E.S, apo I.A, pasi të njëjtit nuk kishin asnjë problem me T. Gjykata ka përjashtuar edhe çdo motiv të A.B e F.A për ta privuar nga jeta tani të ndjerin.

Në anën tjetër, gjykata përjashton çdo mundësi që shtytës të ishte dikush tjetër jashtë të ashtuquajturit “Grupi S” për aq kohë sa T, nuk kishte probleme të një natyre të madhe me askënd tjetër e po ashtu për aq kohë sa vrasja është kryer pikërisht nga punëtor të E.S.

Edhe pse intenca edhe e mbrojtjes edhe e A.B ishte që fillimisht ta mohonte e pastaj t’i quante rastësi takimet e A.B me E.S, pastaj fillimisht të mohojë e pastaj të quajë fakti se ditën kritike ka qenë i armatosur, e pastaj rastësi që ka qenë në “Bar S” atë ditë, e pastaj herë pohuar e here mohuar faktin se atë ditë e ishte takuar edhe me E.S.

Në bindjen e trupit gjykues, të gjitha këto tendenca për të tentuar të shmangej raporti i E.S me A.B e i A.B edhe me të tjerët, është narrativ për të shkëputur lidhshmërinë në kryerjen e vrasjes, fakt që nuk e ka akceptuar kjo gjykatë, e as Gjykata Supreme.

Trupi gjykues ka përjashtuar çdo mundësi që organizimi i vrasjes së T, të ishte bërë nga A.B për motive të tija (pasi që një motiv i tillë nga provat e administruara nuk rezulton). Trupi gjykues ka përjashtuar çdo mundësi tjetër që dikush tjetër të ishte prapa vrasjes së T, për aq kohë sa kjo vrasje e organizuar ka lidhshmëri të drejtë për drejtë mes vrasësve tani të konfirmuar A.B e F.A me E.S si punëtor të tij dhe për deri sa të dyshuar në këtë përfshirje ishin edhe Rr.A e I.A – marr parasysh lidhshmërinë e tyre me E dhe përndjekjet që ata i bënin T., pikërisht sipas kërkesës së E.

Nga këto rrethana faktike, kjo gjykatë ka nxjerrë përfundimin se, pas intestifikimit të përcjelljeve të grupit ndaj T, të cilat veprime janë elaboruar më sipër, ku i përfshirë ishte edhe A.B e Rr.A i raportonte E.S, rezulton se ditën kritike në takimin e tyre në “Kafe Bar S”, pasi që paraprakisht ishin takuar mes vete, E.S duke përdorur ndikimin që kishte tek ai, me dashje kishte shtytur përfundimisht A.B që të kryente vrasjen e T, përkatësisht ta privonte nga jeta të njëjtin për motive

të veta hakmarrëse. Konflikti ishte vetëm i E.S me T dhe motivet ishin të ndërlidhura vetëm të E, për ta vrarë T, dhe të gjitha problemet, përcjelljet, kërcënimet e atentatet kishin ardhur nga E.S, andaj përfundimisht ditën kritike pas takimit të të lartcekurve, gjykata ka vërtetuar se aty E.S me ndikimin që kishte tek ai, shtyti A.B ta privonte nga jeta T.R, për motive personale hakmarrëse.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale Shtytje për kryerjen e Vrasjes e rëndë nga neni 147 paragrafi 3 dhe paragrafi 9 të KPK-së

Gjykata tutje ka bërë analizimin e elementeve të veprës penale ashtu siç fillimisht e ngarkon tani të akuzuarin aktakuza, e që e ngarkon me veprën penale, Shtytja për kryerjen e Vrasjes së rëndë nga neni 147 paragrafi 3 dhe paragrafi 9 të Kodit të Përkohshëm Penal, kod ky që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Fillimisht në nenin 24 është specifikuar se *“Kushdo që me dashje e shtyt tjetrin të kryejë vepër penale dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë vepër penale, nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e tij.*

Në neni 147 është trajtuar vepra penale e Vrasjes së rëndë ku është specifikuar se *“më së paku dhjetë vite burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili”*; ndërsa paragrafi 3 i nenit 147, si formë cilësuese të kësaj vepre penale (rënduese) specifikon veprimet si vijon *“privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake”* ndërsa në paragrafin 9 specifikohet forma tjetër cilësuese (rënduese) në rastet kur *“privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta.”*

Në rastin konkret, fillimisht nuk është kontestuese se tani i ndjeri ishte privuar nga jeta nga A.B e ku i përfshirë ishte edhe F.A, konstatim ky nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin me shenjën API.nr.9/2011 të datës 09.02.2012.Kjo gjykatë ri-kujton faktin se të dy të lartcekurit ishin punëtor në bizneset që udhëhiqte E.S

Lidhshmëria e elementeve të veprës penale sa i përket të akuzuarit konsiston në faktin e veprimeve të tij shtytëse dhe lidhshmërisë së motivit.

Sa i përket paragrafit 3 ka të bëj me mënyrën e kryerjes, që gjykata ka pasur në vëmendje që këto veprime lidhen me mënyrën e kryerjes së veprës penale, por në rastin konkret vepra penale është kryer për motive hakmarrëse të tani shtytësit E.S, andaj kjo gjykatë do të elaborj më në detaje motivet hakmarrëse dhe elementet specifike shtytëse.

Në këtë kontekst, nga rrjedha e ngjarjes që ka vërtetuar kjo gjykatë e cila në detaje do të paraqitet në vijim të aktgjykimit tek vërtetimi i gjendjes faktike, kjo gjykatë ka konstatuar se:

Pas konflikteve që datonin prej vitit 2000-2001, mes E.S dhe T.R, e që u shoqërua me përndjekje, kërcënime, shfryrje e shpuarje gomash e të gjitha këto vinin nga i ashtuquajtur i “Grupi S” që veprimet i ndërmerrnin nën ndikimin e E.S. Më tej shkaku A.I, “Rasti S. Casino”, rasti Ferizaji, përcjelljet e përndjekjet e vazhdueshme, intestifikimi i përcjelljeve e trysnisë pak para vrasjes kishin bërë që tani i ndjeri të kalonte kohen më të madhe në fshatin S, ku aty i organizohet prite-atentati rreth dy javë para vrasjes, ndërsa tri ditë para vrasjes i njëjti ishte në përcjellje nga A.B, I.A e Rr.A ku ky i fundit i raportonte E.S. Ditën kritike dorasi A.B, punëtor i E.S dhe pjesë e grupit të tij, ishte takuar me tani të akuzuarin E.S dhe nga aty ishte dalë i armatosur, në shoqëri të Rr.A e I.A të ndihmuar edhe nga F.A po ashtu punëtor në biznesin që udhëhiqej nga E.S ishin dalë në përcjellje të tani të ndjerit duke komunikuar me sms deri në privimin e tij nga jeta.

Fakti që ngjarja ka qenë e planifikuar e organizuar që i ndjeri të privohej nga jeta dhe jo e rastësishme është konstatuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme me shenjën API.nr.9/2011 të datës 09.02.2012.

Tani, meqë ngjarja ka qenë e planifikuar dhe organizuar, shtrohet pyetja se kush e organizoi dhe për çfarë motive vrasjen e tani të ndjerit dhe pse.

Të gjithë dëshmitarët që ishin të afërm me T, por edhe të tjerë që njihnin edhe T edhe E.S. dhe problemet mes tyre (dëshmitar të dëgjuar në shqyrtim gjyqësor), e dinin që E.S. kishte probleme me T.R, ishin njohuri për incidentet, përcjelljet, konfliktet e atentatet dhe prapa gjithsecilës ishte E.S. Po ashtu u konstatua se T nuk kishte ndonjë problem tjetër me dikë tjetër të ndonjë natyre shqetësuese.

Nga provat e administruara, është konfirmuar konflikti i E.S. mes T.R, po ashtu është konfirmuar se çdo përndjekje, përcjellje, kërcënim, djegie veturash, rasti “S.Casino”, rasti Stagovë ishin të orkestruara nga E.S. e njerëz të tij, dhe askush tjetër nuk kishte problem me T. e as njerëzit e E, sepse problemi ishte mes E, dhe T, dhe se përfundimisht pikërisht njerëzit e E.S. privojnë nga jeta T.R.

Nga kjo rrjedhe ngjarjes kanë rezultuar edhe motivet e tani të akuzuarit për ta privuar të ndjerin nga jeta. Fillimisht motivi i parë që edhe e kishte nisur konfliktin mes të dyve ishte fakti se T, si një zyrtar i ri i policisë aso kohe në zbatim të ligjit e kishte ndalur të akuzuarin E, gjë që për të ishte e pa pranueshme dhe e kishte filluar konfliktin ndaj tani të ndjerit. Pra këtu fillon rivaliteti dhe motivi i parë për hakmarrje. Pas vazhdes së konflikteve për shkakun e parë të lartcekur, T.R. largon përfundimisht dëshmitaren A.I nga E.S. që nxit motivin e radhës së të akuzuarit për hakmarrje gjë që vërtetohej nga gjendja faktike, pasi që nga ajo kohë sulmet nga E.S. ndaj tani të ndjerit ishin në intezitet të shtuar ku pas përcjelljeve të një pas njëshme dhe djegies së veturës kishte ndodhur incidenti në “S.Casino” të gjitha këto në harkun rreth tre muaj që qon haptazi në motivin e të akuzuarit për hakmarrje pas lidhjes së të ndjerit T me dëshmitaren A.

Në incidentin e “S.Casinos” që është elaboruar më sipër, gjatë konfliktit ku kishte gjuajtur edhe me armë e të plagosur, E.S. ishte rrahur nga T, që kishte qar në motivin e radhës që i njëjti ta privonte nga jeta të njëjtin –për hakmarrje dhe se rivaliteti dhe konfliktet vetëm ishin rritur. Rasti Ferizajit ishte një konflikt mes njësisë special atje dhe tani të akuzuarit, ku i njëjti ishte rrahur nga ata e për këtë pretendonte që mbropa saj ishte T.R, e që ishte motivi i radhës.

Në këtë rrjedhë të ngjarjes, pas organizimit javëve-ditëve të fundit për privimin nga jeta të tani të ndjerit T.R, veprime të cilat janë elaboruar më sipër, ditën kritike, pas takimit që kishte në “Kafe Bar S” E.S. me A.B, i akuzuari E, me dashje që përfundimisht ta privoj nga jeta tani të ndjerin T.R, nën ndikimin e tij, ka shtytur tani dorasin A.B punëtorin e tij që ishte edhe pjesë e grupit të tij ta bëjë këtë veprim, pra ta privoj nga jeta tani të ndjerin, ku këto veprime tani i akuzuari i ka marr për motive hakmarrëse nga konfliktet ndër vite e ku shkas kryesor ishin cenimi i primatit të E.S nga T.R në cilësi të zyrtarit policor, A.I, rasti “S Casino” e rasti “Ferizajit”.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë ka vlerësuar se në rastin konkret, në veprimet e tani të akuzuarit, janë manifestuar të gjitha elementet e veprës penale Shtytje në vrasje të rëndë për motive hakmarrëse e përcaktuar me nenin 147 paragrafi 3 dhe 9 lidhur me nenin 24 të Kodit Penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së vrasjes.

Praktikën vendore dhe ndërkombëtare lidhur me shpalljen e të akuzuarit fajtor duke u bazuar edhe në provat rrethore

Siç është vërejtur nga nxjerrja e përfundimit se E.S ishte shtytësi në kryerjen e vrasjes, përfundimet e tilla janë nxjerrë nga rrethanat faktike të rastit e mbështetur edhe në prova rrethore.

Gjykata tërheq vëmendjen, se bindja edhe përfundimet e gjykatës, se E.S është shtytësi, janë nxjerrë vetëm atëherë kur gjykata ka hequr çdo dilemë se A.B nuk kishte asnjë arsye ta privonte nga jeta T.R dhe këtu duke marr parasysh lidhshmërinë e A.B me E.S, lidhshmërinë e njerëzve të tjerë të përfshirë në vrasje me A, E, konfliktet e vazhdueshme, dhe motivet. Në këtë kontekst, gjykata ka përjashtuar çdo mundësi tjetër që vrasja e T, kishte ndodhur për ndonjë arsye tjetër, përveç motiveve hakmarrëse të E.S e që janë manifestuar me veprime shtytëse ndaj A.B që të kryente vrasjen.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë ka marr për bazë edhe praktikën vendore, por edhe ndërkombëtare se si mundet gjykata në raste të ngjashme të nxjerrë përfundime të tilla nga rrethanat faktike të rastit.

Në vijim, gjykata do të specifikoj Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me shenjë Pml.nr.57/2023 të datës 06.04.2023 në faqen 21 të këtij Aktgjykimi përkatësisht në paragrafin e dytë ka specifikuar se *“Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nga provat e administruara nga ana e gjykatës së parë nuk është vërtetuar se autori i veprës penale ishte i pandehuri siç është theksuar në këtë çështje penale nuk ka pasur prova të drejtpërdrejta, por skema e ngjarjes është ndërtuar duke u bazuar në prova rrethore duke e ndërlidhur hallkat e zingjirit të ngjarjes. Për këtë arsye është e rëndësishme të theksohet fakti se për gjykimin e një rasti të bazuar në prova rrethore gjithmonë është i nevojshëm standardi i vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm i cili përmbushet vetëm atëherë kur përfundimi i nxjerrë nga këto prova është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxjerrët prej provave të paraqitura. Pra, duhet të sigurohen prova që të mbyllet qarku, përkatësisht të përjashtohet mundësia që personat e tjerë të jenë kryes të veprës penale”*.

Pikërisht duke ndjekur këto udhëzime ka vepruar edhe në rastin konkret kjo gjykatë.

Siç është konstatuar më sipër, gjykata ka vërtetuar me radhë konfliktet mes E.S dhe T.R, ka vërtetuar motivet e E.S për ta privuar nga jeta tani të ndjerin, ka vërtetuar faktin se A.B nuk kishte asnjë motiv - arsye ta privonte nga jeta tani të ndjerin, ka vërtetuar faktin se A.B ishte punëtor i E.S dhe pjesë e “Grupit S”, ka vërtetuar faktin se vrasja nuk ishte e atëçastshme, por e organizuar dhe të përfshirë ishin persona të tjerë po ashtu të “Grupit S” e ku është vërtetuar po ashtu se asnjëri nga ta nuk kishte konflikte me të ndjerin.

Në këto rrethana, pikërisht kjo gjykatë ka mbyllur qarkun duke përjashtuar çdo mundësi se prapa vrasjes së T, do të ishte dikush tjetër dhe standardi që ka përdorur gjykata në rastin konkret është standardi i vërtetuar përtej çdo dyshimi, dhe se nga hallka zingjirore e provave të administruara në këtë gjykatë, përfundimi i nxjerrë nga këto prova është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxjerrët prej provave të paraqitura.

Andaj, në kontekstin e kërkesave të paraqitura nga praktika gjyqësore për raste të tilla kur kemi të bëjmë me prova rrethore, kjo gjykatë ka mbyllur të gjitha dilemat se prapa kësaj vrasje do ishte dikush tjetër, andaj edhe ka nxjerrë përfundimin e arsyeshëm e të akceptuar edhe tani nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme se kur përfundime të tilla nxirën pas eliminimit të specifikave të lartcekura, përfundimi i drejtë dhe i saktë mund të nxjerrët edhe nga provat rrethore e siç ka vepruar edhe kjo gjykatë në rastin konkret.

Kjo gjykatë po ashtu ka marrë për bazë edhe ka hulumtuar edhe praktikën ndërkombëtare, përkatësisht vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me praktikën e saj, sa i përket arsyetimit të vendimeve duke u bazuar në provat rrethore, e përkatësisht; Rasti Alberti kundër Italisë me numër 12013/86 i datës 10.03.1989 në aktgjykimin e të cilit është konstatuar se “Në mungesë të provave të drejtpërdrejta, gjyqtarët gjykues konstatuan se urdhri për ekzekutimin e z. J. ishte dhënë nga kërkuesi. Për të arritur në këtë përfundim, ata u mbështetën në një grup të tërë provash indirekte, siç është ekzistenca e një motivi të vetëm të besueshëm, pikërisht hakmarrja; mungesa e personave me interes për të vrarë z. J. përveç anëtarëve të organizatës kriminale që ai kishte ndihmuar të zbulonte; fakti që ishte e pamundur për bashkëpunëtorët e kërkuesit që nuk ishin në burg të dinte se z. J. kishte bashkëpunuar me policinë; dhe fakti që kërkuesi ishte i vetmi person, midis të arrestuarve, që kishte autoritetin e nevojshëm për të urdhëruar vrasjen dhe mundësinë e përcjelljes së urdhrave të tij jashtë burgut.”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me rastin e shqyrtimit të ankesave të ankuesit e ka shqyrtuar lidhur me pretendimin e ankuesit se i njëjti është shpallur fajtor duke u bazuar vetëm në prova rrethore dhe lidhur me pretendimin e shkeljes së nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili garanton të drejtën për një “gjykim të drejtë”. E që në këtë rast, gjykata fillimisht ka theksuar se çështja e pranueshmërisë së provave dhe vlerës provuese së këtyre provave bie në kompetencë brenda fushës së ligjit të brendshëm të shtetit duke specifikuar rastet si (, Nr. 7450/76, Dhjetor 28 .2 .77, D.R. 9 f. 108 : Nr 8876/80, 16.10 .80, D .R 233) e që nuk kërkohet nga kjo Gjykatë që vendos lidhur me çështjen nëse gjykata vendase ka vlerësuar saktë provat, duke shtuar se përdorimi i provave indirekte nuk përjashtohet në vetvete nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës, por që gjyqtarët në momentin e marrjes së vendimit të tyre, mund të shpallin fajtorë të pandehurin duke u bazuar në prova të drejtpërdrejta ose prova indirekte, të cilat mjaftojnë për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit. E që në rastin e lartcekur, gjykata deri në shpalljen fajtor të të pandehurit në mungesë të provave drejtpërdrejta, trupi gjykues ka ardhur në përfundim deri tek shpallja fajtor e të pandehurit duke u mbështetur në prova indirekte, siç është ekzistenca e një motivi të besueshme domethënë hakmarrja, mungesa e njerëzve me interes për ta vrarë viktimën.

Rasti i lartcekur është i ngjashëm me rastin tonë dhe është thujse identik, pra vendime të tilla njohin edhe Gjykata të tjera siç ishte rasti i Gjykatës në Itali, e përfundimet e nxjerra edhe me prova rrethore i akcepton edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht nënvizon se një çasje e tillë nuk është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës – gjykimi i drejtë. Në rastin konkret, edhe kjo gjykatë përfundimet e saja i ka nxjerrë nga rrethanat faktike të rastit e të elaboruara më sipër, motivet e hakmarrëse të tani akuzuarit, e po ashtu pasi paraprakisht kjo gjykatë ka hequr çdo dilemë për arsyet që mund të kishte A.B e F.A për vrasjen e tani të ndjerit.

Tutje rasti tjetër i cili është trajtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është Rasti Lisica kundër Kroacisë me nr.20100/06 i datës 25.02.2010 në të cilin rast, përpos që të njëjtit janë shpallur fajtor duke u mbështetur vetëm në një provë të drejtpërdrejtë por edhe në provat tjera rrethore. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me rastin e trajtimit të ankesës së ankuesve lidhur me pranueshmërinë e provës së vetme të drejtpërdrejtë dhe bazimi i aktgjykimit në provat rrethore ka konkluduar se, detyra e gjykatës nuk është të vlerësoj nëse dënimi i të pandehurve do të ishte siguruar nëse prova e vetme e drejtpërdrejtë e cila është kontestuar do të përjashtohet, ndërsa përgjigja lidhur me pyetjen nëse provat rrethore në rrethanat specifike të çështjes në fjalë, se a do të ishin të mjaftueshme për dënimin e të pandehurve është në kompetencë të gjykatave vendore. Ku as Gjykata nuk duhet të spekulojë se cili do të ishte rezultati i gjykimit nëse nuk do të përdreshin provat, e që detyra e gjykatës do të ishte të vendosë nëse përdorimi i provës së kontestuar do të plotësonte standardin për gjykim.

Pra edhe njëherë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut specifikon faktin se detyrë e gjykatës është që nga rezultati i provave qoftë të drejtë për drejta qoftë rrethanore, të nxjerrën përfundimet, e që siç është specifikuar dhe ilustruar disa herë përgjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, gjykata nga rrjedha e ngjarjes, motivet, moslidhmërisë së motivit të kryesit të veprës me viktimën dhe lidhshmërisë se kryesit me shtytësin dhe motivet e shtytësit, ka nxjerr përfundimin se E.S nën ndikimin e tij, ka shtytur A.B ta kryej vrasjen e T., për motive personale hakmarrëse, pasi që askush tjetër nuk kishte një motiv të tillë.

Ndryshimi i përshkrimit faktik

Siç është specifikuar për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, një nga vërejtjet thelbësore të Gjykatës së Apelit me rastin e kthimit të këtij rasti në ri-vendosje ishte edhe përshkrimi faktik i dispozitivit, për faktin se nuk ishin përshkruar saktë veprimet inkriminuese të tani të akuzuarit. Në këtë kontekst, siç është vërejtur nga përshkrimi faktik në dispozitivin e aktgjykimit, kjo gjykatë ka përpiluar përshkrimin faktik në bazë të gjendjes faktike të vërtetuara nga provat që kjo gjykatë i ka administruar.

Kjo gjykatë tërheq vëmendjen, se ani pse gjykata ka ndërhyrë në përshkrimin faktik, kjo gjykatë vetëm ka bërë precizimin e fakteve të pretenduara nga prokuroria dhe të njëjtat i ka ristrukturuar. Pra gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë gjendje tjetër faktike nga pretendimet e prokurorisë dhe se pikërisht gjykata ka vërtetuar faktet e pretenduara nga prokuroria.

Gjykata nuk ka të drejtë të ti ndryshoj faktet, apo të vërteton fakte që si ka pretenduar prokuroria, e as të ndryshoj cilësimin juridik në dëm të tani akuzuarit, sepse në ato rrethana do kishim të bënim me tejkallim të aktakuzës, por nuk ka tejkallim të aktakuzës kur gjykata vërteton faktet e pretenduara nga prokuroria, por të njëjtat i ristrukturon në përshkrimin faktik e as nuk ka tejkallim të aktakuzës, kur vepra penale ri-cilësohet në favorin e të akuzuarit, por gjykata ka vërtetuar faktet e pretenduara nga prokuroria dhe nuk ka ndryshuar gjendjen faktike për tej pretendimeve të prokurorisë, një çështje e tillë tani është determinuar nga praktika gjyqësore.

Se praktika gjyqësore e ka determinuar faktin se gjykata mund të rregulloj përshkrimin faktik të dispozitivit dhe kjo nuk paraqet ndonjë pengese apo tejkallim të aktakuzës, argumentohet në vendimet e Gjykatës Supreme, përkatësisht vendimet me numër Pml.nr.412/2022 të datës 10.11.2022 si dhe vendimi me numër Pml.nr.56/2019 të datës 13.09.2019.

Kjo gjykatë do të trajtoj vetëm në pika të shkurta vendimet e lartcekura.

Rasti me shenjën Pml.nr.412/2022 është rast në të cilin Gjykata Supreme, kishte refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtjes lidhur me atë se a kemi të bëjmë tejkallim të aktakuzë në kuptimin objektiv, kur kemi të bëjmë me ndryshim të përshkrimit faktik. Gjykata Supreme kishte konstatuar se nuk bëhet fjalë për tejkallimin e aktakuzës në kuptimin objektiv duke specifikuar se:

Qëndron fakti se gjykata e shkallës së parë në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit, ku janë përshkruar veprimet inkriminuese të të dënuarit N.K në lidhje me veprën penale për të cilën ishte shpallur fajtor, kishte paraqitur dhe përshkruar edhe disa detaje dhe disa veprime tjera, të cilat nuk janë përmendur në aktakuzën e paraqitur fillimisht dhe të ndryshuar gjatë fjalës përfundimtare.

Gjykata Supreme në këtë rast ka konkluduar se nuk bëhet fjalë për tejkallim të akuzës në kuptimin objektiv, për disa arsye. Së pari, në rastin konkret bëhet fjalë për ngjarjen e njëjtë, por që janë sqaruar dhe precizuar më tepër rrethanat e rastit konkret, duke u bërë më të qartë dhe më të plotë vetë përshkrimin e veprës penale. Së dyti, këto detaje dhe veprime që janë shtuar nuk kanë të bëjnë me elementet themelore të veprës penale. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata Supreme e

Kosovës ka specifikuar se *“do të konsiderohej tejkalim i akuzës në kuptimin objektiv, në rastet kur gjykata e ndryshon përshkrimin faktit të ngjarjes, duke vendosur elemente të caktuara të cilat do të rezultojnë me një kualifikim më të rëndë të veprës penale në krahasim me veprën penale e cila është përfshirë në aktakuzë”*.

Në rastin me shenjë Pml.nr.56/2019, Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me atë se mbrojtësi i të dentarit K.E ka pretenduar se Aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të KPP-së, shkelje të cilat kanë konstituar se me aktgjykimin e shkallës së parë është tejkaluar aktakuza dhe se gjykata nuk ka gjykuar sipas përshkrimit faktik të dhënë në aktakuzë, por ka bërë përshkrimin faktik krejtësisht tjetër, duke shtuar se gjykata ka tejkaluar aktakuzën duke u munduar të përshkruaj veprimet e secilit të akuzuar edhe pse këto veprime janë në kundërshtim me aktakuzën dhe për to nuk është nxjerrë asnjë provë.

Gjykata Supreme lidhur me këtë rast ka konkluduar se në rastin konkret nuk ka tejkalim të aktakuzës, sepse aktgjykimi ka të bëjë me personin e njëjtë të akuzuar dhe nuk ishte përfshirë ndonjë veprë penale e cila nuk ka qenë objekt i akuzës, përkatësisht ngjarja tjetër nga ngjarja e paraqitur me aktakuzë.

Kjo Gjykatë ka marrë referencë edhe vendimin për papranueshmëri në rastin me shenjë nr.Kl.57/21 të datës 13.12.2021 e nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese në të cilin rast përpos që kemi pasur të bëjmë me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale është flitur edhe për pjesën e identitetit objektiv të akuzës, e ku në këtë Aktgjykim është konstatuar se *“Gjykata rikujton se sipas teorisë dhe praktikës të së drejtës penale, identiteti objektiv i akuzës dhe i aktgjykimit nuk do të vihen në dyshim nëse në aktgjykim ndryshohen rrethanat në lidhje me natyrën më të butë të veprës penale, ose rrethanat të cilat e përcaktojnë më nga afër veprën penale dhe nëse në aktgjykim ndryshohen rrethanat, të cilat nuk janë thelbësore për përshkrimin e veprës, ashtu që në aktgjykim përcaktohet më qartë dhe më saktë përshkrimi i përgjithshëm faktik i veprës nga propozimi akuza. Në çdo rast, identiteti objektiv i aktakuzës dhe aktgjykimit nuk cenohet nëse bëhet fjalë për ndryshime të tilla që nuk hyjnë në thelbin e veprës penale të përmbajtur në aktakuzë, me kusht që i akuzuari të mos jetë i dënuar për një veprë penale më të rëndë nga ajo që përfshihet në aktakuzë”*.

Kjo gjykatë, duke i marrë për bazë rekomandimet e Gjykatës së Apelit, dhe duke marrë parasysh praktikën gjyqësore të krijuar deri më tani, ka përshkruar në mënyrë të saktë faktet e vërtetuara nga provat e administruara, faktet nga pretendimet e aktakuzës dhe faktet për ngjarjen e njëjtë, dhe ka përshkruar në detaje veprimet inkrimimuese të tani të akuzuarit në raport me elementet e veprës penale.

Sqarim lidhur me grupin

Për mos të krijuar huti përkitazi në raport me termin “Grupi S”, që është referuar për gjatë arsyetimit të këtij aktgjykimi, kjo gjykatë sjellë në vëmendje faktin se gjykata nuk i jep atributin e domosdoshëm këtij grupi si një grup i strukturuar kriminal, pasi që kjo çështje nuk ishte objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor, sepse ata nuk akuzoheshin se veprën penale se kishin kryer sipas veprës penale të Krimit të organizuar. Termi “Grupi S” ka rrjedhë nga dëshmitë e dëshmitarëve ku personat e afërm me E.S dhe bizneset e tij dhe personat që kryenin veprime sipas kërkesave të tij i kanë quajtur si pjesë të “Grupi S”.

Pra të gjithë dëshmitarët, zyrtarët policor po ashtu dëshmitar në këtë rast, ata i njihnin e i emnonin si “grupi S”.

Këta persona punonin për E.S dhe vepronin në bazë të kërkesave dhe urdhrave të tij qoftë për punë të ligjshme të bizneseve të tyre qoftë për veprime inkriminuese siç ishte rasti i përndjekjeve, kërcënimeve e veprave penale ndaj T.R, qoftë problemeve që kishte familja I me ta, e qoftë rasteve kur ata shpërthenin gomat e veturave të këngëtarëve që bënë këngë me A.I e edhe raste tjera të hapura në polici verdikti i shume prej tyre që nuk është marrë për arsye se të përfshirët në vrasjen e T. përveç A.B e F.A gjendeshin në arrati. Andaj ky ishte konteksti i grupit që u referoheshin, por gjykata nuk i dha epitet në kuptim të grupit të organizuar kriminal që ka të bëjë me vepra penale të krimit të organizuar pasi që ky nuk ishte pretendimi i prokurorisë e as gjykata nuk e ka shpallur fajtor të akuzuarin mbi këtë kontekst, por vetëm në veprimet shtytëse për motive hakmarrëse.

Ky sqarim u specifikua vetëm për të mos krijuar huti se çka i referohej dhe pse i referohej gjykata si “grupi S”, sepse kjo kishte rrjedhë nga rrëfimet e dëshmitarëve mbi gjendjen faktike.

Përfundimi – vendimi gjykatës për ta shpall të akuzuarin fajtor.

Pas administrimit të provave personale dhe materiale, analizimit të praktikave vendore dhe ndërkombëtare, përkritazi me raste të ngjashme, dhe pasi që kjo gjykatë ka dhënë përgjigje për gjitha faktet kontestuese, dhe pasi që kjo gjykatë ka vërtetuar faktet se si kishte nisur konflikti, pastaj duke vërtetuar faktin se prapa të gjitha rasteve të lartshënuara që shkonin drejt T ishte E.S, duke lidhur motivin e E.S për hakmarrje, mos lidhshmërinë e motivit të A.B për vrasjen e T, lidhshmërinë e A.B me E.S, lidhshmërinë e E.S me personin tjetër të përfshirë në vrasje e T, F.A, lidhshmërinë e E.S me Rr.A e I.A e lidhshmërinë e këtyre dy të fundit me A.B si dhe ngjarjet e intensifikuara pak para vrasjes, atentati në fshatin S, përcjellja e A.B , Rr.A e I.A ndaj T vetëm tri ditë para vrasjes e ku Rr.A i raportonte E.S e deri në përfundimin se ditën kritike vrasja ishte e organizuar pas takimit të E.S me A.B, Rr.A e I.A, kjo gjykatë ka nxjerrë përfundimin, respektivisht ka vërtetuar këtë gjendje faktike si vijon:

Nga incidentet që kishin datuar nga viti 2000-2001, kur tani i ndjeri T.R kishte filluar punën si Zyrtar i Policisë së Kosovës, me ç’ rast ishte kërcënuar nga i akuzuari E.S me granat dore, e pastaj duke vazhduar me përcjellje të vazhdueshme për të diktuar primatin nga njerëz të afërm me E.S dhe vet i akuzuari E.S, ku këta persona të afërm vepronin sipas kërkesave të tij, duke e përndjekur e kërcënuar në vazhdimësi tani të ndjerin, duke ja shfryer fillimisht gomat e veturës e pastaj duke i shpërthyer ato. Rivaliteti -Konflikti mes T.R dhe E.S, merr një hov tjetër pasi që tani i ndjeri kishte marrë në mbrojtje A.I pikërisht nga E.S, e ku i ndjeri dhe e lartcekura kishin filluar një lidhje dashurie në periudhën e vitit 2005. Nga kjo kohë motivi për hakmarrje, kërcënimet, sulmet, e përcjelljet ndaj T.R ishin të njëjta pas njëshme ku vetëm në disa raste tani të konstatuara ai ishte përcjellë nga personat e afërm të të akuzuarit, si dhe vetë i akuzuari, fillimisht në një rast në G, pastaj kur i ndjeri ishte me familjaret e tij në V., po ashtu edhe në një rast tek Qafa në Prishtinë ku në gjitha këto raste ishte përcjellë e kërcënuar me vetura të blinduara e me skuter. Përgjatë përndjekjes së të ndjerit në mënyrë të vazhdueshme, të njëjtit i ishte djegur edhe vetura e tij “Land Rover” e të gjitha këto kishin ndodhur nën kërkesat e tani të akuzuarit E.S

E.S me persona të afërm të tij, në fund të vitit 2005 kishte pasur një konflikt tjetër të armatosur ndaj tani të ndjerit T.R me shokë, ku kishte pasur edhe persona të plagosur e të rrezikuar (me ç’ rast E.S kishte akuzuar T.R lidhur me rrahjen që i ishte bërë duke mos ja falur të njëjtit – duke kërkuar hakmarrjen, Rasti “S.Casino”). Tutje për gjatë vitit 2006 (Rasti Ferizajit), E.S kishte pasur një konflikt ku ishte rrahur nga zyrtar policor e që përsëri i njëjti drejtonte gishtin kah T.R, me ç’ rast, për të gjitha rastet e cekura me radhë, i akuzuari kërkonte hakmarrjen.

Rreth dy javë para vrasjes së tani të ndjerit, nën kërkesën e E.S, ishte organizuar atentat ndaj tani të ndjerit, ku në fshatin S, i ishte organizuar pritë duke u munduar të ja rrokullisin veturën të

cilën aj e ngiste me qëllim që të njëjtin ta privojnë nga jeta, me ç' rast konstatohet se E.S kishte vendosur tani ta privoj nga jeta T.R

Tri ditë para vrasjes, T, ishte nën përcjellje të A.B, I.A e Rr.A ku ky i fundit i raportonte E.S Përfundimisht rreth dy javë pas atentatit të lartcekur, dhe tri ditë pas përcjelljes së konfirmuar, me datën 30 gusht 2007 ishte organizuar në detale vrasja e T.R, ku njerëzit e afërm të E.S të cilët ishin prapa gjate çdo përcjellje e kërcënimi ndaj T e që ishin Rr.A (R), I.A (L), ishin takuar me tani dorasin A.B po ashtu person i afërm dhe punëtorë i E.S, ku ishin takuar në kafe "bar S" dhe pasi që E.S i kishte ftuar në takim të lartcekurit, me dashje që përfundimisht ta privonte nga jeta tani të ndjerin T.R për motive të ulëta e hakmarrje të pa skrupullt, nën ndikimin e tij e kishte shtytur A.B ta privonte nga jeta tani të ndjerin, e ku A.B kishte dalur nga Kafe "Bar S" i armatosur i shoqëruar me Rr.A (R), I.A (L), të cilët kishin lënë pastaj në një kafene afër kafenesë "/" ku pasi që paraprakisht T, ishte përcjellë, A.B e kishte pritur rreth një orë e dyzet minuta të ndjerin, me ç' rast në mënyrë tinxare nga prapa kishte shtënë në të njëmbëdhjetë herë në tri rafalë, duke e godit me dy predha në shpinë dhe një predhë në kofshën e djathtë, me armën e tij të tipit "Glock" të kalibrit 9x19, duke qar kështu përfundimisht në arritjen e qëllimit nga E.S, e që ishte privimi nga jeta i T.R për motive të tij hakmarrëse.

Konstatimi i Gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, vlerësimit të tyre veç e veç, si dhe në lidhmëni me njëra tjetrën ashtu siç e përcakton neni 360 paragrafi 2 i KPPRK-së, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje të Rëndë në kundërshtim me nenin 147 (3) dhe (9) lidhur me nenin 25 të Kodit të Përkohshëm Penal.

Kjo gjykatë ka vlerësuar se me veprimet e lartcekura të të akuzuarit, i njëjti ka kryer veprën penale Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje të Rëndë në kundërshtim me nenin 147 (3) dhe (9) të Kodit të Përkohshëm Penal, dhe pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës, e shpalli fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi sanksionin penal

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 64 të Kodit të Përkohshëm Penal (Kodi R.2003/25) tutje (KPK), ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Kjo gjykatë nuk kishte gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht lehtësuese me rastin e matjes së dënimit në rastin konkret.

Si rrethana rënduese kjo gjykatë ka marr për bazë sjelljen e mëparshme të kryerësi ndaj tani të dëmtuarit, si dhe faktin se vrasja ishte e planifikuar.

Kjo gjykatë nuk ka marr për bazë rrethana të tjera, për faktin se rrethanat e tjera veç se janë të inkorporuara në elementet e veprës penale, për çka edhe dënimet janë më të larta.

Gjykata ka bindje se me këtë dënim, respektivisht dënimin me burgim të përcaktuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, në këtë rast i akuzuari E.S do ta kuptojë rëndësinë e veprës penale dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen të mos shkaktojë veprime të ndaluara e çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 34 i KPK-së. Gjykata ka bindjen së një dënim i tillë

është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit dhe se gjykata vlerëson se me dënimi e lartcekur me burgim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 34 të KPK-së.

Llogaritja e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin shqiptuar

Neni 73 paragrafi 1 i Kodit të Përkohshëm është përcaktuar se: “*Koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo periudhë e heqjes nga liria lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, me burgim afatgjatë dhe me dënim me gjobë*”. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, gjykata ka bërë llogaritjen e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit për të akuzuarin E.S, ku koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga nga data 03.01.2014 deri më datën 15.10.2021, dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 15.10.2021 deri më datën 09.02.2024, si dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 23.02.2024 deri më datë 03.05.2024 të cilat data do t’i llogariten në dënimin e lartcekur.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, ka vendosur në kuptim të nenit 452 paragrafi 1 i KPPRK-së. Në këtë drejtim, gjykata e obligoi të akuzuarin që konform nenit 449 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së, të paguaj shumën prej **150€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**, në emër të paushallit gjyqësor. Po ashtu, **konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.05/L-036** për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej **50€ (pesëdhjetë euro)**, në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me shpenzimet tjera eventuale gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas përllogaritjeve të kësaj gjykate.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata të dëmtuarin Sh.R në bazë të nenit në bazë të nenit 462 paragrafi 1 të KPP-së, e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 360 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJKYATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.170/20 datë 02.08.2024

Gjyqtari

Ngadhnjim Arrni

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë